

Oral History Kosovo

INTERVISTË ME NUHI BYTYÇIN

Prishtinë | Data: 14 dhe 15 dhjetor, 2021

Kohëzgjatja: 372 minuta

Të pranishëm:

1. Nuhi Bytyçi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Nëse mundeni me u prezantu, me na jep ni biografi t'shkurtë t'jujën, diçka për familjen, prejardhjen?

Nuhi Bytyçi: Po. Unë jam Nuhi Bytyçi, gazetar i karrierës. Jam i lindur me 17 gusht të vitit 1955 në fshatin Shkozë të Malishevës. Si t'gjithë fmitë e asaj periudhe jemi rritur në kushte të vështira, mirëpo vullneti për mësim dhe për përsperitet ka qenë i jashtëzakonshëm, i pa përshkruar. Ne si ni familje të madhe me xhaxhallarët kemi qenë... unë jom fmija ma i madh i babës Malush dhe nanës Qamile. Nga fmitë e xhaxhallarëve tjerë djali i axhës Alush, Limani, ka qenë ma i madh se unë edhe dada Selë, motra e tij. Kurse, do të thotë, pastaj unë jam ma i madhi prej fmive të babës Malush dhe nënës Qamile.

Ndërkohë familja u zgjerua, fmitë e axhës Sadik, axhës Bajrush e kshtu me radhë. Kshtuqë kemi arritë n'atë kohë deri në 40 anëtarë. Po tani jemi familje ma e madhe se janë rritë shumë djemtë e xhaxhallarëve. Janë martuar, kanë nipa, kanë mbesa dhe jemi një familje shumë shumë e madhe. Mirëpo n'atë periudhë edhe pse kemi qenë n'bashkësi familjare përkushtimi për krijimin e kushteve që ne si fmi të shkollohemi ka qenë i madh. Unë mbaj mend klasën e parë kom qenë në fshatin Shkozë deri në klasën e katërt. Msusi im i parë ka qenë Gani Bytyçi nga ni fshat i komunës së Suharekës. Pastaj ka qenë disa msus tjerë, Avdullah Vuqetaj nga Vuthaj i Vuthaj të Plavës atje e të Gucisë e kshtu msus të tjerë.

Kurse, shkollën fillore prej klasës të katërt deri në klasën e tetë e kom mbaru në fshatin Dragobil, katër kilometra nga fshati jonë. Çdo ditë mbaj mend kemi udhëtue këmbë deri në Dragobil. Tetë kilometra vajtje dhe ardhje. Gjatë dimrit n'atë kohë binte borë më shumë se tani, deri në ni metër. Kshtuqë nuk ka pasë as mekanizma për ta tërhequr borën, larguar borën. Ne si fmi jemi zgjuar herët dhe kemi qenë ata t'parët që kemi hapë rrugën. Shumica prej nesh nuk kishim as qizme por vullneti ynë ishte i madh për të mësuar, për të fituar dije e kshtu me radhë.

Anita Susuri: Deshta pak me ju pytë për familjen. Thatë që keni jetu në bashkësi edhe n'atë kohë, po m'dukët, shumica e familjeve kanë jetu në bashkësi...

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: Si është organizu familja juaj?

Nuhi Bytyçi: Po kshu tash, axha Alush ka qenë ma i madhi ka qenë i zoti i shtëpisë. Ai ka menaxhu familjen, i ka caktu detyrat secili me çka m'u marrë. Babai im ka qenë i dyti me radhë dhe ai ka qenë murator. Kshuqë ka qenë nifar' lloj bartësi i sigurimit të ekzistencës të familjes. Pastaj edhe axha Sadik po ashtu ka qenë murator. Kurse axha Bajrush ka qenë i angazhuar për punët e shtëpisë për m'i mbjellë arat, m'i korrë arat, m'i siguru drutë e puntë tjera që ka nevojë shtëpia.

Ne si fmi kemi kry ndonjë detyrë të vogël, aq sa kemi pasë mundësi krahas angazhimit në msim. Të gjithë... djali i axhës Alush, Limani, po ashtu ka qenë edhe ai murator i dalluar, i shquat në atë trevë. Sepse n'atë kohë është punuar kryesisht me gur edhe ata kanë punuar në fshatrat e Gorës, Opojës, të Hasit. Kryesisht n'atë pjesë po edhe në komunën e Gjakovës kanë punu, ndërtu n'atë kohë. Unë mbaj mend si fmi kom qenë disa herë i kom vizituar, m'ka interesu vetëm m'i pa. Kom qenë n'ato fshatrat e Gorës. E mbaj mend fshatin Orqushë, kufi me Shqipëri. Kisha qef m'i pa malet e Shqipërisë. Ka qenë ni përjetim i veçantë për mua si fmi.

Kshu do të thotë në familjen tonë ka qenë ni harmoni se secili ka punuar sa ka pasë mundësi edhe sa ka ditur. Ka qenë ni, ni vullnet i madh për të kontribuar secili n'atë mënyrën e vet për ekzistencën e familjes për perspektivitetin e familjes. Mbaj mend se n'atë kohë kanë qenë kushtet e vështira për punë mirëpo baba edhe xhaxhallarët kanë punu në mënyrë intenzive dhe kanë siguruar një pjesë t'madhe t'hollave. Ka qenë mungesa e tokës pjellore dhe kanë shpenzuar shumë para për të blerë tokë në mënyrë që të sigurohet një ekzistencë më të sigurt të familjes.

Anita Susuri: A ju kujtohet shpija juaj si ka qenë?

Nuhi Bytyçi: Po, ka qenë ni shpi bukur e madhe, ka qenë 30 metra gati, kshuqë dy kat edhe ni kat ka qenë ahri. Përmi ahër ka qenë, n'atë kohë zakonisht i bojshim odat, odat e burrave. Mbaj mend kur në odën tonë vishin shumë pleq nga t'gjitha viset e Kosovës, miq të familjes tonë. Ka pasë miq edhe nga Negrovci i Drenasit, pastaj nga Drenoci i Zatriçit, nga Mirusha dajhtë e mi i kom në Mirushë. Dajhtë e babës në Carallukë të Malishevës.

Mbaj mend dajën Hamëz i cili vinte shpesh për t'na vizituar edhe ka qenë ni kohë ka qenë edhe në Shqipëri, ka qëndruar si kaçak me bashkë luftëtarët e tij. Se kemi pasë lidhje me familjen e Alush Smajlit, daja i gjyshës. Kshuqë kanë ardhë edhe miq të familjeve tjera nga Pagarusha, nga Zatriçi, nga Prizreni, nga fshatrat e Llapushës, Drenicë kryesisht, nga Dragobili po. Familja e Demir Paqarizit, Isuf Paqarizit, Qazim Paqarizit e të tjerë.

Anita Susuri: Çfarë tradita për shembull keni pasë n'familje që, domethonë, ndoshta veç ju prej familjeve tjera ose që ka qenë traditë e ngjashme?

Nuhi Bytyçi: Nuk ka pasë shumë dallime t'mdha n'atë periudhë. Ekonomikisht kemi qëndruar dobët, thashë që, marrë me zejen e muratorit edhe ekzistenca nuk ka qenë fare n'pytje. Traditat kanë qenë

n'atë kohë që burrat kanë qenë, kanë qëndru n'odë kurse gratë kanë qenë në shtëpi. Vinin shumë mysafir edhe rrinin me dy-tre ditë. Vishin nga Negrovci i Drenasit për ni ditë kërkush s'vinte, se n'atë kohë edhe fqinjët i merrshin mysafirët tanë për shembull. Vishin mysafirt janë ardhë te na, vishin fqinjët aty me bisedu. Ishin biseda shumë interesante për ne fmitë n'atë kohë.

Kryesisht flitej për rezistencën e popullit tonë në periudha të ndryshme të historisë. Gjithë synonim se si të realizohet, t'punohet ma tepër për realizimin e ni lirie t'plotë. Sepse n'ato rrethana, sipas rrëfimeve të pleqve, unë kom lind në vitin '55 kurse n'vitin '56 rrëfejnë se ka qenë aksioni famkeq i armëve në kohën e Rankoviqit. Edhe si t'gjithë Kosova edhe n'fshatin tonë ka pasë malltretime të qytetarëve për t'i dorëzuar armët edhe ato armë që nuk i kishin ishin detyruar t'i blinin dikund edhe kshtu. Kshtu ka qenë ni peripeti e jashtëzakonshme edhe të banorëve të fshatit Shkozë.

Mbaj mend Mulla Ademi ka qenë ni hoxhë atdhetar, i cili ka qenë i njohur që ka marrë pjesë në lufrat në Kollashin, në Mal të Zi e tjerë, për Shqipërinë etnike. Aty ka qenë edhe gjyshi im, Sefe Nuha i cili me 15 bashkë luftëtarët e tjerë të Shkozës ka marrë pjesë për Shqipërinë në luftë, për Shqipërinë etnike. Si dihet n'atë luftë kanë marrë pjesë edhe qytetarët e viseve tjera shqiptare. Dua t'them se fshati ynë ka qenë ni fshat malor, n'atë kohë ka qenë pothuajse i izoluar nga Malisheva dhe nga Rahoveci. Nuk ka pasë rrugë të asfaltuar, ka qenë problem edhe uji për banorët e ktij fshati.

Si familje ne nuk kemi pasë problem me ujë sepse gjyshi im ka jetuar përpara në krye të fshatit, në lagjen e mjekëve. Se lagja jonë është lagje e mjekve se t'parët tanë kanë qenë mjek popullor. Kanë mjekuar edhe Isa Boletinin edhe luftëtarë tjerë. Kshtuqë ka qenë ni problem për banorët e fshatit sigurimi i ujit. Mbaj mend që thojnë kanë bajt edhe me gomar edhe me kali edhe n'shpinë e qysh kanë mujt edhe për me pi edhe për nevoja tjera familjare.

Pastaj, n'vitin '50 kanë dalë nga lagja jonë janë shpërngulë aty në jug të fshatit, ku ka pasë mundësi t'sigurohet uji. Kanë hapur ni pus edhe nuk kanë pasë pastaj problem për ujë. Kushtet kanë qenë të tilla në shumicën e fshatrave të Malishevës dhe të Kosovës. Serbia nuk ka investuar në ngritjen e infrastrukturës për banorët e fshatrave ku kanë jetuar shqiptarët.

Anita Susuri: E përmendet thatë që keni qenë si fshat me mjek popullor, nëse mundeni pak ma shumë me na tregu për kta?

Nuhi Bytyçi: Po disa prej paraardhësve tanë janë marrë me mjekësi popullore sepse atëherë nuk ka pasë mjek t'shkolluar. Kam dëgjuar që Liman Mjeku është marrë me mjekësinë popullore. Dikush nëse e ka thy dorën ose kambën ose ka pasë ndonjë aktident tjetër, janë mundu me ia dhanë ndihmën e parë edhe m'i ndihmu që mos të vdesë nga ndonjë ndihmë elementare. Kom dëgju që kanë mjeku edhe Isa Boletinin edhe shumë atdhetar tjerë.

Anita Susuri: Thatë që në shkollën fillore keni pasë shumë larg edhe keni pasë problem udhëtimin, çfarë probleme tjera jeni ballafaqu? Për shembull, a keni pasë libra? A keni pasë aktivitete jashtë shkollës?

Nuhi Bytyçi: Po. Libra ka pasë relativisht, nuk ka qenë problem mungesa e librave. Thashë meqenëse si familje nuk i kemi pasë gjendjen e vështirë materiale, për libra s'ka pasë problem. Fletore po ashtu, lapsa po kemi pasë. Probleme tjera kanë qenë më shumë të natyrës, si t'them, te shumë fmi tjerë nuk i kanë pasë kushtet. Fmitë e tjerë s'i kanë pasë kushtet. Ashtuqë edhe prindt tanë kanë ba përpjekje që t'mos ketë diferenca t'mdha që unë me pasë e shoku jem mos me pasë.

Unë n'atë kohë shok t'bankës e kom pasë Ymer Hoxhën i cili ka qenë i ni lagje tjetër aty po t'gjithë jemi t'ni fisi Bytyç. Ai e ka marrë mbiemrin në bazë të babës që ka pasë hoxhë. Kemi qenë t'pandashëm edhe n'shollë fillore edhe n'shollë t'mesme në Prizren, në gjimnaz të Prizrenit. Pastaj edhe në studime në Prishtinë. Kshtuqë atë e kom pasë shokun ma t'ngushtë të fëmijërisë time edhe të rinisë time edhe ma vonë edhe tani e kom shok. Kshtuqë me të kemi qenë t'pandashëm.

Në fshat ka ardhë te unë n'shpi n'odë edhe unë kom shku n'odën e tyne kom fjet atje. Kemi pasë ni raport t'mirë. Familja imja me familjen e Mulla Ademit ka pasë ni raport shumë të mirë. N'kohë t'vështira... ka qëndru ni kohë në malet e Shkozës edhe familja ime edhe shumë familje tjera i kanë ndihmuar që të jetë më i sigurt që mos të zihet nga policia serbe.

Anita Susuri: M'tregut ma herët që ka pasë shkollë edhe në Rahovec po keni pasë qef me vazhdu në Prizren shkollimin...

Nuhi Bytyçi: Po në Dragobil t'them tash para se me kalu në Prizren. Në Dragobil kanë qenë shumë arsimtar t'mirë, drejtor t'mirë. Ka qenë, mbaj mend, drejtor i shkollës ishte atëherë Eshref Paqarizi edhe ka qenë edhe arsimtar i gjuhës dhe letërsis shqipe Ilaz Paqarizi, Banush Krasniqi dhe shumë arsimtar tjerë të cilët me ni vullnet t'madh e kanë kry detyrën e vet dhe kanë qenë shumë t'afërt me ne. Na kanë dashur si fmitë tanë. Ne kemi respektuar ata po ashtu.

Mbj mend kur vishim nga Shkoza në Dragobil këmbët u lafshin edhe rrobat edhe qizmet plastike që kemi pasë atëherë. Kshtuqë na kanë ndihmuar që të teremi aty pranë stufës me dru ka qenë stufa, me dru n'atë periudhë. Na kanë përkrah shumë n'atë periudhë. Pastaj, kur mbarova shkollën fillore dëshira ime si fmi ishte që mos të rrij aty në provincë tem, as në Malishevë as në Rahovec. Në Rahovec ekzistonte gjimnazi n'atë periudhë edhe nuk e kishim shumë larg po duhej me udhëtu n'kamë meqë autobusa s'kishte drejtpërdrejt nga fshati jonë.

Unë ju luta xhaxhallarët edhe babën thashë, "A ka mundësi që unë t'shkoj në Prizren se atje janë kushtet ma t'mira me gjetë ni banesë me qera edhe atje me banu edhe atje me vazhdu mësimet?" Kshtuqë ata e përkrahën idenë time. Xhaxha Alush ma i madhi e ka përkrahë, m'ka përkrahë shumë edhe me dadën Zarife edhe me axhën Sadik, axhën Bajrush. Edhe baba pastaj e kishte ma lehtë që me m'përkrahë. Po meqenëse xhaxha Alush ishte ma i madhi, u dufke me marrë pëlqimin e tij patjetër. Ai nuk kishte asni rezervë, se ishte dëshira e madhe që ne si fmi... kshtu gjatë tërë jetës m'kanë përkrahë vazhdimisht.

Në Prizren kam shkuar, mbaj mend, djali i axhës Alush Limani m'ka qit' deri në autobus në Rahovec këmbë bjeshkëve të Rahovecit, të Shkozës. Kur jom hyp në autobus kom shku në Prizren edhe nuk e kom ditë as ku është gjimnazi. Kom pytë. Aty kom taku në autobus banor të Rogovës së Hasit. Thashë, "A bon me m'tregu ku osht' gjimnazi? Se po du m'u regjistru". Kisha marrë dokumentat me veti. Kom shku n'gjimnaz, m'ka tregu. Kom shku n'gjimnaz i kom paraqit dokumentet edhe m'kanë pranë. Nuk kishte problem atëherë. Kishte mjaft vende t'lira.

Mbay mend klasën e parë kemi qenë kryesisht nxanës të fshatrave të Prizrenit, të Rahovecit, të Suharekës, fshatra tjera. Kujdestar e kemi pasë Esat Haskukën, ka qenë profesor i historisë. Ni njeri i mirë, pedagog i mirë. Na ka respektuar si fëmijët e vet edhe ne e kemi respektuar atë. Pastaj kemi pasë shumë profesor t'mirë Qazim Berishën, ka qenë profesor i njohur i frengjishtës edhe i latinishtës. Pastaj në vitin e dytë, drejtimi, janë nda drejtimi shoqnor edhe shkenca natyrore. Unë jom përcaktu për drejtimin shoqëror bashkë me Ymer Hoxhën. Kemi qenë ni klasë edhe ni bankë.

Kështu që kujdestar klase kemi pasë profesorin e historisë Habib Ahmetin nga Kërçova. Të cilin e respektoj, osht' gjallë. Shihemi shpesh në Prizren kur vizitoj Prizrenin, kur vizitoj Ymer Hoxhën dhe shoktë e tjerë. Kemi pasë profesor të mirë po ashtu Azem Mazrekaj profesor i gjuhës dhe letërsisë i cili m'ka përkrahë shumë, dhe Sabri Bresën. Ka qenë drejtor i shkollës n'atë kohë Luigj Lumezi, edhe ai m'ka përkrahë shumë. Se unë kom qenë kryetar i klubit letrat të shkollës të gjimnazit edhe kryeredaktor i Revistës shkollore Jehona. Pa përkrahjen e profesorit Azem edhe profesorit Luigj nuk kisha mujtë gjitha kto aktivitete dhe suksese m'i arritë.

Kshtuqë që në atë periudhë kom fillu m'u marrë me shkrime, me poezi edhe ktu m'ka motivu edhe bashkëvendasi im Shaip Hoxha. I cili ka qenë ni gjeneratë a dy para meje edhe u marrë me shkrime. Ka qenë poet i ri edhe ai m'ka motivu, m'ka inkurajë që edhe unë t'merrem me shkrime. Kam fillu t'i botoj disa shkrime edhe në Gazetën e atëhershme Rilindja, në Zëri të Rinisë, në Revistën Shkëndija, Fjala, Kosovarja dhe kshtu në revista të asaj kohe.

Anita Susuri: Cili gjimnaz ka qenë...

Nuhi Bytyçi: Gjimnazi Gjon Buzuku.

Anita Susuri: Gjon Buzuku që osht' sot...

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: Në Prizren ku keni banu?

Nuhi Bytyçi: Në vitin e parë kemi banu aty afër gjimnazit, te ni familje që e ka pasë lidhje familjare Ymer Hoxha, vllaznit e Ymer Hoxhës, Avdullahu. Ka qenë familje, msusi i cili kishte vdekur, po ia harroj edhe emrin tani, ka qenë Bytyçi po jo nga fshati jonë, nga fshati i Prizrenit aty. Kemi kalu mirë aty n'vitin e parë. Pastaj vitin e dytë familja e Ymerit është shpërngulë nga fshati Shkozë në Arbanë edhe ka ndërtu shtëpinë.

Ymeri ka kalu në shtëpinë e vet unë kam kalu bashkë me nipin tim, Agim Paqarizi me ni banesë tjetër afër stacionit të autobusave aty. Deri në mbarimin e gjimnazit aty kemi qenë s'bashku me Agimin, t'cilin kom pasë nip, djalë të hallës dhe kemi qenë të pandashëm me të.

Anita Susuri: E përveç shkollimit, a ka pasë aktivitet tjetër që keni zhvillu ose a keni dalë? A keni shiju si i ri qytetin?

Nuhi Bytyçi: Po n'qytet kemi dalë vazhdimisht, kemi dalë në shadervan aty ato korzo në mramje ka qenë n'atë kohë shumë të përhapura. Kemi... kanë qenë ato ëmbëltoreset e njohura të Prizrenit me tullumba, me sutlijasha edhe kshtu gjelltoreset popullore të Zhurit. Ni kohë jom ushqy në gjelltoreset e familjes Ademaj, Selam Ademaj në Prizren. Kanë pasë ni gjelltoreset popullore aty, unë shkojsa, hajsha gjithmonë ushqehesha aty. Axha Sadik vinte i pagunte pastaj aty. Qashtu ka qenë n'atë kohë.

Ishte lehtësi për mu mos me hup kohë me përgatitë ushqimin n'banesë. Se ni kohë n'vit t'parë kemi përgatitë me Ymerin bashkarisht ose kemi hangër qebapa ose gjella tjera. Mirëpo aty ka qenë përparësi e madhe që gjelltoreset... Selami ka qenë ni burrë i mirë, m'ka përkrahë edhe vinte shpesh edhe profesori Ademaj, vllau i tij, Sinani aty. Mbaj mend ka qenë n'atë kohë student i dalluar edhe n'atë, me ata njerëz kemi kaluar shumë mirë. Kemi pasë ni respekt të ndërsjelltë.

Anita Susuri: Qysh ka qenë qyteti n'atë kohë? Nëse mundeni me na përshkru pak? Atmosfera e qytetit?

Nuhi Bytyçi: Po qyteti ka qenë... Prizreni siç dihet qytet shumë i lashtë. Kemi shëtitë aty te Lidhja Shqiptare e Prizrenit, pastaj në kala edhe në Marash edhe pjestë tjera të qytetit t'cilat kanë qenë shumë atraktive për ne si të rinjë. Njerëzit e Prizrenit kanë qenë njerëz t'butë, njerëz t'qetë, njerëz t'afërt. Po n'atë kohë, n'atë kohë m'pengonte pak që përdorej shumë gjuha turke edhe ata që nuk ishin turk e përdorshin, sidomos ata nga Opoja kur vinin në Prizren. Për mos me ju thanë çyli flisnin turqisht. Por, me rëndësi që edhe unë i kam mësu disa fjalë n'atë kohë të turqishtes.

Ajo ishte ni atmosferë që në kohën të përvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit edhe kur botoheshin shumë libra për Skënderbeun edhe për heriozmin e tij, ne kishim rastin që për ato ngjarje të mësonim edhe nga profesori i historisë, Habib Ahmeti. Unë nga Prizreni kom shku disa herë në Prishtinë, kom udhëtu me autobus kom shku në Prishtinë në redaksinë e Rilindjes edhe të Zërit të Rinisë për m'i dërgu punimet, disa poezi, shkrime t'mija, informata, reportazhe t'mia që i kom shkru dhe m'i botonin. Ishte ni motivim i madh për mua sepse pa përkrahjen e kolegëve të Rilindjes dhe Zërit, Shkëndijes e tjera nuk do t'kisha mujtë me arritë të bëhem gazetar.

Anita Susuri: Qysh ju ka dokë kjo, po mendoj që ka qenë hera e parë që keni udhëtu ndoshta në Prishtinë a po?

Nuhi Bytyçi: Po, ashtu ashtu.

Anita Susuri: Qysh e keni pa Prishtinën n'krahasim edhe me fshatin po edhe Prizrenin?

Nuhi Bytyçi: Po Prishtina megjithatë ishte, ishte kryeqyteti i Kosovës edhe ishte ma i zhvilluar sesa Prizreni. Po Prizreni i kishte ato veçoritë tjera. Kishte lumin n'mes, kishte gjelbrim, kishte ni tjetër urbanistik. Ishte shumë ma tërheqës Prizreni. Po Prishtina m'u dukej atraktive. Unë kom ardhë ktu ka qenë Rilindja e vjetër, afër, afër kto Xhamisë të Madhe në Prishtinë. Aty ka qenë zyret e Rilindjes ka qenë shtypshkronja e vjetër me plumb.

Mbaj mend aty ato kolegët e Rilindjes shpesh që ndaq m'i pa qysh shtypej gazeta i radhisshin me dorë. Ka qenë teknologji shumë e vjetruar. Po mu m'bonte shumë përshtypje se si po arrijnë secilën shkronjë me dorë me radhitë. Ishte punë shumë e mundimshme në krahasim me tash qysh ka mbërri teknologjia informative dhe teknologjia në përgjithësi për shtypin e gazetave, librave e tjera e tjera.

Anita Susuri: M'tregut që keni qenë i interesun për me shkru edhe keni pasë dëshirë edhe jeni marrë gjatë shkollës me shkrime...

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: Po gjithashtu lexova që ka qenë si ni lloj, jo t'them rastësie, po ka ndodhë, ju ka ardhë posta...

Nuhi Bytyçi: Po, po. Tani unë në vitin '74 kom mbaru gjimnazin në Prizren, në vjeshtë. Në '74-ten u pata regjistru në Prishtinë, në Universitetin e Prishtinës. Dëshira ime ishte që të studioj gazetarinë, n'atë kohë ishte hapur për herë t'parë dega gazetari diplomaci në kuadër të Fakultetit Juridik. Mirëpo nuk arrita t'regjistrohem, ishte konkurrencë e madhe, nuk e di. Nuk arrita të regjistrohem. Nuk kisha asni familjar timin, asni vendas timin që t'më ndihmonte n'atë drejtim. Se ni ndihmë e vogël ndoshta do të më kontribonte që të regjistrohem.

Kshtuqë u detyrova të regjistrohem në Fakultetin Filologjik, Filozofik atëherë i thojshin në degën e letërsisë dhe gjuhës shqipe. Pastaj, u shpall ni konkurs për gazetar dhe anëtarë të redaksisë, të redaksisë studentore të Universitetit të Prishtinës Bota e Re. Unë meqenëse kisha shumë shkrime të botuara në revista të asaj kohe, konsiderova se do t'ishte ni shansë e mirë që të pranohem.

Aplikova në konkursin e kësaj redaksie dhe pas ni interviste me komisionin n'atë kohë dhe pas përkrahjes që kisha edhe nga Daut Demaku dhe nga Zeqir Gërvalla dhe nga Gani Ademi edhe disa që kishin qenë në krye të asaj gazete n'atë kohë jom pranuar bashkë me Mehmet Krajën. I cili Mehmet Kraja ka qenë n'atë kohë kryeredaktor, u zgjedhë kryeredaktor i gazetës. Skender Zogaj u zgjedhë redaktor i gazetës, unë anëtar i redaksisë. Narkize Kelmendi, Nazmi Misini, Samine Cana, Avdyl Krasniqi e kshtu me radhë jemi zgjedhë anëtarë të redaksisë dhe kemi bashkëpunuar për nxjerren e gazetës.

Duhet t'them se n'atë kohë në lokale të redaksisë tonë të cilat kanë qenë afër Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës aty ka qenë ni pavijon, si i thojshin atëherë. Kanë ardhë edhe atdhetarët e shquar gazetarë. Gazetari i Rilindjes n'atë kohë Jusuf Gërvalla. Pastaj ka qenë Kadri, Kadri Rexha. Ka

qenë miku i Mehmet Krajës. Pastaj kanë ardhë edhe Daut Demaku. Përpara ka qenë kryeredaktor i gazetës. Ka ardhë ka vizituar shpesh. Arif Demolli, Bajram Krasniqi edhe shumë e shumë gazetar me përvojë të Rilindjes me të cilët kemi bashkëpunuar në mënyrë intensive.

Mbaj mend sidomos përkrahjen e madhe të Zeqir Gërvallës. Ka qenë njeri i mirë, poet, atdhetar, bashkë veprimtar i Adem Demaçit. I cili na përkrahte neve t'rive edhe ne respektonim bacën Zeqë si e quanim atëherë, edhe ai na respektonte neve. Po ndërkohë unë e kreu vitin e parë të studimeve edhe edhe u angazhova si msus në fshat. Klasën e pestë. U hap klasa e pestë në fshat dhe unë e mora si kujdestar i klasës të pestë. Shtator '75-ten. Ndërkohë u shpall ni konkurs për gazetar në Televizionin e Prishtinës, ka qenë televizion i ri, medium i ri. Gazetar fillestar.

N'atë kohë nuk kërkohej fakulteti, kërkohej shkolla e mesme s'paku edhe meqenëse unë kisha edhe përvojë edhe shkrime t'botuara edhe dashuri për gazetarinë, aplikova në konkurs. Por fillova msimin atje n'fshat edhe ni ditë postieri e sjell postën n'fshat edhe më erdh edhe ftesa për me marrë pjesë në testim për gazetar. Kur e shoh datën, kishte kalu si me thanë dje ishte mbajtë testimi. Thashë, m'paska humb shansa për me shku me marrë pjesë n'testim. Mirëpo gjithmonë nuk jom dorëzu para sfidave dhe thashë t'provoj t'shkoj në Prishtinë t'ju tregoj që posta m'ka ardhë me vonesë që t'ka mirëkuptim t'hyj në testim. Jom i gatshëm me iu ushtru atyne kushteve të konkursit.

Kshtu kom hy në testim. M'kujtohet Qenan Shaipi ka qenë redaktor përgjegjës i programit informativ të Televizionit të Prishtinës. Ai hyni me ni zyre tjetër edhe n'atë kohë ishte edhe Bitulla Sokoli nga Rahoveci, edhe ai kishte marrë ftesën me vonesë. Bashkë kemi hy aty. Na tha Qenani që, 'Ni lajm, ni reportazh edhe ni shkrim tjetër me ba', me shiku a kemi përvojë, a kemi dije për m'u bo gazetar të televizionit. Kshtuqë ne i plotësum ato kërkesat e Qenanit dhe pas disa dite na shkum atje, u interesum se s'kishte atëherë telefona mobil.

Shkum u interesum, 'A i keni lexu ato punimet, shkrimet tona?' Qenani na tha që, 'Ju jeni pranuar gazetar fillestar'. Pas ni kohe kemi filluar punën. Meqenëse ka qenë fillimi i vitit të ri akademik tetor, m'kanë caktu në kuadër të rubrikës së kulturës që ta përgatis ni storie, ni kronik për fillimin e vitit të ri akademik të Universitetit të Prishtinës. M'kujtohet me kameramanin Azis Krasniqin kemi shkuar për t'i xhiruar fakultetet e Universitetit të Prishtinës. Unë e kom ba ni tekst edhe ma ka redaktuar redaktori i atëhershëm i kulturës Ali Lluni.

Aliu m'ka përkrahë edhe m'ka thënë se me ni angazhim ma t'madh, ni përkushtim ma t'madh mund të bëhem gazetar. Kshtuqë ai m'ka ndihmuar bashkë me kolegët tjerë Zenun Rexhepin, Muhamet Mjekun, Ali Alën dhe kemi bashkëpunu ni kohë t'gjatë. Pastaj kom marrë vendimin për gazetar i rregullt në Televizionin e Prishtinës. Mirëpo meqenëse Qenani shkoj për të raportuar nga vizita e kryetarit të atëhershëm të Jugosllavisë Titos në Meksisë, e pati fatkeqësinë dhe vdiq në Meksikë. Ishte hyrë në deti për t'u larë dhe fati deshti që të mbytej atje, ishte ni ngjarje tragjike për kolegët e Televizionit të Prishtinës.

N'vend të Qenanit erdh shef i programit informativ Qemajl Hasani. I cili ishte ni njeri shumë i mirë, njeri i respektueshëm, bashkëpunues edhe ai më ndihmoj që ta marrë vendimin e rregullt si gazetar me kontratë të rregulltë. Derisa u bë vendimi ktu, unë pata apliku ni konkurs të Rilindjes për gazetar. Meqenëse thashë po shtyhet shumë marrja e vendimit edhe aplikova. M'pranun në atë konkursin e Rilindjes. Gazetar bashkë me Hydajet Hysenin, Berat Luzhën, Gani Molliqin dhe disa koleg të tjerë të cilët kanë punuar në Rilindje.

Unë mas ni muji e gjysë ma lshun vendimin në televizion dhe unë e lash Rilindjen. Sepse televizioni ishte shumë më atraktiv, jo pse ishin t'ardhurat t'mirat po ishte për neve t'ritë, gazetarët e rinj, ishte ma atraktiv. Unë e doja shumë gazetarinë dhe aty m'u dha shansa që të bëhem gazetar dhe tërë jetën time dhe karrierën time ta përfundoj si gazetar pikërisht në Televizionin e Prishtinës në Radio Televizionin e Kosovës tani.

Anita Susuri: Keni fillu me punu si gazetar po punën si msus e keni lanë atje a po?

Nuhi Bytyçi: Po, po patjetër.

Anita Susuri: E në fshat, cili fshat ka qenë?

Nuhi Bytyçi: Në Shkozë.

Anita Susuri: E pastaj në Prishtinë ju kur keni jetu, jeni shkollu, keni punu. Keni jetu në konvikte diku apo privat?

Nuhi Bytyçi: Po vitin e parë kom qenë n'konvikt, pavilon. Vitin e dytë kom qenë në konviktin numër tre. Sepse kom qenë edhe kryetar i rinisë grupit letërsi dhe gjuhë shqipe në kuadër të fakultetit dhe unë bashkë me disa koleg tjerë, me Shaip Hasanin, i cili ka qenë kryetar i rinisë të krejt fakultetit. Kadri Metaj ka qenë për filozofi-sociologji. Beqir Sadiku, Mehmet Sadiku e disa koleg tjerë kemi qenë udhëheqës të rinisë në kuadër të fakultetit. Ne kemi qenë n'komision që kemi nda konviktet.

Normalisht që neve ma së pari na ka taku nga ni shtrat. Aty në ni dhomë gasonjere e kom marrë edhe Ymerin, Ymer Hoxhën. Jo që s'i ka pasë kushtet Ymeri po kemi qenë shokë t'mirë edhe kom dashtë bashkë t'jemi. Ai ka qenë aty me mu ni vit në konviktin numër tre. Pastaj unë, meqenëse kom punu gazetar i rregullt atëherë kom kalu në banesë private.

Anita Susuri: A ka qenë vështirë edhe mësimi edhe me punu...

Nuhi Bytyçi: Shumë vështirë ka qenë, shumë vështirë. Kshtuqë unë ndërpreva studimet tash u dufke angazhim i përhershëm, i vazhdueshëm. Angazhim i madh. Me dalë në teren, m'i përcjellë ngjarjet, me bo kroniken, me montu pastaj ma vonë edhe n'televizion. Kshtuqë ishte e pamundur me arritë m'i kry me kohë studimet. Kshtuqë m'vijke keq me shku pa përgatitë te profesorat. Tash isha gazetar, figurë publike edhe ishte shumë vështirë me shku pa përgatitë aty. Kshtuqë unë i ndërpreva studimet letërsi.

Ma vonë ndërkohë kom regjistru kshtu, m'u doke ma lehtë, studimet e agronomisë, bujqësisë edhe herë pas here, pas disa viteve i kom mbaru ato. Kshtu pas luftës nga dëshira e madhe që të studioj gazetarinë, kom regjistru studimet master në Universitetin AAB dhe bashkë me disa koleg tjerë me Ilire Zajmin, me Mentor Shalën, me Xhymret Veliun, me Ridvan Berishën dhe shumë koleg tjerë kemi mbarur studimet master. Kemi qenë ndër gjeneratat ma të suksesshme të asaj periudhe.

Anita Susuri: Kohën kur keni fillu me punu ka qenë '76-ten u kanë a po?

Nuhi Bytyçi: '75-ten në vjeshtë, vendimin në '76-ten ma kanë lshu, vendimin e përhershëm.

Anita Susuri: Kjo periudhë ka qenë si me thanë pak ma e mirë pozita e Kosovës se u bo kushtetuta '74-ten edhe hapja e universiteteve e kto. Qysh ka qenë krejt atmosfera edhe politike po edhe kulturore, sociale n'atë kohë?

Nuhi Bytyçi: Po osht' e vërtetë që pas miratimit të kushtetutës të vitit '74, Kosova ka fitu ni autonomi më të zgjeruar sesa më parë. Me hapjen e Universitetit të Prishtinës u krijun mundësitë që të shkollohen kuadrat e reja edhe rinia kishte mundësi t'merrte, merrshim atëherë edhe bursa nga Ministria e Arsimit, atëherë BVI-ja për arsim quhej. Kshtuqë kishim ni përkrahje ma t'madhe nga strukturat e atëhershme politike. Kosova mund t'them lirisht se ishte në ni stad ma të lartë të zhvillimit edhe ekonomik edhe shoqëror edhe kulturor. Ndonëse Serbia me mekanizmat e veta kontrollonte çdo sferë të jetës dhe nuk kishte lehtë për kuadrat që udhëheqnin n'atë kohë edhe institucionet.

Mirëpo u kriju ni klimë e avancimit të çështjes së avansimit të Kosovës edhe federatës të atëhershme jugosllave. Unë mbaj mend atëherë si gazetar kom përcjellë shumë ngjarje ekonomike, politike, kulturore e tjera. Ku mjerisht n'atë kohë flitej më shumë në gjuhën serbo-kroate, përkthimi ishte stimulant. Kishte t'drejtë çdo kush të fliste edhe n'gjuhën shqipe normalisht po kryesisht me qenë më lehtë për komunikim reciprok aty, ata flisnin për shkak t'serbëve flisnin serbisht.

E mbaj mend kur kom përcjellë edhe mbledhjet e Qeverisë të atëhershme të Kosovës, i vetmi që ka folë në gjuhën shqipe ka qenë profesori Ukshin Hoti. Ka qenë ministër i punëve të jashtme, sekretar për punë me jasht n'atë kohë quhej. Mu m'linte përshtypje shumë ajo. Në të vërtetë profesori Ukshin u dëshmua se ka qenë ni atdhetar, ni njeri i cili nuk është dorëzuar kurrë para sfidave dhe ka kontribuar që çështja e Kosovës të avancohet dhe t'u bëhet me dije insitucioneve, jo vetëm të federatës po edhe më gjerë t'botës, që Kosova është problem i pa zgjidhur edhe duhet të ketë statusin e republikës.

Që u dëshmua që ai pastaj në vitin '81 bashkë me Ekrem Kryeziun, Mentor Kaçën dhe disa bashkë veprimtar të tjerë, u burgos, u dënua me burg dhe kshtu ai mbetet një ndër figurat e shquara të jetës politike dhe atdhetare të asaj kohe. Dua t'them se Kosova filloj t'i marrë këmbët edhe filloj të përmirësohet struktura racionale e të punësuarve edhe struktura udhëheqëse kombëtare në institucione të ndryshme. Bile ka qenë ni qëndrim n'atë kohë, unë e kom përcjellë mbledhjet e Lidhjes së Komunistëve, sepse atëherë s'ka pasë parti tjera. Lidhja e Komunistëve, Lidhja Socialiste, Sindikatat qito janë kanë sektorët.

Kem pasë të ndame sektorët bashkë me Muhamet Mjekun edhe kolegët e tjerë kemi përcjellë strukturën politike. Mbaj mend që Mahmut Bakalli n'atë kohë si kryetar i komitetit krahinor ka dhënë urdhër t'gjitha komiteteve komunale që të ndikojnë në përmirësimin e strukturës udhëheqëse nacionale të institucionit të fabrikave, të shkollave, të ndërmarrjeve edhe kështu me radhë. Do të thotë u kriju ni frymë e re e ngritjes së zhvillimit, e ngritjes së vetëdijes kombëtare. Filluan që kuadrat që ishin në krye të institucioneve të kontribojnë në këtë drejtim, secili në mënyrën e vet.

Normalisht që Serbia tentonte të bllokonte, t'i bllokonte kto procese. Mirëpo me krijimin e kuadrave të reja në Universitetin e Prishtinës por edhe në Universitetin e Zagrebit por edhe të Beogradit dhe universitete tjera, Kosova filloj t'i marrë këmbët e veta, të ngritet gjithnji edhe më lartë. Ndonëse paknaqësitë e popullit ishin të mdha, sidomos të rinisë, e cila me gjakun e vet rinor nuk pajtohej me tretmanin që kishte Kosova n'atë periudhë dhe kërkonte avancimin e pozitës kushtetuese të Kosovës dhe si dihet demonstratat e vitit '81 ishin kryesisht me kërkesën, 'Kosova Republikë!', që Kosova ta ketë vërtetë statusin Republikë.

Mirëpo Serbia kundërshtonte me ngulm këtë kërkesë dhe si dihet pat' ushtruar dhunë të paparë mbi rininë studentore. N'atë kohë redaktor, rektor i Universitetit të Prishtinës ka qenë akademik Gazmend Zajmi. Ni figurë shumë e përgatitur, ni atdhetar i cili i përkrahte kërkesat e studentëve. Normalisht nuk e thonte publikisht mirëpo ai në takimet e mbyllura me student edhe ma herët edhe sipas informatave t'mija... unë kam marrë pjesë me ni takim kur ka mbajtur rektori Zajmi me studentët bashkë me Pajazit Nushin, i cili po ashtu ka qenë ni atdhetar i shquar. Ai ka qenë nënkryetar i Qeverisë të Kosovës n'atë kohë.

Në takim me studentët te konviktet e studentëve në vitin '81 ku kom qenë edhe unë aty afër, ai ju ka thënë studentëve që, 'Ne jemi duke punuar së bashku me institucionet që kërkesat e juja t'i drejtojmë edhe duhet t'i shqyrtojmë edhe në nivelin e federatës'. Gazmend Zajmi ka qenë ni njeri i cili nuk i ka dënu kurrë demonstratat studentore dhe meqenëse nuk i dënoj, pas kërkesave të vazhdueshme të ish udhëheqjes së atëhershme të Serbisë dhe të Jugosllavisë që ai të distancohet nga kërkesat e studentëve. Ai nuk pranoi të distancohet dhe u detyru që të japë dorëheqje nga pozita e rektorit.

Ndërkohë profesorin Gazmend Zajmi e larguan edhe nga procesi mësimor në Fakultetin Jurifik të Prishtinës. Sepse e konsideronin si frymëzues të studentëve edhe ishte vërtetë ni pozitë shumë të vështirë. Sepse ai n'atë kohë, në vitin '83 u largua bashkë me profesor Fehmi Agani nga procesi mësimor në Universitetin e Prishtinës. Sikurse janë larguar edhe shumë shumë kuadra tjera ma herët dhe janë burgosë dhe janë dënuar dhe larguar nga vendet e punës.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Deshta pak ma subjektiv me qenë ky narracioni ju, me tregu për shembull kur kanë shpërthyer demonstratat...

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: 11 marsi.

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: Si e keni kuptu ju? Si medium a osht' prit që diçka ka me ndodhë? Televizioni ose mediumi, çkado qoftë. Ose edhe në shoqëri ose kudo n'rrethin e juv a osht' ditë që diçka ka me shpërthi? Si osht' prit prej juve? Ku keni qenë ju?

Nuhi Bytyçi: Po mbaj mend kur me 11 mars ka ndodhë demonstratat në Qendrën e Studentëve, te Mensa e Studentëve. N'atë kohë ne si gazetar ka ekzistuar në cenzurë tepër e rrept, sidomos për ngjarje të tilla. Ka qenë e pamundur të t'jipet në lajm real çka ka ndodhë. Bili mbaj mend, unë kam qenë gazetar n'atë kohë, mbaj mend që zakonisht ka qenë në urdhër që t'jepen në komunikata zyrtare nga Tanjugi. Serbisht vishin komunikatat pastaj i përkthenin përkthyesit tanë aty. Do të thotë lajmi i parë osht' dhanë nga, duke cituar Tanjugi.

Na si gazetar nuk kemi pasë asni shansë ma t'vogël për m'i dhënë... edhe ka qenë e ndaluar edhe të xhirohet me kamerë. Ka xhiru vetëm UDB-ja, sigurimi shtetnor. Ka xhiru për nevoja të veta, për me mujt m'i identifikuar ata organizatorët e demonstratave edhe m'i arrestu për m'i dënu, m'i qit' para gjykatës. Do të thotë ne kemi qenë të kontrolluar plotësisht nga, nga pushteti i atëhershëm.

Anita Susuri: M'duket që ka qenë veç në konferencë për media prej Stane Dollanc...

Nuhi Bytyçi: Po ka qenë ajo sigurisht ma vonë ka qenë ma vonë. Unë sa e mbaj mend aty me 13 mars, me 13 mars osht' mbajtë mbledhja komitetit krahinor. Unë kom qenë një nga gazetarët që kam përcjellë atë mbledhje, bashkë me Muhamet Mjekun dhe kolegët e tjerë. Kem qenë n'sallë, se gazetarët e televizionit i kemi pasë kamerat aty edhe ashtu ka qenë si procedurë që gazetarët e Televizionit të Prishtinës të jenë n'sallë, të komunikojnë me kameramanët.

Mbj mend aty kur u paraqit... Mahmut Bakalli ka udhëheq mbledhjen, ka qenë kryetar i komitetit krahinor Mahmuti. Bante përpjekje që t'mos t'i pranonte ato vlerësimet që janë demonstrata armiqësore, nacionaliste, irredentiste. Po munohej që t'i neutralizonte ato vlerësime dhe... sepse ishte i vetëdijshëm për pasojat që do të do t'kishte Kosova nëse pranohej vlerësimi se janë demonstrata armiqësore. Mbj mend aty kur osht' paraqit reni i ditës edhe mbasi osht' miratu reni i ditës Azem Vllasi ka paraqit disa vlerësime t'tij për kërkesat e studentëve. Që kishte qenë Azemi vet, kishte marrë pjesë aty në mesin e studentëve bashkë me disa udhëheqës të asaj kohe.

Azemi tha, "Kom dëgju brohoritje për bashkim, brohoritje tjera, për Kosovën Republikë dihet po edhe për bashkim", tha, "s'pe di bashkim me kond", tha, "duhet me analizu këtë kërkesë ma në detaje". Qerim Gashi m'kujtohet, ka qenë anëtarë i komitetit krahinor, ai u zgju mori fjalën dhe tha, "Ju lutem", tha, "t'kemi kujdes mos t'japim vlerësime t'pamatura, të nxituara sepse pasojat për Kosovën dhe popullin shqiptar do t'jenë shumë t'mdha". Kshtuqë Qerimi kërkonte në maturi ma t'madhe në vlerësimin e kërkesave të rinisë të atëhershme studentore.

Normalisht që pak kush i përkrahte kto publikisht kërkesat. Mirëpo ishte insistimi i Mahmut Bakallit, Qerim Gashit dhe disa pak anëtarë tjerë që mos të nxitohet vlerësimi. Kjo u dëshmu ma vonë se edhe disa shqiptarë t'cilët ishin karrierist edhe t'cilët nxitonin që të zinin pozita t'reja në udhëheqjen e atëhershme të Kosovës, siç ishte Ali Shukriu dhe disa të tjerë, arritën që bashkë me udhëheqjen e atëhershme të Serbisë dhe në pjesë të Jugosllavisë arritën që t'i japin vlerësimet se kto demonstrata janë armiqësore, nacionaliste, irridentiste e kшту me radhë.

Intelektualët ishin n'pozitë shumë të vështirë. Filloj diferencimi neo-politik në universitet, filloj diferencimi në televizion, filloj në Rilindje, filloj në të gjitha institucionet. Ishte në atmosferë shumë e tendosur, ishte në situatë shumë e vështirë që të, publikisht të përkrahen kërkesat e studentëve. Sepse ne intimisht të gjithë i përkrahim mirëpo publikisht ishte e pamundur sepse pasojat ishin t'mdha. Secili do të arrestohej, secili do t'burgosej e nuk ish qëllimi që t'gjithë të burgosemi, t'gjithë të arrestohemi po t'punojmë sa më shumë në afirmimin dhe të arritemi në realizimin e atyne kërkesave që u dëshmu edhe ma vonë pastaj.

Ne në Televizionin e Prishtinës kemi qenë në ekip shumë homogjen dhe kemi bashkëpunuar mes veti. Sidomos unë e kom pasë n'atë kohë redaktor të redaksisë të lajmeve të rubrikës së brendshme Muhamet Mjeku i cili ka qenë në njeri shumë i pjekur, në koleg i mirë, i afërt. Bashkarisht kemi bisedu për zhvillimet n'atë kohë. Bile Unë kom biseduar shumë hapur me Muhametin edhe ai me mu. Se n'atë kohë ka qenë vështirë edhe me familjar me bisedu sepse sigurimi shtetnor i ka, ka pasë në ndikim të jashtëzakonshëm gjikund edhe n'familje edhe gjithkund.

Kштуqë kemi bisedu edhe ne, unë për shembull, kur janë arrestuar organizatorët e demonstratave, unë kam propozu që si gazetar t'i përcjelli gjykimet e organizatorëve të demonstratave. Unë kom pasë në liri të veçantë me Muhamet Mjekun, jo në mbledhje po jashtë mbledhjes i kom thanë, "Muhamet, t'lutëm mos më parashih që t'raportoje nga gjykimet e organizatorëve sepse jam i vetëdijshëm që unë ta marrë prap lajmin e Tanjugut edhe në emër ashtu si raporton Tanjugu edhe ne ta transmetojmë në Universitetin e Prishtinës". Nuk isha n'gjendje që të bëhem servil i tillë dhe të raportoje për diçka që unë intimisht nuk mendojsha që duhet me raportu n'atë mënyrë...

Anita Susuri: Dashta me ju pytë...

Nuhi Bytyçi: Kishim cenzurë të jashtëzakonshme dhe i thashë Muhametit, "T'lutem hiqëm nga lista", edhe m'ka heq Muhameti nga lista e ka caktu dikë tjetër n'vend timin edhe thashë, "nuk jam jurist". Ashtu e gjeta si arsyetim edhe Muhameti me pasë ma lehtë me kolegët e redaksisë me arsyetu që 'Nuhiu nuk osht' jurist edhe ka detyra, obligime tjera dhe nuk osht' i gatshëm me përcjellë kto ngjarje'.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë qysh e keni pa ju gjendjen qato ditë në Prishtinë? Me na përshkru qysh ka qenë?

Nuhi Bytyçi: Është e papërshkrueshme gjendja me t'vërtetë. Ka qenë në, në situatë shumë, shumë e tendosur edhe meqenëse filloj diferencimi ideo-politik në të gjitha institucioneve edhe drejtorin e

përgjithshëm të asaj kohe të RTP-së, Riza Ala e ndrruan nga pozita. Sepse ai ishte ni, ni intelektual edhe ishte bashkëpunëtor i Mahmut Bakallit. Kshtuqë t'gjithë ata bashkëpunëtorët e Mahmut Bakallit n'atë kohë... sepse Mahmut Bakalli detyrohej t'jap dorëheqje nga pozita e kryetarit të komitetit krahinor dhe kshtu ndrruan drejtorin e përgjithshëm të Radio Televizionit të Prishtinës. Po edhe drejtorin edhe krejt strukturat tjera brenda Televizionit të Prishtinës. Ishte shumë vështirë me punu n'ato rrethana. Me punu në mënyrë profesionale t'them, a din, ishte shumë, shumë vështirë.

Anita Susuri: E në rrugë për shembull qysh ka qenë gjendja? A keni pa dhunë? A ka qenë veç 11 marsi e 01, 02 prilli ka qenë edhe 25...

Nuhi Bytyçi: 26 marsi po.

Anita Susuri: 26 kur ka ardhë shtafeta.

Nuhi Bytyçi: Po dhuna ka qenë çdo kund e paraqitun sepse Beogradi dërgoj njësi speciale në Kosovë dhe ushtria ishte n'rrugë. Ne n'televizion e kishim një njësi speciale të ushtrisë jugosllave. Aty ka qenë n'hyrje të televizionit ni ndërtesë e vjetër, aty ka qenë ushtarakët e armatosur. Të cilët kanë qenë edhe në shkallët e televizionit, në hyrje të ndërtesës, të studios nëse e dini ku është edhe tani ku është, aty ka qenë studioja. Aty i kemi pasë edhe shoqërinë do të thotë. Ka qenë orë policore deri në ora 08:00, ka qenë munësh me punu mas orës 08:00 ora policore, nuk ka mujtë me lëvizë kërkush.

Ne që punonim n'lajme kta të ushtrisë ka qenë ni shqiptar aty udhëheqës i asaj njësie, ka qenë nga Opoja, emrin ia kom harru. Ka qenë njeri i mirë, na ka ndihmu shumë. Mbas orës 08:00 ai na hypte në ato kompanjollat e tyre dhe na dërgonte nëpër shtëpia. Nuk kemi qenë ekip i madh n'atë kohë që kemi qenë mbas orës 08:00 edhe na dërgonte në shtëpia sepse nuk guxojshe me çarkullu ti n'rrugë se të vrajshin, pa paralajmërim. Ora policore i ka rregullat e veta nuk pyt kush je, ku po shkon ose çfarë problemi ke.

Kshtuqë ka qenë, ka qenë shumë vështirë. Unë e kom vrejt aty, e kom pa dhunën policore edhe ushtarake serbe te Mensa e Studentëve me 26, me 26 mars. Edhe me 01 prill ma janë mbajtë në qendër të Prishtinës ku Hidajet Hyseni ka paraqitur, ka folur aty para masës, e mbaj si sot mend. Ishin, ishin momente shumë t'vështira. Definivisht t'gjithë i përkrahshim ato kërkesa po publikisht ishte e pamundur m'i përkrah sepse u dishin pasojat. Ka qenë, Skender Blakaj, ka qenë koleg i joni në Televizionin e Prishtinës, ai ka qenë shok i ngusht i Jusuf Gërvallës. Ai meniherë u largu nga detyra e vet edhe ka qenë i anatimuar.

Mirëpo ne gjithnji kemi vlerësuar sakrifikën e intelektualëve shqiptar, guximin e tyre. Se n'atë kohë shumë vështirë ka qenë që ni intelektual ta shpreh mendimin e vet t'libër. Sidomos publikisht. Ka qenë me t'vërtetë ni atmosferë shumë e randë. Policia çdo kund ka qenë e pranishme. Mirëpo rinia nuk është frikësuar, kanë qenë shumë t'guximshëm. Nuk janë frikësuar fare dhe nuk kanë heq dorë nga kërkesat e tyre për liri dhe pavarësi.

Anita Susuri: Në çfarë mase ka shku, qysh me thanë, është përhap kjo demonstratë? A ka qenë e kufizuar veç te studentat...

Nuhi Bytyçi: Jo, ndërkohë siç dihet, studentëve iu kanë bashkangjitur edhe punëtorë e elektro-premier të Kosovës, punëtorët e fabrikës së armotizatorëve, punëtorët e ndërmarrjeve tjera të Prishtinës edhe fshatarësia, edhe bujqërit edhe t'gjitha shtresat e popullit i kanë përkrah, ju kanë bashkangjitur demonstratave. T'cilat me 01 dhe 02 prill kanë qenë edhe ma masovike në qendër të Prishtinës. Mirëpo filloj, filloj arrestimi i t'rive, filloj arrestimi i organizatorëve të demonstratave dhe kshu pastaj pas ni kohe siç dihet janë dalë edhe para gjykatës. Ka qenë n'atë kohë ai neni i famshëm 113 i Ligjit Penal të ish Jugosllavisë për nacionalizëm, për armiqësori. N'bazë t'atij ligji deri në 15 vjet edhe ma shumë i kanë dënuar t'ritë shqiptar.

Anita Susuri: Nuk e di a ju kujtohet juve, në Rilindje ka qenë bash në vitin '81 n'qato ditë, n'qato muj muj me thanë, s'po di saktë...

Nuhi Bytyçi: Po, po.

Anita Susuri: Ka qenë ni poezi për Titon edhe ka qenë afër saj ni karikaturë e ni qeni të pikëllun...

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: Në Rilindje. Tash e di që në Pollitika ka qenë ni artikull, ni lajm me komentu kta pse ka ndodhë kjo poezia për Titon me qenë afër karikaturës së qenit. Nuk e di a ju kujtohet kjo juve?

Nuhi Bytyçi: Nuk më kujtohet. Po atëherë çdo gja politizohej, çdo gja analizohej me ni sy krejt tjetër. Jepet menihërë vlerësimi se ka pasë prapavijë politike, u bo me qëllim e krejt. Ashtu ka qenë. Tash unë, për shembull, m'kujtohet kom përcjellë ni mbledhje solemne në Mitrovicë. Ku Mitrovicës iu ndrru emri iu bo Mitrovica e Titos. M'dërgoj mu shefi i programeve Pehlivan Zhuri m'tha, "Nuhi, a po shkon në Mitrovicë?" Pritova me shku e kur priton pastaj t'del problem. Mirëpo me refuzu ishte vështirë me refuzu.

Shkova dhe përgatita ni kronikë për lajme për ditarin e atëhershëm që ka qenë ditari 19:30. E përgatita kronikën po ni teknik i ri ka qenë në montim derisa e montoj pak ishte i ngathët edhe meqenëse fillonin lajmet me atë kronik, duhej t'montohej kronika e parë. Ai tekniku, jo me qëllim, po ishte pa përvojë. U vonu. Fillun lajmet, 'Shikues të nderuar mirëmrëma, sot Mitrovica e mori emrin e Titos edhe nga atje e kemi raportin e gazetarit tonë'. Tash duhej m'u transmetu kronika mirëpo nuk ishte gati me fillu me kohë edhe u errësu ekrani.

Ekrani zakonisht errësohet kur vdes dikush. U errësu ekrani disa sekonda edhe pastaj startoj kronika po me vonesë. U bo problem politik, u bo problem politik menihërë. Posa u kryen lajmet drejtori i përgjithshëm, drejtori i emisionit, kryeredaktori, kryetari i partisë atëherë që ishte (qeshë) Enver Mulliqi e gjithmonë problem politik. Ishim bashkë me Muhamet Mjekun aty n'bankën e të akuzuarve. Ai ishte redaktor i lajmeve, unë isha autor i kronikës. Tash ata po thojnë, kjo osht' bo me qëllim.

M'kujtohet ka qenë drejtor i televizionit Agim Zatriqi edhe tha, “Nuhi”, tha, “çka ndodhi?” “Valla”, thashë, “unë e montova po ai tekniku ishte pa përvojë, unë s’e kom caktu atë ashtu ma caktun”. Ka qenë ni Enver Shamli, ishte pa përvojë. Thashë, “Kshtu ndodhi”, thashë, “unë e kom përgatitë ma herët tekstin e krejt po montazheri i ngathët”, tha, “Mirë mirë montazheri po unë çka me i thanë”, Veli Deva ishte atëherë kryetar i komitetit, “çka m’i thanë Veli Devës? Qysh me ia shpjegu? Qysh me u arsyetu para Veli Devës?” M’erdh me kesh pak. I thashë, “Thuj çka t’dush, qikjo është realiteti. Nuk ka kufar’ prapavije ktu”. Se dyshojnë mos u bo me qëllim kjo. Dyshim s’ka pasë.

Do të thotë gjithmonë ka qenë prirja që m’i politizu edhe naj gabim teknik edhe naj gabim t’rastit. Atë ka qenë ashtu periudhë e vështirë. T’kanë qit’ në teren tjetër politik meniherë kanë kqyrë me t’bo armik t’popullit edhe të sistemit, armiq të sistemit se jo armik të popullit...

Anita Susuri: A janë shiku gjithmonë raportimet, kto reportazhat, shkrimet para se me dalë n’publik?

Nuhi Bytyçi: Patjetër, po, po. Qat’ rregull se redaktori i lajmeve ose redaktori i ndonjë emisionit me pa tekstin, me pa emisionin. Krejt para se me u transmetu. Edhe sot osht’ ajo, po sot a din, janë rrethana tjera...

Anita Susuri: Po mendoj për m’u cenzuru...

Nuhi Bytyçi: Po atëherë cenzura ka qenë patjeter. Asni, asni temë, asni emision s’ke mujtë me ba pa e ditë ku po shkon, për çka po shkon. Gjithmonë janë dhanë edhe instruksionet çka me ba, qysh me ba e sene. Ka qenë qajo periudhë ashtu ka qenë t’drejtën me thanë. Ne nuk kem mujtë as me shprehë aftësinë tonë profesionale. Kanë qenë disa klishe të gatune sidomos për tema politike. Për tema tjera kulturën e arsimin pak ma ndryshe. Po për tema politike kanë qenë ato korniza të caktuara qysh ma herët.

Anita Susuri: E qysh ka qenë krejt kjo skena e politike e viteve ‘80-ta? Se pas vitit ‘81 është vështirësi shumë edhe ka shku t’u u bo ma keq. Po qysh ka qenë edhe pozita e juv si gazetar edhe personalisht juve qysh ju ka ndiku kjo?

Nuhi Bytyçi: Po atëherë gazetarët kanë pasë ni tretman punëtor, gati si punëtor shoqëror politik thoshin. Ashtu na konsideroshin që duhemi me qenë edhe na pjesë të sistemit. Mirëpo kemi bo përpjekje që megjithatë edhe në ato rrethana të punojmë dhe me ni lajm, me ni mini lajm ta informojmë, me ni rresht t’shkurtë ta informojmë opinionin. Se diçka ktu ka ndodhë edhe kshtu duhet me ndodhë.

Meqenëse ishte cenzurë shumë e rreptë, rreth vitit ‘84, ‘85, ‘86 disa lajme i jepnim kah fundi i lajmeve Ditari dhe nuk e lajmëronim shefin e lajmeve ose shefin e programit në të vërtetë. Kur i transmetonim ato pastaj kishim pasoja t’mdha. Merrshim në biseda informative, sidomos në mbledhje të kolegiumit aty, u dukte shumë, ‘Pse e ke dhanë këtë lajm? Pse s’më ke informu për këtë lajm?’ Edhe pse ishin

lajme të zakonshme, nuk ishin diçka lajme të jashtëzakonshme. Po konsideronim që s'paku duhet të informohet opinioni.

Për shembull ka ndodhë në Pejë është mbajtur në protestë e nanave shqiptare t'cilat protestonin për kthimin që ktheheshin kufomat, djemt e tyre nga armata jugosllave që ktheheshin n'kufoma. Ato protestuan në Pejë atje, e mbajtën në tubim protestues. Na erdh lajmi nga korrespondenti, atëherë ka qenë Xhavit Husaj korrespondent nga Peja. Unë isha redaktor i lajmeve bashkë me Enver Malokun të Klloricës së Klinës. Se kemi pasë dy Enver Maloku, një ka qenë nga Llapi, Enver Maloku që ka punu në qendrën informative të Lidhjes Demokratike. Enver Maloku në gazetë koleg i imi.

Erdh lajmi se janë mbajtur protestat për të kundërshtu regjimin serb se qysh po kthehen djemtë tanë në arkivole. M'thirr mu drejtori i televizionit, ka qenë Arif Osmani. Ditën e parë, atë ditë ishte dita e parë e tina. Arifin e kishin koleg të Radio Kosovës, Radio Prishtinës n'atë kohë edhe njiheshim mirë, kishim përcjellë disa ngjarje bashkë edhe njiheshim shumë mirë mes veti. M'thirri mu n'zyre tha, "Nuhi t'lutem m'i bjer krejt tekstet e ditarit atë natë". I mora tekstet shkova. Enverin e lash mos po vjen ndonjë lajm i ri. I thom, "Prit Enver ktu edhe unë të informoj çka m'ka thanë drejtori".

Aty ishte kshtu si ushtrues detyrë e kryeredaktorit t'bëhesh Boshko Drobnjak. Ka qenë në nacionalist shumë i ngarkuar. Ishte përgjegjës i programit ai. Po i lexon tekstet edhe Dërmjaku po i thotë, Arifi po i thotë, "Ky lajmi nga Peja", thotë, "nuk bon m'u transmetu", unë veç po dëgjoj edhe po pres reagimin e Arifit. Arifi po m'thotë, p'e lexon edhe Arifi, "Nuhi", tha, "osht' mirë", tha, "Po t'lutem", thashë, "mos me transmetu këtë lajm". Ishte drejtor mund të thoshte me heq edhe s'kishe çka me ba. Unë e kisha qëllimin që atë lajm mos ta heqi po ta transmetoj. Përkundër insistimit të drejtorit edhe të kryeredaktorit.

Isha i vetëdijshëm për pasojat. Po m'thotë Arifi kshtu, m'i thonë që nuk e hjeqi e hiqte ai. I thashë, "Ani, s'ka problem. Nuk osht' mirë që po thuni po masi po thuni ju po e heqi". I kom marrë tekstet kom dalë nga zyra e tyre edhe kisha, ata kanë mendu që u morëm vesh për këtë punë, u kry kjo punë. U takova me Enverin n'koridor te studioja. Na pritshin spikeret me i dhanë tekstet për m'i lexu. Ishte para orës 07:30. Po informoj për korrektësi kolegun tim që ishim dyt redaktor dyt, përgjegjës atë natë.

Thashë, "Enver", kshtu drejtori tha, "edhe me insistimin e Dërmjakut këtë lajmin nga Peja me heq, mos me transmetu", "Çka i the ti?" "Unë i thashë po s'po heqi po", thashë, "mos me heq po me transmetu. Unë atyne nuk ju thashë se me ju thanë që s'e heqi e heqin ata edhe për me arrit qëllimin". Enveri ka qenë njeri i mirë, është njeri i mirë. Tha, "Po t'del problem, p'e heqim", thashë, "O' problem po du me pasë bash problem po du me pasë me ta", thashë, "nuk e heqi", thashë, "nëse ti nuk don s'ta qes emrin aty hiç, s'ki përgjegjësi hiç, unë e marrë përgjegjësinë", thashë.

Po i erdh keq Enverit m'u largu ashtu, me ma lanë përgjegjësinë me ma ngarku vetëm mu. Tha, "Jo, jo s'ka problem, na bashkë ta mbajmë përgjegjësinë. Masi po thu, hajt p'e transmetojmë". Ashtu ndodhi. U dhanë tekstet spikerëve edhe spikerët e lexun ashtu qysh e kishim parapa na. Si u transmetu lajmi ka ardhë ai Dërmjaku aty n'realizim te Ditari. Po thotë, unë isha atje te tonisti, ai ishte ma afër n'fillim. Nga

inati me mu s'donte me komuniku. Tha, "Malok", tha, "t'ka tregu Nuhiu se këtë lajm s'u dashtë me transmetu", ai tha, "Nuk e di unë ju jeni marrë vesh me të". Shkoj, doli i revoltuar nga aty, "Keni me pa", tha, "keni me pa", tha.

Doli. T'nesërmen ishim prap në orar të parapam për redaktor. Nga dy ditë zakonisht kujdestarët. Dy ditë tjera kolegët e tjerë, me radhë kshtu. T'nesërmen na hoqën nga orari i redakturës. Por, ne ishim unik atëherë. Fillum të bashkohemi, të jemi unik redaktorët e lajmeve dhe u solidarizojshim me njëri tjetrin. Kshtuqë e pan që osht' e kot, se me neve s'munden me urdhëra të veprojnë edhe s'mund ta pengoj askush informimin. Na kurgjo nuk dezinfomonim, kurgjo nuk rrenim. Po donim me tregu ngjarjet që kanë ndodhë, protestat që kanë ndodhë edhe kshtu.

Ditët në vijim ka pasë tendenca... u bo ni list nga komiteti prej 13 redaktorëve që me na largu krejt prej lajmeve. Mirëpo me insistimin e drejtorit të atëhershëm të përgjithshëm Agim Malës i cili ka qenë ni njeri intelektual edhe i guximshëm na ka përkrahë. Neve intimisht na ka përkrahë gjithmonë kshtu në takime kur kemi pasë unë për shembull me Agim Malën edhe Qani Mehmetin. Qaniu e ka pasë shok t'vjetër kshtu mik t'vjetër edhe ka qenë ma i lirë. Kurse unë si dhandër i Gllloxhanit edhe ai ka qenë i Gllloxhanit kshtuqë kisha ni raport ma të afërt me të.

Ai thonte, "Ju punoni po mos tregoni që jeni marrë vesh me drejtorin se masnej edhe mu m'hjekin komiteti edhe nuk mundemi m'i kry detyrat tona". Kshtuqë ai na ka përkrah. Ne kemi marrë sinjalin prej tij se duhet, duhet të japim komente. Rexhep Kasumaj ka pasë ni koment për kolonizimin e Kosovës. Unë kom pasë disa komente politike kundër masave që ndërmerre Serbia në Kosovë. Dhe kolegët e tjerë Ali Ali dhe të tjerët kishin komente tjera t'cilat i bënin me dije popullit të Kosovës se duhet të mos dorëzohet në rrugën e vet për avancim të mëtejshëm të pozitës kushtetuese të Kosovës.

Anita Susuri: Po m'duket keni përcjellë atë ngjarjen kur në Fushë Kosovë ka ardhë Millosheviçi?

Nuhi Bytyçi: Po, po është e vërtetë. M'kujtohet si sot, ka qenë 24 prilli i vitit 1987. Ardhja e Millosheviçit në Kosovë dihej. Se serbët e Fushë Kosovës edhe të disa vendbanimeve tjera rreth Fushë Kosovës kanë qenë ekstremisht të ngritur kundër shqiptarëve, kundër intelektualëve shqiptarë të cilët kërkonin t'drejtat e popullit të Kosovës. Ata me kërkesat e tyre anti shqiptare donin që Serbia të ashpërsonte masat e veta ndaj popullit shqiptar në Kosovë.

Kshtu Millosheviçi erdhi për t'i përkrahur ata dhe ia organizoj ni tubim në Shtëpi të Kulturës në Fushë Kosovë. Ku ishte salla shumë e vogël për t'i nxënë gjithë ata serb e malazez t'cilët ishin të interesuar të merrnin pjesë n'atë tubim. M'kujtohet kur u mbush salla, hyjnë brenda, i kishim dy kameraman që i morëm me veti se e dishim që xhirimi është me rëndësi dhe dëshironim që ta kemi të inxhizuar të tërën, t'mos shpëtoj kurgjo pa pasë.

Ni pjesë e serbëve nuk arriti që të hynte në sallë për shkak se nuk kishte vend edhe policia ishte atëherë afër aty t'u mbajtë rendin. Ka qenë komandant i policisë e mbaj mend, Destan Thaçi, ni komandant në të vërtetë i aftë dhe shumë i zgjuar. Ai dha urdhër që të ndërhyhet ndaj atyne serbëve

dhe malazezëve t'cilët dëshironin me dhunë me hy në sallën e shtëpisë së kulturës ku mbahej tubimi. Policia për shkaqe sigurie nuk i lejon të hyj po përdorej ni dhunë, dhunë normale ndaj tyne.

Pastaj, Millosheviçi e ndërpreu tubimin edhe doli në dritare, si e keni pa në këto xhirime që dalin shpesh. Ju tha që juve nuk guxon askush t'ju rrah. I përkrahi edhe ata brenda edhe ata jashtë. Aty në sallë ka qenë ni atmosferë shumë e randë. Ka qenë edhe Azem Vllasi aty, ka qenë Kaqusha Jashari, ka qenë Daut Jashanica edhe disa të tjerë. Flisnin ata, shumë kanë qenë ato diskutime ekstremiste, urrejtëse ndaj shqiptarëve në përgjithësi. Vishin edhe nja dy shqiptarë, Daut Bogujevci sa e di unë edhe ni Kelmendi ka qenë, Shaban m'duket, s'e di saktësisht.

Ata morën fjalën dhe thanë, 'Po si po mendoni ju me ndërtu vllaznim-bashkimin me kto diskutime urrejtëse ndaj shqiptarëve, ndaj fqinjëve t'juj?' Dhe e demaskuan politikën e Serbisë ndaj Kosovës. Azemi ishte, kishte parapa të fliste aty. Bile ka qenë Ibrahim Osmani shef i kabinetit t'tij, kolegu Ibrahim Osmani ka qenë shok i joni, koleg i joni. Ai ishte shef i kabinetit të Azem Vllasit. I them, "Ibro, a ka me folë Azemi?" Tha, "Po", thashë, "Mos ke rastësisht fjalimin e tij të gatshëm që t'ia jap kameramanit edhe me zgjedhë ni pjesë, mos ta xhirojmë krejt, me zgjedhë ni pjesë që osht' ma interesante", tha, "Jo Nuhi", tha, "nuk osht' mirë para se me folë me ta dhanë", tha, "kur t'flet", tha, "ta jap", "Nejse n'rregull s'ka problem".

Po Azemi nuk arriti ta marr fjalën fare. U kriju ni atmosferë e randë që ishte e kot. Nuk i besonin kërkujt ata serbët e malazezët aty. Azemi nuk pat' shansë me marrë fjalën, nuk pat' klimë për me marrë fjalën aty, as atmosferë, as gatishmëri. Tubimi ka zgjatë deri kah ora 05:00 a 06:00 t'mëngjesit, se di saktë, qashtu diçka shumë ka zgjatë shumë. Mbetëm pa gjum. Morëm vesh me Muhamet Mjekun kemi përcjellë bashkë këtë ngjarje të randësishme, çka, si me raportu?

E thirrim drejtorin e përgjithshëm të RTP-së atëherë Qemal Hasanin edhe i themi që, "Ne kemi përcjellë këtë ngjarje edhe osht' mirë m'u marrë vesh që mos me dalë për t'njejtën ngjarje dy-tri raporte të ndryshme në Radio Televizionin e Prishtinës. Osht' mirë ndoshta me bo na bashkë, unë e Muhameti edhe për programin e serbëve". Sepse ato diskutimet ishin serbisht krejt, aty nuk kishte shqip kurgjo. Qëllimi ishte që ne mos t'dalim kontra, ata ndryshe na ndryshe, turqit ndryshe.

Ishte sugjerimi im dhe i Muhametit që këtë ngjarje t'jetë ni raport i përbashkët. Ata ma shkurt, na ma gjatë meqë kishim hapësirë programi shqip ma gjatë. Na përkthejshin. Qemali parimisht u pajtu po tha, "Osht' mirë, do t'bisedoj me atë shefin e programit të serbëve", se s'munësh me imponu, e kishin pavarësinë e vet dhe t'drejtën e vet. Mirëpo siç duket ai Gjukanoviçi ka qenë shef i programit edhe ai ka marrë pjesë aty në ngjarje. Ka pritu sigurisht m'i hi ksaj pune ka thanë, "Ani le t'pregadisni kolegët, ma lehtë e kom", dhe u pajtu që me pregadit ni raport të përbashkët.

Fillun na me montu ni verzion ma t'shkurt për lajmet në gjuhën serbo-kroate edhe jo nashta qëllimit po ashtu ne e kemi pa. I zgjedhëm disa diskutime që kanë qenë pak ma ekstreme edhe pse fund e kry ato ishin ekstreme, ishin urrejtëse shumica prej tyne. Na i zgjedhëm me atë shijen tonë, me vlerësimin tonë disa diskutime i montum aty. Erdh redaktori i programit serbisht edhe zoti Bytyçi, "Ta shoh

kronikën që e keni pregaditë para se me transmetu”, a din. Lajmet serbisht shkojshin ma herët se lajmet shqip. Them, “Po more munësh me pa”, se s’bon me pa s’munësh me i thanë.

Mirëpo me ia tregu mendojsha që nuk e transmetojnë. I thom atij montazherit ka qenë ni Hashani i Obiliqit thashë, “Sille pak atë kaseten”, thashë, “thuj s’e kemi gati edhe pak kur ta kemi gati ta tregojmë”. E sillke ai majtas djathtas. Ai tash s’kishte kohë me prit se na e kishim kry po dojshim mos me ia dhanë shansin me pa, a din. Filloj tash, ofroj koha që u dufke me hi n’studio, i udhëheqke lajmet. ‘Shikues të nderuar mirëmrama’, serisht, ‘e kemi raportin e kolegëve tanë nga Fushë Kosova, kolegëve tanë nga programi i gjuhës shqipe’.

Startojnë kroniken, transmetohet kronika. Si janë kty lajmet serbisht ka ardhë i revoltuar ai. Redaktori ka qenë ni Grujiqi i Lipjanit a din edhe tha, e lujke kryt tha, “Ma keni kajt nanën”, serbisht tha, a din. “Pse çka ka ndodhë?” “Qysh more çka ka ndodhë? Shumë i keni zgjedhë ato diskutime ekstreme”, thashë, “Krejt janë konë qaso fryme”, thashë, “mos ki merak. Fund e krye ka qenë. Na s’kemi folë n’vend tyne, ata kanë folë”, “Po, po”, tha, “po i keni zgjedhë si me pincetë”. U munojke me m’akuzu që me qëllim e keni bo ata.

Mas nja dhetë minutave kanë ardhë nga komiteti krahinor n’televizion kanë ardhë. Ka ardhë Lubo Popoviçi ka qenë sekretar i komitetit krahinor ka qenë. Sonja Shaponoviçi ka qenë anëtare e kryesisë, përgjegjëse për informim. Te drejtori presion t’jashtëzakonshëm te drejtori me marrë masa ndaj neve. Qemal Hasani ka qenë atëherë drejtor i përgjithshëm aty. Ka qëndru burrisht Qemali, nuk u dorëzu. “Kanë folë qashtu, gazetarët e kanë bo edhe na s’mujmë me rrejt”. Qëllimi jonë ishte që na me demasku politikën e Serbisë edhe aty Millosheviçin. Ai diskutoj, i përkrahi krejt ato kërkesat serbe edhe malazezëve të cilat ishin shumë ekstremiste t’papurueshme.

Nuk u dorëzu as Qemal Hasani nuk u dorëzum as unë as Muhameti. Shkum na në Beograd me përcjell ni mbledhje të kuvendit federativ për Kosovën. Po e lexojmë gazetën “Ekspres Politika” në mbramje botohej e dilte në mbramje. Po e marrim numrin ma t’ri. Po e kqyrim n’faqe t’parë titulli “*Montaža i diverzija*”, “Montazhë dhe diverzion”. Ishte për raportin tonë nga tubimi në Fushë Kosovë. Kërkonin aty masa ndaj meje, ndaj Muhamet Mjekut edhe ndaj meje. Masa ideo politike, masa ndëshkimore e tjera. Sepse ata e vlerësonin Boshko Drobnjaku, Boshko Prodari edhe disa koleg tanë aty në Televizionin e Prishtinës serb. Vlerësonin se ky raport ka qenë i qëllishëm edhe duhet me marrë masa ndaj neve.

Ta them edhe ni element tjetër që ne pregaditëm ni raport të zgjeruar edhe për rrjetin e zgjeruar jugosllav n’atë kohë. Meqenëse ishin sigurisht kta të Beogradit kërkun që ne t’ju japim materialin, t’ju tregojmë edhe atyne. Ka fillu m’u transmetu emisioni special n’gjuhë te na në Prishtinë edhe t’njejtën kohë edhe në Beograd, edhe në Sarajevë, edhe në Lublane, edhe në Zagreb edhe media tjera jugosllave atëherë. Kur kishte ngjarje u lidhshin drejtpërdrejt. Kemi dëgjuar se pas disa minutave është ndërpre nga emisioni i Beogradit, u ndërpre raporti jonë nga Fushë Kosova. U ndërpre se s’ju ka pëlqy atyne qysh e kemi ba.

Kjo ka qenë ni sinjal për krejt Jugosllavinë se Serbia diçka po përgatit në Kosovë. Qëllimi jonë ka qenë me demasku vërtetë politiken nacionaliste, udhëheqëse ndaj popullit shqiptar. Demaskimin e politikës të Beogradit në krye me Millosheviçin. I cili pas eliminimit politik të Ivan Staboliçit arriti që ndaj Kosovës ta ndryshoj qind për qind kursin politik ndaj Kosovës. Kshtuqë, po thom, ka qenë ni periudhë e vështirë mirëpo ne gazetarët dhe redaktorët kosovar ishim unik dhe nuk lejuam.

U mbajt mbledhja e partisë aty, na thirrën nga Beogradi m'u kthy urgjentisht në Prishtinë me mbajtë mbledhjen e Lidhjes Komunistëve atëherë. Se aty bohej vlerësimi. Muhameti ka qenë sekretar i organizatës të Lidhjes Komunistëve të televizionit edhe mora vesh që mos me lshu pe as Muhameti as unë. Qemalit i tham, nëse ka presion... qëllimi ishte edhe Qemalin me heq nga detyra e drejtorit. I thashë, i tham na Qemalit që 'Mos u dorëzo as ti, nëse ka nevojë na pranojmë nga ni kritikë për me t'shpët, m'u liru presioni ndaj teje', tha, "Jo, as ju mos pranoni as une".

Kshtuqë kemi qëndru burrisht edhe kolegët tjerë na kanë përkrahë. Se vet s'mundet njeri kurgja me ba. U kriju klima vetëvetiu te intelektualët shqiptarë që duhet me përkrah njëni tjetrin sepse t'gjithve synonin nga një nga një m'i burgosë, m'i arrestu, m'i dënu, m'i largu nga puna dhe kshtu mos me mujtë me kontribu për Kosovën asgjë.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Deshta me vazhdu me folë për kto tubimet e nëntorit që kanë ndodhë në vitin '88 edhe në pikëpamjen e ju me tregut çka keni pa? Çka keni raportu?

Nuhi Bytyçi: Po, m'kujtohet shumë mirë kto ngjarje në tetor pjesën e dytë të tetorit, nëntorit në të vërtetë, nëntor 1988. Beogradi synonte që edhe ta kontrollonte edhe kryesinë e komitetit krahinor të Lidhjes së Komunistëve. N'atë kohë kryetare ishte Kaqusha Jashari edhe Azem Vllasi ishte anëtarë i kryesisë të komitetit krahinor, ashtu sa e di une. Beogradit s'i pëlqente qëndrimi i Kaqusha Jasharit edhe i Azemit. Sepse Azemi filloj që të kundërshtonte t'gjitha ato veprime, ato skenarin e Millosheviçit ndaj Kosovës. Kta ishin pengesë.

Kshtuqë dolën me propozime që duhet të japin dorëheqje Kaqusha edhe Azemi, edhe ndonjë tjetër nashta. Po kta ishin shënjesër. Populli duke parë tendencën te Beogradi edhe ndaj udhëheqjes së Kosovës atëherë, ndonëse kishte vrejttet e veta edhe për punën e tyre t'mahershme. Mirëpo ju kishte dalur gjumi edhe Kaqushës edhe Azemit dhe kishin pa synimet e Beogradit dhe i kishin kundërshtuar ato. Kshtuqë populli i përkrahu Azemin edhe Kaqushën. Nuk dëshironte që ata të largohen nga skena politike për shkak se po kërkon pikërisht Beogradi dhe meqenëse po kërkonte Beogradi dhe Millosheviçi ata dolën në mbrojtje të tyre.

Kshtuqë u organizun ato tubimet masovike në qendrat e Prishtinës, vinin qytetar nga mbarë Kosova. Mbaj mend edhe nga edhe nga Rahoveci kur kanë ardhë. Ata të Rahovecit i kanë kap Prishtinën (qeshë) me ato qëndrimet e tyre. Rahovecjanët janë shumë t'vendosur kur ndërmarrin diçka, ata nuk dorëzohen lehtë. Kshtuqë filluan t'vijnë edhe minatorët edhe punëtorët edhe bujqit edhe rini edhe

t'gjithë me kundërshtu insistimin e Beogradit që Kaqusha edhe Azemi me dhanë dorëheqje. Kjo ishte një sinjal se populli i Kosovës duhet t'punoj, intelektualët t'jenë unik, skena politike po ashtu duhet t'jetë unike. Të veprojnë kundër qëllimeve të Beogradit për suprimimin edhe të asaj autonomie që kishte Kosova.

Në nëntor u tubuan disa ditë janë mbajtur tubime protestuese në qendër të Prishtinës. Unë i kom përcjellë disa prej tyre. Sidomos m'kujtohet në tubim me 18 nëntor edhe ku ka dalë ka folur protestuesve edhe në atë kohë Remzi Kolgeci ka qenë në krye të komitetit a anëtarë i kryesisë të komitetit, s'e di saktësisht. Ai u mundu m'i qetësu protestuesit edhe me thanë që na do t'i shqyrtojmë kërkesat e juja, m'i qetësu pak edhe m'u shpërnda. Mirëpo masa ishte e vetëdijshme se vështirë se do të, do të arrihet që t'i shpëtojnë dorëheqjes ose shkarkimit.

Ndërkohë u mbajt mbledhja e komitetit krahinor mbas disa kohe dhe u dhanë vlerësimet për kto protesta. Në pjesë e shqiptarëve ishin t'mendimit se kto protesta ishin t'arsyeshme, t'argumentume. Nuk ishin kundër Serbisë po ishin të arsyeshme. Në pjesë e serbëve, si dihet, ishin ekstremistët ata thoshin se kto protesta kanë qenë të papranueshme, nacionaliste, irredentiste e tjera e tjera. Unë u caktova që ta përgadisja raportin për Ditarin, për lajmet qendrore të Televizionit të Prishtinës. Përgatita një version. Mbledhja zgjati deri në orët e vona. S'kishte mbaruar ende. Unë e përgatita një version timin dhe i nxora ato diskutimet.

Ma shumë i dhashë hapësirë diskutimit që kto protesta kanë qenë të arsyeshme, të argumentune edhe kanë qenë që të mbrohet autonomia e Kosovës dhe kanë kundërshtu qëndrimet e Serbisë. Kshtuqë kur e kontrolloj kryeredaktori i televizionit Ismet Smakaj këtë kronikën time tha, "A e din që mbledhja ende po vazhdon dhe janë propozu disa qëndrime krejt tjera? Krejt kundër me ata që ti ke synu me prezentu në kronikë", thashë, "Po m'vjen keq", tha, "po unë nuk muj m'i prediku çfarë qëndrime do t'miratohen", thashë, "unë kom bo përpjekje me prezentu në pjesë të debatit që u zhvillu deri tash edhe sipas mendimit timin kto kanë dominu, kto vlerësime se kto protesta janë të arsyeshme", tha, "Po m'vjen keq po nuk mundet m'u transmetu kjo kronikë", tha, "duhesh me përgatit një kronikë tjetër".

Ishte ora 07:00, jo që s'kishte kohë me përgatitë po unë s'doja me përgatitë kronikë tjetër. S'pranoja që të cenzohej kronika ime. Thashë, "Unë kronikë tjetër nuk pregadis kurrë, pregadite ti". Ndodhi atë natë që nuk u transmetu kronika ime. U dha lajmi krejt Ditarit se në Prishtinë po mbahet mbledhja e komitetit krahinor, temë osht' vlerësimi i ngjarjeve, tubimeve gjithë popullorë të nëntorit të '88 dhe në emision special do të japim pas përfundimit të kësaj Ditari në ora 08:00. Domethënë nuk kishte kronikë speciale për shkak se unë nuk desha që ta ndryshoj kronikën time dhe kryeredaktori insistoj që ajo kronikë që kisha pregaditur unë të mos transmetohet.

Kshtuqë ndodhi t'nesërmen në mbledhje të kolegiumit atje ku kanë qenë edhe të tjerët osht' marrë qëndrimi që unë të suspendohem po pa shkrim, pa vendim me shkrim. Ishin disa që s'kishin arsye shumë t'madhe për me m'suspendu, i bojshin interne. Nuk mundësh me punu, rrogën e merr. As në ngjarje as redaktur të lajmeve nuk m'caktojshin. Qashtu vijsha në punë, pijsha kafe me koleg bisedonim. As me përcjellë ngjarje as me qenë redaktor i lajmeve. Kshtuqë kjo ka zgjatë disa muj edhe

ndodhën ndërkohë tubimet e minatorëve, protestat, greva e minatorëve të Trepçës prej 20 deri më 28 shkurt të vitit '89.

Nji ditë, redaktori i rubrikës së brendshme ishte edhe redaktor i lajmeve atë ditë, qendrore, Muhamet Mjeku m' thotë, "Nuhi", thotë, "a munësh me shku", thotë, "në Stantërg me bo ni kronikë për lajme për grevën e minatorëve". Unë mbeta pa tekst. Thashë, "Muhamet ti e din që unë jom i suspendun", thashë, "unë me dëshirën ma t' madhe jom t' u prit m' u angazhu po mos po të bojnë edhe ty problem, mos po t' largojnë edhe ty si mu", tha, "Shko", tha, "boll", tha, "ke kjo punë, s' ka kuptim", a din. Unë e mora përgjegjësinë, thashë, "Po shkoj". Shkova me dëshirën ma t' madhe. E mora ekipin, shkum atje në zgafellë. M' kujtohet si sot kur shkum.

Ata minatorët, për shkak se disa gazetar ishin të instrumentalizim dhe ishin në shërbim nashta edhe të sigurimit shtetnor nashta edhe të Beogradit, disa jo t' gjithë. Serbe, turqe, shqiptar besa. Kur i tregoj atij n' hyrje të zgafellës se komunikonte me këshillin e grevistëve në horizonte e minierës. "Kush osht' prej gazetarëve?" Thotë, "Ktu osht' Nuhi Bytyçi me ekipin e Televizionit të Prishtinës po don me ardhë me xhiru, a bon me ardhë?" Tha, "A m' i lshu?" Ka pyetë ata këshillin e grevistëve. Ata janë kshillu edhe kanë thanë, "Po". Kur kanë thanë po m' ka ardhë mirë shumë që m' u dha shansa me raportu. Ishte ni ndjenjë e veçantë për mua, ni përgjegjësi e madhe edhe isha shumë i lumtur që kisha rastin edhe nderin që t' raportoj nga kjo ngjarje shumë historike, e madhe historike.

Hyra brenda atje, takova minatorët. Disa prej tyre i njihsha përpara që kisha bërë edhe kronika, emisione tjera. Takoj edhe Burhan Kavajën, drejtorin e minierës. Ni njeri shumë i mirë, energjik, atdhetar. E disa qëndrimin e tij edhe m' tregoj, tha, "Nuhi e kemi punën shumë shumë ngusht. Kemi presion t' madh nga politika me ndërpre grevën, mos me dështu greva edhe m' dhimën minatorët". Ai kishte përkrahjen edhe të drejtorit të Trepçës të përgjithshëm n' atë kohë, të Aziz Abrashit. Edhe Azizi ishte njeri fenomenal, menaxher i mirë, një ekonomist i mirë, një atdhetar i shquar.

Ata i përkrahshin kërkesat e minatorëve sepse pa përkrahjen e tyre edhe greva s' do të mbahej me siguri. Kshtuqë isha i vetëdijshëm për rolin tim si gazetar për të raportuar nga kjo ngjarje historike. Aty në horizontin e nëntë dhe të njëmbëdhjetë xhirojmë. Minatorët ishin t' lodhur mirëpo ishin shumë optimist se greva do t' ketë sukses. Kërkesat e tyre, s' paku ato kryesore do t' përkrahen edhe kjo i mbante ata gjallë. Na mbante edhe neve gazetarëve e tjerëve që ishin në funksion të asaj greve. Unë aty marrë intervistat edhe deklaratat nga minatorët, nga disa minatorë. Aty ka qenë edhe Avdi Uka edhe Mensuri e disa të tjerë, Ibush Jonuzi.

I morëm ato deklarata dhe kthehem në Prishtinë me vullnetin ma t' madh edhe t' pregadis një kronikë speciale nga kjo ngjarje e rëndësishme. Kur shkoj aty vjen kryeredaktori, Smajli, dhe i thotë Muhametit, "Çka ka ngjarje sot në Kosovë?" Thotë kto, kto, kto, "Greva e minatorëve", "Kush ka përcjellë grevën e minatorëve?" Thotë, "Nuhiu", thotë, "Qysh Nuhiu? Po Nuhiu është i suspendum, qysh e ke çu?" Thotë Muhameti i thotë Smajlit, "Smajl t' lutem boll ke kjo ma, s' ka kuptim kshtu. Pse me qenë i suspendum ky? Tash kemi nevojë me punu me informu e jo m' i suspendu njerëzit m' i lanë mos me mujt me kry detyrën e vet". Smajli s' pat' qare, mbet para aktit të kryen.

Lajmet s'mujshin me fillu pa këtë kronikë se ishte ngjarja kryesore ato ditë. Unë u gzova që m'u dha rasti që të raportoj nga kjo ngjarje historike dhe t'gjithë kemi bo përpjekje që ta informojmë opinionin me t'gjithë ato kërkesa. Solidaritetin e madh që ka qenë n'atë kohë në Kosovë. Krejt viset e Kosovës dhe jo vetëm të Kosovës po nga Lugina e Preshevës edhe nga Maqedonia edhe nga Diaspora t'gjithë kanë ndihmu edhe me t'holla edhe me ndihma humanitare minatorët e Trepçës për me ju tregu atyne që krejt populli është me ju.

Anita Susuri: Si e keni pa ju ata minatorët nëse mundeni me na përshkru krejt qat' atmosferën? Qysh ka qenë?

Nuhi Bytyçi: Po në syrin, në figurat e tyre, ftyrat e tyre kemi pa një vendosshmëri të paparë, si t'them, të tyre. Sepse ata ishin të vetëdijshëm se Beogradi me t'gjitha mjetet po përpiket ta suprimoj autonominë e Kosovës. T'i marrë edhe ato pak t'drejta që kishin shqiptarët e Kosovës me Kushtetutën e vitit 1974. Kshtuqë minatorët ishin ata interpretuesit edhe të kërkesave edhe të vendimeve edhe të synimeve edhe aspiratave t'popullit të Kosovës ma vonë për liri dhe pavarësi.

Ata përmes sakrificës së tyre, qëndresës së tyre përpiqeshin jo vetëm opinionit jugosllav por edhe opinionit botëror t'ia bojnë me dije se Kosova osht' ni problem i pa zgjidhur për Ballkanin, është një minë e montuar nga Beogradi e cila do t'eksplodoj dhe do t'ketë pasoja t'mdha. Jo vetëm për rajonin po edhe për Europën. Kshtuqë si dihet në Jugosllavi atëherë Sllovenët kanë qenë n'përkrahje të fuqishme ndaj kërkesave të minatorëve të Trepçës. Janë solidarizu me minatorët e Trepçës.

M'kujtohet te tubimi i njohur në Crkven Dom në Lubljanë ku Millan Kuçani edhe udhëheqja tjetër e atëhershme e Sllovenisë ka qenë në mbështetje të kërkesave të minatorëve. Normalisht kjo ka qenë ni kërkesë e shoqatës së atëhershme Migjeni. Nga studentat shqiptarë që kanë studiu në Universitetin e Lublanës, nga intelektualët shqiptarë që kanë vepruar në Lublanë n'atë kohë si ka qenë Martin Berisha, Naim Maloku, ky gazetari, kolegu, Sali Kabashi që ka nxjerrë Alternativën, Revista Alternativa. Që ka qenë ni revistë shumë mobilizuese e që shumë frymëzuese për intelektualët shqiptarë.

Kshtuqë u kriju ajo klima që edhe bota demokraike filloj t'i përkrahë kërkesat e minatorëve të Trepçës. Pat' jehonë të jashtëzakonshme edhe në opinionin botëror edhe jashtë edhe jashtë Jugosllavisë. Populli ishte i gatshëm me sakrifiku. Edhe si dihet pastaj edhe ardhja e minatorëve në qendër të Prishtinës, të cilëve iu bashkangjitën të gjitha shtresat e popullit për m'i bë me dije kshtu fuqimisht Beogradit edhe botës demokratike se populli shqiptar nuk lejon nënshtrimin, populli shqiptar nuk lejon nëpërkëmbjen, populli shqiptar aspirojnë lirin dhe pavarësinë e plotë.

Kjo ishte ni atmosferë kudo mobilizuese n'atë kohë dhe t'gjithë edhe rinia ishte shumë optimiste me ato synimet e klasës punëtore, me minatorët. Sepse minatorët ishin shtresa ma e, ma e vujtur e klasës punëtore n'atë kohë. Me hy 1000 metra nën tokë me punu, me nxjerrë xehe, m'i kontribu zhvillimit të Kosovës, m'i kontribu zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë nuk ishte e lehtë. Ishte sakrificë e madhe për ta me qëndru aty, me punu edhe më n'fund si dihet u tradhtuan nga udhëheqja politike e Kosovës

atëherë edhe nga e Serbisë. Me ato skenaret e famshme të Millosheviçit për m'i demasku kta kishe organizatorët e demonstratave edhe protestave edhe të grevës.

Vazhduan me arrestimin e Aziz Abrashit, Azem Vllasit, Burhan Kavajës, Lazër Krasniqit edhe grupit të minatorëve të cilët ishin më të zëshëm në paraqitjen e kërkesave të drejta për popullin e Kosovës, për ni status të barabartë të Kosovës s'paku n'atë kohë me republikat e tjera të ish Jugosllavisë. Procesi gjyqësor zgjati disa muaj mirëpo për fat nuk u ndëshkuan as Azem Vllasi as Aziz Abrashi as Burhan Kavaja as Naser Krasniqi. Ata u liruan dhe populli i priti dur hapur, i priti ma padurim që iu kthyen jetës së tyre.

Anita Susuri: Cilat kanë qenë shqetësimet ma të mëdhaja të minatorëve kur kanë bisedu me juve çka ju kanë thanë ata? A kanë përmend kërkesat e tyre?

Nuhi Bytyçi: Ata kërkesat i kanë paraqit qysh ditët e para. Ato kanë qenë nja nëntë kërkesa, njëmbëdhjetë, nuk p'e di saktë tani për me qenë i saktë. Ata kanë qenë konsistent në ato kërkesa. Mirëpo kërkesa kryesore ka qenë që Kosova kursesi nuk duhet të ketë një tretman ma të ulët sesa që kishte. Përkundrazi, kërkonin ni tretman të barabartë me krejt njësit e atëhershme të ish Federatës Jugosllave. Minatorët kishin përkrahjen e udhëheqjes së tyre, kishin përkrahjen e popullit edhe ata ishin shumë t'vendosur, shumë optimist se greva e tyre do t'ketë efekt. Greva e tyre do t'ketë sukses.

Unë konsideroj se me gjithë dështimin e skenës politike të atëhershme e cila për interesa të ngushta personale edhe grupe nuk arriti që të jetë në anën e drejtë, në anën e minatorëve. Konsideroj se kjo greva ishin një grevë, ishin një ngjarje që bën kthesë historike për ngjarje që pasuan pastaj ma vonë me rezistencën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, të Lëvizjes Kombëtare për Çlirimin e Kosovës dhe pastaj edhe me luftën e drejtë. Luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe për çlirimin e Kosovës dhe shtetin demokratik të Kosovës.

Anita Susuri: A keni përcjellë ju ato kur janë, kur kanë qenë n'gjykim Burhan Kavaja edhe...

Nuhi Bytyçi: Jo. Unë s'e kom përcjellë. Kolegët e mi e kanë përcjellë. Enver Maloku e ka përcjellë, ka raportu nga kjo ngjarje edhe kolegët e tjerë. Ne si televizion kemi raportu vazhdimisht për këtë proces edhe nuk kemi pasë censurë në atë periudhë n'këtë drejtim.

Anita Susuri: E në grevën e dytë që ka ndodhë, a është përcjellë ajo?

Nuhi Bytyçi: Po është përcjellë, është përcjellë. Unë nuk e kom përcjellë ata, e kanë përcjellë kolegët e tjerë po edhe asaj ju ka dhanë hapësirë. Po atëherë u patën arrestu ni pjesë e madhe e anëtarëve të grevës edhe të udhëheqjes së atëhershme. Kshtuqë pat' fillu ni lloj frike te njerëzit osht' e vërtetë mirëpo megjithatë ekzistonte bindja se do t'i vijë fundi, do t'i vijë fundi. Se Jugosllavia nuk do të mund ta bajë këtë, këtë presion n'aspektin, thënë presion n'aspektin pozitiv, të popullit të Kosovës, të punëtorëve të Kosovës, intelektualëve të Kosovës edhe shtresave tjera të rinisë së Kosovës.

Anita Susuri: Thatë që në vitin '90 veç ka pasë presion edhe në redaksin e ju, kanë qenë edhe polic të pranishëm...

Nuhi Bytyçi: Po. Po është e vërtetë kjo. Në studion e Televizionit të Prishtinës ku transmetoheshin lajmet ka qenë ni polic ka qenë serb. Në pjesën teknikës atje te realizimi ku ka qëndru redaktori edhe ekipi tjetër realizues teknik, realizatori edhe tonisti e tjerë edhe në ambientët e teknikës ka qëndru ni polic tjetër. Ata dijnë shqip shumë mirë. Si duket, sipas informatave tona, ata kanë qenë nga Gjakova dhe kanë ditë gjuhën shqipe mirë. Për atë qëllim i kanë dërgu atje për me i ndëgju çka po flasin, çka po bajnë. Gjithmonë e kanë pasë ni bllok edhe ni laps edhe shënonin emra, s'po di çka kanë shënu. Kanë mbajtur evidencë edhe pastaj i kanë procedu atje te shefat e tyre.

Mirëpo përkundrazi qëndrimin të tyre në studio, në galeri aty në realizim, nuk na ka frikësuar. Përkundrazi na ka dhanë kurajo ma t'madhe që ne ta kryjmë detyrën tonë, t'punojmë, mos t'lejomë kursesi që t'ketë ndërhyrje drejtpërdrejt as nga policia, as nga udhëheqja, as nga, nga askush. Ne të punojmë dhe ta informojmë opinionin. N'atë kohë me t'vërtetë të gjithë gazetarët, redaktorët e Televizionit të Prishtinës, Radio Prishtinës po edhe të Rilindjes kanë qenë në shërbim të publikut, shërbim t'plotë të publikut. Nuk ka pasë informatë që nuk e kemi plasuar. Secili në mënyrën e vet.

Masi televizioni ka fuqi ma t'madhe për me kriju opinion se hyn vullshëm si t'them ashtu çdo familje dhe atëherë s'ka pasë televizion tjetër, ka qenë vetëm Televizioni i Prishtinës dhe ka pasë ndikim të jashtëzakonshëm në krijimin e opinionit. Populli ka qenë shumë ka shiku programin tonë dhe ne kemi qenë t'vetëdijshëm për këtë dhe kështu jemi ba, kemi ba përpjekje që ta informojmë për krejt zhvillimet që kanë ndodhë n'atë kohë. M'kujtohet që n'atë kohë janë mbajtur shumë tubime në krejt Kosovën të Lidhjes Socialiste si organizatë e popullit punues i thojshin atëherë.

Kanë mbajtur tubime edhe kur janë kundërshtu doli Serbia me propozime që të ndryshohet Kushtetuta e Jugosllavisë edhe Serbisë po edhe Kushtetuta e Kosovës natyrisht. Që Serbia të ketë ingrenca ma t'mdhaja në Kosovë. Sepse konsideronin se Kosova ka fitu shumë ma shumë t'drejta sesa që meriton edhe Serbia dëshironte të kontrollonte çdo sferë të jetës dhe të punës. Ato tubime mbaheshin në shumë fshatra të Kosovës edhe na vinin neve në redaksi se ishte e pamundur me çu kamerën në çdo tubim, s'kishte edhe nevojë ndoshta.

Po e çojshim me ni tubim diku ndoshta që ishte ma masovik ose në Elektro ekonomi ose m'kujtohet kur janë mbajtur tubimet punëtorëve të Elektro Kosovës ktu në Sallën 1 Tetori. Krejt salla ka qenë plot edhe aty i kanë kundërshtu qëndrimet e Beogradit që të ndryshohet Kushtetuta e Kosovës e vitit '74. Kurse tubimet tjera që mbaheshin na vishin informata të shkruara me dorë, me laps, diku edhe me makinë se s'ka pasë atëherë kompjutera. Na vinin redaksia aty, këtë fshat është mbajtur mbledhja me kundërshtu kto qëndrimet e Beogradit, na nuk pranojmë që të ndryshohet Kushtetuta, kërkojmë që të anacohet pozita kushtetuese e Kosovës, t'jetë e barabartë me republika tjera dhe kështu.

Ne i mblidhshim ato dhe i përmendshim disa nga ato tubime. Këtë fshat u mbajtur kjo, këtë vend u mbajtur ky tubim. Dhe ni ditë, ni ditë shkoj unë, isha redaktor i lajmeve. Në portë vishin, në portë të

televizionit ato informata. Po i thom atij portierit po i thom, “A kanë ardhë sot informatat e terenit?” Thotë, “Po kanë ardhë”, thotë, “Nuhi, po nuk guxoj me t’i dhanë”, thashë, “Pse çka ka ndodhë?” Tha, “E kom vendimin me shkrim”. E kishin qit’ aty n’portë, s’e kisha pa. Vendimin me shkrim nga drejtori i administratës edhe kryeredaktori Boshko Drobnjaku edhe thotë... drejtori i administratës ka qenë serb, ni Ivko Jagodiq a qishtu.

Thotë, aty shkrun, ‘T’gjitha informatat që vijnë nga tereni nuk bën, është e ndalueshme të transmetohen në lajme’, edhe vulën e nënshkrimit aty. Unë thashë, “A bon veç m’i shfletu pak çka ka, te di për afërsisht çka ka”, tha, “Po m’i shfletu po. T’u kisha lut mos i merr se m’qesin prej pune”. Isha i vetëdijshëm për atë, thashë t’mos ma sheh sherrin. Ka qenë ni Musa Demhasaj i Deçanit, ka qenë njeri i mirë shumë. Unë i shfletova ato i pashë. M’interesojke mesazhi i tyre çka ishte edhe e lash aty dhe shkova n’redaksi.

I them daktilografit thom, “Shëno aty, shikues të nderuar edhe sot në redaksinë tonë kanë ardhë shumë informata për mbajtjen e tubimeve mbarë Kosovën për kundërshtohet fuqimisht synimi i Serbisë për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës të vitit ‘74. Mirëpo me ni vendim të çuditshëm të udhëheqjes të Televizionit të Prishtinës këto informata nuk guxojnë të bijnë as në duart e redaktorit të këtij ditari televizim. Prandaj, kërkojmë familje për informim të mangët”. Kjo ishte ni bombë për udhëheqjen e Kosovës atëherë dhe për televizionin sidomos.

Sepse aty unë e përmenda, thashë, “Sipas ni qëndrimi të ushtrimit të kryeredaktorit Boshko Drobnjakit këto informata nuk bën të transmetohen për opinionin”. Me ia përmend emrin kryeredaktorit në emisione qendrore n’atë kohë ishte e paparë, ishte ni guxim i jashtëzakonshëm. Mirëpo dojsha t’ia boj me dije opinionit se vazhdoni ju mbani tubime, ne do ta gjejmë mënyrën për m’i transmetu kto kërkesa t’juja që janë kërkesa t’drejta.

Mu m’thirr n’telefon, Agim Malaj, ka qenë drejtor i përgjithshëm atëherë edhe kështu pak i hareshëm po tha, “Nuhi”, tha, “s’mujte pa ia përmend emrin”, tha, “kryeredaktorit n’lajme a?” Thashë, “Agim po m’vjen keq po ma mirë sa ma shan nanën mu opinionin ma mirë atina t’ja shajnë se unë nuk muj me marrë përgjegjësinë për ato tendencat e tij, përpjekjet e tij për me apliku cenzurë në lajmet tona”. Kshtuqë, po thom, mas disa dite udhëheqja politike e Kosovës në krye me Rrahmon Morinën tuboj t’gjithë redaktorët edhe gazetarët e Radio Televizionit të Prishtinës, m’kujtohet Salla e Filarmonisë të Kosovës ka qenë atje në Radio Prishtinë, aty ku osht’ Koha Vizioni dikund.

Aty në tubim ka qenë Rrahmani, ka qenë Zhivorad Igqi. Ai ka qenë i Lidhjes Socialiste. Pastaj Moma Trajkoviqi e kështu me radhë disa udhëheqës të atëhershëm. Edhe neve na u kërcënu. Thanë, “Ju keni deviju misionin e juv të informimit. Jeni në shërbim të nacionalistëve shqiptarë edhe na”, Trajkoviqi m’kujtohet si sot thotë, Moma Trajkoviqi thotë, “Serbia nuk investon ma n’këtë televizion që nuk osht’ n’shërbim të Beogradit”. Na tham aty, ‘Na nuk lejomë të cenzurohem, ne duam ta kryejmë detyrën tonë si gazetar, ta informojmë opinionin çka po ndodhë, jo me manipulu as me dezinformu’.

Agim Mala doli aty me propozimin pastaj tha, “Nëse nuk kemi financim nga shteti”, se atëherë Kosova financonte se normalisht themelues ka qenë Kuvendi i Kosovës po ni pjesë edhe nga buxheti i federatës. Federatën e dirigjonte Beogradi. Kshtuqë Agim Mala doli me propozimin që, “Nëse ndërprehet buxheti na populli i Kosovës e financon Radio Televizionin e Prishtinës”. Kshtuqë doli me ni propozim n’lajme që thanë që, ‘Ne nuk mund të funksionojmë për shkak se Serbia edhe ni pjesë e udhëheqjes politike të Kosovës po kundërshton punën tonë edhe po synon që t’na pamundësoj veprimtarinë tonë si medium se pa buxhet s’mund të funksionoj as t’paguhen pagat as të sigurohen shpenzime tjera për punën profesionale të ekipeve televizive n’teren’.

Populli n’atë kohë doli dhe përkrahi idenë e Agim Malës që të ndajë kafshatën, nga kafshata e gojës dhe ta ndihmoj Radio Televizionin e Prishtinës. Si thashë, populli ato ditë erdhi në ambientet e Televizionit të Prishtinës ku ishte shërbimi i kontabilitetit dhe në mënyrë të organizuar, në mënyrë institucionale merrshin gjithë ato ndihma që populli ipte fizikisht. Se kishte edhe ndihma në llogarinë e Radio Televizionit të Prishtinës. Po ni pjesë e popullit fizikisht i dorëzonte mjetet e veta që kishte kursyer.

Kemi dëgjuar që disa familje t’cilat kanë pasë vetëm edhe ni lopë qumështi për mbajtjen e fmise, nipave e mesave të ekzistencës të familjes e kanë shitë vetëm për ta ndihmuar Radio Televizionin e Prishtinës, për t’u solidarizuar me gazetarët dhe redaktorët e Televizionit të Prishtinës. Për të vazhduar punën, për të informuar opinionin për të gjitha zhvillimet në Kosovë. Kjo ka qenë ni përkrahje e jashtëzakonshme për ne punëtorët e Radio Televizionit të Prishtinës dhe na ka obliguar që të punojmë edhe më shumë dhe të rrezikojmë edhe më shumë, të sakrifikojmë edhe më shumë duke mos i llogaritur kursesi pasojat që mund të kishim n’atë kohë nga pushteti, nga burgosja e tjera e tjera.

Kshtuqë kemi qenë vërtetë tamon ni tribun e fuqishme e informimit, e opinionit në Kosovë edhe jashtë Kosovës. Djali i axhës sim, Limani, m’kujtohet si sot ka ardhë me m’i sjellë disa t’holla që kishte kursyer nga puna vet si mjeshtër dhe i ka sjellë 400 marka. Tha, “Nuhi unë nuk po mundem me prit”, se ishte radhë e madhe aty për me prit, u duk me prit nja dy ditë me siguri, “merri kto të holla dorëzoj e masnej ma bjen vërtetimin”. Unë i kom dorëzu te arkatari Bedriu edhe pastaj ma ka dhanë vërtetimin dhe pastaj ia kam dërgu si dëshmi djalit të axhës, Limanit.

Edhe ai ka kontribuar bashkë me shumë vendas tjerë që të financohet Radio Televizioni i Prishtinës, të kontribohet në mbarrvajtjen e punës të tij që t’mos të vije në pyetje ekzistenca e Radio Televizionit të Prishtinës. Sepse Beogradi synonte që të paralizonte punën e çdo institucioni në Kosovë që nuk ishte në funksion të Serbisë në dirxhim të politikës së Beogradit.

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: E keni përmend ni ngjarje ni seancë e kuvendit në vitin ‘90...

Nuhi Bytyçi: Po ashtu është e vërtetë. Ato ditë janë mbajtur disa mbledhje të Kuvendit të Kosovës, unë bashkë me Ali Alën, me Enver Malokun, Tahire Govorin dhe disa koleg të tjerë kemi përcjellë disa

mbledhje të Kuvendit të Kosovës. Ka qenë bukur shpeshta. Aty patën fillu m'u paraqit kërkesat e delegatëve shqiptar, sidomos kërkesa e ktij... Ruzhdi Bakalli ka qenë ma i zëshmi, Adem Mikullovc, Skender Skenderi, Xhemajl Lekë Bajraj, Daut Krasniqi, Muharrem Shabani. Ka shumë, shumë... Qazim Shabani e të tjerë. Shumë delegat të cilët kanë qenë shumë aktiv, të zëshëm, të vendosur.

Paraqitën kërkesën që t'hyjnë në atë ditën e Kuvendit të Kosovës kërkesën që të avansohet pozita kushtetuese e Kosovës. 'Kosova nuk ka qenë kurrë pjesë e Serbisë ashtu meqenëse nuk ka qenë pjesë e Serbisë edhe është imponuar që të funksionoj në kuadër të Serbisë atëherë duhet të ndahet nga Serbia. Nuk kemi kurfar' obligimi që të mbesim gjithë jetën me Serbinë. Ne kërkojmë që të pavarësohet Kosova'. Ajo kërkesë ka has në zë, në kundërshtim të jashtëzakonshëm nga udhëheqja e atëhershme e Kuvendit të Kosovës Gjorgje Bozhoviqi.

Gjorgje Bozhoviqi ka qenë kryetar i Kuvendit të Kosovës edhe ai nuk i qitke kursesi as në rend dite lëre më me votu, po as s'e qitke në rend të ditës. Bëhej ni luftë e madhe mes delegatëve shqiptarë dhe atyne serb të cilët me çdo kusht kundërshtonin që kjo kërkesë të përfshihej në rend të ditës të Kuvendit të Kosovës, edhe pse ishte kërkesë shumë legjitime. Ne si televizion kemi qenë aty me kamera në sallë edhe kemi pasë reflektorët tanë aty për ndriçim, për me dalë xhirimi ma kualitativ. Ka qenë kjo e reportazhit dhe nëse nalet rryma e kemi pasë gjeneratorin në kerr të reportazhit.

Aty tash meqenëse delegatët shqiptarë nuk dilshin nga salla edhe Bozhoviqi rrijke aty po insistojsin edhe ata nuk dilshin. Ishte ni skenar i udhëheqjes së kuvendit atëherë që të ndërprehet rryma. Kur të ndërprehet rryma aty nuk kishte ndriçim natyral edhe ata s'kanë mujt me qëndru kishe aty n'sallë edhe me dalë prej sallës. Çka ka ndodhë? Tash, udhëheqja e teknikës të Televizionit të Prishtinës, aty ishin në oborrin e kuvendit, ishin me kablo krejt ato ndriçimi. Ata i kanë dhezë gjeneratorin edhe osht' ndriçu salla me dritat e Televizionit të Prishtinës.

Kshtuqë neve gazetarëve na kanë thanë, "Dilni edhe ju prej sallës se s'ka mbledhje", na kemi thanë,"Derisa edhe ni delegat qëndron n'sallë na kemi me qenë n'sallë. Kur t'dalin delegatët nga salla, dalim edhe ne". Ata delegatët nuk dilshin nga salla kshtuqë edhe na jemi mundu me kry detyrën tonë edhe me konitribu që edhe delegatët qëndrojnë aty, t'kenë kushte për me qëndru, t'kenë ndriçim. Pastaj është pasë ndërpre mbledhja edhe ishte ni marrëveshje... erdh Jusuf Zejnullahu aty ka qenë kryetar i këshillit ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës. Ai kishte biseduar me Millosheviçin se si me gjetë ni zgjidhje. Delegatët dilnin nga salla pa e marrë ni zotim se kur do t'mbahet mbledhja e ardhshme e Kuvendit të Kosovës.

Kshtuqë në marrëveshje me Millosheviçin, Jusuf Zejnullahu kishte caktuar, kishte propozuar që mbledhja të mbahet, Kuvendi i Kosovës të mbahet me 02 korrik të vitit 1990 dhe aty të paraqiten kërkesat e tyre, t'hyjnë në rend të ditës kërkesat e delegatëve. Ata delegatët i besuan Jusuf Zejnullahut dhe dolën pastaj nga salla. Pastaj si dihet me 02 korrik është bërë përpjekje që të minohet ky vendim. Beogradi ka urdhnu që t'mos mbahet mbledhja me 02 korrik. Delegatëve të Kuvendit të Kosovës iu kanë mbyllë dyrtë, s'kanë mujtë me hy brenda, sidomos delegatët shqiptarë.

Ne si gazetar të Televizionit të Prishtinës kemi qenë të mobilizuar n'atë mënyrë që t'i përcjellim krejt çka ndodhë atë ditë edhe n'qytet, ma s'pari para kuvendit, edhe n'kuvend. Menojshim që do t'hyjmë n'kuvend, nëse hyjnë delegatët edhe ne kemi qenë bashkë me delegat. Kur kemi shku aty para Kuvendit të Kosovës nga hymja jo zyrtare po hymja prapa, aty kemi pa delegatët që kanë qenë të tubuar po dera mbyllur. Ne kemi xhiru, kameramanët kemi pasë t'caktuar disa kameraman dhe kemi xhiru t'gjitha ato momente.

Derisa janë bo konsultimet a po vazhdon mbledhja, ku po vazhdon, qysh po vazhdon kemi bo disa intervista. Unë kom bo intervista me Adem Mikullovcin, me Sabri Hashanin, me Xhemajl Ibarin. Xhemajl Ibari pat' shku ni takim me Jusuf Zejnullahun edhe Hysen Kajdon që ka qenë në kryesi të Kosovës dhe si me vazhdu mbledhjen, pse s'po vazhdohet, pse s'po hapen dyert e kuvendit. Serbia kishte dhënë urdhër që t'mos mbahet kursesi mbledhja e Kuvendit të Kosovës me 02 korrik.

Edhe delegatët e Kosovës n'krye me Ilaz Ramajlin, Muharrem Shabanin, Skender Skenderin, Bujar Gjorgjealën dhe të tjerë Xhemajl Bajrën dhe të tjerë janë konsultuar edhe me, me disa avokat t'njohur ndërkombëtarë edhe disa veprimtar të të drejtave të njeriut mbarë botën. Eva Brendli e kanë konsultu i kanë thanë Eva Brendlit që si t'veprojmë tash po na mbyllen dyert. Eva Brendli edhe tjerët kanë sugjeru që s'o me rëndësi ku mbani mbledhjen po me rëndësi m'i pasë votat ju, m'i pasë forumin, me pasë legjitimitetin e plotë për me vendosë, me marrë vendime. Mundeni me mbajtë kudo, mundeni me mbajtë jashtë kuvendit.

Ashtu ka ndodhë, u mbajt para dyerve të kuvendit. Ne si gazetar edhe unë e kom pasë nderin që të raportoj nga kjo ngjarje historike. Ato ishin momente të papërshkruara. Kishim ni vullnet të jashtëzakonshëm edhe ishim t'bindur se edhe pse nuk lejohet hyerja e delegatëve shqiptar në sallën e Kuvendit të Kosovës, mbledhja do të mbahet. Ne kemi raportuar hollësisht nga kjo ngjarje historike. Kshtu ka qenë moment, moment shumë i paparë për neve edhe ni moment shumë i gzueshëm kur Muharrem Shabani, kur Bujar Gjorgjeala e hapi mbledhjen e Kuvendit të Kosovës në ato rrethana ku ishte ni shtet rrethim policor.

Policët aty afër kuvendit silleshin, ishin disa makina nga Beogradi, nga Kraleva. Edhe kishte shumë polic civil, të cilët në çdo kusht synonin ta pengonin punën e Kuvendit të Kosovës. Kshtuqë Bujar Gjorgjeala e hapi mbledhjen e kuvendit aty, i konstatoj forumin bashkë me Adem Mikullovcin edhe Muharrem Shabanin, si dihet, e ka lexuar tekstin e deklaratës kushtetuese të 02 korrikut. Të cilën e ka shkruar, autor i së cilës ka qenë profesori i nderuar akademik Gazmend Zajmi. Nji ekspert i çështjes kushtetuese, një akademik me renome ndërkombëtare.

Kshtuqë deklarata e tij u lexua dhe u miratua në mënyrë unanime nga t'gjithë delegatët, 111 delegatët e Kuvendit të Kosovës. Përveç shqiptarëve aty ka pasë edhe turq edhe boshnjak edhe të tjerë. Të cilët e kanë përkrahur këtë deklaratë me t'cilën Kosova shpallej njësi e barabartë në kuadër të ish federatës të atëhershme jugosllave. Nifar' mënyre kjo ishte ni shkëputje përfundimtare e Kosovës në mënyrë kshtu legjitime nga Serbia. Une aty përveç xhirimeve që bëm me delegat, bisedat me delegat dhe masi u lexu deklarata kushtetuese, gjithmonë si gazetar kom pasë idetë e mija. Kurrë nuk kom pritë që redaktorët

t'mi caktojnë temat ose t'më japin ide. Kanë dhanë ndonjë ide po zakonisht unë kom pasë iniciativën time edhe m'u ka kujtu.

Thom, e tash mirë, deklarata u miratu tash po pres t'i marrë disa opinione të qytetarëve të Kosovës çfarë mendojnë rreth deklaratës. Marrë kameramanin, Leonard Mulliqin edhe i thom, "Leo, hajde dalim n'qytet". Atëherë ka qenë Hoteli Bozhur i thojshin, Iliria ma vonë, tash Swiss Diamod. Aty ka qenë ni terasë e bukur jashtë edhe ka qenë ditë vere, korrik do të thotë vapë e mirë, kohë e mirë. Marr kamerën i thom, e nali ni kalimtar t'rastit pa e njoftë hiç.

Thom, "Mirëdita", "Mirëdita", thom, "Si e vlerësoni vendimin e Kuvendit të Kosovës për shpalljen e Kosovës njësi e barabartë në kuadër të federatës të atëhershme jugosllave?" Për ni moment aty polici, ni polic serb ka qenë komandant. Masanej e kom kuptu që ka qenë ni komandant i njërive speciale që ka ardhë nga Serbia. Më ndërpreu mu gjatë xhirimit. Unë si gazetar as nuk kom ditë ndonjë frikë se do t'kem pasoja, kom deshtë me kry detyrën time si gazetar. Ia kom bo pytjen atij qytetari i cili ka qenë, masanej kom kuptu që ka qenë Hamëz Gashi nga Çabiqi i Klinës, ni arsimtar.

Ai Hamza kur pa policin aty, mbetë. Ai s'mund t'fliste, s'kishte si me folë. Unë ia mbajsha mikrofonin po ai nuk guxonte të fliste, ishte pozitë shumë të palakmueshme. Polici mu m'u kërcënojke, "Ndërpreje xhirimin", i keni ato xhirime, i keni pa me siguri. "Ndërpreje xhirimin", "Prit ta kryj intervistën, kur ta kryj shkojmë". Ai, "Ndërpreje xhirimin", disa herë. S'pata zgjidhje tjetër. U paraqita para kamerës kshtu, "Shikues të nderuar, po e shihni se policia serbe s'po na lejon ta kryejmë detyrën prej gazetari, kërkojmë ndjesë".

Mirëpo unë prap se prap aty me atë policin u shtyna. I pari kisha dy tekste të deklaratës kushtetuese që ma kish dhanë mu edhe gazetarit tjerë Adem Mikullovc, na kish shpërnda. E kisha, m'i pa, m'i vrejti që i kom. M'tha, "Ma jep, i paske dy kopje a ma jep njanen?" Thashë, "Nuk jom i autorizun", thashë, "ty me ta dhanë", atij komandantit i thashë, "Nuk jom i autorizun me ta dhanë". Mujke me ma marrë me dhunë po unë s'dojsha m'u bo servil i tina. Thashë, "Kjo ka me u publiku n'gazetë zyrtare e merr atje ku duhet, rendi". Fillova pak me lujt me të. Aty nuk e përdori forcën ai.

Unë insistova që patjetër këtë bisedë me Hamëz Gashin ta zhvilloj patjetër ta kem në edicionin qendror t'lajmeve të Televizionit të Prishtinës. Pasi kaloj, iku polici me policët e vet, komandanti me policët e vet unë me ni vend pak ma larg atje afër televizionit e mora i thashë, "Hajde ktu fol se s'paska polic", edhe e kom bo intervistën me të edhe me ni tjetër. Ka qenë ni Raci m'duket, Hamëz Raci. Kshtu kemi transmetu edhe këto intervista t'cilat nuk kanë qenë të parapara n'atë skenarin që ne zakonisht në redaksi merreshim vesh po ka qenë iniciativë e imja që t'i kem edhe opinionet e qytetarëve dhe kjo doli shumë mirë, u realizu shumë mirë. U dha në edicionin qendror të lajmit të Televizionit të Prishtinës.

Secili e kemi kry detyrën tonë edhe kameramanët edhe gazetarët edhe redaktorët. Të gjithë kemi qenë në shërbim t'plotë të informimit. Atë natë ka qenë nata e bajramit, sa e di unë, nata e bajramit ka qenë. Ne tash, a din, 'Urime Bajramin', e bojshim ni ditë përpara. Qat' ditë u aprovu deklarata e kushtetutës

ishte ngjarje e madhe për neve. ‘Urime festa, urime festa’, edhe bajramin edhe 02 korrikun e kemi uru njeni tjetrin. Ka qenë, ka qenë në moment shumë me randësi për neve që edhe me gjithë pengesat që kishim nga policia ne kemi informuar.

Pastaj ka ndodhë me 05 korrik, mas tri dite, ato kemi vazhdu me qat’ ritëm, me qat’ mënyrë të informimit pa censurë. E kishim përkrahjen të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës atëherë që ka qenë Jusuf Zejnullahu. Kishim përkrahjen edhe të Ilaz Rrahmanit i cili ishte nënkryetar i Kuvendit të Kosovës, kishim kontakte me ta, kishim bashkëpunim me ta. Ata kishin disa informata që dishin. Thojshin, ‘Serbia po përgatitë disa masa të jashtëzakonshme kundër Kosovës pas kësaj që ndodhi’. Mirëpo ne vendosëm që t’ishim n’shërbim të plotë të informimit të opinionit dhe kemi informu.

Me 05 korrik i kemi caktu detyrat. Unë kom pasë për detyrë me bo disa biseda me disa delegat të cilët kanë qenë në atë kohë Kosova i ka pasë përfaqësuesit e vet edhe në Beograd, në Serbi, në Kuvendit e Serbisë edhe në Kuvendin Federativ. Unë e mora si temë që ta boj me disa delegat nga Kosova dhe i thashë, “A do t’shkoni në mbledhjen e Kuvendit të Serbisë?” Ishte 05 korrik e caktune mbledhja. Ata thanë, “Ne nuk shkojmë, nuk kemi nevojë me shku në mbledhjen e Kuvendit të Serbisë sepse Kosova tash është njësi e barabartë në kuadër të Federatës Jugosllave. Ne marrim pjesë vetëm në federatë, nuk marrim pjesë në organet e Serbisë sepse ne kemi shpallur nifar’ mënyre pavarësinë tonë”.

Unë i përgadis ato informata, ato biseda edhe edhe t’u i pa tash synimet që mund t’ketë rrezik që masa t’dhunshme në Radio Televizionin e Prishtinës mund ta bllokojnë policia dhe ushtria prap Televizionin e Prishtinës. Edhe pse ishin parapa që të transmetohet në lajmet e orës 07:30 në mbramje, unë bisedova me kolegët e mi, me Rexhep Kasumin, me Muhamet Mjekun që një pjesë të ktyne intervistave ta transmetojmë në lajmet, që kanë qenë, lajmet e para i thojshim atje. Kanë qenë kah ora 03:00 pasdite. Ato transmetoheshin edhe për rrjetin e gjerë të Radio Televizionit Jugosllav. Mundeshin me u pa edhe në Slloveni edhe në Kroaci edhe gjithkund. Ashtu ishte skema programore.

Ishin lajmet 15 minuta 20 minuta, ashtu maksimumi. Ne i përmbledhëm të gjitha ngjarjet që kanë ndodhë atë ditë në Kuvendin e Kosovës. Ishte në deklaratë, në bisedë e Skender Rumishit, me Skender Durmishit me Ibrahim Rugovën, kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ku kundërshton masat e Serbisë, masat e dhunshme të Serbisë në Kosovë nga Kuvendi i Serbisë. Dhe Rexhep Qosjen, Demaçin edhe disa opinione tjera. Ato ishin, qato deklaratat, bisedat e mija dhe i përfshijmë në edicionin e lajmeve t’para.

T’u mendu se meqë u dufke lajmet në ora 07:30 se ne ishim t’vetëdijshëm që ata do t’bëjnë përpjekje me pasë në ekip, me siguri në ekip që do t’punon në shërbim sipas dirixhimeve të Beogradit. Mirëpo ne ishim shumë të organizuar kështu me vetëdije t’lartë që kurrësi mos të jemi në shërbim të Beogradit po në shërbim të interesit të popullit të Kosovës. Sepse populli i Kosovës ish i përcaktuar për me qenë i pavarur dhe kurrësi t’mos jetë tutelë e Beogradit. Ato u transmetuan, ato gjatë transmetimit atyre lajmeve ka hy policia, si dihet që i keni pa. Ka hy policia, unë kom qenë aty në zyrën time ku rrishin redaktorët e lajmeve.

Për ni moment ka ardhë policia, ka hy edhe n'atë zyre aty. Unë isha ulur aty n'karrige. Kisha aty dy kasetat që menojsa nëse kemi mundësi m'i transmetu edhe në lajmet qendrore në ora 07:30. Ka hy ai komandanti që ka ndërpre aty n'qytet, i njeiti komandant. I armatosur ka qenë. Pas tij edhe nja dy polic tjerë në gjendje gatishmërie. Ni kameraman, ni kameraman po xhironte. Ishte kameraman i panjohur për ne po e dishim që është ose nga Beogradi ose nga Novi Sadi ose serb. Edhe kur e kom pa kameramanin, e kom marrë ni kurajo ma t'madhe, thashë, ka me qëndru burrnisht.

Ai ka tentu m'i marrë kasetat, detyra e parë kasetat ka tentu m'i marrë. Unë e kom qit' dorën kom thanë, "Mos i prek, s'janë për ty kto". Kur e pashë që po xhiron kameramani thashë nuk du me dalë si n'emër t'kolegëve aty, nuk isha vetëm Nuhi Bytyçi po isha një prej gazetarëve, një prej redaktorëve aty. Mos t'dal si qyqar. Ia kom qit' dorën i kom thanë, "T'lutem mos i prek kto, s'janë për ty", tha, "Vetëm t'i marrë". Ai nuk u sjell me arrogancë po tha, "Unë kom detyrë që çka marr materiale të dyshimta m'i marrë m'i shiku edhe pastaj çka mundeni me transmetu", thashë, "A ju jeni ardhë ktu me cenzuru? Ne nuk pranojmë me punu sipas diktatit t'juj".

Ai ka insistu m'i marrë edhe i ka marrë kasetat. Unë, nuk m'vyjke kurgjo vërtetimi po i thashë, "Ma jep ni vërtetim që m'i ke marrë ti kasetat", që nesër te kom edhe si dëshmi para opinionit botëror që qe Serbia çfarë censure po bon edhe ndaj gazetarëve, i pengon edhe gazetarët. N'atë mënyrë që me sensibilizu çështjen tonë. I ka thanë ni policit, "A ki vërtetime?" "S'kom me veti", "Shko atje në stacion policor". U shku ai shpejt edhe pas disa minuta i ka pru. E ka plotësu vërtetimin, e ka shkru kasetat numër kaq, kaq, kaq. Dy kasetat kanë qenë. I ka nënshkru që i ka marrë.

Prej asaj zyrës na kemi qenë nja dy-tre gazetar aty. Ka qenë ni Qerime Avdiu, m'kujtohet si sot, edhe dikush ka qenë tjetër, ka qenë kujdestar aty n'atë kohë. Na kanë qit' me ni zyre ni kat ma lart. Se s'kishte ishte koha e ndrrimit të paraditës, kta teknika që punojnë zakonisht me orar. Na gazetarët s'kemi orar edhe paradite edhe masditës sipas nevojës kemi punu. Aty derisa kanë ardhë ndrrimi i dytë i teknikës, pak kanë pasë ndrrimi i parë ka shku edhe ndrrimi i dytë sa ka fillu me ardhë. Na kanë çu me ni zyre teknike të drejtorit teknik ni kat ma naltë.

Aty ka qenë Mehdi Këpuska, une, Qerime Avdiu, dikush tjetër s'e di kush. Aty na kanë mbyllë kanë thanë, "Rrini ktu derisa t'ju urdhnojmë që mundeni me dalë". E kanë marrë në kontrollë krejt Televizionin e Prishtinës, çdo zyre, çdo kat, çdo studio, çdo pjesë. Mbas disa minutave na kanë çelë derën. Ka qenë si lloj burgu aty, i shkurt, po si burg. Na kanë çelë derën kanë thanë, "Tash mundeni me dalë". Na kemi dalë. Qashtu t'u bisedu shkallve t'u shku, t'u zbrit me dalë nga ndërtesa.

Polici kishte qenë, e dinte shqipen krejt. Kishte qenë i lindur diku me ni fshat të Klinës, aty ku u vra Adrian Krasniqi m'doket i atij fshati, Leqinë, jo Leqinë po ndryshe. Leshan, qaty te Leshani thirret. Kur, t'u dalë po thotë, "E keni tepru ju", thashë, "Çka po kërkon policia ktu? Nuk osht' mirë kjo, nuk osht' mirë për demokracinë. Ne jemi gazetar do t'bëjmë me kry detyrën tonë", tha, "E keni tepru", tha, "na kemi përcjellë programin e ju", tha, "sidomos kto ditë. E keni ba ni Shqipëri t'madhe". Mic Sokoli do programe i kemi pasë t'mira me t'vërtetë edhe muzikë edhe dokumentare, emisione tjera.

Kshtuqë tha, “E keni tepru”, tha, “për ata edhe Serbia ka vendosë me apliku masa t’dhunshme. Ju”, tha, “vazhdoni me punu”, tha, “vazhdoni me punu”. Kishe që ata janë shumë liberal, a din edhe s’pengojnë. “Po”, tha, “ju duhet me punu qysh t’ju thotë drejtori i ri”. Na kishim dëgju që drejtor i ri është caktuar Beqir Hoti me disa të tjerë. I them unë, thom, “Na nuk e pranojmë, nuk e pranojmë drejtorin e ri e kemi drejtorin tonë, Agim Malën edhe nuk i pranojmë urdhërat e tij. Na punojmë vetëm sipas standardeve tona profesionale edhe nuk pranojmë kurfar masa t’dhunshme”.

Sepse krejt krejt me apliku masa t’dhunshme në media, masat e dhunshme janë të pa qëndrueshme dhe ne si gazetar, si natyrë që kemi me informu në mënyrë objektive edhe në mënyrë t’lirë nuk mund t’i pranojmë, nuk shkon gazetaria e censuruar, gazetaria e dirixhuar edhe në mbikqyrjen e policisë. Kshtuqë i kemi ndrru ato biseda me të. Nuk ka qenë i vrazhdë, nuk ka qenë i dhunshëm. Unë e kisha ni vetëbesim në vetëvete edhe isha i vetëdijshtëm që edhe kolegët e tjerë nuk do ta pranojnë këtë diktakt të Beogradit. Kemi kalu nga ndërtesa që osht’ mbi rrugë, e kemi pasë edhe disa zyre në rrugë aty. Ku osht’ tash Agjensia e Privatizimit. Aty ka qenë bile redaktorët e lajmeve edhe gazetarët edhe disa shërbime tjera, programe tjera.

Bashkë me... ai komandanti na ka prit neve, ka dashtë çdo gjë me pasë në kontrollë. Jemi shku atje te zyra e redaktorëve t’lajmeve që atë ditë ka qenë kujdestar Asllan Bajrami edhe Skender Durmishi, Milazim Koci ka qenë si shef i programit. Aty kemi shku n’atë zyre edhe ka ardhë me neve edhe ky komandanti Mirko. E di që Mirko, Marko, s’po di. U hi aty për ni minut, sa ka hy ka thirrë të redaksisë në gjuhën serbo-kroate. “Shoku Marko, po du diçka m’u konsultu me ty”. Derisa ka dalë ai na jemi marrë vesh shpejt e shpejt, jemi konsultu në çfarë shtate kemi ardhë, a din.

Ka qenë, ka qenë vetëdija e lartë edhe te Asllani edhe te Skenderi që ne kursesi t’mos pranojmë sipas diktakteve, mos t’koritemi para popullit tonë. Se populli jonë kishte pritë me ditë të tëra n’radhë për të dhënë mjetet e fundit që kishte nga ekzistenca për familjen e vet dhe kishte thënë për ne gazetarët. E ne tash me u çu me përbuzë atë sakrificë, atë kontribut të tyre ishte e pakuptimt edhe intimisht edhe unë edhe kolegët e tjerë kemi qenë të vetëdijshtëm dhe pavarësisht asaj nuk guxon kursesi të jemi zëdhënës të Millosheviçit, të Beogradit.

Aty i kemi thanë që qito informata çka i kemi na s’mun na lejoni m’i transmetu, ngjarjet që i patëm lajmet e para edhe n’lajmet qendrore m’i transmetu veç m’i zgjeru edhe n’do informata tjera. Nëse ka cenzurë mos me pranu as kurgjo. Ashtu ka qenë ni vetëdije e jona. Na s’jemi taku as me Agim Malën ato ditë as kurgjo po vetëdija ka qenë ashtu. Jo vetëm te ne por te krejt populli që t’mos pranojmë diktaktet nga Beogradi. Aty n’atë kohë Asllani edhe ky Skenderi kanë shku te Beqir Hoti m’u konsultu, i ka thirrë ai në të vërtetë. I ka thanë, “Na i bini ato materiale çka i keni përgadit për lajme”, i kanë çu qato që i transmetum ma herët, Rexhep Kasumaj me neve.

Kur i kanë pa kanë thanë, “Jo, a jeni t’vetëdijshtëm ju çka ka ndodhë? Kuvendi i Serbisë ka marrë masa të jashtëzakonshme ka apliku masa t’dhunshme, e ka ndrru udhëheqësinë”. Atëherë ata s’janë pajtu, ka dalë prej zyrës edhe s’kanë pranu me punu qysh kanë dirixhu Beqir Hoti edhe bashkëpunëtorët e tij. Atë ditë kom dëgju pastaj që kanë ba përpjekje edhe nga policia edhe nga udhëheqja e dhunshme që

t'gjejnë ndonjë gazetar, ndonjë redaktor, ndonjë spiker i cili do t'i lexonte lajmet. Se ata kishin bo skenare që m'i bo vet lajmet aty, prej serbëve m'i përkthi edhe m'i transmetu në gjuhën shqipe (qeshë). Çka ka ndodhë? Kërkush s'ka pranë.

Kanë thirrë, kanë josh me pare, me pozita gjithçka. Kërkush s'ka pranë asnjë s'ka pranë hiç, asnjë punëtor i Radio Televizionit të Prishtinës. Ka qenë në vetëdije e lartë do të thotë e të gjithëve dhe do të thotë nuk ka qenë kjo kurgjo e montuar po ka qenë vërtetë e natyrshme në vetëdijësim i natyrshëm. Në vendosshmëri që kursesi të mos pranojmë ato urdhërat e Beogradit. Në ora 07:30 unë kom qenë në banesë duke pritur çka po ndodhë, mos kanë gjetë naj shqip folës, a din me na korit. Televizioni i Prishtinës është lidhë me Televizionin e Novi Sadit, me lajmet e Novi Sadit. Kanë qenë serbisht normalisht.

Aty janë dhanë edhe ajo kronika ku shihem edhe unë t'u kundërshtu policinë serbe që mos m'i marrë kasetat edhe ngjarjet tjera që kanë ndodhë atë ditë. Ato i kanë dhanë në mënyrën e vet. Do të thotë e kanë arsyetu vendimin e Kuvendit të Serbisë që osht' suprimu Kuvendi i Kosovës, është suprimu Qeveria e Kosovës. Në televizion dhe Rilindje janë apliku masa t'dhunshme edhe në institucione tjera. Kshtuqë unë jom gzu kur i kom pa që s'ka pasë asni gazetar, asni redaktor, asni spiker që s'ka pranë që të dal në mbramje aty edhe t'i pranoj nifar' mënyre masat e Kuvendit të Serbisë. Kshtu ka qenë.

Me 05 ka qenë ditë e vështirë mirëpo ne pritshim që bashkësia ndërkombëtare, faktorët ndërkombëtarë do të intervenojnë, do të ndikojnë te Beogradi që këto masa të shfuqizohen sa më parë. Televizioni i Prishtinës të vazhdoj punën e vet. 1300 punëtor shqiptarë nuk kemi pranë të punojmë do të thotë sipas urdhërave të Beogradit. Kshtuqë atë ditë, me 06 korrik kemi shku para televizionit për mos me thanë që kta s'po dojnë me punu. Na me shku me xhiru mediat tjerat edhe ndërkombëtare edhe tonat tjera, me xhiru edhe m'i paraqit që ne po dojmë me punu po me punu sipas, qysh kemi punu deri dje. Me vazhdu punën qysh kemi informu në mënyrë objektive opinionin.

Por, ata kishin fillu m'i ba disa lista, disa gazetar, disa redaktor që për ta kanë qenë pengesë. N'mesin e tyne në listen e parë kom qenë edhe unë. Pas disa dite na kanë konfirmu që ju jeni t'larguar, edhe me deshtë me punu s'muni me punu se jeni t'larguar nga udhëheqja e dhunshme. Na s'i pranojshim ato masa t'dhunshme. Kur dilke lista, secili gzohej thojshin, 'Shyqyr jom n'liftë aty e s'jom në mesin e atyne shqiptarëve të ndershëm që po munojnë ata me zgjedhë në ekip për me vazhdu punën'.

Ata ndërkohë mas disa muajve kanë gjetë disa shqip folës si Hajrie Spikerica e disa refugjat shqiptaro-malazez edhe kanë vazhdu m'i përgatit lajmet n'atë kohë. Mirëpo ato lajme kërkush s'i ka dëgju, ato lajme kërkush s'i ka shiku, atyne lajmeve kërkush s'ju ka besu. Ashtu ka qenë n'ato vite t'vështira. Kosova mbet pa informim, mbet në terr informativ. S'kishte as radio as televizion t'vetin edhe kshtuqë ndërkohë unë... disa koleg filluan m'u marrë me tregti, me mbajtë familjen se ishte lufta për ekzistencë, s'kishim t'ardhura ishte e kuptueshme ajo.

Unë nuk kisha ndonjë prirje për tregti as për ndonjë punë tjetër, kisha dëshirë m'u marrë me gazetari. Se krejt jetën time jom marrë me gazetari. Kshtuqë kisha ni, ni shok në Zvicërr. N'atë kohë s'ka pasë

viza, kemi mujtë me shku pa viza. E thrras n'telefon ni tezak të bashkëshortes time, Sylejman Beqën, i cili ka qenë në Zvicër. Ni veprimtar i Lëvizjes për Çlirimin e Kosovës, ma vonë edhe i Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ato ditë u themelu edhe Lidhja Demokratike e Kosovës e cila ishte ni lloj lëvizje gjithë popullore. Ma vonë dolën edhe partitë tjera shqiptare. Partia Parlamentare, Partia Shqiptare Demokristiane, Partia Fshatare, Partia Social Demokrate e tjera e tjera.

Kshtuqë unë fola me Sylejmanin edhe Sylejmani tha, “Ndash me ardhë ktu munësh me ardhë”, tha, “unë”, tha, “e kom shtëpinë ktu vend t'siguroj”, tha, “Unë”, thashë, “nuk jom i interesun si turist atje po unë”, thashë, “po du me vazhdu me punu si gazetar. A ka far' hapësire, a ka far' mundësie me punu diçka?” Tha, “Po”, tha, “unë jom në kryesinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës”, degës të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Zvicërr atje. Ishin edhe disa veprimtarë Shaip Latifi i cili, t'cilin e njihja gjatë punës time si gazetar. Ka qenë drejtor i Minierës në Golesh të Lipjanit. Ka qenë ni atdhetar i mirë.

Ai ka ikë n'atë kohë nga regjimi i Beogradit sepse kolegët e tij i patën arrestu edhe patën fillu ni proces gjyqësor sikur me minatorët e Trepçës, të grevës së minatorëve. Ata u patën solidarizu me grevën e minatorëve të Trepçës dhe Shaipi me ni Vokri e disa të tjerë kanë qenë ndër organizatorët aty për të cilët unë kisha raportu në Televizionin e Prishtinës. Kisha ni komunikim me Shaipin edhe ma ofrun që... thashë, “Si gazetar muj në ndonjë revistë, gazetë nëse keni mjete financiare me financu”. Filloj aty m'u tubu anëtarësia, mjetet, m'u tubu ni buxhet për solidaritet edhe për nevoja tjera. Kshtuqë thanë, “Kemi mjete hajde”, tha.

Unë nifar' mënyre ishte ideja ime që ta themeloj Gazetën Demokracia. Aty ishte demokracia n'formë, demokracia në Kosovë, demokracia në Shqipëri. Ishte ni frymë e re e demokracisë. Sinonim që meqenëse Rilindja nuk botohej ajo t'jetë një far' lloj përgaditje për vazhdimin e punës së rilindjes edhe jashtë Kosovës. Kshtu ndodhi. Ata kryesia e degës të Lidhjes Demokratike, edhe pse unë nuk isha kshtu si gazetar, nuk kisha dëshirë m'u kufizu me qenë në asni parti politike. Atje në Lidhje të Komunistëve na kanë imponue qëndrimin e komunistëve tash ishte demokracia. Por me qenë si i pavarur.

E pranun insistimin tim që të nxirret ni, idenë time që të nxirret ni revistë, gazetë javore. Dy javore, s'e di, ashtu. Fillum përgatitjet për nxjerrjen e numrit t'parë të gazetës. Dëshiroja që mos me qenë ajo gazetë partiake po m'i bashku të gjithë shqiptarët. Se atëherë kishte edhe Lëvizja Popullore e Kosovës vepronte në Zvicërr dhe ishin sindikatat e kishin disa aktivitete tjera që ishin n'shërbim të sensibilizimit të opinionit në Kosovë edhe më gjerë. Kshtuqë numrin e parë të kësaj gazete e kemi përgatitë bashkë me Kamber Thaçin ni koleg timin dhe bashkë me Avdyll Gërvallën, vllaun e Jusuf Gërvallës në familjen e Gërvallëve në Delimon të Zvicrës.

Aty me Hysenin kemi bashkëpunu me Avdylin edhe me veprimtarët e Lidhjes Demokratike n'atë kohë që kanë qenë në Zvicërr. Sylejman Beqa na ka përkrahë shumë, Latifi që thashë ma herët. Demë Jashari e disa koleg, tash mos t'i përmendi me emra se janë shumë. Nagip Murati e shumë shumë tjerë. T'cilët e kanë çmu punën time profesionale edhe do të thotë kom qenë i gatshëm që këtë gazetë

partiake që financonte Lidhja Demokratike ta shndërroj në ni tribun të hapur edhe për intelektualët e tjerë edhe që s'janë në parti. Ashtu ishte qëllimi im.

Une aty i pata thirrë Bacën Adem Demaçi, sa pat' dalë ai nga burgu. I thashë... Baca Adem ishte simbol i lirisë tonë, simbol i rezistencës tonë. I thashë, "Unë numrin e parë të kësaj gazete e kom parapa ni shkrim autorial tanin me nënshkrim tanin ta botoj n'faqen e parë të gazetës". Ashtu ka ndodhë. Baca Adem ma ka çu me telefaks shkrimin e vet. E kom botu në atë numrin e parë. Pastaj kom thirrë edhe të tjerët që kanë shkru. Kom bo ni intervisë me Dom Lush Gjergjin (to check min 34 e 09) me Zekerija Canën.

Në ato ditë bile në Delimon pat' ardhë me ni tubim, shqiptarët, senatori, kongresmeni Josef Dio Gardi nga Amerika bashkë me Osman Osmanin, veprimtari Osman Osmani, me Zekerija Canën edhe të tjerët. Ni tubim aty edhe i tubun disa mjete. Shqiptarët kanë qenë shumë solidar, kanë ndihmuar senatorët dhe kongresmenët amerikan për ta paraqitur çështjen e Kosovës në kongresin e senatin amerikan. Për ta sensibilizuar çështjen tonë atje sepse Serbia me propagandën e vet mudohej që të arsyetonte t'gjitha masat që mirreshin në Kosovë ndaj shqiptarëve. Aty do të thotë kemi fillu ni bashkëpunim të mirë me veprimtarët e Lidhjes Demokratike dhe veprimtarët e tjerë.

Pjesa e Pestë

Nuhi Bytyçi: Në Zvicërr aty ndërkohë, meqenëse demokracia ishte zyrtarisht organ i degës të Lidhjes Demografike të Kosovës atëherë selia qendrore në Prishtinë t'u e pa dhe nisi ni projekt shumë t'rëndësishëm. Po nuk kishte ide e Prishtinës po ishte ide e imja edhe pse s'isha unë aktiv në parti. Ata me qëllimin ma t'mirë me siguri, a din që, me më ndihmu edhe mu se s'kishte shumë gazetar n'atë kohë atje në Zvicërr. Me na ndihmu mu edhe Kamber Thaçit e kishin dërgu si përforsim Xhemajl Mustafën, kolegun e Rilindjes i cili ishte anëtarë i kryesis qendrore të Lidhjes Demokratike në Prishtinë. Ni gazetar me përvojë i rubrikës së kulturës, ni njeri i mirë, atdhetar.

M'kujtohet erdh Xhemajli. Atje na caktun edhe ni zyre në Cyrih. Lidhja Demokratike kishte buxhet edhe e kishin marrë ni zyre aty për punë për mbajtjen e mbledhjeve të Lidhjes Demokratike edhe redaksia me punu, redaksia. Na sigurun kompjuterët aty me punu redaksia e gazetës. Aty ni dhomë, unë e Kamberi me fjet ni dhomë. Ni dhomë aty në kuadër të atyne zyreve aty. Erdh Xhemajli me na ndihmu edhe shumë na ka ndihmu Xhemajli, kemi bashkëpunu mirë me Xhemajlin. Ka qenë njeri kooperativ, profesionist edhe korrekt. Mu m'ka ndihmu shumë t'drejtën me thanë, shumë m'ka ndihmu.

Aty Xhemajli kishte ni tretman tjetër se ishte i deleguar nga selia qendrore, nga Rugova, nga Fehmi Agani e tjerë. Kshuqë tash Xhemajli organizonte në bashkëpunim me kryesin e degës LDK-së në Zvicërr tubime t'ndryshme me veprimtar të Lidhjes Demokratike po edhe me veprimtar tjerë. M'kujtohet ni tubim ktu në Zvicërr që kemi majtë me veprimtarë të të gjitha partive politike shqiptare n'atë kohë që kanë zgjedhë për çlirimin e Kosovës. Ka qenë Komiteti për Kosovën në krye me Xhafer Shatrin. Edhe Xhaferi ka qenë në mbledhje aty. Emrush Xhemajli i lëvizjes edhe shumë veprimtarë tjerë.

Kshtuqë Mustafë Xhemajlin e kom taku po ashtu atje ku ni koleg i joni i Televizionit të Prishtinës vllaun e Emrushit... aty kemi majtë ni tubim edhe krejt mesazhi i atij tubimi ka qenë që qysh të unifikohen shqiptarët, jo të shkapërderdhen nëpër parti të ndryshme edhe të tregojnë jo solidaritet. Por, të jenë unik në paraqitjen e çështjes së Kosovës, çështjen e pa zgjidhur të Kosovës në Zvicërr dhe jashtë Zvicrrës në Europë edhe më gjerë. Kshtuqë mesazhi i atij tubimi ishte do të thotë, bashkimi i t'gjitha subjekteve shqiptare në ni front unik për avancimin e çështjes sonë. Aty edhe unë kom diskutuar si anëtarë i redaksisë, si kryeredaktor. Isha kryeredaktor i Gazetës Demokracia.

Kemi bashkëbiseduar me Xhafer Shatrin, me Emrush Xhemajlin, me Shaip Latifin edhe të tjerët dhe kemi kriju ni atmosferë të bashkëpunimit të ndërsjelltë. Sepse n'atë kohë ishte ni divergjencë e madhe në mes Lidhjes Demokratike dhe Lëvizjes Popullore për Çlirimin e Kosovës dhe subjekteve tjera, sindikatave e tjera. Ishte shkapërdherdhë dhe secila i kishte ato fondet e veta. Secila synonte të dominonte. Mirëpo mesazhi i atij tubimi ishte që t'bashkohen t'gjithë shqiptarët edhe t'jenë unik, t'jenë ma serioz edhe para zvicrranëve edhe para institucioneve tjera.

Kshtuqë bashkë me Xhemajlin kemi bashkëpunu mirë, kom marrë pjesë bashkë me të në tubime t'ndryshme. Kemi kriju ni klimë bashkëpunimi reciprok edhe kemi begatu. Gazeta osht' begatu dhe ky është mision se kta kishin përvojë ma t'madhe se unë n'gazetë. Unë kisha përvojë n'televizion ma shumë. Ata kishin edhe rrjetin e bashkëpunëtorëve në Prishtinë më t'madh dhe shumë koleg na kanë ndihmu edhe me informata tjera. Ndërkohë ka ardhë edhe Mehmet Kraja si përforsim edhe më i madh. Mehmeti ka qenë edhe ai anëtarë i kryesisë të Lidhjes Demokratike të Kosovës në Prishtinë. Kemi bashkëpunu edhe me Mehmetin edhe kshtu gazeta osht' begatu gjithnji e më shumë.

Ka pasë edhe ndikim edhe n'opinionin shqiptar atje në Zvicërr. Ndërkohë kanë ardhë edhe Mehmet Emerllahu edhe disa gazetar tjerë të Rilindjes dhe kshtu demokracia ka shërby si përgatitje për nxjerrjen e botimin e Gazetës Rilindja në Zofingen të Zvicrrës. Aty ka fillu do të thotë Gazeta Rilindja. Osht' botu në Zvicërr pastaj në Tiranë edhe kshtu osht' kriju ni bërthamë më e mirë për të vazhduar informimi i opinionit se në të vërtetë ishte, ishin shqiptarët në ni terr informativ.

Unë ndërkohë jom kthy, bashkë me Xhemajl Mustafën jemi kthy për ni ditë nga Zvicrra. Drejtën me t'thanë kurrë s'kom pasë dëshirë që, edhe pse isha pa punë edhe unë edhe bashkëshortja, s'kishim as të ardhura për ekzistencë. Po kurrë s'kom pasë dëshirë me lshu Kosovën. Atje kom pasë oferta me marrë edhe azil politik në Zvicërr, ma vonë edhe në Gjermani me marrë azil politik. Se ishin rrethanat dhe unë kisha argumente sepse kisha kasetën, policia serbe m'kishte hy n'zyre edhe s'kisha nevojë fort m'u mundu me improvizu diçka që jom i ndjekur. Po qe urdhnoni, jom filan fisteku n'zyre m'ka ardhë m'ka pengu m'ka qit' prej pune tash jom i rrezikun. Ashtu ishte e vërtetë.

Po kurrë nuk ka qenë synimi im që të largohem nga Kosova. Sepse konsiderojsha që boll ka shqiptar të larguar nga Kosova. Ishin larguar shumë e shumë shqiptarë për shkak t'dhunës, për shkak t'situatës politike edhe për shkak t'pamundësisë për me punu, me ezistu për me mbajtë familjen. Unë isha ndër ta që s'e kisha ekzistencën po thojsha edhe unë edhe tjerët me lshu krejt Kosovën atëherë çka kemi ba,

ia kemi dhanë Serbisë, ia kemi falë Kosovën dhe kemi hudh poshtë krejt atë sakrificë, krejt atë gjak të dëshmorëve, njerëzve, atdhetarëve që kanë gjenerata me gjenerata.

Sepse historia s'kishte fillu as me mu as me tjerët. Po shumë gjenerata para meje kishin kontribuar që Kosova të jetë e lirë, Kosova t'jetë e pavarur edhe ne duhet t'sakrifikonim secili diçka. Dikush me pare, dikush me sakrificë, dikush edhe duke dhanë jetën, dikush nëpër burgje e tjerë, e tjerë. Po nuk ishte qëllimi që t'gjithë me hy n'burg se u dufke me punu dikush për me çu përpara çështjen tonë. Unë isha njëri prej atyre idealistëve t'cilët mendojshim nuk bon me mbetë në perëndim, me lshu Kosovën.

Anita Susuri: Për sa kohë jeni kthy?

Nuhi Bytyçi: Po unë pas tre mujve jom kthy, s'kom nejt ma tepër. Xhemajli tha, "Po kthehem une", thashë, "Edhe unë valla jom mërzit isha kthy edhe unë me ty Xhemajl". S'kisha nxjerrë biletë as kurgjo të aeroplanit po s'kish problem, kish vende. Nja dy-tri ditë përpara shoqja ime n'telefon po m'thotë, thotë, "Po kisha ardhë edhe unë atje", e kishte Sylejmani tezake e kishte shtëpinë, kishte vend edhe Sylejmani na ofroi, mu m'kishte ofru disa herë përpara po unë s'isha interesu familjen me pru. Unë po menoja t'paktën m'u kthy prap në Kosovë dhe varësisht prej rrethanave me vepru.

"Ani bre", i thashë. Kish me ardhë me nejt ni javë ditë a dy e m'u kthy. Djali ishte i vogël, Arianiti. '81 osht', sa i kishte, nantë vjet i kishte. Ishte n'shkollë. Thashë... atëherë ishte koha e pushimeve hala. Thashë, "Ani ani po jo me nejt shumë", tha, "Jo s'po rrijmë shumë". Atëherë në të vërtetë s'kish nevojë viza, veç me nxjerrë biletën edhe me ardhë. U tuta thashë po vijnë edhe jesim ktu. Jom kthy. Si tha Xhemajli, "Po shkoj", edhe unë thashë, "Po kthehna me ty Xhemajl" (qeshë). Jemi kthy bashkë me Xhemajlin, si sot m'kujtohet.

E ka pasë banesën në Dardani aty. Me makinë jemi shku deri te banesa e Xhemajlit dhe jam shku në banesë timen. S'jom kthy ma në Zvicërr. Mehmeti ka vazhdu atëherë Rilindjen me t'gjithë unë s'isha anëtarë i redaksisë së Rilindjes dhe kshtuqë kom vazhdu punën. Kom punu si korrespondent i Televizionit Viktory. Ka qenë, osht' hapë ni televizion shqiptar në New York, Hys Shkreli ka qenë kryeredaktor i këtij televizionit. Hysin e kom pasë koleg të televizionit. Edhe pse s'kemi punu me ni redaksi, ai ka qenë në redaksi të kulturës, të dokumentar e tjera, kulturo-artistik e unë në programin informativ.

Ai ka ditë që unë jom marrë me lajme, programin informativ edhe ma ka ofru. Jemi taku n'qytet rastësisht tha, "Nuhi", tha, "a kishe punu si korrespondent i televizionit, po dojmë me hapë njo në Amerikë?" Thashë, "Me gjithë dëshirë, qita p'e pres", thashë, "tjetër punë s'po du me bo vetëm me gazetari nëse ka mundësi m'u marrë", tha, "Osht' shansë i mirë", "Faleminderit shumë për ofertën". Niherë n'javtë kom pasë obligim m'u paraqit për ngjarje çka po ndodhë në Kosovë me telefon se atëherë s'kem pasë kamera po si drejtpërdrejt. I kom përgatit krejt.

Konferencat për shtyp të Rugovës, aktivitete tjera sindikaliste, Hajrullah Gorani e tjerë që kanë mbajtë konferenca dhe aktivitete tjera edhe partitë tjera normalisht që kanë qenë pjesë e Lëvizjes Paqësore

n'atë kohë në Kosovë, të Alternativës së Kosovës. Kom raportu niherë n'javë për ngjarje. Ishte knaqësi për mu, a din, nuk ishte ngarkesë kurrsesi po ishte ni privilegj që ma dha. Plus m'pagunin, m'pagunin mirë për atë kohë. 150 dollar m'kujtohet si sot rregullisht m'i dërgonin përmes kushërive të atij Osman Osmanit, Avdullah Osmanit. Këtu në Prishtinë ka qenë bashkë me Fatos Kadriun.

Bile m'i sjellën, pinim nga ni kafe në Breg të Diellit atje edhe ishte, ishin t'holla t'mdhaja për atë kohë a. Unë me ato pare siguroja familjen time, siguroja ekzistencën familjes time. Nuk e kisha problemin e ekzistencës. Ndërkohë kom qenë korrespondent i Televizionit Zëri i Shqiptarëve në Berlin. Ka qenë ai televizion i shqiptarëve atje Offener në kuadër të Offener kanalit në Berlin. Sylejman Berisha ka qenë themelues i atij televizioni, ni veprimtar nga Kaçaniku. Ai, s'e di përmes kujt, qysh ka qenë ideja, ka thirrë me raportu nga Prishtina. Kom fillu me raportu për ngjarje qashtu qysh kom raportu për Televizionin Victory.

Në ndërkohë aty në Televizionin Victory u angazhu Muharrem Nitaj, ai ishte nip i themeluesit të ktij televizionit, Osman Osmanin. Ai kishte thanë, 'Unë s'kom ekzistencë edhe ka qenë mirë me më angazhu mu'. Atëherë s'ka pasë nevojë për dy korrespondent nga Prishtina. Atëherë e ka angazhu Muharremin meqenëse e ka pasë edhe nip edhe s'e ka pasë ekzistencën e sigurune, ka qenë shumë e natyrshme. Unë u pajtova, thashë, "Jo s'ka kuptim", thashë, "mos me ia leju nipit të Osmanit me raportu". Ka vazhdu ai. Unë kom vazhdu në Televizionin Zëri i Shqiptarëve. Kom raportu ni kohë, kah 200 marka i kom marrë n'atë kohë që ka qenë pare e madhe.

Masanej ndërkohë ka lind ideja që unë t'shkoj ta udhëheqi televizionin atje në Berlin. T'jem kryeredaktor i ktij televizioni atje. Si thashë edhe ma herët, kurrë s'kom pasë dëshirë me qëndru jashtë, pavarësisht që kom pasë oferta edhe për punë edhe për azil e krejt. Nuk ka qenë dëshirë. Unë thashë, "Vi përkohësisht pak edhe kthehna apet në Prishtinë" (qeshë), edhe ashtu ka ndodhë. Unë i thashë atij themeluesit të atij televizionit i thashë, "Unë vi po pa shokë s'muj me punu, pa koleg t'mi".

E kom propozu Rexhep Kasumaj, ka qenë koleg i joni. Ai ka pasë prirje shumë për komente politike. Rexhepi edhe sot shkrun në këto portale për zhvillime të ndryshme. Edhe e kom... i thashë, "A pajtohesh m'i marrë edhe nja dy koleg?" E kom marrë Rexhep Kasumin edhe Shaqir Foniqin. Shaqa kulturën e ka përcjellë, ni koleg i joni djalë i mirë, bashkëpunëtor i mirë. Kemi shku. Me Rexhepin niherë kemi shku në Zvicërr për ni aktivitet, se unë kom qenë ni kohë edhe veprimtar, anëtarë i kryesisë së Partisë Shqiptare Demokristiane.

Thashë, edhe pse n'parti kurrë si gazetar nuk osht' mirë me qenë n'parti mirëpo atëherë ka qenë koha që të kontribojmë dhe ta gjejmë mënyrën me kontribu dikund. Kisha ni ofertë prej Lazër Krasniqit dhe kojshisë tim Mark Lekajt. Insistun shumë që t'ju ndihmoj atyne sepse Partia Shqiptare Demokristiane u bë krah i fortë i lëvizjes paqësore n'atë kohë, i Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe ka kontribu shumë në sensibilizimin e opinionit ndërkombëtarë për Kosovën në Europë. Kishte lidhje drejtpërdrejtë me Partinë Demokristiane Europiane dhe aty ishte edhe qëllimi që edhe ne shqiptarët e besimit islam të jemi pjesë e asaj partie, që t'mos thonë që kjo parti vetëm e katolikëve. Po parti gjithë shqiptare.

Aty ka qenë anëtarë i kryesisë Avdullah Karagidiu ka qenë Zejnullah Gruda, ka qenë figura intelektuale të shquara. Ymer Jaka, profesori Ymer Jaka. Ka qenë Tade Rodiçi, ka qenë, masanej u bo edhe Mark Krasniqi, profesori Mark Krasniqi, akademiku Mark Krasniqi, t'cilin e kemi propozu me udhëheq këtë parti pas vështirësive që kishte Ilaz Krasniqi. Kishte me qëndru në Kosovë se ishte i ndjekur nga regjimi. Pastaj do të thotë kanë qenë edhe shumë e shumë profesor tjerë të respektuar të cilët kemi bashkangjitur ksaj partie për të kontribuar edhe ne në kompletimin e atij spektri politik të alternativës shqiptare në vitet e '90-ta.

Kshtuqë shkum në ni aktivitet me Rexhep Kasumaj bashkë se edhe Rexhepi ishte anëtar i kryesisë i Partisë Shqiptare Demokristiane. Shkum në Zvicërr, në Gjermani edhe nga aty masi kishte oferta për me shku në Berlin, i hypëm trenit. Kemi bo pesë-gjashtë orë, ni tren shumë i lirë ish kanë kshtu lokal që osht' vikendeve me ni kosto shumë t'libër. Se s'kishim buxhet t'madh na n'atë kohë t'papunë ishim. Kemi shku në Berlin atje nga Zvicrra. Bile na skadoj viza se fillun me apliku vizat pastaj, ka qenë '93, viti '92-'93 qashtu fillun m'u apliku vizat. Na kaloj.

E morëm na ni vizë për dhetë ditë a sa kem punë në Zvicërr. Tham, "A bon me na dhanë se kena në Gjermani me shku?" Në kufi të Gjermanisë na dhanë vizën. Aty afër St. Gallen ka qenë, afër Bazelit ni pikë kufitare. Gjermanët na dhanë vizën aty, si gazetar. Na tham, 'Jemi gazetar'. Kishim ato librezat e gazetarëve që bashkëpunojshim me Televizionin e Berlinit. Kshtuqë na dhanë vizat, vazhdum na shkum në Berlin. Unë meqenëse nuk dojsa me qëndru në Berlin, s'kisha aspirata me qëndru në Gjermani. Tash Rexhepin e bonën kryeredaktor. Unë thashë, "I ndihmoj Rexhepit", edhe Shaqa erdh ndërkohë.

Shaqën e sigurum, erdh Shaqa edhe kemi bashkëpunu dy-tre muj qashtu s'kom nejt ma tepër. Kemi bashkëpunu, kemi majtë program sa kemi mujtë, sa kemi pasë kushte. Na kanë përkrahë bashkëatdhetarët shumë aty. Kemi bo intervista të ndryshme. Na ka ndihmu edhe Milazim Vllasaliu edhe disa koleg tjerë. Kshtuqë e kemi bo ni lloj tribune aty për informimin e shqiptarëve të rajonit të Berlinit se ai televizion s'ka mujtë m'u pa jashtë Berlinit. Në Berlin edhe rrethinë. Gjermanët na kanë siguru aty studion për m'i transmetu programet pa pare, pa asni lek.

Neve na ka ndihmu Sylejman Berisha me kta veprimtarët e tjerë të Klubit Bajram Curri të Berlinit për m'i mbulu shpenzimet e ekzistencës tonë aty në Berlin edhe naj markë me çu edhe në Kosovë familjes. Kemi qenë modest nuk kemi kërku privilegje t'mdhaja aty. Jemi socializu me ata bashkëveprimtarët aty. Kemi bo përpjekje që t'i organizojmë n'aspektin politik. Se kishte aty edhe nga Tetova edhe nga viset e tjera edhe nga Presheva edhe mbarë Kosova edhe viset e tjera edhe nga Shqipëria. Që ta krijojmë ni fond unik të veprimit të organizimit të shqiptarëve në Berlin edhe rrethin.

Kishte shumë afarist të shquar aty edhe ka qenë ni Dobruna nga rrethi i Deçanit e tjerë, e tjerë, s'po mund t'i përmendi me emër t'gjithë se kom nisë edhe m'i haru. Por, kanë qenë me t'vërtetë t'gatshëm me kontribu, me ndihmu t'gjithë intelektualët edhe në Kosovë edhe atje që të përballohet sa ma lehtë edhe të krijohet ni front i lëvizjes gjithë kombëtare për të kundërshtuar Serbinë për të avansuar çështjet e Kosovës edhe në Europë.

Anita Susuri: E ju ndërkohë ktu në Prishtinë keni ble banesën, keni jetu me familje në Prishtinë. Po deshta me ju pytë për familjen e ju, për shembull, si jeni njoftu me grun? Si e keni formu familjen?

Nuhi Bytyçi: Po. Unë si gazetar në Televizionin e Prishtinës jom njoftë edhe aty me bashkëshorten time, edhe ajo ka qenë gazetare, ka përcjellë shëndetësinë në Televizionin e Prishtinës. Aty ka qenë fati që t'njihemi dhe të martohemi. Shoqja ime, Ryva, është pedagoge e diplomuar edhe me të kom ni djalë Arianitin i cili është arkitekt i përkushtuar. Pastaj, e kemi ndërtu do të thotë familjen dhe në bashkëpunim me Radio Televizionin e Prishtinës ma ka mundësu ni banesë dy dhomëshe. Po unë i kom pasë do mjete t'mija edhe kom deshtë me pasë ni banesë pak ma të zgjeruar, tre dhomëshe dhe këtë diferencë e kom pagu vet, pjesën tjetër televizioni.

Kshtuqë jemi në bashkëpronësi kshtu në bashkëfinancim e kom siguru banesën që e kom edhe sot. Qat' banesë e kom arritë të ndërtoj ni shtëpi edhe pse andrra ime si një që jom rritë n'fshat kom pasë qef ta kem ni shtëpi, ni oborr, ni bahçe. Po mundësitë t'tilla ekonomike kanë qenë që unë gjithmonë i përkushtuar me gazetari dhe gazetaria s'mund, vështirë me ba shpi e pasuri, s'jam marrë me biznes. Kshtuqë kom arritë me siguru ni ekzistencë, ni standard normal sikur shumica e familjeve të Kosovës. Me punu ndershëm edhe me kriju ni familje të ndershme, ni familje që punon dhe sakrifikon edhe për interesin ma t'madh.

Kshtuqë aty në banesën në Breg të Diellit ku jetoj prej vitit 1984-'85, aty kemi kriju me fqinj të raporte shumë t'mira me fqinj të aty. E kom Gani Sejdiun ndër fqinj të e parë të asaj kohe. Nga themelimi ndërkohë u ndrru struktura kanë ardhë fqinj të tjerë. I kanë shitë banesa, kanë ble shpi dikush, ka ndërtu shtëpi. Kshtuqë është ni strukturë krejt tjetër. Po Ganiu prej fillimit, me të kemi pasë ni raport t'mirë ndërfamiljar. Unë për familjen time mund t'them se Arianiti, jo që është djali i vetëm i familjes i imi, por me Arianitin kom kriju ni rapport ma shumë si shok jo si djalë-babë, a din. Jo në atë mënyrën e vjetër, hajt se ti je fmi ti s'din.

Po gjithmonë i kom thanë që, 'Lirisht shprehe mendimin tond, idetë e tua edhe para meje. Ato çka janë t'mira unë t'i pranoj edhe idetë e mija, sugjerimet e mija unë t'i jap lirisht. Ato që t'konvenojnë i merr, ato që s'konvenojnë ti vendos vet'. Nuk kom qenë kurrë imponues që me çdo kusht me ia imponue jetën, qëndrimin edhe gjithë ato tjerat që ka qenë përpara. Arianitin e kom kshilltarin ma t'mirë për t'gjitha puntë edhe m'ka motivu shumë me punu edhe ai lexon shumë.

Tash kohëve t'fundit ma shumë se unë lexon. Ka ndiku që gjithë punën time që kam bërë në kohë të vështira ta rrumbullakësoj, ta nxjerri ni libër të kujtimeve t'mija si gazetar. Sepse fati ka deshtë që unë si gazetar të përcjelli të gjitha ato zhvillime ma të rëndësishme në të cilat ka kalu populli i Kosovës. Kom botu atë librin e luftës me titull Libri i Luftës. Luftës sepse pjesa kryesore e punës time ka qenë raportimi nga lufta edhe ka qenë ni punë e jashtëzakonshme, ni punë shumë e vështirë. Ni punë e cila ka deshtë, përveç përkushtimit profesional, është dashtë edhe ta bësh ni sakrificë jo vetëm personale po edhe familjare.

Unë me raportu nga lufta kurse familjen e kisha në Prishtinë, ata ishin ma t'rrezikun se unë, djali edhe shoqja ime. Shoqja, thashë, e kom pasë përkrahjen e bashkëshortes e cila m'ka ndihmuar, m'ka inkurajuar edhe ajo të punoj dhe unë kom arritë t'ja siguroj ekzistencën dhe ajo t'mos ketë pastaj vështirësi edhe unë po ashtu t'mos kem pengesa për t'punuar. Arianiti ndërkohë është martuar me Lumturie Selmanin, bijen e afaristit të njohur dhe veprimtarit të shquar të çështjes kombëtare, Bedri Selmanit.

I cili gjatë kohës së luftës ka vepruar në Kroaci dhe ka ndihmuar gjithë ata oficerët që e kanë braktisur armatën jugosllave. I ka organizuar ata, shumicën e tyre si Agim Çekun edhe të tjerët për t'ju bashkangjitur Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ka ndihmuar edhe materialisht në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kshtuqë Bedriun unë e kom njoftë para se me pasë fatin Arianiti m'u njoftë me vazhën e tij, Lumturijen, ma t'madhën. Kom pasë shok qysh prej vitit 1999 kur e kom taku për herë të parë në Tiranë kur kom shku me punu në Televizionin Shqiptar.

Aty e kom taku me disa afarist nga Amerika dhe nga Europa edhe kom pa ni njeri shumë t'vendosur, ni intelektual për të sakrifikuar dhe kontribuar për Kosovën në ato rrethana t'vështira. Krejt pasurinë e vet e ka shit për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Lumturia me Arianitin m'kanë bërë gjysh tri herë. Riana tash i ka dhetë vjet, është ndër nxanëset ma t'mira të Shkollës Amerikane në Prishtinë. Ajo anglishten e ka mësu nga kompjuteri edhe flet bukur anglisht. Unë i kom lakmi asaj se me pasë ditë anglishten unë do t'isha gazetar edhe ma i njohur edhe jashtë Kosovës. Ka qenë hendikepi ma i madh i punës time. Ne gjenerata jonë pak kush e ka ditë gjuhën e anglishtes ose frangjishtes ose gjuhë tjetër.

Kshtuqë pastaj tash i kom edhe ni nip edhe ni mesë tjetër. Aria edhe Lumi, të cilët mua më japin vullnet me punu edhe më tutje. Edhe pse jom në penzion tash mirrem edhe me ta edhe ata më motivojnë me punu, sidomos Riana. Ajo lexon shumë shumë, punon shumë edhe e dua shumë edhe m'don shumë. Kshtu fati ka deshtë që familja ime në të vërtetë tash të kompletohet ashtu si duhet dhe jam optimist se kom ni familje shumë të lumtur dhe mua më inkurajon që t'punoj edhe më tutje edhe pse thashë jom n'moshë tash po kom ende vullnet t'madh.

Nipi dhe mbesat m'japin vullnet t'madh, sidomos Lumturia. Por Arianiti me sugjerimet e veta, me idetë e veta, me kshillat e veta, më kontribon që unë ato punë që s'kom arritë m'i kry ma herët tash t'i kryj. Ta bëj ni seri dokumentarësh për sakrificën e popullit tonë për rrugëtimin e popullit tonë në periudhat ma t'vështirat të popullit tonë.

Anita Susuri: Çka ka qenë për juve edhe si ka qenë me balancu jetën personale dhe karrierën? Kur gjithmonë keni qenë t'u raportu prej vendeve të rrezikshme ose vitet e '90-ta kanë qenë të rrezikshme?

Nuhi Bytyçi: Ashtu. Tash t'them t'drejtën nuk ka qenë lehtë. Por, kur ti si gazetar e kryen detyrën në mënyrë profesionale edhe je, tashmë je publik, je figurë publike edhe nuk munësh ti m'u sjellë, ni ftyrë me pasë ndryshe për publikun, ni ftyrë tjetër ndryshe për rrethin e ngushtë ose për dikënd. Unë jom mundu gjithmonë me qenë real edhe kurrë mos me mshef që jom gazetar. Gjatë luftës e kom mshef se kanë qenë arsytet.

Por, para luftës kur m'kanë dalë policia, kur kom shku në Televizion Shqiptar me montu emisionet e mia se ktu në Prishtinë nuk kemi pasë kushte m'i montu, kom shku shpesh në Tiranë m'i montu dhe m'i transmetu në Televizionin Shqiptar. Ku kom pasë përkrahje t'madhe nga udhëheqja e atëhershme e Televizionin Shqiptar në krye me Qemal Sakajevën, me Eduard Mazën edhe kolegët e tjerë. Kur jom kthy në Kosovë edhe kta policia e Maqedonisë kom has, jom marrë në biseda informative edhe nga Sigurimi Shtetnor i Maqedonisë edhe nga Sigurimi Shtetnor i Serbisë. Po kurrë nuk e kom mshef që jom gazetar.

Ata e kanë ditë po edhe unë kom thanë që nuk ka nevojë me rrejt, mburrem që jom gazetar, informoj realisht, nuk improvizoj kurgjo, nuk rrej kurgjo. Ju kom thanë bile aty kur m'kanë marrë në biseda informative punëtori i sigurimit shtetnor serb në Han të Elezit viti '97, korrik të '97-tes kur jom kthy nga Tirana. Pasi m'nalën në kufirin Shqipëri-Maqedoni, ata si duket kanë bashkëpunu, sigurisht kanë bashkëpunu, Sigurimi Shtetnor i Maqedonisë. Ata e kishin informu për mu që, 'Osht' ni gazetar Bytyçi, na e kemi nalë tash me siguri ai kalon në kufinin nga ju atje edhe nalne'.

Kur jom mrri në kufi në Han të Elezit, ata maqedonët m'i kanë marrë pesë gazeta ose ma shumë, s'disa kaseta që i kom pasë unë pasi kom ardhë m'i montu atje në Tiranë. Ma ka dhanë vërtetimin po kurrë s'mi kanë kthy. Bile aty e kom pasë edhe ni kaset ku e kom bo ni dokumentar për veprimtarin e shquar Avdyl Lahun, dajën e Bacës Adem Demaçit. Ka qenë veprimtar i shquar. Edhe ma kanë marrë kasetën e varrimit të tij, të cilët origjinalin ma ka dhanë familja.

I luta policin të sigurimit shtetnor maqedon thashë, "T'lutem, e kom ni kaset osht' ni vorrim, familja ma ka dhanë t'lutem këtë mos ma merr". Po ai ka dyshu mos ka diçka tjetër, mos po mshefi diçka tjetër. N'atë kohë ishin ato protestat me Gostivar për flamurin kombëtar, Rufi Osmani që u pat' burgosë e sene edhe na në Televizion Shqiptar patëm raportu për ato ngjarje në Televizion Shqiptar. Patën mendu mos i kemi ato, mos ka ndonjë xhirim ajo protestë.

M'i morën të gjitha kasetat që i kisha aty n'çantë edhe u ndjeva shumë keq. M'erdh keq për qit' kasetën e fundit t'familjes që kisha premtu që do ta ruaj dhe do t'ia kthej familjes Lahu. Kur u ktheva, dy-tri orë aty kom prit në Qaf Thanë në intervistë. Më merrshin në informata për çka, ju tregova që kurgjo s'kom kundër juve, kundra Beogradit kom, kundra juve kurgjo. Thashë, "Unë jom t'u bo emision nga Kosova edhe për arsimin e për veprimtarët e Kosovës s'kom kurgjo kundra juve", kishe që mos më malltretoni pa nevojë.

Ata e kishin informu sigurimin shtetror serb në Han të Elezit. M'nalën, hyni në autobus polici, tha, "Kush osht' Nuhi Bytyçi ktu?" Serbisht. Thashë, "Unë". E dita që kanë lajmëru ata. Tha, "Merri teshat çka ki dil, çantën merre zbrit". E dita që dojnë me m'nalë ma shumë aty. Kisha gazeta aty, Rilindja Demokratike, Zëri i Popullit. I lash aty që t'mos më bojnë sherr ma shumë, i lash në autobus. I kisha nja 400 marka m'i pat' dhanë regjisorin Esat Brajshori me ia çu nanës t'vet. E kishte nanën në Prishtinë, t'lodhur. Tha, "Nuhi a s'priton me ia dërgu nanës", m'tregoj ku e ka shpinë. Thashë, "S'ka problem".

I mora edhe tash m'ra n'mend thashë masi po më zbresin m'i marrin t'hollat e Esatit e thashë jet' nana pa t'holla, gjyna. Ia kom dhanë ni shqiptari ishte n'karrigë me mua aty. Ka qenë ni Musli Musliu m'kujtohet se ia mora emrin me ditë kujt ia kom dhanë, a din. Tha, "E kom ni dyqan në Pallat të Rinisë në Prishtinë", thashë, "Ani vi tani i marr unë mas do dite". M'pa polici t'u ia dhanë t'hollat atij. Tha, "Çka i dhe?" Thashë, "Ia dhashë do t'holla". E zbriti edhe ata. Thashë do me bo telashe edhe ktij, a din. Edhe e luta policin thashë, "T'lutem ato janë t'holla t'mija edhe ky s'ka faj kurgjo, mos e malltretoni kta. Çka keni keni punë me mu". E zbritën ata, tha, "Ti kqyre punën tane".

Ata e çun tjetër kund mu m'çun te ai sigurimi që m'pritke sigurimi shtetnor serb me më marrë në bisedë informative. Po m'tregon masanej jom taku me atë Musliun. Po m'tregon tha, "M'kanë rreh", tha, "m'kanë rreth sherri yt. M'kanë rreh goxha shumë që me kond ti po bashkëpunon ai shumë i rrezikshëm, gazetar i rrezikshëm shumë. Qysh po i ndihmon ti atina", edhe e kishin pasë rreh.

E luta ata të sigurimit shtetnor serb aty i thashë, "Mos i malltretoni bashkë udhëtarin tim se s'ka faj ai kurgjo, ai është ni punëtor i thjeshtë ka ardhë me mbajtë familjen prej Tetovës, prej ni fshati të Tetovës. Do t'holla", thashë, "m'i ka dhanë Esat Brajshori ni koleg i jemi edhe me ia çu nanës t'vet e ka smutë", thashë, "edhe me ia dorëzu s'ka kuptim", thashë, "ju kisha lut që t'keni mirëkuptim. Unë jam njeri serioz, s'merrem me tregti as kurgjo punë t'paligjshme. Ato janë pare t'atij shoku edhe me m'i kthy ato pare me ia kthy familjes".

M'i kanë kthy paret, m'i kanë dhanë paret. Kanë qenë shumë korrekt, nuk mund t'them tash. Kanë kalu sa vite s'mund t'them kurgjo. Ai e ka kry detyrën e vet, u mundu me siguru ndonjë informatë nga unë, me kond jom taku atje, çka kom ba atje, çfarë emisione kom montu. Unë i tregova thashë, "Kto emisionet nga Kosova, për arsimin për krejt çka duhet". Nuk mshefa kurgjo se ato ishin publike edhe s'kishe çka veç çka koritesh. E kom pasë ni parim që unë jom gazetar edhe nëse kom pasoja edhe bota le të informohet çka po bon Serbia ndaj gazetarëve. Ky ishte ni kontribut ma i madh sesa me thanë unë nul jom gazetar, m'u mshef e me rrejt. Edhe me t'rreh edhe me t'dënu edhe i koritun.

Thashë, "Unë punoj", thashë, "ky osht' profesioni im edhe", thashë, "ju kisha lut t'hollat me mi dhanë". M'i dhanë t'hollat. E kisha ni librezë të Shoqatës të Gazetarëve, Federatës të Kosovarëve me seli në Bruksel të pavarur të botës. Ishte nifar' legjitimimi, nifar' përkrahje që ishte ni, ni e kishim ni mbrojtje. Nëse arrestohesh ose burgosesh ose diçka ishte, na ishim anëtarë të asaj federatës së gazetarëve i informonim çka ka ndodhë me neve. Nuk ishte rasti i parë që mirreshim në bisedë informative, ishin edhe shumë koleg tjerë që ishin marrë para meje.

Kshtuqë i thashë, "Unë jom anëtarë i Shoqatës së Gazetarëve të Pavarur, me seli në Bruksel dhe ju kisha lut", thashë, "nëse ndërmerrni diçka ndaj meje, unë duhna m'i informu ata". Ata marrin vesh edhe prej kolegëve tjerë çka ka ndodhë e sene, t'keni kujdes. Dojsha megjithatë me tregu që unë jom njeri serioz edhe nuk jom njeri hajgarexhi ktu. Tani u munu ai m'i nxjerrë do informata po ishte e pamundur m'i nxjerrë ato informata sekrete.

Tha, “Kemi informatë me kond je taku”, thashë, “Jom taku me kolegët e mi, me Asllanin, me Esatin, me tjerët. Kolegët e mi të Televizionit Shqiptarë, bashkëpunoj me ta”, thashë, “ky është profesioni im dhe nëse juve s’ju pëlqen puna ime që unë e bëj”, thashë, “nashta as mu s’më pëlqen puna jote që e bon se te dyt i kryjmë detyrat tona. Ti detyrën tane, unë detyrën time”, thashë, “duhet me qenë korrekt”. Ka qenë korrekt, me të vërtetë as s’më ka fy as s’më ka rrah as kurgjo.

Aty ka qenë ni bisedë dy orë e ma tepër. Mandej kur kom dalë nga aty tha, “Ni pyetje”, tha, “a ishe kthy”, tha, “ti me punu në Televizionin e Prishtinës”, atëherë që punojke Hajrie Spikerica (qeshë). Kom keshë thashë, “Me gjithë dëshirë kur kthehen kolegët e mi”, thashë, “qat’ ditë p’e pres. Me dëshirën ma t’madhe. Qat’ ditë jemi t’u prit. Kur t’kthehen gjithë”, thashë, “Po tash a ishe kthy?” “Jo”, thashë, “faleminderit shumë për ofertën. Kom pasë oferta edhe atëherë kom mujtë me punu”, thashë, “jo nuk pranoj kurfar diktakti nga askush”, thashë, “kur t’krijohen kushtet me punu t’gjithë kolegët e mi punoj edhe unë. Qat’ ditë p’e presim”.

M’lshoj, m’liroj. Kur dola unë thashë tash kisha dashtë me m’gjetë ni taksi diçka ni autobus tjetër me prit, kur ish kanë autobusi t’u prit me udhëtar ashtu. Ka qenë ni autobus i Novi Pazarit, m’kujtohet si sot. Ka qenë me udhëtar kryesisht shqiptar po edhe boshnjak ka pasë sigurisht. Mu m’erdh keq prej tyne që kanë prit, kërkova falje. Thashë, “Kërkoj falje”, thashë, “që keni prit shkak im po s’kom pasë, kom qenë i pafuqishëm n’këtë drejtim, s’e kom ditë kom mendu që keni shku bile”. Kshtu ka qenë.

Anita Susuri: S’kanë përdorë dhunë ndaj...

Nuhi Bytyçi: Jo nuk kanë përdorë.

Anita Susuri: E a është kthy edhe ai që kanë përdorë dhunë n’to?

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: Osht’ kthy edhe ai?

Nuhi Bytyçi: Po, po u kthy edhe ai. Ai ishte kthy pak ma herët se unë. Tani jom kthy në Prishtinë e kom informu Xhemajl Mustafën për këtë bisedë informative. Xhemajli ia ka prezentu Presidentit Rugova aty në konferencën për shtyp që mbahej çdo të premte edhe e ka paraqit se gazetari Nuhi Bytyçi është ndalë, është marrë në bisedë informative nga Sigurimi Shtetnor në Han të Elezit edhe ashtu, kshtu. Ajo informatë është plasur edhe në mediat botërore se ata e nxirrnin edhe informatorin në gjuhën angleze, Qendra Informative e Kosovës e botonte informatorin edhe në gjuhën angleze.

Anita Susuri: A keni raportu ju n’vitet e ‘90-ta për daljen e UÇK-së për grupet?

Nuhi Bytyçi: Une për paraqitjen e parë publike në, ktu në Llaushë, nuk kom raportu. Bile atë ditë kom pasë me shku, kom pasë me shku me do shokë e kom pasë planifiku me shku n’vorrim se s’e kemi ditë që ka me dalë UÇK-ja aty. Kërkush. Na s’e kemi ditë se UÇK-ja, na s’e kemi ditë. Tha, “Me shku n’vorrim me marrë pjesë”, me disa koleg u morëm vesh. Po s’kishim makinë u bo puna ashtu nuk mujtëm me

shku. Pastaj aty Rexhep Selimi si dihet Daut Haradinaj ka qenë edhe Mujë Krasniqi janë paraqit për herë t'parë publikisht në Llaushë me 28 nëntor 1997. Varrimin e msusit të Halit Geci.

Pjesa e Gjashtë

Nuhi Bytyçi: Tash, si thashë ma herët, Kosova mbet në terr informativ. Televizioni Shqiptar ende nuk i kishte emisionet e veta posaçshme për Kosovën. Jipte ndonjë informatë siç jipnin agjensitë tjera botërore t'lajmeve çka po ndodhë në Kosovë. Po kshtu në mënyrë telegrafike t'shkurtë nga agjensitë e ndryshme. Si burim informimit ishin agjensitë e ndryshme informative. Tash ndërkohë u arrit marrëveshja mes Kosovës dhe Kroacisë që të sigurohet ni hapësirë e shkurtër për ni edicion lajmesh, pesë minuta fillimisht në kuadër të Radio Kroacisë, Radio Zagrebit.

Fillum na ato lajmet, n'fillim ka shku me raportu Sylejman Shaqiri, Besa Çeku edhe ma vonë ndërkohë ju bashkangjitë... janë ndrru, herë pas here janë ndrru gazetarët e Radio Televizionit të Prishtinës. Ma vonë ka shku edhe Mehmet Haziri e Fatmir Podrimja, Isa Bajrami e të tjerë. Unë fillova ktu bashkë me Kurtesh Devajën. Kurteshi raportonte, jepte lajme disa informata i çonte pastaj edhe unë. Tha, "A po më ndihmon m'i çu lajmet për Zagreb", s'kishim t'ardhura, rroga, pa rrogë në mënyrë vullnetare. Po kishim vullnet me punu, me informu. Masiqë na u dha shansa... numri i kufizum që mujshim m'u angazhu aty. Pa t'holla po s'mundeshin t'gjithë m'u angazhu, s'kish nevojë.

I mbledhshim çka ndodhë, i merrshim informatat në Rilindje edhe me kolegët e Rilindjes bashkëpunojshim. Ata përcjellshin disa ngjarje, kishin rrjetin e bashkpunëtorëve edhe nga Qendra Informative e Kosovës. E bojshim ni raport e çojshim për Radio Zagrebin. Fillova unë me bashkëpunu në marrëveshje me Shaban Hysenin. I cili ishte kryetar i Këshillit Koordinues të Radio Televizionit të Prishtinës. Raportojsim nga ngjarje të ndryshme nga Prishtina, nga Kosova.

Mirëpo u ndëpre lidhja telefonike për shkak të luftës në Kroaci edhe në Slloveni, u ndërpre lidhjet mes Kosovës, mes Serbisë dhe Kroacisë. Se postën e kontrollonte Serbia, Postën e Kosovës. Nuk kishte lidhje telefonike, kurfar' me Zagrebin. Ishte shumë vështirë. Çka me bo tash? Qysh m'i plasu informatat? Atëherë mu m'lindi ideja si njeri i njohur i iniciativave thashë, "E kom shok mik Sylejman Beqën në Zvicërr", thashë, "edhe Sylja e kishte zyrën atje të përkthimeve edhe çështjeve juridike e tjera", se osht' jurist. Thashë, "P'e lus Sylën i çojmë informatat prej Prishtinës pastaj ai prej Zvicrrës i çon në Zagreb".

Ishte ide e mirë. Shkoj te... disa herë te Rilindja, redaksia e Rilindjes, e kishin telefaksin çojshim disa herë mirëpo ju bojshin shpenzime. Kishim shumë informata, shumë shpenzime. Ata kaniherë pritojshin, disa koleg të Rilindjes me na dhanë se ju pengojshim. Ni telefaks e kishin, s'kishin tjetër. Kishin me përdorë për nevoja të veta. Ishte shumë vështirë me punu, në mënyrë komode. Atëherë bij n'kontakt me mikun tim Muharrem Ramabajën i cili ishte drejtor i Zërit të Rinisë. Muharremi pa hezitim ma lshoj zyrën e vet të drejtorin tha, "Qitu zyrën e ki, çelsat i ki kur t'dush vjen punon, ki telefonin, e ki telefaksin". Unë atëherë krijova ni komoditet të paparë që s'kisha mendu që do t'krijohen aso kushte t'mira për me punu.

Disa herë i çojsha fotot me telefon edhe prej banesës time, naj lajm po s'kisha telefaks. I çojsha informatat nga zyrja e Muharremi në Zvicërr te Sylejman Beqa edhe ai i përcillte në Zagreb. Në mbramje i lexonte spikerja atje kush ka qenë Mehmeti, Asllani e tjetër. Ndërkohë masi bona ni përvojë atëherë m'thanë, "Në vjeshtë me shku edhe ti në Zagreb, m'u ndrru". Agim Mala ishte drejtor i përgjithshëm në Zvicërr qendronte me familje. Shkova unë. U morëm vesh me këshillin koordinues ktu, me Shaban Hysenin.

Shabani tha, "Nuhi", tha, "ti me Fatmir Podrimën", kolegu Fatmir Podrima nga Radio Kosova ni gazetar i mirë, koleg i mirë edhe zërin e kishte radiofonik. Tha, "Shkoni ju", tha, "i redaktoni lajmet edhe i lexoni atje në Zagreb". Shkum me aeroplan prej Prishtine në Cyrih. Në Cyrih atje m'u taku me Agim Malën edhe Agimi tha, "Po vi me juve në Zagreb shkojmë bashkë". Kemi shku me makinë prej Cyrihut. Jemi nalë rrugës se ishte mbramje dashtëm me vizitu ni shok klase, Hasan Gashin e Landovicës. Ai kishte ni biznes atje, kishte ni restaurant familjar afër Lausanne. Shkum, kemi bujtë aty, kemi hangër darkë. Na ka pritë mirë shumë Hasani.

Na aty t'nesërmen n'mëngjes jemi çu edhe me makinë... Milazim Salihu ka qenë me neve, drejtori i kinos që osht' ktu Cinema, përpara ka qenë, drejtor i Kinemasë ABC. Ai ishte koleg i joni kameraman i Televizionit të Prishtinës, kemi shku bashkë në Zagreb. Aty në Fruktus, e kemi pasë zyrën e punës. Selim Shabanaj na ka përkrahë edhe me Agimin bashkë kemi qenë, ai e ka pasë si dajë Selimin. Fjetjen e kemi pasë në Hotel Dubrovnik në Zagreb në qendër të Zagrebit. Radio Zagrebi nuk ishte shumë larg aty afër qendrës. I kemi pasë kushtet e mira për punë, ushqimin e kemi pasë të sigurun, fjetjen e krejt.

Kemi punu i kemi marrë informatat edhe nga Kosova edhe nga Diaspora edhe krejt aty te Selim Shabanaj e kishim edhe telefaksin edhe makinën e shkrimit. Se s'kishte kompjutera atëherë. Kemi punu kshtu kemi përgatitë. Lajmet pesë minuta kanë zgjatë dhjetë minuta kur kish ngjarje. Kanë qenë mas orës 10:00 po ishin shumë të ndëgjueshme në atë kohë për shqiptarët edhe në Kosovë. S'kishte lajme tjera. Arrinim që të mbanim gjallë informimin e opinionit shqiptar në Kosovë dhe Diasporë.

Diaspora ishte mobilizuar që të ndihmonte Kosovën. Kishte nevojë për solidaritet, kishte shumë familje që s'e kishin të sigurune ekzistencën dhe diaspora jonë ka ndihmu shumë që të mbahet gjallë jeta e bashkëkombasëve tanë ktu në Kosovë. Të cilët ishin largu në mënyrë masive nga puna dhe kjo ishte ni, ni solidaritet i jashtëzakonshëm për të majtë rezistencën paqësore, aktive në Kosovë kundër Serbisë. Kshtuqë pastaj jam kthy... aty në Zagreb po du t'them tash se s'muj me kalu.

Ka qenë luftë do të thotë. Ushtria dhe policia, sidomos ushtria serbe që kanë qenë kryesisht nga kazerma kanë qenë të udhëhequr nga eprorët serb. Ata kanë dominu edhe në Kroaci. N'atë kohë e mbaj mend nga Kazerma e Marshall Tito që ka qenë në Zagreb aty u patën largu ushtria serbe me mekanizmat e vet dhe patën shku në Bosne. Aty ishte situatë lufte. Dritaret e Radio Zagrebit ishin me sa thas të zi për drita mos m'u pa, mos m'u ditë. Se bombardonin aeroplanët e armatës jugosllave edhe i kanë pasë bombardu edhe selinë e Tuchmanit, Presidentit Tuchman n'atë kohë.

U frikësojshim mos po bombordohet edhe Radio Zagrebi se ishte medium shumë me rëndësi t'informimit. Aty kur jipej alarmi që osht' rrezik ku kishin sinjale që është rrezik nga sulmet ajrore e tjera, ata të sigurimit që ishin në Radio Zagreb aty na thojshin neve, "Kur t'jipet alarmi duhet me shku në podrum". E kishin në podrum ni studio rezervë edhe makina me shkru lajme edhe m'i lexu lajmet në podrum (qeshë). Unë s'di çka m'u tek, në podrum s'kishim kushte me punu, aty kishim komoditet ma shumë n'zyre. Thashë, "Jo bre s'ka rrezik po punoj qitu", tha, "Urdhëri osht', s'ka, urdhëri i ushtrisë s'ka koment ktu".

U dashke me shku në podrum me punu. M'i lexu lajmet atje. Kur dilshim prej ndërtesës i shishim ato thasët me rërë aty. Ka qenë në gjendje gatishmërie edhe m'u mbrojtë, a din, se sulmohet Radio Zagrebi. Unë aty drejtën me t'thanë e pata fitu nifar' e pata humb frikën për të kriju, u pata bo imun, s'kisha frikë. N'fillim po nashta po ma vonë u adaptova dhe e humba frikën. Kjo m'ka dënu shumë masanej kur ka fillu lufta në Kosovë që unë të startoj kshtu me ni besim pa frikë. Frika ekzistonte po atë fazën e parë të frikës e kisha kalu në Zagreb atje.

M'kujtohet si sot kur vinin lajmet nga Vokuvvari për gjendjen shumë t'randë të popullatës civile në Vukovar. Ku ushtria serbe kishte vra shumë civil. I kishte fut nëpër podrume të Vukovarit. Edhe vinte informacioni nga korrespondenti i Radio Zagrebit, ka qenë n'atë kohë po me emër kom haru tash emrin e saktë, mundem ndërkohë me plotësu nëse ka nevojë. Ai raportonte tamon në mënyrë reale, qysh osht' situata atje. Kom dëgju aty kur ka çu raportin telefonik edhe teknik. Ata të Radio Zagrebit e inxhizojshin e lishin thojshin deri t'vjen redaktori edhe redakton a vendos me transmetu a jo.

Erdh redaktori i lajmeve të Radio Zagrebit, kom qenë atëherë vet dëshmitar. Thotë, "Mos e transmeto", atij teknikut i thotë, "le aty". Nuk e transmeton. Unë mbetëm pa tekst, thom, qysh me ndodhë kjo mos me transmetu? Çfarë censure koka? Mazi se Serbia në Kosovë po bojkan kta. Po masanej t'u analizu pse si gazetar pak edhe pak masanej si diplomat, a qysh me thanë, pse nuk e ka transmetu? Ka qenë se nuk dëshironte Kroacia me fut frikë te popullata kroate edhe në qytetet e tjera m'i frikësu, m'i lshu vendet, me ikë. Krejt aty që mos me thanë që ushtria kroate s'po mund me qëndru tash, s'po mund m'i bo rezistencë ushtrisë jugosllave, ushtrisë serbe.

Mos me fut frikë te popullata për atë edhe nuk e kanë transmetu atë redaktorët e lajmeve. Edhe pse unë si profesionist nuk e arsyetoj atë. Po e kom analizu masanej se ata kanë bashkëpunu edhe me shtabin e ushtrisë kroate edhe me Tuchman edhe me tjerë. Informata defitiste që fusnin frikën edhe që krijojnë opinionin që ushtria kroate s'ka fuqi me i ba rezistencë ushtrisë jugosllave... se me t'vërtetë ushtria jugosllave n'atë kohë ka qenë, ka pasë arsenal t'randë, ka manipulu me krejt arsenalin e tanksave dhe armatimin që ka pasë krejt Jugosllavia n'atë kohë. Ata kanë dirixhu.

Në atë fazë Kroacia me të vërtetë ushtarakisht nuk ka qenë e gatshme m'i përballu ktyne sulmeve të armatës jugosllave, armatës serbe. E mbaj mend kur kanë ardhë civil, kur ka ra Vukovari në nëntor, nëntor '91-ten. Kur ka ra Vukovari kanë ardhë civil nga Vukovari në Zagreb janë strehu nëpër disa hotele të Zagrebit. Në mesin e hoteleve që i kanë strehu ka qenë edhe hoteli ku kom banu une edhe Fatmir Podrimja. Në Dubrovnik, aty i kanë strehu. Ka pasë dhoma, aty edhe janë ushqy në restaurant.

I kom pa t'ritë e t'rejat krejt, sidomos vajzat qysh ishin, me puçrra, do të thotë s'kanë mujtë m'u pastru disa ditë të tëra dhe janë infektu. Ka qenë tmerr çfarë situatë t'randë kanë qenë ata civilët, çfarë trauma kishin përjetu nga policia dhe ushtria serbe. Aty e kom pa çka domethonë lufta. Kur ka fillu lufta në Kosovë, unë e kom pasë shumë ma lehtë m'u gjetë, me raportu, me plasu informatën për Televizionin Shqiptar dhe për media tjera. Kjo m'ka ndihmu shumë, shumë m'ka ndihmu që unë edhe në Kosovë të gjej mënyra për të informuar.

E tash puna për... para se me fillu te lufta dua t'them edhe... ni kohë kom shku në Gjermani kom qëndru. Se thashë, herë pas here po kurrë me qëndru kshtu me familje ose me lyp azil. Kam shku për me i realizu disa emisione në Gjermani për Televizionin Shqiptar. Ka qenë iniciativa ime prap në marrëveshje me Xhafer Shatrin që ka qenë ministër i informatave, i qeverisë ekzil të Kosovës. Xhaferi ka përkrahë idenë time.

Thashë, "Bo përpjekje çka për ni emision për organizimin e shqiptarëve atje në mërgatë, sidomos për funksionimin e fondit 3%-shit të Qeverisë së Kosovës". Sepse ai fond mbante gjallë arsimin shqip në Kosovë, shëndetësinë, kulturën, t'gjitha poret e jetës që vepronin në mënyrë paralele në Kosovë. Atëherë funksionin nifar mënyre shteti i Kosovës pa u varur nga Serbia. Kemi afirmu fondin e 3%-shit me veprimtarët e këtij fondit, me ministrin e financave Isa Mustafa atëherë edhe me veprimtarë të tjerë.

Kshtuqë ktu m'ka ndihmu shumë miku im dhe afaristi i shquar Milazim Destani i cili ma ka siguruar biletën e aeroplanit nga Prishtina në Dusseldorf edhe atje ma ka siguruar ni zyre me punu edhe m'ka ndihmu edhe materialisht për me ekzistiu aty. Unë atij i kom ofru disa informata që ka pasë nevojë ai për kompaninë e vet. Atëherë ka qenë ni kompani turistike, Sharr Turist. Ma ka siguru ni dhomë pune aty. M'ka kriju edhe kompjuterët aty edhe m'ka ndihmu shumë për me mujt me funksionu si gazetar, me punu.

Kom shkrujtë masanej edhe për gazetat n'atë kohë që kanë dalë në Prishtinë, në të vërtetë në Zvicërr. Bota Sot ka qenë gazetë t'cilën ka qenë n'krye Agim Mala, Emin Azemi kryeredaktor ka qenë, shok i joni. Ka qenë përmbajtje e cila ka qenë n'frymën e mobilizimit të informimit të shqiptarëve. Kemi bashkëpunu edhe me atë gazetë. Kom analizu disa emisione. Kom bo ni dokumentar për Doktor Shaban Fetaj nga Strellci i Deçanit. I cili si i ri kishte shkuar në Gjermani edhe pa e ditë fare gjermanishtën e kishte kry edhe shkollën e mesme edhe fakultetin atje. Kishte arritë sukses, ishte ba udhëheqës i ni klinike të njohur atje afër Hanover.

Propozova që ta bëj ni dokumentar. Ka dalë ni dokumentar shumë i mirë. Kemi xhiruar bashkë me kameramanin profesionist Fatos Kastratin. E kom transmetu në Televizionin Shqiptar në Tiranë. Pastaj kom realizu edhe emisione tjera. Egzodi i fundit shqiptar m'kujtohet si sot, këtë titull e kom pasë dhanë. Kom vlerësu se egzodi i viteve '90-ta do t'jetë i fundit për shqiptarët e Kosovës pas dëbimit masiv të shqiptarëve nga puna dhe do t'vijë dita që kta do t'kontribojnë për krijimin e Kosovës së re, për organizimin e rezistencës së armatosur, për kthimin e tyre në Kosovë.

Kshtuqë jom mundu edhe në ato rrethana me gjetë mënyra, me punu si gazetar edhe niherë bile jom kthy prej Gjermanisë edhe jom kthy në Prishtinë. Prej Prishtinës mandej kom dashtë me shku në Tiranë. Qysh me shku mos me has policia serbe kasetat me m'i kontrollu edhe me pengu punën time. Kom propozu, mora vesh që po mbahet në përvjetor të Lidhjes Demokratike Shqiptare në Mal të Zi, në Ulçin. Mehmet Bardhin e kom pasë shok edhe mik familjar. Kom bashkëpunu me të.

I thom Mehmetit, “Qysh me ardhë bre unë atje?” Tha, “Ftesën e ki prej meje”, tha, “hajde”, tha, “merru vesh me Mehmet Hajrizin edhe kta shoktë nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe hajde me ta”. Thashë, “Se unë i kom do kaseta m'i çu në Tiranë m'i montu edhe ti me ma siguru rrugën mu ka me kalu ilegalisht kufirin për me shku në Shqipëri”, tha, “Unë ta siguroj ata s'ka problem”, tha, “veç hajde ti ktu”.

Tash kom bisedu me Mehmet Hajrizin i thashë Mehmet kshtu kshtu, “Unë kom disa materiale me i çu m'i montu në Tiranë”, thashë, “a më ndihmoni me ardhë me juve deri në Ulçin se Mehmet Bardhi m'ka premtu që m'siguron kalimin ilegal të kufirit për Tiranë”. Ai tha, “Nuhi”, tha, “na jemi t'caktun, unë”, tha, “edhe Zenun Pajaziti”, ka qenë kryetar i Forumit Rinor të Lidhjes Demokratike. Ni djalë i mirë shumë. Kanë bisedu me Zenunin i kanë tregu, “Nuhiu ka në punë me shku në Tiranë e po lyp me ardhë me kerr me neve”.

Zenuni kur ka marrë vesh kta edhe m'ka njoftë e ka ditë punën time ka thanë, “Edhe pse unë kom dëshirë me shku atje me marrë pjesë”, thotë, “unë Nuhiut ia lshoj venin”. Zenuni s'ka ardhë. Kom shku unë me Mhemetin edhe Hydën. Kom shku në Ulçin aty kom marrë pjesë aty. E kom bo edhe në kronikë për Televizionin Shqiptar edhe t'nesërmen Mehmeti ma ka organizu kalumjen ilegal të kufirit për Shqipëri. E kishte gjetë në shok t'vetin, veprimtar të Lidhjes Demokratike Shqiptare atje. Vladimir aty është pjesë kufitare me Malin e Zi. Buna.

Si sot m'kujtohet kur shkum aty. Ai kishte frikë se kufiri kut 'kalohet edhe ditën edhe natën kufi është, rreziqet ekzistojnë. S'e ki t'garatune jetën. Unë isha me kaseta, plot kaseta në çantë. Jemi shku aty, jom taku me atë shqiptarin, ia kom harru emrin tash s'ia di saktë. Ai bisedon me ata kufitarët. Kishin qenë ushtar ata kufitarët. S'i ka kallxu, s'e di a i ka kallxu po s'besoj që i ka kallxu si gazetar po me pare me pagu. Unë i dhashë do pare atina, ai atyne. Me pak pare me sa e di unë, me pak pare kom hyp... atje m'pritke tash me barkë një i Shqipërisë. Ish organizu ajo krejt me telefon po atyne ju rujsa, shërbimit, veç me kalu.

Kemi, kom hypë në barkë vet. Jom frikësu shumë se unë nuk di me notu. Na atje s'kemi pasë lum në fshatin tonë edhe s'kom pasë kohë fort as me mësu notin fort. Kshtu jom frikësu po mbytem ktu edhe po përfundon jeta ime qysh ma së keqti. Po fati ka deshtë kemi kalu mirë në atë anën në Shqipëri anena. Pastaj nga aty ka qenë e organizune me makinë nga Shkodra edhe nga Shkodra në Tiranë. Kom hypë me në kombi, e kom pagu normalisht. Jom shku në Tiranë në Televizionin Shqiptar.

Ktu dua t'them që gjatë kësaj periudhe, sigurimin e kasetave, sigurimin e transportit për Tiranë se m'ka ndihmu shumë Ismajl Kastrati. Ismajl Kastrati është një prej veprimtarëve shumë serioz të

Këshillit Qendror për Financim të Kosovës, i cili ka qenë kryetar i atij këshilli. Ai m'njhihte mu mirë edhe unë e njëjsha atë mirë, e kishte besimin e plotë. Se ishte ni punë shumë e rëndësishme edhe mu m'vyjshin shpenzime elementare. Kaseta s'kisha, rroga s'kisha. Ai m'i mbulonte disa shpenzime edhe të autobusit edhe kur shkonim me autobus edhe me fjet naj natë në Tiranë, me hangër diçka, me pi diçka, ma pagunte qiranë e banesës krejt.

Ismajl Kastrati shpenzimet na ka hjekë pa problem, na ka ndihmu shumë. Pa ndihmën e tij këto punë para luftës po edhe gjatë luftës pa ndihmën e Ismajl Kastratit po edhe të komisionit parlamentar për buxhet edhe ekonomi, Nagip Zeka dhe Fatmir Rexhepi, nuk do t'ishin ba. Duhet me qenë real. Vullneti ka qenë, gatishmëria ka qenë edhe e kolegëve t'mi mirëpo s'kemi pasë mjetet tona as për mbajtjen e familjes lehma me siguru me ble gazeta ose m'i pagu shpenzimet e udhëtimit për Tiranë. Ne ishim shumë modest, nuk kërkojshim veç m'i mbulu këto shpenzime edhe me mujt me kry detyrën tonë.

Kshtuqë dua t'them se ka qenë ni organizim shumë i mirë edhe n'ato rrethana kur ka pasë vullnet edhe gatishmëri edhe ide për me punu, me kontribu edhe për informim edhe për mbajtjen gjallë të arsimit shqip edhe të kulturës edhe të sektorëve tjerë ka pasë gatishmëri. Na ka ndihmu gjatë kohës për raportim për Zagreb po ashtu edhe Aziz Abrashi, Burhan Kavaja. Shpenzimet e telefonit që u dufke m'i bo shpesh atje në Zvicërr se u dufke prej Zvicrrës m'i çu në Zagreb. Kshtuqë shpenzimet e telefonit Sindikata e Pavarur i hiqte. Rroga jo po qato shpenzime. Fatura çojshim sa bojke telefoni e pagujshin.

Kshtu ka qenë ni organizim i vogël po shumë i rëndësishëm që e ka majtë gjallë funksionimin e jetës. M'i tregu Serbisë që na edhe në ato kushte dijmë m'u organizu, dijmë me mbajtë jetën institucionale të pavarur. Tash ka shumë ngjarje, mos po i kapërcej do du t'dal te lufta se tani e përfundojmë shpejt, a din (qeshë). Kur është fjala këtë periudhë para luftës, me iniciativën time kom bo përpjekje që ta organizoj ni tryezë, tryezë të rrumbullakët si të them për t'i tubuar të gjithë liderët e partive shqiptare dhe jo vetëm shqiptare n'atë kohë. Do të thotë edhe ato boshnjake, turke që ishin me Alternativën e Kosovës.

Qëllimi im ishte që... sepse edhe pse funksiononte Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare, n'krye me Rugovën, prap se prap ishin do fërkime t'vogla. Jo shumë t'mdhaja, t'vogla po nuk u bashkojshin me ni tryezë, rrallë krejt liderët. Gjysa, zakonisht gjysa. Krejt ishte, s'e di si e pamundur gati m'u bashku me ni tryezë edhe me diskutu për situatën çka me ba, e çfarë zgjidhje me gjetë, qysh me gjetë zgjidhjen e duhur. Unë propozoj thom, hajde t'mujsha me organizu.

Ish ideja që bash me majtë në selinë e Lidhjes Demokratike edhe pse kishim studio vende tjera të përshtatshme po ish si simbolikë me mbajtë bash në selinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës si përfaqësuesi kryesor i lëvizjes së atëhershme paqësore. Menojsha që mos p'e, mos p'e arrij qëllimin që edhe Rugovën me shti me marrë pjesë n'atë tryezë. Qaty ish qëllimi kryesor se kta tjerët s'ish problem m'i ba bashkë. Bacën Adem e Hylën e kta nuk ish problem m'i ba. Po qëllimi ishte edhe Rugovën me shti aty me marrë pjesë bashkë.

Insistova fola me Adnan Merovcin e me disa t'kryesis të tij, Xhemajl Mustafën, po me Xhemën. Me Xhemën kisha raporte t'mira ai ishte për informim e sene e kisha shok, mik. I thom, "Xhemë, ideja jeme është që Rugova në emër të Lidhjes Demokratike", ishte Baca Adem Demaçi ishte kryetar i Paritë Parlamentare, u pat' zgjedhë n'atë kohë. Pastaj ishte Mark Krasniqi, kryetar i Partisë Shqiptare Demokristiane, ishte Besim Bokshi kryetar i Partisë Social Demokrate. Masnej u formu ndërkohë po dy krah edhe Partia Social Demokrate e Luljeta Pulës.

Pastaj, e Partisë Boshnjake ishte, jo Neman Barliçi po dikush tjetër ka qenë ni kohë aty kryetar. Jo s'o Kandiçi. Muj me nxjerrë ndërkohë, për transkript muj me nxjerrë. Tha, "Ide shumë e mirë", Xhema e përkrahi, "Ide shumë e mirë", tha, "po bisedojmë me presidentin, a ka kohë e qysh e sene", thashë, "Kur don ai, s'ka problem". E gjeta ni kamerë, kameraman s'kishim. E gjeta ni kamerë, Rizvanollin e mora unë me xhiru. Xhema tha, "Po bisedoj e të informoj", "Ani", thashë, "mirë shumë". Ndërkohë ka bisedu, ka qenë i angazhun, i ngarkun Rugova me Serbinë. Ai ka thanë, "Nuk muj me marrë pjesë në atë tryezë", po e kish caktu Hidajet Hysenin n'vend t'tij.

Nejse, thashë, "S'ka problem. Dëshira ime ka qenë me qenë Rugova masiqë është edhe kryetar i Këshillit Koordinues të Partive Shqiptare", po ishte e pamundur. E organizum xhirimin e ksaj tryeze aty në selinë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, pa Rugovën do të thotë. Po doli ni tryezë e mirë. Baca Adem aty në fillim të tryezës kur e bona unë pytjen tha, "Shumë ide e mirë", m'falënderoj, tha, "që na ke bashku të gjithëve. Duhet me bisedu se si ta tejkalojmë këtë situatë se si të organizohemi t'gjitha subjektet politike të Kosovës. T'gjejmë forma për ta avancuar rezistencën aktive".

Sepse ishte atëherë hala herët. Ishte viti '97 po hala për luftë... "konsideroj se ish herët", e s'ishim t'përgaditur. "Sado kudo", Baca Adem thojke, "duhet m'u ulë me bisedu na si shqiptarë se si me avancu rezistencën aktive paqësore". Biseda, tryeza u realizua me sukses. Shkova në Tiranë e montova, tash me shkurtu pak se doli gjatë. E transmetova, pat' jehonë t'mirë. Ndërkohë filloj m'u acarë situata në Kosovë. Ushtria Çlirimtare e Kosovës kishte disa bërthama t'veta edhe brenda Kosovës, kishte disa njësi operative në mbarë Kosovën. Sidomos në zonën e Llapit dhe të Dukagjinit, Llapushës e tjera, në Drenicë.

Kshtuqë ndodhi me 31 janar, me 31 janar 1997 ndodhi që policia ra n'gjurmë të veprimtarisë të Zahir Pajazitit, Hakif Zejnullahut dhe Edmond Hoxhës dhe shokve të tyre. Në atë kohë Adem Jashari ka vepru në Drenicë. Pastaj në Dukagjin Luan Haradinaj, Smajl Haradinaj. Këna kah Drenica, Destim Zogaj, Xheladin Gashi, Nuhit Hasani, Rexhep Selimi e të tjerë, e të tjerë. Kshtuqë ranë ata në prit në, në Pestovë të Vushtrisë dhe në rezistencë me forca serbe ranë heroikisht Zahiri, Hakifi dhe Edmondi.

Unë vendosa me ba prap ni, ni emision special nga kjo ngjarje me paraqit edhe dhunën e ushtrisë dhe policisë serbe në Kosovë ndaj shqiptarëve. Tubova me ni zyre në Këshillin për të Drejtat e Njeriut në Prishtinë edhe veprimtarin e atëhershëm të atëhershëm të shquar të këtij këshilli avokatin e njohur Bajram Kelmendin, Fazli Balën. Edhe Bujar Dugolli ka qenë i ri atëherë po vllaun e vet e ka pasë n'burg, Enver Dugollin. Enveri ka qenë edhe ai i dënuar bashkë me grupin e Nait Hasanit e ktyne të tjerëve.

Kshtuqë e bona ni emision bukur t'mirë për ato rrethana. Pasqyrova edhe fotografi e çka kishim materiale tjera dhe e dërgova në Tiranë e montova në Tiranë atje. Kshtuqë nifar' mënyre fillova edhe t'i realizoj edhe disa emisione tjera për funksionin e arsimit shqip në Kosovë. Kom bo ni emision për shkollat e vet kontributit që fillun m'u ndërtu disa shkolla me vet kontribut të banorëve. Siç ishte shkolla në Kraikovë të Drenasit. Në krye të këshillit të solidaritetit, të financimit dhe të organizimit të ndërtimit të kësaj shkolle ishte drejtori i shquar Hafir Shala. Ka qenë ni veprimtar i palodhshëm, njeri i vyeshëm, njeri i vendosur, ardhëtar.

M'kujtohet si sot kur e kom bo ni intervistë me të aty para shkollës së re në Kraikovë. Ka qenë me t'vërtetë ni përjetim i veçantë. Prej asaj kohe Hafirin nuk e kom pa. Pastaj kom dëgju n'fillim t'luftës është arrestu dhe është marrë nga policia serbe, nga sigurimi serb dhe sot e kësaj dite nuk dihen as eshtrat e tij ku janë. Kom pasë fatin që t'realizoj disa emisione edhe për funksionimin e Këshillit Qendror të Financimit në Kosovë.

Funksionimin e këshillave lokale me t'cilat ka qenë ma aktiv ka qenë Këshilli i Suharekës në krye me Blerim Kuçin. Këshilli i Drenasit në krye me Alush Istogun. Pastaj Këshilli në Deçan, Ajmane Tahirsylaj, Tafilaj e disa këshilla tjera. Po kryesori ka qenë Ismajl Kastrati i cili ka qenë motorri i kësaj pune në bashkëpunim edhe me Selatin Noovsellën, Bedri Novosellën edhe shumë, Shaip, këtë Shaban Hoxhën, Zenel Kastratin, Ymer Halimin edhe shumë veprimar tjerë.

Marte Palokaj ka qenë ni aktiviste e shquar e Këshillit Qendror për Financim, përfaqësuese e Partisë Shqiptare Demokristiane e cila m'ka përkahë shumë idetë e mija. M'ka tregu disa herë Ismail Kastrati që Marte Palokaj t'ka përkrahë ma së shumti se e ka ditë punën tane edhe m'ka ndihmu edhe mu që ato vendime... sepse atëherë ekzistonin dy rryma.

Ni rymë pak ma radikale që ishte me sensibilizu, me shpejtu rezistencën aktive dhe tjetra që ishte veç me numëru, me mbajtë ni status kohe e cila nuk shpinte kurgjo, nuk garantonte që mund të sillte suksese. Kshtuqë ata që kanë qenë t'gatshëm me kontribu me punu e kanë dëshmu vetën edhe unë i falënderoj shumë për përkrahjen që ma kanë dhanë në ato periudha t'vështira.

Anita Susuri: Ju e keni bo edhe nifar' emisioni në prag të demonstratave të '97-tes...

Nuhi Bytyçi: Po, po se kem t'u harru. Edhe ky, edhe ky projekt shumë me rëndësi ka qenë iniciativë e imja. Po m'vjen keq tashti nashta është modesti po kjo është e vërtetë. Ka qenë ide e imja. Unë nuk isha pjesë zyrtare e ekipit, e Radio Televizionit të Kosovës që punonte për Radio Televizionin Shqiptar, nuk isha në ekip. Tash si ta realizoj, s'kishim pare, s'kishim kamera, s'kishim montazhë ishte problem, gati e pamundur ishte. Mirëpo kur njeri ka vullnet edhe gjen mundësi edhe n'rrethana të tilla gazetari duhet me gjetë mënyra.

Unë menojsa që kjo osht' ni ngjarje shumë me randësi edhe ne si gazetar duhet të japim kontributin tonë, ta sensibilizojmë opinionin. Tash detyrë e imja ishte, unë e propozoj këtë temë te Xhafer Shatri që ishte ministër, mirëpo unë s'isha pjesë e ekipit aty tash. Bisedoj qysh me pasë ma lehtë me realizu,

bisedoj me mikun, kolegun tim të nderuar Qani Mehmedin, t'cilin e falënderoj për kontributin e tij, për mbështetjen që ma ka dhënë n'kohë të vështira. Kemi pasë raporte që nga Televizioni i Prishtinës ku ka qenë shoku i tij, miku i tij drejtor i RTP-së Agim Mala. Prej asaj kohe ne kemi qenë të pandashëm edhe kemi pasë besim me njëri tjetrin.

I thom Qaniut, “Masiqë ti je pjesë e ekipit të Televizionit Shqiptar ktu në Prishtinë hajde bashkë ta bojmë dokumentarin për protestat”. Ato s'ishin mbajtë hala, n'prag të protestave. Me organizu realizimin e ni dokumentari të posaçëm për kërkesat e studentëve, me bisedu me t'gjithë përfaqësuesit e asaj kohe të partive politike, të popullit, të intelektualëve. Bile e patëm marrë në intervistë Rexhep Qosjen, Qaniu e pat' intervistë Rexhep Qosjen në Adem Demaçin. Liderët studentor Muhamet Mavrën, Bujar Dugollin, Albin Kurtin, Ernest Lumën, Driton Lajçin edhe liderët tjerë.

Profesorin, unë kom bo intervistë me profesorin e nderuar prorektorin e atëhershëm të Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovcin. Ka qenë do të thotë shtatori i vitit 1997. Kur kom shku te profesori Ejup në zyre në Velani në rektorat m'ka prit me shumë dashamirësi. Sepse unë me të kom realizu edhe disa intervista në vitin '92 kur osht' kthyer nga një vizitë shumë e suksesshme që ka pasë si rektor në Universitetin e Prishtinës në Austri dhe Gjermani.

Ku kishte shkuar për të marrë përkrahjen e univeristeteve europiane për Universitetin e Prishtinës që universitetet europiane t'i njohin diplomat e studentëve që diplomojnë në Universitetin e Prishtinës dhe universitetet europiane të ndihmojnë edhe për regjistrimin e atyre studentëve që dëshirojnë të studiojnë në universitetet europiane. Kshtuqë me Profesorin Ejup jom taku disa vite ma herët. Shpesh edhe n'banesën e tij në Rrugën Agim Ramadani dhe kemi realizu disa emisione për Televizionin Shqiptar, pastaj për Televizionin Zëri i Shqiptarëve në Berlin, Televizionin Offener kanal në Hamburg.

Kshtuqë kom qenë në vazhdimësi në kontakt me Profesorin Ejup dhe m'ka prit me dashamirësi, sidomos për... e ka përkrah iniciativën time për me realizu ni emision në prag të protestave studentore. Sepse ato ditë kishte ni hezitim nga lideri i atëhershëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe disa bashkëpunëtorë të tij. Sepse osht' rrezik, konsideronin se osht' rrezik me dalë me protestu n'rrugë. Sepse frikësoheshin nga dhuna që mund të ushtronte policia serbe ndaj protestuesve.

Tash duke parë vendosshmërinë e rektorit Statovci, se protesta duhet të mbahet sepse ishin kërkesa shumë legjitime. Lirimin e objekteve të ozurpuara universitare nga pushteti serb. Ato kërkesa i përkrahen pastaj edhe Unioni i Pavarur i Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Se ideja ishte e studentëve po edhe rektori i përkrahi protestat. Unë isha në kontakt të vazhdueshëm me Muhamet Mavrën edhe me Bujar Dugollin edhe me Albin Kurtin, Ernest Lumën, Driton Lajçin. Kshtuqë isha shumë i informuar se për skenarin e atyre protestave.

Dëshirojsha që ta kem edhe përkrahjen e t'gjithë spektrit politik të Kosovës që në dokumentar të përfshihen të gjithë spektri politik i atëhershëm. Besa edhe të rinisë shkollore, shkollave të mesme, Gjimnazit Sami Frashëri, Xhevdet Doda edhe shkollave tjera. Aty pata angazhu Vlora Çitakun edhe

Arianitin, djalit tim t'cilët kanë qenë shok klase. Ju thashë, "Shkoni boni do biseda me nxansa, deklarata me nxansa unë i përfshij në dokumentar". Bashkë me Qaniun, me Qani Mehmedin e kemi bo këtë dokumentar.

E kemi bo ni tryezë në lokalet e atëhershme të Unionit të Pavarur Studentor bashkarisht me Qaniun. Aty e kemi bo si studio të improvizune, krejt liderët i kemi përfshi aty, i kemi bo intervistat. Pastaj unë e kom bo intervistën, si thashë, me Profesorin Ejup Statovci. Ai ka përkrahë kërkesat dhe organizimin e protestave. Ka qenë shumë i vendosur që kto protesta të mbahen. Pasi kto dëshiroja ta kem edhe ni përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës e cila kish, si thashë ma herët, hezitimet e veta.

Që mos të ketë përshtypje në opinion që Lidhja Demokratike osht' kundër edhe tash nëse s'e ka përkrahjen protestat nga Lidhja Demokratike nuk mund të mbahen. Nga ni numër i vogël edhe policia ta përdorë dhunën mos t'kenë efekt protestat. Unë e kisha ni qëllim shumë t'mirë me përfshi dikë nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe e kontaktoj drejtpërdrejt profesorin e nderuar Avdyl Ramaj. I cili ka qenë profesor edhe drejtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike në Prishtinë dhe ka qenë anëtarë i kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, përgjegjës për arsim.

Konsideroja që nëse Avdyl Ramaj pranon me folë atëherë unë nuk kom nevojë me marrë Rugovën se Rugova ishte kundër. Thashë, përmes tij populli e vlerëson që Rugova i paska dhanë sinjal ktina që m'i përkrahë protestat edhe thom, "Profesor a s'priton me dhanë ni mendim, a i përkrah ti protestat e studentëve të Universitetit të Prishtinës?" Ai s'mujke tash, ish pyetja shumë e drejtpërdrejtë edhe shumë imponuese. Tha, "Unë i përkrahi, qysh nuk i përkrahi. Kërkesat e studentëve t'mi unë i përkrahi". S'mujke me thanë që s'i përkrahi.

Unë inxhizoj me kamerë atë, jo tinza po kshtu me marrëveshje. E boj ni intervistë pak ma t'gjatë edhe flet shumë superlativ për idenë e protestave. Thashë, "Ti s'ki nevojë me thanë qëndrimin e Lidhjes Demokratike", se hala kishte rezerva. Nashta ndërkohë e përkrahë po ma shumë ishte kundër. Ai e dha atë mendim që unë i përkrahi protesat e studentëve po nuk foli n'emër të kryesisë të Lidhjes Demokratike, si profesor ma shumë.

Mirëpo aty tash në titull e shkrova Avdyl Ramaj anëtarë i kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, në titra. Opinioni me ditë që ky po flet në emër të kryesisë të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe nifar' mënyre populli me kuptu që edhe Lidhja Demokratike po i përkrahka kto protesta. Kshtuqë atë natë kur e kom montu dokumentarin nja 50 minuta ka zgjatë montazhi. Se ka qenë shumë materiale. E kom thirrë... ka ardhë ndërkohë komunikata nga kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës në zyrat e Televizionit Shqiptar në redaksinë e Kosovës.

Asllani më informon thotë, "Nuhi", thotë, "ka ardhë informata nga kryesia", thotë, "osht' kundër mbajtje së protestave 01 tetorit". Ishte 30 shtator atë ditë. Me 01 tetor ishte nesër. Tash frika ishte nëse kta të Lidhjes Demokratike e kundërshtojnë nashta nuk mbahet protesta, a din, shtyhet. E kom marrë n'telefon Profesorin Ejup edhe i kom tregu. Thashë, "Profesor unë e kom montu emisionin, ka dalë

shumë mirë po ka ardhë ni komunikatë nga Lidhja Demokratike e Kosovës që është kundër protestët dhe propozon që të shtyhen protestat. A ka naj ndryshim i qëndrimit t'juj?"

M'kujtohet si sot Profesori Statovci shumë i vendosur tha, "Nuhi", tha, "protesta kofsha unë gjallë kanë m'u mbajtë ashtu qysh i kena parapa bashkë me liderët studentor", tha, "unë jom me studenta, unë përkrahi idenë e tyre dhe do t'jem bashkë me ta". Mu m'dha kurajo edhe mu. Thashë mirë s'më paska shku puna huq se po t'shtyhen protestat, emisioni s'kish kuptim me dalë, a din (qeshë). Thashë, "Ani mirë", thashë, "unë e kom montu emisionin ju përgëzoj, ju dëshiroj sukses. M'vjen keq që unë nesër s'muj me ardhë herët", se s'kisha as lidhje autobusi me ardhë aq herët. Thashë, "Emisioni transmetohet sonte".

Ka qenë ni termin shumë i shikushëm edhe ka pasë jehonë t'madhe shumë. Kush e ka pa atë emision, s'ka mujtë mos me dalë. Masiviteti t'nesërmen u pa në protestat e 01 tetorit në Velani. Të cilat patën ni efekt të jashtëzakonshëm dhe ban ni kthesë historike jo vetëm para opinionit në Kosovë por edhe atij botëror. Sepse aty ishin krejt diplomatët edhe patëm marrë në intervistë edhe shefin e Zyrës Amerikane në Prishtinë Richard Hakëbi. Deshtëm me ditë edhe mendimin e amerikanëve për këtë far' proteste. Nëse janë t'qetë ata. "Kërkesat e drejta dhe protestat e qeta na i përkrahim, po të dhunshme jo". Ishte sinjal i mirë që dilni në protesta edhe kini përkrahjen e Amerikës.

E kemi marrë edhe të Ambasadorit Gjerman, Rober. Kshtuqë ka qenë, ka qenë ni emision i cili ka ndiku në krijimin e opinionit që protestat t'jenë sa më masovike dhe kshtu si u pa, dhuna, Serbia e hupi orientimin. E përdori dhunën po ishte ni vetëvrasje e Serbisë. Sepse n'këtë mënyrë dëshmoj edhe niherë se shteti serb e pengon çdo kërkesë legjitime të shqiptarëve. Kërkesa legjitime ishte m'u liru objektet universitare, që i kishte ozurpu Serbia që ishin ndërtu me ndjersën e klasës punëtore shqiptare.

Në këtë drejtim opinionin ndërkombëtarë u zgjua nga gjumi. Diplomacia ndërkombëtare u zgjua nga gjumi dhe filloj ni kthesë historike për Kosovën, filloj ni përkrahje ma e madhe e kërkesave të drejta, jo vetëm të studentëve po ma vonë edhe të atyre që dolën në ballë të udhëheqjes së luftës për çlirimin e Kosovës, në ballë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Të cilat, e cila luftë solli lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Ktu do të them se protesta e 01 tetorit ishte ni uvërtyrë, ishte... sepse n'atë protestë merrshin pjesë, ishin studentë, ishin profesorët e tyre, ishin prindërit e studentëve. Ishin ata që kishin organizu luftën për çlirimin e Kosovës.

E di që Komandant Remi ka qenë komandant i zonës së Llapit. Ka pasë njerëzit e vet aty për m'i siguru studentët, për m'i mbrojtë Profesorin Statovci, për m'i mbrojtë profesorët e tjerë. Kta ni pjesë e madhe e ktyne studentëve pastaj kanë qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesë e luftës për çlirimin e Kosovës.

Pjesa e Shtatë

Anita Susuri: Zoti Nuhi, ju keni punu nifar' lloj iniciative për me bo ni grup të xhirimit kur kanë fillu në Drenicë kto ngjarjet, kur ka fillu lufta. Nëse mundeni për kta me na tregu?

Nuhi Bytyçi: Po. Pas bejetës së njohur të Likoshanit dhe të Çirezit me 28 shkurt të vitit '98 dhe pastaj pas epopesë së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në krye me komandatin legjendar të UÇK-së, Adem Jasharin, në Prekaz me 05, 06 dhe 07 mars të vitit po ashtu '98. Opinioni botëror u informua për kto zhvillime dramatike të cilat paralajmëruan ni luftë t'hapur, luftë frontale në mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave ushtarake dhe policore serbe.

Kshtuqë Kosovën e vërshuan shumë media botërore kurse në Televizionin Shqiptar nuk kishte imazhe nga ekipi i Televizionit të Prishtinës që punonte në Prishtinë për lajmet e Televizionit Shqiptar. Unë nuk isha pjesë e atij ekipi. Mirëpo si gazetar m'dukej se po rri kot në shtëpi edhe s'po bëj asgjë për ta informu opinionin se çka po ndodhë në të vërtetë në Drenicë. Kshtuqë mora iniciativën që ta, të gjej mundësitë për krijimin e një ekipi të xhirimit për të gjetur ni kameraman, ni kamerë dhe për të shkuar në Drenicë vet dhe për të raportuar dhe për të realizuar ndonjë dokumentar lidhur me kto ngjarje.

Kshtuqë mora n'telefon Xhafer Shatrin, ministrin e informatave të Qeverisë së Kosovës në ekzil dhe i thashë, "Xhafer, Televizioni Shqiptar nuk ka imazhe nga Kosova po shërbehet me imazhet e mediave t'huja. Lufta osht' intensifikuar dhe ne kemi obligim si gazetar dhe ju si Ministri e Informacionit të gjeni mundësi për të krijuar një ekip xhirimi dhe për të sjellë imazhet e ekipit tonë nga Drenica". Xhaferi e përkrahu mendimin tim. Tha, "Do ta gjej një kamerë digjitale edhe kasetat edhe", tha, "ju në bashkëpunim me Migjen Kelmendin", i cili ishte shef i redaksisë së Televizionit të Prishtinës në Prishtinë për Televizionin Shqiptar. "Në marrëveshje me Migjenin gjeni ni kameraman".

Bisedova me Migjenin, i tregova për bisedën me Shatrin edhe Migjeni përkrahu idenë time edhe tash ishte përpjekja që t'sigurohet ni kameraman. Disa kameraman ishin jashtë Kosove, disa ishin jashtë Prishtinës në Mitrovicë e qytete tjera. Kshtuqë kisha vështirësi edhe ta siguroj kameramanin. Ndërkohë pas disa konsultimeve, disa koleg të Televizionit të Prishtinës përmes Qemajl Hasanit, ish drejtorit të përgjithshëm të RTP-së e sigurova numrin e telefonit të vllaut të tij, Sadik Shaborit i cili ka qenë kameraman në Televizionin e Prishtinës. Ai jetonte në Mitrovicë n'atë kohë.

E marrë n'telefon Sadikun i them, "T'lutem", se nuk dojsa me folë n'telefon mos po përgjohen bisedat atëherë. I thashë, "Kom ni punë shumë me rëndësi nëse munësh me ardhë në Prishtinë, me pi nga ni kafe, m'u konsultu". Sadiku erdh në Prishtinë. Shkuam në Kafe Dora ktu në Prishtinë biseduam. I tregova për çka e kom thirrë e përkrahu iniciativën time. Tha, "Unë jam i gatshëm vetëm gjeje kamerën". E gjetëm kamerën edhe meniherë kom shku jom marrë vesh me Sadikun që nga Prishtina të nisemi me autobus. Jemi nisë me autobus për Mitrovicë.

Kur kom mrri në Nedakovc ka qenë ni punkt famkeq i policisë serbe aty. Filloj kontrolla e udhëtarëve. Unë nuk tregova që jom gazetar normalisht se kta kërkonin akreditimin. Akreditim ne s'kërkonim n'atë kohë, Ministria e Informatave të Serbisë. Kshtu kalova pa pasoja. Mrrina në Mitrovicë. U takum me Sadikun, me Halit Baronin edhe me ish luftëtarin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, tani dëshmor i

kombit, Agim Rrahim Ramadani. Me prejardhje nga Prekazi i Epërm i Drenicës me vendbanim në Mitrovicë.

Kshtuqë bashkarisht me ta jemi nisur dhe kemi shkuar në Polac fillimisht. Pastaj kemi bo plane që të xhirojmë rreth Prekazit të Ulët dhe Prekazit të Epërm. Në atë kohë Prekazi i Ulët ishte i rrethuar i tëri me forca policore dhe ushtarake serbe. Ishte e pamundur me hy në shtëpi të Jasharëve. Kshtuqë kemi bo përpjekje prej lagjes së Prekazit të Epërm atje kemi ba disa imazhe. Aty m'kujtohen imazhet Shkollën Azem Bejta edhe kemi fillu nga poshtë te shtëpitë afër Jasharëve. Atje nga largësia kemi marrë disa imazhe. Kemi marrë disa rrëfime shumë interesante nga Bahtije Jashari që ka qenë kojshi e familjes së Adem Jasharit. Edhe disa rrëfime tjera...

Anita Susuri: Çka kanë tregu ata?

Nuhi Bytyçi: Kanë tregu për ngjarje për 05, 06, 07 marsin çka kanë pa aty krejt. Tmerr çfarë veprimi kanë bo policia serbe natën. Ishin ato rrëfime tronditëse për mu, të cilat i kemi regjistru me kamerën e Sadik Shabanajt. Pastaj i kemi regjistru edhe rrëfimet e tjera edhe për pjesëmarrësit e betejës së Likoshanit dhe Çirezit. Atje kishin vra edhe gra shtatzana, fmi, pleq. Kshtu kemi realizu ni dokumentar me titull Sërish Drenica. Unë e kom lexu tekstin, e kom shkru tekstin. E kemi montu bashkë me Migjen Kelmendin dhe Ekran Dobergjanin dhe Ergyn Dobergjanit në shtëpinë e Dobergjanëve në Arbëri.

Ishte dokumentar që pasqyronte ato ngjarje në Prekaz edhe Likoshan. Pastaj edhe rrëfimin e historianit Zekerija Cana për kto ngjarje. Dhe kshtu përgatita ni dokumentar t'cilin e transmetuam në Televizionin Shqiptar. Kjo ishte do të thotë puna e parë që e bëm për betejën Epopenë e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prekaz dhe Likoshan dhe Çirez. Ndërkohë, meqenëse Sadiku ishte në Mitrovicë, ishte e pamundur tash unë nga Prishtina me çarkullu niherë në Mitrovicë e Drenicë e tjera. Kshtuqë bona përpjekje ta siguroj ni kameraman tjetër ktu në Prishtinë dhe t'nisemi bashkë nga Prishtina.

Kur na ftoj në Këshillin e të Drejtave të Njeriut me Shaban Shalën, i cili ka qenë nënkryetar i Këshillit të të Drejtave të Njeriut në nivel të Kosovës. Më informoj Shabani që ai tash osht' aktiv në kuadër të zonës operative të Drenicës dhe ai shprehi gatishmërinë që t'na ndihmoj për të xhiruar imazhe në Drenicë dhe në zona të tjera. Bisedum me Shabanin dhe ndërkohë unë e sigurova bashkë me Migjen Kelmendin kameramanin e rregullt Abaz Zekën. I cili ishte ni kameraman i studios por kishte vullnet të jashtëzakonshëm për të ardhë bashkë me mu dhe për të xhiruar gjithë ato imazhe nga Drenica, pastaj nga Llapusha, nga Anadrenija, nga Dukagjini, nga Llapi, Shala dhe zona të tjera të luftës.

Në bashkëpunim me disa shokë që ndihmonin me logjistikë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës me të cilët unë takohesha në Prishtinë, Shaban Hoxhën, Profesorin Ymer Halimin. Pastaj me Zenel Kastratin, Sali Zariçin dhe disa të tjerë. Kshtuqë u morëm vesh që ata t'na ndihmojnë me na siguru transportin për të shkuar në Drenicë. Ni ditë bashkë me Shabanin, Profesorin Ymer edhe Zenelin u nisëm në drejtim të Drenicës bashkë me Abazin. Ni mbrëmje ata kishin marrë me veti edhe ni kombi në të cilin vendosë edhe ni aparat të rentgenit të cilin e dërgonin në spitalin ushtarak të UÇK-së në Likoc.

Ne ishim me ni makinë tjetër. Kemi depërtuar, kemi kaluar Fushë Kosovën kemi hyrë nga ajo pjesa Guri i Plakës që i thojnë në drejtim të Dritanit, ish Dubroshevcit. Kemi shkuar, kemi kaluar në pjesën e Drenicës afër Drenasit në Baicë. Prej Baicës pastaj aty kemi takuar për herë t'parë Musa Jasharin në uniformë të UÇK-së. Ishte ni përjetim i veçantë për ne. Pastaj kemi shku në Obri të Epërme në familjen e Hajdin dhe Afrim Hysenaj. Ku ishte ni pjesë e luftëtarëve, komandantëve të UÇK-së. Aty kemi takuar për herë t'parë Komandant Fehmi Lladrovcin dhe bashkëshorten e tij Xhevë Lladrovcin.

Pastaj jemi takuar edhe me Rexhep Selimin, kemi biseduar me Rexhep Selimin, Ilaz Selimin dhe disa luftëtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Biseda kishte të bënte që ne jemi, unë e Abazi jemi t'gatshëm m'i xhiru të gjitha imazhet që janë të randësishme për t'i prezentuar në Televizionin Shqiptar. Në atë kohë nuk kishte ende qëndrim nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që ndonjë gazetar me kamerë t'vijë edhe të xhiroj gjitha zhvillimet në zonat e luftës.

Kshtuqë bisedum me Rexhep Selimin, tha, "Ne", tha, "kemi shumë vrejte në informimin që e bën Televizioni Shqiptar që e bën për luftën në Kosovë. Atje", tha, "po raportohet kinse popullata shqiptare po e mbron pragun e shtëpisë e nuk po thuhet që po lufton Ushtria Çlirimtare e Kosovës". Unë i thashë, "Po m'vjen keq", thashë, "Rexhep", thashë, "po unë nuk jom pjesë e redaksisë edhe nuk kom dhanë informacione të tilla. Kshtuqë pikërisht për atë kom ardhë unë ktu me xhiru, me raportu në mënyrë objektive çka po ndodhë, kush po lufton, për çka po lufton".

Ndërkohë jom takuar me Musa Jasharin. Musa m'thotë, "Nuhi", thotë... na aty kemi fjetë edhe kemi bisedu me Fehmi Lladrovcin gati tërë natën për zhvillimet në Kosovë. Fehmiu ishte ni idealist i jashtëzakonshëm, një luftëtar komandant i vendosur, njeri i gatshëm për t'u flijuar për lirinë e Kosovës. Bile aty ato ditë unë s'e kisha ditë e kishe dhënë ni intervistë për BBC-në edhe kishte kasetën origjinale të intervistës dhe e lshum aty në videon. M'ka fasionu paraqitja e tij publike për BBC ku thoshte, "Unë me dëshirë ma t'madhe do të vdisja për lirinë e Kosovës, ku me pasë atë fat me vdekë për lirinë e Kosovës".

Kshtuqë unë mora ni vullnet edhe une që si gazetar t'kontriboj në afirmimin e luftës për liri dhe pavarësi. Ndërkohë thashë, Musa Jashari m'tha, "Nuhi", tha, "ni shok i yti", tha, "po ka dëshirë me të taku", tha, "shok i studimeve në Likoc", tha, "osht". Po s'po ma tregon emrin fare, don me ma bo si befasi. Unë i kisha pasë disa shokë të studimeve nga Drenica po nuk e dija saktë kush mund t'jetë. Shkum aty bashkë me Musa Jasharin në Likoc edhe kur e takoj ni shok t'studimeve, Avdullah Qorraj nga Tica e Skenderajt.

Ishte i angazhuar në Këshillin e Emergjencës në zonën operative të Drenicës. I ndihmonte luftëtarët e lirisë me ushqim, me karborante me t'gjitha nevojat logjistike që kishte nevojë Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Kshtuqë bisedum aty u takova edhe me Sami Lushtakun dhe Samiu si Samiu i tregova thashë, "Ende Shtabi i Përgjithshëm nuk paska ndonjë vendim se kush duhet të raportoj". Samiu ishte i gatshëm tha, "Unë mund t'jep intervistë kur t'dush", thashë, "Du me marrëveshje me punu, nuk du pa marrëveshje".

Kshtuqë ndërkohë kemi bo marrëveshje me Shtabin e Përgjithshëm dhe unë edhe Abazi kemi pasë pëlqimin nga Shtabi i Përgjithshëm që për t'gjitha zhvillimet që ndodhin në zonat e luftës ne të jemi ata që raportojmë në mënyrë profesionale për zhvillimet e luftës në Kosovë. Ndërkohë, takoj Shaban Shalën, i cili ishte përgjegjës për moral dhe informim në zonën operative të Drenicës. Shabani na ka ndihmuar shumë me mjete logjistike duke na siguruar çarkullimin e lëvizjes në zona të luftës.

Kshtuqë vendosëm bashkë me Shabanin, tha, “Unë ka me shku”, tha, “Nuhi në Ratkoc të Rahovecit”. Atje ishte vra nipi i, Muhedin Morina. Tha, “Nëse doni me ardhë mund t’ju marrë me makinë”, thashë, “Koka rast i mirë shumë me shku edhe unë në Drenoc të Rahovecit”. Atje kisha dhëndrin e familjes tonë Jusuf Gashin, i cili ishte i angazhuar në mënyrë aktive në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Jom shku bashkë me nipin, me djalë të Isuf Gashit, Florim Gashi i cili n’atë kohë ishte gazetar në Revistën Zëri.

Bashkë u nisëm n’drejtimit të Malishevës edhe kur u ofrum te Gryka e Llapushnikut po na tregon Shabani thotë, “Në maj të vitit ‘98 ktu ka qenë ni betejë shumë e ashpër mes forcave të UÇK-së dhe forcave policore serbe”. Po na tregon krejt çka ka ndodhë. Aty ishte ni pizgaver i forcave serbe, të cilin UÇK-ja e kishte dëmtuar dhe ishte i djegur dhe s’kishin arritë as forcat serbe ta tërheqin. Kshtuqë për ne ishte ni rast i mirë që ta xhirojmë pizgaverin. Unë e luta Shabanin thashë, “Shaban, osht’ mirë ni deklaratë”, në uniformë ishte Shabani, “ni deklaratë”, thashë, “me dhanë çka ka ndodhë në maj të ‘98-tes për atë betejë”.

Shabani tha, “Nuhi”, tha, “osht’ mirë marrëveshjen me Shtabin e Përgjithshëm se ashtu jemi marrë vesh mos m’u prononcu askush niherë derisa”, se hala s’ishte caktu zëdhënësi i UÇK-së. Unë thashë, “Po xhirojmë kta pastaj unë ndërkohë merrna vesh me Shtabin e Përgjithshëm, s’besoj që do t’kemi problem”. Shabani foli për ato ngjarje edhe ne u nisëm në drejtim të Malishevës...

Anita Susuri: M’fal, veç ni pyetje e kom...

Nuhi Bytyçi: Po.

Anita Susuri: Kur kanë folë ata, a kanë pasë maska?

Nuhi Bytyçi: Jo, Shabani ka dalë kshtu me ftyrë me dalë, me ftyrë, “Edhe emrin”, tha, “qitma, lirisht. Vetëm duhet m’u marrë vesh me Shtabin e Përgjithshëm”. Jo, s’ka pasë maskë. Ka qenë eprori i parë që ka dalë publikisht. Vazhdojmë ne rrugës për Malishevë, Abazi merr disa imazhe nga makina aty edhe bisedën nga Shabani, bisedën në mënyrë t’lirë. Mbrrijmë në Malishevë, xhirojmë në mbramje. Xhirojmë atë stacionin e policisë në Malishevë, aty ishin UÇK-ja në Malishevë, nuk ishin policia serbe, nuk kishte n’atë kohë. Ishte territor, qendër e territorit t’lira.

Vazhdojmë rrugën për Drenoc të Zatriqit. Kemi mrri në Drenoc të Zatriqit. Jom shku te Jusuf Gashi kom bisedu me Jusuf Gashin. Aty pashë që ishin shumë luftëtar të UÇK-së edhe nga Rahoveci edhe nga viset e tjera. Nuk kishte vend ku me fjet te Jusuf Gashi, ishte aty vajza e axhës e martune për Jusuf Gashin, Dada Selë. Kshtuqë tha, “Shkoni”, tha, “te Bedri Zymberaj”. Edhe ai ishte i angazhun në UÇK

edhe njihesha me Bedriun, babën e Bedriut Bajramin. Aty kemi shku unë e Abazi kemi bujtë ni natë, kemi bisedu.

Të nesërmen Florim Gashi, nipi jonë, tha, “Dajë”, tha, “hajde ktu te shpija jonë”, tha, “se së shpejti pritët me ardhë ni njeri shumë i rëndësishëm për UÇK-në”. Nuk tregonte as për emrin, as për pozitën e tij se qashtu ishte ajo kohë. Unë nuk pytsha ma tepër. Isha i vetëdijshtëm që mos ta marrin si provokim. S’kanë shku disa minuta edhe ka ardhë Hashim Thaçi. Aty për herë t’parë e takoj Hashim Thaçin, nuk e dija kush osht’ as çfarë pozite ka.

Kemi bisedu, i tregova, thashë, “Unë kom ardhë me kontaktu me përgjegjësit e Shtabit të Përgjithshëm edhe nëse ju pajtoheni mund, unë edhe Abazi jemi për me ndihmu me i xhiru gjitha ato imazhet që kanë të bëjnë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës por edhe me jetën e civilëve edhe me zhvillimet që ndodhin në zonat e luftës”. Hashimi e ka përkrahë idenë time edhe tha, “Së shpejti Shtabi i Përgjithshëm do t’merr vendim për caktimin e zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”.

Bile në atë kohë, sipas mendimeve të tyre, ata kishin mendu në Prishtinë me publiku, zëdhënësi m’u paraqit nga Prishtina. Po ka analizu rrethanat e asaj kohe dhe ka vendosë që zëdhënësi të paraqitet nga Shtabi në Kleçkë dhe Devjakë. Kshtuqë tha, “Ma jep telefonin”, tha, “edhe unë t’lajmëroj. Kur ta marrim vendimin, kur t’caktohet zëdhënësi i UÇK-së”, nuk tregonte kush. Tha, “Unë ju marrë n’telefon edhe mirremi vesh”.

S’kanë kalu ni javë ditë edhe Hashim Thaçi ni mbramje t’vonë ka thirrë në telefonin e shtëpisë time, banesës time edhe receptorin e telefonit e ka ngrit Arianiti, djali. M’tha, “Babi”, tha, “po t’kërkon studenti”, se ashtu u morëm vesh. Tha, “Me shifër t’thom studenti ose Bashkimi”, tha, “dije që unë jom”. Kto kanë qenë pseudonimet e tij n’fillim. Unë e dita, s’i tregova Arianitit çka se ishte ashtu që nuk mund të tregohet as familjes as kërkujt, me majt diskret.

Tha, “Nuh”, tha, “a munësh me ardhë nesër”, tha, “me dalë në Grykën e Llapushnikut me u taku”, tha, “te pllumi”, bash ashtu po m’thotë. Unë thashë, “Po bon hajgare, ku me zanë pllumin n’hava”, a din (qeshë). Pseudonimi i Komandant Ferat Shalës ka qenë Pllumbi, Njësi Pllumbi, ka qenë komandant i Njësitit Pllumbi. Tha, “Ti lype pllumbin, mos ki gajle ta gjojnë ushtartë aty”. Ata ty të presin. Thashë, për me qenë i sigurt, se ishte luftë edhe m’i thanë nesër, nëse s’muj me ardhë nesër atëherë ishte ma problem. Thashë, “P’e lojmë për masnesër se bisedoj me kameramanin a munet nesër e mos ka ndonjë obligim ose ka ndonjë pengesë. Duhet edhe makinën me siguru kush na çon deri atje”.

Kshtuqë sigurova unë makinën, Zenel Kastrati tha, “Unë iu çoj, pa problem”. Edhe Abazi ka ardhë me mu. Masnesërmen jemi nisë në drejtim kah Magurja edhe kemi hy aty në fshatra kah Nikoci edhe fshatra që të shpijnë për Grykë të Llapushnikut, po jo nga rruga kryesore do të thotë rrugë anësore. Kemi mrrri atje në pozicione të UÇK-së në male të Llapushnikut. Aty kemi takuar disa luftëtarë të UÇK-së. M’kujtohet si sot ka qenë Shefqet Buqaj nga Lladrovci, Komandant Msusin të cilin e njifsha dhe e kena mik t’familjes.

Pastaj, Shani Hotin e kisha djalin e dajës t'babës edhe ishte në uniformë të UÇK-së. Kshtuqë meniherë hasa në njerëz të më njifshin edhe i njifsha. Thashë, "T'lutem a po na siguroni Komandant Pllumbin", thashë, "se kshtu e kemi ni marrëveshje". Kanë thanë, "Po, tash ju dërgojmë te Komandant Pllumbi". E kemi marrë rrugën në drejtim të Arllatit. Aty kemi, në anë të djathtë rruga për Negroc që shkon, aty pa shku te shtëpitë e Jakup Krasniqit, knej hyrjes t'fshatit Negroc. Kemi taku në ara Ferat Shalën, i cili u prezantu me emër, me mbiemër.

Tha, "Nuhi", tha, "unë jom Ferat Shala, Komandant Pllumbi", tha, "unë ty t'njoh prej xhaxhallarëve t'mi Beqirit edhe Islamit", t'cilët kishin qenë mjeshtër, kishin punu në Arbëri te ni shok i imi, kishin punu në shtëpinë e tij. Kshtuqë u kriju ni raport shumë i mirë mes meje edhe Feratit. Tha, "Zëdhëndësi", tha, "jom i informuar që keni me bo intervistë me zëdhëndsin". Jakup Krasniqi ishte caktuar zëdhëndës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe zëdhëndësi donte, sipas marrëveshjes me Hashim Thaçin, donte që për herë t'parë t'paraqitet në Televizionin Shqiptar e pastaj në mediat tjera.

Pritshin ato ditë gazetarët e BBC-së, CNN-it, Zërit të Amerikës, Deutsche Welle edhe media tjera. Por ishte qëndrimi që fillimisht për hrë t'parë t'paraqitet në Televizionin Shqiptar. Ky ishte ni nder dhe respekt i veçantë që mund t'mu kishte bërë mua personalisht dhe Abaz Zekës. Kshtuqë e morëm me shumë përgjegjësi që ta kryjmë këtë detyrë. Aty kemi shkuar në shtëpinë e Halim Krasniqit, ku ka qenë të vendosur ni pjesë e Shtabit të Njësitit Pllumbi. Pastaj kemi kontaktu me Kadri Veselin për herë t'parë edhe tha, "Tash mund të shkoni", edhe na caktun, nuk tregohej vendi ishte i msheft, mbahej sekret vendi. "Mund t'shkoni", tha, "me xhiru".

Erdh për me na marrë Hysenaj, ka qenë ni i burgosur politik, shok i Jakup Krasniqit. Ai me makinë na ka marrë na ka dërgu deri në hyrje të fshatit Tërpezë. Aty t'u shku rrugës po i thom, "Ku po na çon komandant?" Tha, "Në Likoc", tha, "po shkojmë". Unë në Likoc isha kanë para do ditëve që tregova edhe tash e disha që... thashë, "Jo po m'vjen keq", thashë, "Likoci knej s'osht". Ishte rruga për Malishevë kah ana ime atje, kah fshati im. Thashë, "Mos bon hajgare", tha, "Qy zoti gazetar, mos pyt ku po shkojmë", tha, "se osht' sekret nuk deshtëm me ua lidh sytë me shami", tha, "osht', janë do vendime sekrete nuk duhet me tregu vendin se osht' situatë shumë e rrezikshme".

Kshtuqë unë nuk fola masanej, e pashë situatën qysh osht'. Vetëm i tregova që nuk osht' qiknej Likoci. Aty kemi shku në Tërpezë te ni depo me materiale ndërtimore edhe ka ardhë edhe Haxhi Shala nga Shtabi i Kleçkës edhe na ka marrë me makinë të tij na ka çu në Kleçkë. Ishte mbramje vonë krejt. Ishin ato rrugë, për herë t'parë në ato rrugë kisha shku. Ni vend shumë fantastik. Kleçka është ni vend piktoresk. Ishte qershori domethonë '98, pikërisht me 13 qershor. Në orët e para të 14 qershorit, do të thotë pas mesnatës, me 14 qershor '98 i bëjmë përgatitjet bashkë me Abazin.

Tham, "Ku kemi me xhiru?" Ishte ni si lloj ode e vogël aty, pranë odës së madhe ku rrishin ushtarët. E kishin qit' ni tavolinë, ni kompjuter edhe ishte ni oxhak. E kishin punu në mënyrë me gur shumë bukur. Ishte ajo prapavija aty edhe kemi fillu me testu zanin, ndriçim nuk kishim edhe mikrofon po ashtu special s'kishim. Ni kamerë digjitale Sonny e vogël edhe unë frikësohesha që nëse nuk na del xhirimi

mirë do t'bohemi hor. Tash e dishim që ata mund ta marrin edhe mediat botërore, atë intervistë. Po qato ishin kushtet tona n'atë kohë.

Bile ata luftëtarët tentun që të sigurojnë diçka. Do drita t'luleve aty, n'ballkon aty. Po ato s'bojshin punë se ishin shumë ashtu me kapacitet t'vogël. Po mirë, kamera digjitale nuk kërkohej shumë ndriçim edhe kemi xhiru intervistën. Aty bile mas Jakup Krasniqit u paraqitën me armë moderne Fatmir Limaj edhe Ferat Shala. Unë thashë, "Çka po kërkojnë ata mrapa teje aty?" Tha, "Qashtu është vendimi i Shtabit të Përgjithshëm", tha, "duhet me dalë". Thashë, "N'rregull, ju vendosni". Po tash unë u frikësojsha a e transmetojnë Televizioni Shqiptar a jo. Ato ishin probleme tona tjera.

Qëndrimi i shtabit ishte që ata t'dilnin në prapavijë. Jakupi ma bon mu tha, "Nuhi, cilat janë pytjet që do t'mi bësh?" N'atë situatë ishte ni nder që m'bënte mu që si gazetar i parë ta intervistoj zëdhëndësin e UÇK-së, mirëpo nëse unë dal edhe identifikohem kush jam, frikësoheshim. Bisedum edhe me Jakupin thashë, "Unë jom i gatshëm me ju ndihmu juve, po nëse identifikohna edhe shkoj në Prishtinë, mu mujnë me më arrestu edhe unë s'muj me ju ndihmu juve kurgjo mas ksaj". Kshtuqë vendosëm... unë i kisha shkru pytjet, thashë, "Qito përgjegjesh qito pytje".

Për çka lufton UÇK-ja? Kush e ndihmon UÇK-në? Kush e financon UÇK-në edhe disa aspekte tjera në renin e dëshmorëve. Ka përkrahje nga faktori ndërkombëtarë e tjera e tjera. Kshtuqë Jakupi u pajtu me propozimin tim që unë t'mos shihem bashkë me të në ekran. Ai të fliste vet. Kshtuqë si dihet ajo paraqitja e Jakup Krasniqit ishte shumë dinjitoze. Edhe n'fund kur mbarova intervistën, unë thashë, "Kjo osht' ngjarje historike", thashë, "du me rreziku", thashë, "du me bo ni fotografi s'paku me Bacën Jakup si Zëdhënës i UÇK-së".

E luta Abazin edhe tjerë aty që ishin, me neve ishte edhe Kadri Veseli aty edhe Fatmir Limaj edhe Ferat Shala. Thashë, "Ma bon ni fotografi", thashë, "po rrezikoj. Filmin nashta s'ma zanë, do ta mshefi edhe ta zhvilloj pas luftës ta kem si kujtim për pas luftës nëse arrijmë t'kemi fat me shpëtu". Sot e kom atë fotografi, e kom mbrojtë për kujtim. E kom çu me zhvillu te ni shok i imi se s'mujshje gjithkund me çu me zhvillu filmin. Ktu e ka pasë në Qafë bile, Bashkim Mula, e ka pasë Art Photo, jo, Top Photo. Thashë, "E kom ni film të posaçëm mos i trego kërkuja". E ka zhvillu filmin e ka bo fotografinë. Prapa aty i ka dalë kush i ka ba. Ata e kishte të skanune Top Photo.

Masanej ka thirrë m'ka thanë, "Osht' mirë", se ishte rrezik shumë, t'mos kishte pasoja edhe ai. Thotë, "M'i bjen ato fotografi t'i boj do tjera pa logon e Top Photos", edhe ashtu ka ndodhë, me të vërtetë ka qenë ashtu. Ishte ni situatë shumë e vështirë, t'gjithë kishim dëshirë t'punonim, t'kontribonim mirëpo rreziku përmanent ekzistonte. Tash, ne e montum këtë paraqitjen e parë publike të zëdhënësit. Nuk kishe çka me montu qashtu qysh osht' xhiru e kemi dërgu, vetëm e kemi bartë në kasetën Beta camp EXP.

Unë e kom marrë kasetën kom shku te Agjensia Turistike Meti Turs. Atëherë çarkullonte për nga Prishtina për Tiranë, tri herë n'javë. Pastaj edhe Beli Turs edhe disa kompani tjera. Po atë ditë ishte radha e Meti Tursit edhe nuk e kisha pronarin e kompanisë, shkova n'zyre aty vetëm ai kish qenë. E

mbylla derën edhe thashë, “Unë jam”, filan fisteku, thashë, “kom ni material shumë me rëndësi nëse mundesh me na ndihmu me çu në Tiranë”. Po m’pytë ai, tha, “Çka ka Nuhi?” thashë, “M’duhet me qenë shumë i singertë”, edhe i tregova.

Me i thanë ka muzikë ose ka humor ose diçka me ia zanë policia atëherë ishin pasojat shumë t’mdhaja. Thashë ma mirë m’i tregu drejtë edhe le t’vendosë a guxon me kry këtë obligim. Kur i kom tregu që osht’ paraqitja e parë publike e Zëdhënësit të UÇK-së, Jakup Krasniqit, u step. I ka ardhë mirë po ishte, ishte shumë situatë e rrezikshme, gjendje e rrezikshme. E mori atë kasetë edhe me bo me bo me zanë policia pasojat ishin t’mdhaja për shoferin edhe për udhëtarët, për t’gjithë. Mirëpo Ahmeti, Ahmet Kaqiu tha, “Nuhi”, tha, “s’mundem”, tha, “me t’kthy”. E thirri shoferin Elmi Gashi ka qenë nga Hajvalia.

Elmiu tha, “Po unë e çoj nuk frikësohna”, tha, “unë e çoj”, “Me ia dhanë Asllan Bajramit”, thashë, “në Tiranë edhe kërkujt mos i kallxo tjetër kurgjo”. E ka marrë kasetën edhe e ka përzi me ato kaseta tjera të muzikës që kanë qenë aty në atë fatrollë për mos m’u dallu që osht’ kasetë tjetër, formati tjetër. Kshtuqë e ka kry detyrën Ahmet Kaqiu edhe Elmi Gashi. E kanë dërgu kasetën në Tiranë. Kshtuqë me 15 tetor në mbrëmje në lajmet e orës 06:30 minuta është transmetuar për herë t’parë paraqitja e parë publike e Zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Jakup Krasniqit. E cila ka pasë ni jehonë të jashtëzakonshme. Jo vetëm në opinionin shqiptar po edhe në atë botëror.

Kshtu me këtë punë që e bëm unë e Abazi ne e dham provimin edhe fitum besimin te Shtabi i Përgjithshëm që ne jemi t’përkushtuar edhe jemi t’gatshëm dhe krijum bindjen dhe besimin e plotë të Shtabi i Përgjithshëm që ne mund t’vazhdojmë bashkëpunimin drejt informimit profesional, objektiv nga zonat e luftës. Çka t’them tjetër? Ktu Asllani ka shkurtu pak bisedën sidomos atë pjesën ku flitet Ushtria Çlirimtare e Kosovës bazën e themelimit e ka në Lëvizjen Popullore të Kosovës dhe se funksionimin e UÇK-së e ndihmon Fondi Vendlindja Thrret.

Për shkak se n’atë kohë Qeveria Bukoshi kontrollonte Televizionin Shqiptar dhe financonte dhe kontrollonte. Kshtuqë kjo u pa se aty Qeveria Bukoshi ka ndikim edhe në Televizionin Shqiptar. Mirëpo me randësi ishte që paraqitja e parë publike e zëdhënësit u realizua me sukses, u transmetua. Si thashë, ne pastaj vazhdum punën me Abazin dhe shkuam në Shtabin e Përgjithshëm për të bërë skenarin sipas idesë sime për ni emision të posaçëm dokumentar kushtuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ato ditë ishte vrarë komandanti, luftëtari, Imer Krasniqi në Duhle të Suharekës dhe ishte vorrimi i tij në Carallukë të Malishevës. Ne me Abazin shkum atje, i xhirum kto imazhet ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës e prapa ushtarëve të UÇK-së ishte ni lum i tërë i njerëzve prapavijë. Kshtuqë ato imazhe kur i kemi plasuar në Televizionin Shqiptar edhe mediat botërore edhe në BBC, televizioni serb thonte kjo nuk është e mundur është montazhë. Nuk i besonin atyne pamjeve. Ato nuk ishin montazhë po ashtu ishte e vërtetë që ishte ni lum i tërë i njerëzve t’cilët ishin n’radhë pas shumë luftëtarëve të UÇK-së që kishin ardhë për t’i bërë nderimet e merituar bashkëluftëtarit të tyre, dëshmorit Imer Krasniqi.

Kshtuqë ne bëm planin bashkë me drejtuesit e UÇK-së, sidomos me Jakup Krasniqin i cili ishte shumë bashkëpunues, ishte shumë korrekt po edhe me Fatmir Limën. Xhiruam imazhet e para të betimit të UÇK-së në, në Kleçkë. Në ni lëndinë, në ni arë që ishte me ni pozitë që nuk dallohej pastaj ai vend, e kishim qëllimin që mos m'u hetu cili vend osht', ashtu e bom planin e xhirit bashkë me Abazin. Atëherë e sigurum edhe ni stativ për kamerë nga Foto Nesha, na dha Foto Nesha edhe ni mikrofon t'vogël. Kshtuqë kemi xhiru me ni kamerë kemi xhiru betimin edhe zërin edhe pamjet. Ishte ni betim, momente shumë prekse, shumë emocionuese.

Aty n'rresht ishin përveç djemve më t'mirë ishin edhe vajzat ma t'mira që iu kishin bashkangjitë Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Drenica, nga Llapusha edhe viset e tjera. Kshtuqë kemi bërë ni punë shumë të rëndësishme bashkë me Abazin aty edhe e dojshim që ai betim të dalë sa më mirë. UÇK-ja të paraqitet dinjitoze. Aty bile kemi bisedu para se me xhiru këtë betim, bisedum me Jakup Krasniqin. Unë i thashë, "Baca Jakup", thashë, "kom ni propozim që përshëndetja e UÇK-së mos t'bëhet me grusht". Sepse n'atë kohë deri vonë përshëndetjet i bënin me grusht sikur Ushtria e Shqipërisë në kohën e Enver Hoxhës.

Nuk ishte pritur mirë ky stil i përshëndetjes në opinion. Ngjithshin pastaj epitete, kta janë marksista lininista e tjera e tjerë. Kshtuqë i thashë bacës Jakup thashë, "Osht' mirë me qenë përshëndetja në stilin amerikan, Ushtrisë Amerikane". Baca Jakup u pajtua plotësisht, tha, "Kemi biseduar edhe për këtë mënyrë po hala s'kemi marrë vendim defenitiv po përkrahim propozimin tënd". Kur kemi xhiru betimin në Kleçkë është xhiruar në stilin amerikan {shpjegon me duar, dorën tek koka}. Kshtuqë ka dalë ni xhirim i mirë.

Edhe ishin momente që për mu edhe për Abazin ishin momente shumë t'randësishme. Sepse për herë t'parë merrnim pjesë me ni betim të Ushtrisë së Kosovës, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në të cilën ishin bashkangjitur edhe vllazërit dhe motrat nga të gjitha viset etnike shqiptare, jo vetëm nga Kosova po edhe nga Shqipëria edhe nga Maqedonia edhe nga Presheva edhe nga Mali i Zi edhe nga Diaspora e kshtu me radhë. Aty t'u bisedu për këtë emision mora vesh që n'mesin e luftëtarëve është edhe Komandant Kumanova, Ismet Jashari.

Atëherë emrin nuk ia përmendshin thojshin veç Komandant Kumanova. Mu m'la përshtypje ajo thashë, "Shumë mirë", thashë, "meqenëse koka nga Kumanova unë kom propozim që ai t'jetë aty n'xhirim në betim edhe ta marrë ni deklaratë prej tij". U pajtun t'gjithë drejtuesit e UÇK-së që të inxhizohet betimi në praninë e Kumanovës. Bile Kumanova aty bashkë me Fatmir Limën ia dhanë raportin Musa Jasharit i cili n'atë kohë ishte komandant i zonës operative të Pashtrikut.

Pasi i krym xhirimet e betimit, e marr thom, "Kumanovë", thom, "ti m'i thanë disa fjalë. 'Jom nga Kumanova, kom ardhë me ju bashkangjitë vllazërve t'mi nga Kosova, luftojmë për çlirimin e Kosovës edhe t'gjitha viseve shqiptare, bashkimin e t'gjitha viseve shqiptare", ashtu ka qenë teksti i betimit. Nuk ishte shumë orator po ishte ni luftëtar i vendosur edhe për mu ishte moment shumë, shumë i rrallë që në atë dokumentar ta përfshij edhe ni luftëtar nga Kumanova. Ashtu e realizum me sukses.

Ndërkohë duke shku për të xhiru ni dokumentar për territoret ilire në Kosovë bashkë me Shaban Shalën, kemi shku në Jashanicë të Klinës. Aty kemi hasë për herë t'parë në ni oficer karriere Gjeneral Agim Qelën. I cili kishte ardhë nga Gjermania iu kishte bashkangjitë në mënyrë vullnetare Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ishte ni oficer me akademi ushtarake. Kishte ni pamje imponante. Uniforma i kishte hije edhe qëndrimi edhe ishte orator.

Kshtuqë aty kur u takum, tha, “Nuhi”, tha, “osht’ zonë shumë e rrezikshme ktu, ki kujdes se janë forcat policore shumë afër, keni kujdes. Duhet m’u sjellë me ni kujdes të veçantë sepse mund të rrezikoheni gjatë xhimitit”. Kemi xhiru disa imazhe aty dhe pastaj jemi kthy, jemi kthy në Kleçkë atje dhe po ashtu kemi informu ata të Shtabit të Përgjithshëm që është mirë edhe ni intervistë me pasë edhe me Gjeneral Agim Qelën dhe janë pajtuar plotësisht. Sepse ai ishte pjesë e Shtabit Operativ të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe në Luzhnicë ato ditë qershori realizum ni intervistë të shkurtër me të, po ishte ni paraqitje dinjitoze e tij.

Tha, “Unë kom ardhë”, tha, “nga perëndimi, kom hasë ni vullnet të jashtëzakonshëm te t’ritë, t’rejat, te populli dhe jom optimist se liria do t’vijë”. Kshtuqë s’i harroj kurrë atë paraqitje të tij. Pastaj kemi ba edhe ni intervistë me Bislim Zyrapin i cili ka qenë shef i Shtabit Operativ të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe pastaj kemi realizu edhe disa biseda tjera edhe me Jakup Krasniqin, ni bisedë t’veçantë për këtë dokumentar. Pastaj, me Hasit Jasharin i cili ishte komandant i policisë ushtarake i zonës operative të Drenicës.

Pastaj kisha dëshirë që edhe vajzat e reja t’i përfshij në atë dokumentar. Kemi përfshi Irfete Spahiun, e cila ishte ni luftëtare e guximshme. Tani osht’ gjeneralja e parë e Ushtrisë së Kosovës, e forcave të Sigurisë së Kosovës. Pastaj kemi pa ato imazhet aty disa ushtrime në Kleçkë me Valbona Morinën, Xhemile Jasharin dhe disa vajza Bukurije Zogun e të tjera. Të cilat ishin krahas vllëzërve të tyre nga Drenica dhe Llapusha. Kto ishin emisionet e para, do të thotë, kanë qenë emisione dokumentare për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Pastaj territoret e lira ka qenë ni emision tjetër i veçantë. Kemi xhiru në Malishevë, kemi xhiru në Rahovec. Kemi hy, atje ka qenë shumë rrezik në Rahovec me hy me xhiru hymjen e Rahovecit sepse punkti i policisë serbe ishte deri vonë te rrasat e Rahovecit. Por ato ditë kishte pasë sulme nga njësitë i UÇK-së, fshatit tim Shkoza. Ata ishin larguar nga ato pozicione. Kshtuqë ne patëm rastin që t’hyjmë të xhirojmë edhe ni pjesë të Rahovecit. Pastaj kemi qenë edhe në Runik të Skenderaj.

Aty mund ta përshkruj ni moment, ka qenë shumë rrezik për mu edhe Azabin edhe Shaban Shalën. Sandokani ka qenë, Komandant Sandokani, Ramadan Kaqini, Jetullah Geci edhe disa luftëtar të tjerë të cilët na kanë shoqëru aty. Për ni moment ne fillum të xhirojmë aty, te ni pozicion i UÇK-së dhe forcat serbe na kishin hetuar dhe me snajper na kanë sulmuar dhe është xhirimi dokumentar, dëgjohet plumbi i snajperit. Po fati ka deshtë që kemi shpëtuar nga më e keqja.

Them se janë do momente të papërshkrune por vullneti, gatishmëria jonë për t’punuar, për t’sakrifikuar dhe për të paraqitur ato imazhe të ni ushtrie pro perëndimore, ni ushtrie që nuk është

ushtri terroriste, organizatë terroriste po ushtri që lufton për lirinë e Kosovës. Nuk ka asgjë ndaj popullit serb po lufton kundër regjimit të Millosheviçit, kundër dhunës, kundër terrorit serb mbi popullatën civile shqiptare. Kshtu kemi bo përpjekje që, që jo të bëjmë propagandë po me të vërtetë ta paraqesim Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ashtu siç ishte.

Ni ushtri që kishte përkrahjen e pa rezervë të popullit, ni ushtri të cilës i ishin bashkangjitur kryesisht student të Universitetit të Prishtinës, ni ushtri që po ashtu e drejtonin kryesisht ish studentët e Universitetit të Prishtinës, intelektualët e Kosovës dhe ni ushtri e cila ishte në koordinim të përhershëm me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me diplomacinë europiane. Dhe kishte arritur që ta fitonte përkrahjen edhe të faktorëve ndërkombëtarë.

Pjesa e Tetë

Anita Susuri: Ju na keni tregu edhe që ka pasë raste edhe kur nuk jeni leju, për shembull, te Gryka e Llapushnikut ku nuk ju ka dhanë leje Jakup Krasniqi, pse ka ndodhë kjo?

Nuhi Bytyçi: Po. Nejse, tash, kto imazhe, kto emisione që i dërgum në Tiranë, unë për Shtabin e Përgjithshëm kishte ni qëllim që m'i dërgu ndoshta përmes kanaleve të tyre që kishin logjistike nëpër male m'i dërgu. Mirëpo thoshin, "Nëpër male, mundeni me ardhë edhe ju me neve". Mirëpo Abazi printonte nëpër male me udhëtu edhe unë thosha rrugë e mundimshme. Kshtuqë vendosa që kto kaseta t'i dërgojmë në Tiranë vet.

I hypa autobusit, e mora edhe bashkëshorten me veti edhe djalë Arianitin me veti edhe Abazi me mu edhe kemi hypë n'autobus edhe kemi shku në Tiranë. Kemi dërgu kasetat për transmetim në Televizionin Shqiptar. Pastaj jemi kthi nga Televizioni Shqiptar, nga Tirana masi janë transmetu kto. Ka ndodhë beteja e Rahovecit ndërkohë edhe me 26, me 25 korrik '98 kom shku në Grykën e Llapushnikut aty afër shtëpive të Jakup Krasniqit, në Negroc. Jemi taku me Ferat Shalën edhe disa luftëtar të tjerë.

Ishte situata shumë e vështirë sepse forcat serbe kishin filluar me tankse, me ratileri nga Komorani dhe kishin, ishin nisë në drejtim të Malishevës. Konkretisht në Grykën e Llapushnikut. Une isha kureshtar që bashkë me Abazin t'i xhirojmë imazhe nga beteja frontale të UÇK-së me forcat serbe. I them Feratit them, "Ferat, bisedo me Jakupin edhe na osht' mirë me marrë pëlqimin edhe me na përcjellë dikush nga ushtarët se s'e dijmë terenin edhe për shkaqe sigurie", nuk kishim armë, se ishim gazetarë kishim vetëm kamerë, lapsin, bllokun. S'kishim armatim të posaçëm. Arma jonë ishte kamera edhe lapsi.

Kshtuqë thashë, "Bisedo", thashë, "nashta osht' mirë me xhiru nga Malet e Kosmaçit", aty ku ishin pozicionet e UÇK-së edhe rezistencën e forcave serbe. Ka bisedu Ferati me Jakupin, Jakupi ka thanë, "Jo nuk bon". Unë u preka t'drejtën me thanë, pse nuk bon, a din? Mendova që ka diçka kundra neve a din. Po masanej m'ka tregu edhe Ferati edhe Jakupi, tha, "Na e kemi ditë që situata ka qenë shumë e vështirë, ata janë nisë me armatim t'randë me atileri edhe keni mujtë m'u vra aty ju. Me ra dëshmor aty. Atë kemi deshtë me ju ru juve se kemi pasë nevojë për punën e ju, mbështetjen ju si gazetar".

Ajo ka qenë arsyeja s'ka pasë arsye tjetër sepse ka qenë situatë, raporti i forcave ka qenë shumë i papërshtatshëm, jo proporcional mes UÇK-së dhe s'kishte armatim. M'kujtohet niherë ni top e kishin sjellë, ni top të vjetër nga Llausha edhe bonin përpjekje që t'i bonin ni rezistencë sado t'vogël t'i bëjnë forcave serbe. Mirëpo ishte e pamundur se me tankste, me atileri të rëndë ishte e pamundur që me ni armatim të lehtë të rezistohej forcave serbe. Aty takoj edhe Nuri Behxhetin i cili ka qenë anëtarë i Shtabit të Përgjithshëm, profesor i historisë. Me ni t'folur s'disha a është nga Tetova a nga Shqipëria. S'mund ta identifikoj se atëherë emrat s'i tregojshin.

Kur dëgjoj që unë po insistoja me xhiru atë pamje nga beteja frontale. I erdh mirë tha, "Qisi gazetar", tha, "kem nevojë na", tha, "bravo t'qoftë", tha. Po pastaj aty kemi pasë, prej asaj kohe kemi pasë raporte t'mira me Nuri Behxhetin, Komandant Hoxhën dhe kemi bashkëpunu. Ai disa herë ka xhiruar me kamerën që e ka siguru Shtabi i Përgjithshëm edhe imazhet e tij i kemi përdorë për disa dokumentar, sidomos dokumentari për Mujë Krasniqin. Ai ka qenë në grupin e Mujë Krasniqit dhe ka xhiru atje nisë nga Cahani.

Thotë... kjo ka qenë për 25 dhe 26 korrik kur ka ra Gryka e Llapushnikut. Ka qenë moment shumë i rëndë. Në Grykë të Llapushnikut pastaj ra edhe Malisheva, ra... kontroll të drejtpërdrejtë të forcave serbe. UÇK-ja u detyru të largohet nga Malisheva po edhe popullata civile. Se nuk kishte siguri për popullatën civile në Malishevë kështuqë janë largu në fshatra tjera ku kanë qenë ma të sigurta.

Anita Susuri: Deshta edhe me ju pyetë për shembull marrëdhënie ndërmjet diplomatëve amerikan që kanë ardhë ktu me krejt gjendjen e UÇK-në, qysh ka qenë kjo?

Nuhi Bytyçi: Meqenëse tash unë e Abazi ishim pjesë e pandashme e UÇK-së, kishim informacione për t'gjitha zhvillimet që ndodhnin, t'gjitha. Edhe kontaktet që kishin Shtabi i Përgjithshëm me diplomatët amerikan dhe europian. Kështuqë u informum që në Dragobil do t'mbahet ni takim i parë publik mes drejtesve politik të UÇK-së në krye me Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Ramë Mujën, Sokol Bashotën. Shkuam në Dragobil për të xhiruar dhe ishte edhe Ambasadori Christopher Hill. Ishte ni ngjarje e jashtëzakonshme sepse për herë t'parë publikisht... ata kishin pasë disa takime tjera interne por ky ishte takimi i parë publik.

Ishin ardhë edhe gazetarët e mediave tjera aty, Sylejman Kllokoqi, Rrahmon Paqarizi, Muharrem Nitaj, Valentina Saraçini e tjerë e tjerë gazetar. Ibrahim Osmani i Zërit të Amerikës. Behxhet Baraliu e tjerë e tjerë. Kështuqë shkum në Dragobil aty. Ishte ni shtëpi e familjes së djemve të Zekë Paqarizit. Aty ishte selia e misionit ushtarak amerikan, vëzhguesit amerikan. Aty unë institova që Abazi t'hy t'i marrë disa imazhe shkurt nga ai takim edhe u përkrah iniciativa ime nga udhëheqësit e UÇK-së. Insistojnë edhe gazetarët e tjerë, kta kameramanët e tjerë me hy edhe...

Anita Susuri: A ka pasë edhe t'huj gazetar?

Nuhi Bytyçi: Ka pasë, ka pasë po. Po ishin zakonisht kta që raportnin për mediat e huja. Ata insistonin po thanë, "Jo ktu vetëm Abazi munet me hy për TVSH-në edhe ju mund t'i merrni nga ai".

Abazi ka hy ka xhiru aty imazhe të takimit të Hill-it me udhëheqjen politike të UÇK-së. Pastaj kemi marrë edhe ni deklaratë prej Jakup Krasniqit aty për çka u bisedu. Ky ka qenë ni moment shumë kthese për UÇK-në sepse UÇK-ja publikisht takohej me ni diplomat, ni ambasador amerikan. I cili ishte ambasador në Shkup po ishte i deleguar special për Kosovën.

Christopher Hill, i cili ka lujt rol të rëndësishëm për përgatitjen e Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje të Francës bashkë me ambasadorin austriak i cili ishte përfaqësues i Bashkimit European Wolfgang Petriq. Aty pas disa dite kemi xhiru edhe ni bisedë me Ambasadorin Petriç në Dragobil që kishte ardhë me përcjellë gjendjen në komunën e Malishevës. Bashkë me të ka qenë edhe Ambasadori gjerman Ruber. I kemi xhiru bisedat edhe me Ruberin. Kshtuqë kemi arritur që opinionit ndërkombëtarë t'ia prezantojmë edhe interesimin e bashkësisë ndërkombëtare për të gjitha zhvillimet që ndodhin në zonat e luftës.

Kanë qenë ato imazhe shumë t'randësishme që pasqyronin gjendjen tejet të vështirë në Kosovë. Sepse popullata civile tashmë ishte larguar kryesisht nga shtëpitë e tyre dhe ishte vendosur në malet e Berishës, në malet e Tërpezës, në Grykën e Krojmiri, Grykën e Shalës dhe në pjesë tjera të Kosovës. Ku ishin të pozicionuara, ishin nën kontrollin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës...

Anita Susuri: Për civilët e ka pasë... se ju m'tregut për reportazhe që keni bo me UÇK-në me krejt situatën që u kriju. Po a keni marrë edhe pamje me grupe të civilëve ose raste që janë bo masakra?

Nuhi Bytyçi: Po patjetër se lufta bëhet për njerëzit dhe për civilët. Lufta për me pasë ni siguri, ni liri të civilëve, popullatës. Kshtuqë gjitha ato zonat që kemi pasë rastin të shkojmë me Abazin ne edhe në komunën e Malishevës edhe në komunën e Klinës edhe në komunën e Lipjanit dhe fshatra tjera por edhe në zona tjera edhe në zonën e Llapit edhe të Dukagjinit edhe të Shalës edhe të Rahovecit. Kshtuqë kemi, kemi bërë xhirime të veçanta për dramën, jetën e civilëve, fmise, pleqve, plakave në malet e Kosovës. Sepse shumica e shtëpive ishin djegur pas granatimeve të forcave serbe edhe popullata civile nuk kishte siguri t'jetonte në shtëpitë e tyre.

Kshtuqë kemi, kemi rrëfimet e popullatës civile në malet e Tërpezës. Pastaj në Golloboc të Malishevës, në Dragobil, në Suzup. Konkretisht edhe në Malishevë kemi hy. Unë e Abazi kemi xhiru edhe në Malishevë derisa kanë qenë edhe forcat serbe aty. Kemi parë në gjendje të mjerueshme në Malishevë. Qyteza pa njerëz, qytezë fantazmë i thojshim. Në Drenicë po ashtu kemi xhiruar fmitë nëpër ledina, nëpër male. Ishin momente shumë t'vështira por shihsha ni vullnet t'madh te populli. Nuk ishin kurrsesi të zhgënjyn. Ata ishin optimist se lufta do t'përfundoj edhe liria do t'vijë.

Kshtuqë edhe ata ishin pjesë e ni rezistence aktive, e ni rezistence ni mbështetje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me ato potencialet e veta, mundësitë e veta bënte përpjekje që të ofronte edhe ushqim edhe mbështetje logjistike edhe përkrahje morale edhe të tjera. Kemi bo emisione t'veçanta, do të thotë jeta pranë gërmadhëve, jeta në qiellin e hapur, lufta për shkollën. Kemi xhiru fmitë për shembull në Malet e Berishës kur jemi shku me xhiru civilët aty në Malet e Kishnarekës. Kemi pa civilët nëpër tenda të najllonit, tenda tjera.

Mjekët, humanistët e shquar Gani Demolli, Ymeri, Nazim Ymeri, motra Sevdie Llalloshi m'kujtohen si sot i kanë ndihmuar shumë popullatën civile, për t'i kaluar traumat e luftës. Pasi xhirum ato imazhe duke u ngjitur Bjeshkëve të Berishës hasëm në ni ledin ku disa prindër dhe luftëtar ndihmonin që të ngritet shkolla e najllonit. Për nxënësit që ishin aty n'ato Malet e Berishës. Që sado pak ata t'mos mbetën në mënyrë vetëm nëpër male mos të zhgënjehen, t'i kalojnë më lehtë traumat e luftës. Kshtuqë arsimtarët bashkë me prindërit kishin filluar që ta ngrisin tendën e najllonit. Unë i thashë Azabit, "Xhiroj kadal kadale t'gjitha ato pamje duke ngritur tendën e najllonit".

Aty shkrunte klasa e parë, klasa e dytë, klasa e tretë, salla e arsimtarëve. Ishte ni moment, i veçantë për neve. Fmitë ishin në ni lendinë të ulur edhe t'zbathur, t'deshur. Por kishin ni vullnet, pritshin çdo moment që t'filloj mësimi. Erdhi momenti kur ata u renditën në rresht edhe arsimtarët ju prinin për me hy n'klasë. Ishin disa drrasa në vend t'bankave edhe t'karrigave. Arsimtari Sami Qelaj m'kujtohet si sot, Sahit Bajraktari, Fadil Bajraktari, Hasan Nishori edhe disa arsimtar tjerë. Ju shpërndanin nga ni fletore dhe nga ni laps, libra s'kishte. Nga ni laps dhe nga ni fletore.

Ata fmitë i morën ato dhe unë insistova që t'i recitojnë disa vjersha. I recitun. Bile m'kujtohet si sot ni vjershë, 'Duke pritur lirinë'. Ishin momente të papërshkruara për ne por ishin xhirime t'veçanta që kishim, që kanë mbetë në histori. Pastaj disa prej tyre imazheve i kemi transmetuar në emision të veçantë për Televizionin Shqiptar edhe pas luftës kemi ba ni film dokumentar për shkolla dhe mbijetesa.

Dua t'them se në kuadër të ktyre emisioneve televizive në Prekaz të Epërm kam takuar Komandant Rrahmon Ramën që ishte komandant i zonës operative të Shalës. Ishte familjar mik i familjes të Komandantit Legjendar Adem Jasharit dhe familja e Adem Jasharit ishte vendosur pikërisht në familjen e tij. Kshtuqë tha, "Nuhi", tha, "a po vjen me mu dikund është me rëndësi", tha, "Po more, qysh jo. Ku po shkojmë?" Tha, "Në Prekaz", tha, "familja e Adem Jasharit", tha, "ni pjesë e familjes të Adem Jasharit për herë t'parë po shkon m'i vizitu shtëpitë pas 05 marsit edhe 06...

Anita Susuri: Pas sa mujve po i bjen?

Nuhi Bytyçi: Po n'gusht ka qenë ajo, në gusht. Ajo ishte ngjarje e papërshkrueshme, ishte ngjarje e veçantë për neve. Kom hyp në makinë me Rrahmanin. Ata kanë qenë, familja e komandantit kanë qenë me ni traktor. Kemi xhiru, Abazi ka xhiru, t'u hy aty në oborr të shtëpive të tyre. Ishin gërmadha. Fillun pastaj aty me shiku çka ka shpëtu, a ka naj armatim, a ka diçka çka ka shpëtu nga ajo periudha e luftës. Aty kanë gjetë edhe ni automatik të Komandantit Legjendar edhe disa armë tjera.

Kshtuqë kemi xhiru ato momente, ka qenë motra e Adem Jasharit, Qamilja. Ka qenë Iliriana, vajza e Rifat Jasharit, ka qenë Shqipja, vajza e Komandantit Legjendar edhe disa fmi tjerë ma t'vegjël se kta. I kemi xhiru krejt në mënyrë dokumentare edhe kom marrë ni bisedë me Bashkim Jashari, ka qenë Komandant Bashkim Jashari. Bashkimi i Rifatit aty. Ai i ka prit për shkaqe sigurie mos po sulmojnë forcat serbe. E kom marrë ni deklaratë prej tij. Ai shprehet, thotë, "Na edhe pse shpijat na janë

shkatërru, na nuk i lshojmë trojet tona. Na kem m'u kthy shpejt n'trojet tona". Por edhe Iliriana ashtu përafërsisht këtë përmbajtje e ka pasë, "Nuk e lshojmë Kosovën, kurrë s'e lshojmë Kosovën".

Se qëllimi i Serbisë ishte me largu popullatën shqiptare nga Kosova edhe me bo serbizimin e Kosovës. Kshtuqë kto ishin momente t'veçanta për ne m'i xhiru ato imazhe edhe i kemi përfshi me ni emision special për zhvillimet në zonat e luftës. Dua t'them ktu tash që lidhet me shkollën shqipe, n'atë kohë UÇK-ja kishte edhe përkrahjen e rinisë shkollore në Prishtinë, t'shkollave t'mesme. Nxënësit e Gjimnazit Sami Frashëri, të Gjimnazit Xhevdet Doda kishin marrë iniciativën për me organizu ni tryezë t'rumbullakët me disa intelektual. Tema ishte lufta e UÇK-së dhe mbështetja e saj.

Kshtuqë rinia shkollore e Xhevdet Dodës kishte marrë këtë iniciativë edhe kërkonin edhe mbështetjen time. Thanë, "A po vjen edhe ti meqenëse je gazetar raporton nga zonat e luftës". Unë s'kisha mundësi atë ditë kur organizojshin tryezën me marrë pjesë. Vetëm i propozova Besfort Recës, Arianit Bytyçit, Fiton Pejës, propozova që, Kreshnik Gashit, propozova që ktu të ftohet profesori Arsim Bajrami, Behlul Beqaj, Muhamet Mavraj edhe drejtori i shkollës normalisht, Binak Ulaj ka qenë aty si drejtor e ka përkrahë këtë iniciativë të nxënësve të Gjimnazit Xhevdet Doda.

Ata kanë tani ndërkohë kanë nxjerrë edhe revistën shkollore 'Gjimnazisti' edhe n'ato shkrimet kryesisht ka pasë shkrime për luftën e UÇK-së. Unë i kom siguru disa fotografi, ia kom dhanë Arianitit dhe i kanë plasuar fotografitë e betimit të UÇK-së në Kleçkë. Disa fotografi të Fehmi Lladrovçit. Ka qenë edhe Bujar Sadiku aty e ka pasë ni shkrim për luftëtarët e Ortakollit. Arianiti ni shkrim të veçantë po ashtu për UÇK-në dhe kanë, edhe tekstin e betimit të UÇK-së e kanë botu në revistën 'Gjimnazisti'. E cila ishte ni ftesë publike që UÇK-ja të përkrahet edhe nga nxënësit e shkollave të mesme.

Kshtuqë dua t'them se u krijua ni klimë shumë e favorshme edhe jashtë zonës t'luftës që interesimi ishte i jashtëzakonshëm për ato çka po ndodhë në zonat e luftës. Kishte gadishmëri nga rinia, nga qytetarët, nga intelektualët, nga organizatat humanitare për të ndihmuar popullatën civile në zonat e luftës. Sidomos Shoqata Nënë Tereza bënte ni punë të jashtëzakonshme për të ndihmuar civilët, qoftë me ndihma humanitare, qoftë ndihmë mjekësore, me barna edhe ndihma tjera që kishte nevojë popullata civile.

Ndërkohë bashkë me Muhamet Mavrën jemi nisë nga Prishtina për të marrë pjesë në kremtimin e festës së 28 nëntorit, ditës së flamurit kombëtar në Divjakë. Ishte caktuar manifestimi qendror që organizohej nga Shtabi i Përgjithshëm. Ku ishte paraparë që të fliste edhe Zëdhënësi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, zotëri Jakup Krasniqi. Aty merrte pjesë edhe eprori i lartë i Shtabit të Përgjithshëm, Naim Maloku. Tahir Sinani m'kujtohet që ka dhanë raportin Jakup Krasniqit, raportin solemn aty me rastin e festës së flamurit. Ka qenë Shaban Dragaj. U bë parakalimi aty i njësiteve të UÇK-së. Ishte borë, acar i madh.

Kemi vrejt te luftëtarët e lirisë ni vullnet të jashtëzakonshëm për të vazhduar luftën deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës. Aty kishte edhe familjar të dëshmorëve t'cilët merrnin pjesë dhe bënë me madhështor këtë solemnitë të festë kombëtare. Ishte festa e parë që kremtohej në rrethana lufta dhe

t'gjithë ishin optimist se festa tjetër do t'kremtohet në liri. Tash ishte ni emision, ushtria nën flamur, si sot m'kujtohet e kom titullu ashtu, ushtria nën flamur. Ishin ato imazhe që kishin ni mesazh shumë të qartë se lufta ka marrë përmasa të gjera dhe përkrahja nga bashkësia ndërkombëtare nga faktorët ndërkombëtarë ishte shumë me rëndësi për atë fazë të luftës për liri. T'gjithë ishim optimist se liria është e pashmangshme.

Aty dua të potencoj që pas përfundimit të xhirimit pjesës së flamurit, Fatmir Limaj na tha mu e Abazit na tha, "A po rrini sonte ktu", tha, "të festojmë bashkë me luftëtarët". Kemi nejt. Ishte për ne pjesa e parë që kremtonin n'atë mënyrë. Kemi ba disa xhirime aty. Fatmiri kur i ka pa shkrimet e 'Gjimnazistit' i ka falënderu në mënyrë të veçantë rininë e Prishtinës, Fiton Pejën, Arianit Bytyçin, Kreshnik Gashin, Bujar Sadikun, Besfort Recën dhe të tjerët të cilët ishin në përkrahje të plotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe ishte kjo ni mirënjohje e veçantë që i jepej rinisë së atëhershme të Prishtinës. E cila ishte shumë e preokupuar me zhvillimet në zonat e luftës dhe ishte e gatshme të ndihmonte në mënyrën e vet.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë qysh ka qenë gjendja n'qytet n'qat' kohë? Në Prishtinë për shembull? Qysh ka qenë atmosfera?

Nuhi Bytyçi: T'them t'drejtën në Prishtinë, kur kthehesha në Prishtinë m'i montu ato emisione natën i montoja zakonisht në familjen e Doberqanëve. Kur dilja n'qytet, kur kisha kohë me dalë n'qytet te Qafa sidomos aty grumbulloheshin gazetarët. Qysh u thirrë kjo kafja ktu që ka qenë n'qosh ku osht' LDK-ja tash, Puntë a qysh ka qenë? Kom harrru. Aty ka qenë ni kafe, aty vishin edhe gazetarët e huj. Unë u përzisha me gazetarët e huj pak nëse ndodhë naj arrestim a diçka bile t'jenë edhe kolegët e mi nga media tjera edhe raportojnë çka ka ndodhë.

Mirëpo te popullata te shumica e njerëzve e vrejshim ni indiferencë për atë çka po ndodhë në vise tjera. Sikur mos, thojshin, "S'osht' e mundur në Prishtinë me ndodhë kjo. Le t'luftojnë atje po ktu mos t'na prekin ktu". Bojshin biznes edhe me serb edhe me tjerë. Kshtuqë e vrejsha nifar' gjendje jo reale se atje ata luftonin për lirinë edhe të ktyne njerëzve të Prishtinës. Kurse kta fort nuk preokupoheshin me situatën në zonat e luftës. Ashtu ishte. Me t'vërtetë kish edhe disa koleg t'mi që thojshin, "Mos rreziko shumë se je t'u rreziku shumë".

Kto te unë përkundrazi jo që m'kanë dekuraju po m'kanë dhanë kurajo që t'punoj ma tepër. Kom thanë që unë nuk do të ndalëm vetëm do t'shkoj dhe do t'raportoij nga zonat e luftës edhe nëse rrezikohem është e natyrshëm që ni gazetar t'rrezikoj. Por vetëm duhet të kontriboj që të plasohet e vërteta për luftën për liri.

Anita Susuri: A ka qenë numri ma i madh që keni pa n'qytet policve ose ushtarakve ose...

Nuhi Bytyçi: Ka pasë, ka pasë polic. Ka pasë polic po nuk janë vërtet shumë. Ka pasë më shumë civil si duket. N'qytet ashtu nuk ka pasë ni organizim kshtu luftarak a din. Kontrolla ka pasë. Unë bile natën

nuk guxojsha me çarkullu se thojsha n'atë kohë bjen njeri i dyshimt. Kom, ka ndodhë që kom fjet në shtëpinë e Doberqanëve aty nëse kom mbetë me montu natën. Kom pushu pak aty.

Natën s'kom lëvizë se ishte larg Arbëria me Bregun e Diellit dhe bisha n'sy t'forcave serbe dhe mund të zbulohesha se jom gazetar. N'atë kohë ishte problem me çarkullu. Mirëpo, thashë, njerëzit e Prishtinës kanë qenë shumë indiferent. Ni pjesë e madhe e tyre po them se ka që kanë kontribu nga Prishtina kanë dërgu ndihma dhe kanë ndihmu edhe popullatën civile edhe UÇK-në e kшту me radhë.

Anita Susuri: E a keni pasë problem ndonjëherë me policinë ju?

Nuhi Bytyçi: Fati ka deshtë që s'kemi pasë problem. Kur jemi taku, disa herë jemi taku afër Drenasit, kom qenë bashkë me Shaban Hoxhën. Kur e kanë nalë makinën, ai Shabani ka qenë shumë i guximshëm hiç s'u frikësojke, s'u frikësojke. Na nifar' mënyre qashtu pas tij. Kishim ni siguri ma t'madhe. E mshefshim kamerën n'kepek dikund, e kishte ni bunker t'veçantë ai në kepek. Kamera s'ishte e madhe edhe kasetat edhe thoshin nëse s'na gjojnë kasetat edhe kamerën ma lehtë shpëtojmë.

Mirëpo ishte shumë vështirë me tregu që je gazetar. Ata kërkonin pastaj akreditimin. Akreditimin e Ministrisë së Informatave të Serbisë. Na nuk e pranojshim atë shtet, nuk dojshim me apliku as me na dhanë akreditimin. Kштуqë kemi sakrifiku kшту pa asni akreditim. Ni kohë filloj mendum që nashta na ndihmon me pasë ni librezë të bashkëpunitorit nga Revista Zëri, e nënshkruar nga drejtori i Zërit, Blerim Shala, me t'cilin kemi bashkëpunuar gjatë kohës së luftës. Unë kam marrë disa shkrime për çdo javë për këtë revistë për situatën në zonat e luftës. Blerimi dhe Bardh Hamza kryeredaktori i kanë botuar me knaqësi. Kштуqë kemi pasë ni bashkëpunim t'mirë me ta.

I kemi thanë, "Bona mu e Abazit nga ni librezë që jemi bashkëpunëtor që nëse kemi ndonjë problem mujshim m'u nxjerrë disi". Mirëpo s'kemi pasë nevojë me tregu asniherë. Gjithmonë jemi paraqit si civil, s'jemi paraqit si gazetar sepse masnej dilshin probleme tjera. Kom bashkëpunu në mënyrë të veçantë edhe me redaksinë e Botës së Re. Ka qenë Gazeta Studendore në krye me Muhamet Mavrën i cili insistonte që në çdo numër të kësaj gazete të kem nga ni shkrim për luftëtarët e UÇK-së. Ka ndodhë disa herë që n'gjysë natës ma ka dërgu taksin te banesa edhe m'thojke, "Nuhi po t'pret taksi me ardhë në Velani". E kishte selinë e gazetës aty.

Ishte problem n'atë kohë me çarkullu drejt me thanë. Mirëpo vullneti, dëshira e Muhametit ishte që unë ta kem nga një shkrim atje. I shkrujsha shkrimet në kompjuter në banesë e atëherë e merrsha floppy-in, flopp i kemi thonë atij që kemi punu. Shkojsha edhe fotografitë i merrsha edhe i çojsha në redaksinë e kësaj gazete dhe i ka botuar Muhameti. Muhameti ka qenë ni përkrahës i jashtëzakonshëm i UÇK-së. Nifar' mënyre Bota e Re u bë tribunë e vërtetë si me qenë gazetë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së.

Anita Susuri: Si kanë qenë, po mendoj, mujt e fundit të vitit '98? Pastaj ato varrimet që kanë qenë... ndoshta ka qenë edhe varrimi i rrezikshëm në masë t'madhe t'njerëzve m'u mbledhë?

Nuhi Bytyçi: Po. M'kujtohet si sot kur me 14 dhjetor '98 në Malet e Pashtrikut duke hy në Kosovë ni grup i madh i luftëtarëve të UÇK-së i pajisun me armatime të ndryshme kanë has në prit të forcave kufitare serbe në Malet e Pashtrikut. Aty ishin vrarë Komandant Mujë Krasniqi, Kapuqi edhe disa komandant të tjerë. Gjithsej 38 luftëtar të devotshëm të UÇK-së. Ishte ni humbje e madhe për UÇK-në edhe disa ditë ka zgjatë ajo procedura e verifikimit të kufomave, mjekësia ligjore e tjera e tjera.

Me 20 dhejtor '98 është bërë varrimi i tyre në një ledinë në fshatin Polac të Skenderajt. Kemi shku unë e Abazi atje. Ka qenë ni varrim shumë dinjitoz. Ka marrë pjesë familjarët e tyre dëshmorëve po edhe familjar të tjerë, qytetar tjerë nga Drenica. Ishin momente të vështira shumë, përjetime t'vështira. Aty takoj edhe babën e Mujë Krasniqit, axhën Halil. Axha Halil kishte dhimbje për rënien e djalit të tij, dy djemve, edhe të Alisë edhe të Mujës. Mirëpo ai ishte krenar me veprën e tyre dhe qëndronte burrërisht.

Deri në mramje ka zgjatë m'kujtohet varrimi, në orët e vona të mbramjes ku filloj edhe blenda të bie. Xhirimet na kanë dalë ni pjesë mjaft të errëta. Mirëpo ishin xhirime historike, ishin xhirime shumë të rëndësishme dhe kshtu aty Shtabi i Përgjithshëm organizoj atë ceremoni me, me përshëndetje ushtarake me nderime ushtarake janë varros t'gjithë dëshmorët që janë ra në Malet e Pashtrikut.

Ishin luftëtar nga të gjitha viset e Kosovës. Ishin ardhë, m'kujtohet, edhe nga Zhuri i Prizrenit edhe nga fshatrat e komunës së Prizrenit. Ishin momente t'vështira me t'vërtetë por t'gjithë ishin krenar edhe se gjaku i tyre nuk do t'shkoj huq por ai do t'jetë themel i lirisë tonë.

Pjesa e Nëntë

Anita Susuri: Na tregut për Drenicën edhe për pjesën që e keni mbulu, po nga ana e Dukagjinit? Se edhe atje ka pasë...

Nuhi Bytyçi: Po sigurisht. Kam qenë edhe në Dukagjin edhe pse ka qenë bukur vështirë me shku në Dukagjin sepse duhej kaluar disa rrugë shumë t'rrezikshme ku kishte edhe forca policore serbe të cilat vëzhgonin çdo lëvizje. Kshtuqë pata shku shumë herët në fund të prillit '98. Me 29 prill saktësisht kur u bë vorrimi i disa dëshmorëve që ranë në rrugë duke u kthyer nga Tropoja me armatim në Malet e Pashtrikut. Kshtuqë shkova me marrë pjesë në varrim në Prilep të Deçanit. Thashë, ndoshta t'kontaktoj me ndonjë komandant të UÇK-së se nuk dija as kush osht' komandant as ku e kanë shtabin.

Meqenëse isha dhandërr i Glllogjanit thashë në Glllogjan duhet me pasë ndonjë shtab dhe kontaktoj me ndonjë drejtues të UÇK-së. Kshtuqë mora pjesë në vorrim të dëshmorëve në Prilep edhe vendosa të shkoj në... raportova për të gjithë shqiptarët nga aty, nga Prilepi me ni telefon satelitor. Shkova kërkova që dikush me makinë t'më dërgoj në Glllogjan. M'dërgun për Glllogjan. N'rrugë për Glllogjan na ndalën disa luftëtar të UÇK-së. Për fat ata m'njihnin mue si dhëndërr i Glllogjanit. Edhe pse kishin pasë urdhër që asni gazetar t'mos të hyj në zonën operative të Dukagjinit, më saktësisht në Glllogjan. Ata nuk më kthyen.

Unë e shfrytëzoja afërsin që kisha me familjen Selmanaj, me djemtë e Muhamet Selmanaj, me Alin, me Nazmin, me Fahrin edhe djemtë tjerë. Sepse Rasimi ishte n'burg, Rasim Selmanaj. Shkoj aty në odën e familjes Selmanaj, aty e pashë luftëtarët e UÇK-së. Ishte djali i Alisë, Agimi në uniformë. Ishin nipi i tyre, djali i motrës së Alisë, Luani, Luan Nimalaj. Kshtu e shumë luftëtar të tjerë. Unë më erdh mirë që ata janë, ju kanë bashkangjitur Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kërkova, pyta, thashë, “Kam dëshirë që të takohem me ndonji komandant të UÇK-së për zonën e juj”, m’thanë, “Do t’bëjmë përpjekje tash osht’ luftë s’e di a osht’ ktu komandanti”. S’e tregonin as emrin, as mbiemrin. Po mu s’më interesonte as emri, as mbiemri, vetëm kisha dëshirë të takohem dhe t’bisedoj me të çka mund të ndihmoj si gazetar. Pas ni kohe kanë shku kanë bisedu me komandantin. Mas ni kohe ka ardhë, si sot m’kujtohet Ramushi, Ramush Haradinaj. Për herë t’parë e takoja aty. Erdh në uniformë. I kishin treguar që jam dhandërr i Glogjanit.

Tha, “He dhanderr, qysh ke ardhë? Çka ke ardhë? Kush t’ka lanë me hy ktu se e kemi të ndaluar për gazetar”, thashë, “Unë jom dhandërr edhe kom do përparësi në krahasim me gazetarët e tjerë”, thashë, “unë jom i interesun me ju ndihmu juve çka keni nevojë me informim”. Tha, “Niherë s’ka qëndrim Shtabi i Përgjithshëm se si do të menaxhohet kjo punë”, tha, “ma jep telefonin ndërkohë kur t’marrim ndonjë qëndrim t’informoj me çka ka mundësi”.

Ndërkohë unë rash në kontakt ma herët me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së dhe atje kam vazhduar punën time intenzive bashkë me Abaz Zekën dhe kolegët e tjerë. Duke raportuar nga të gjitha zonat e luftës në Kosovë. Ma vonë në Glogjan kam qenë kur ka ra Glogjani me 16 gusht të vitit ‘98. Ishin pamje të tmerrshme, shtëpitë ende digjeshin, dilte tymi. Shumë lopë i kishin vrrarë policia serbe, vetëm që shqiptarët t’mos kenë as qumësht, as mish, as t’kenë mundësi të ekzistojnë. Kshtuqë i xhirum ne me Abazin ato imazhe aty, shkum bashkë me Emrush Xhemajlin.

Ramushin e takum në lug Baranit duke shkuar në betejën e Logjës. Tha, “Shkoni”, tha, “te Faton Mehmetaj në Pozhar dhe takone Fatonin edhe Emrush Xhemajlin dhe kqyrni nëse doni me shku në Glogjan. Po keni kujdes se s’ka UÇK në Glogjan edhe osht’ rrezik mos ka forca serbe aty, mos po rrezikohej”. Ne kishim ni vullnet t’jashtëzakonshëm edhe kemi shku, kemi hy në Glogjan, kemi xhiru bashkë me me Emrushin. I kemi bo disa fotografi me aparatit e tij, t’cilat i kemi disa për kujtim. E kem bo ni intervistë me Fatonin se ishte përfaqësues politik nga zona e Dukagjinit për gjendjen në përgjithësi në Dukagjin. Pas ofenzivës të forcave serbe.

Pastaj bom edhe disa xhirime tjera në Lumbardh, popullatën civile që kishin dalë nga shtëpitë ishin vendosur në disa livadhe aty afër Lumbardhit dhe fshatrave të Lugut të Baranit. U kthym do të thotë nga Dukagjini. Aty kemi bujtë ni natë në familjen e Ramë Lekajt, dajës së bashkëshortes time. Kemi pa ni vullnet t’jashtëzakonshëm të popullatës civile dhe të luftëtarëve të lirisë për t’i dhënë fund luftës për çlirimin e Kosovës. Aty jemi kthy nga Glogjani.

Niherë tjetër kemi shku bashkë me Hashim Thaçin, Rexhep Selimin, Lahi Ibrahimaj. Natën kemi shku në Dukagjin. Kemi qenë në fshatin e Lahisë në Jabllanicë kemi kalu aty. Pastaj kemi shku në Broliç,

kemi bujtë te ni shok i studimeve të Zotit Thaçi. Ai ka qenë Xhafer Gashi. Pastaj kemi bo disa imazhe në fshatin Krushevc. Në fshatin e vendlindjes të Ardian Krasniqit. Kemi xhiru pikërisht edhe varrin e Ardian Krasniqit, heroit të Kosovës. Edhe disa imazhe tjera. Djegiet e shtëpive në Baran edhe në fshatin e Adrianit.

Kshtuqë jemi kthyer pastaj bashkë me Hashim Thaçin në Zatriç dhe kemi xhiru aty imazhet në hyrje të Rahovecit dhe ku ka qenë shoqëruar njësitë Lumi në Bjeshkët e Rahovecit. Kemi shkuar pastaj në zonën e Therandës. Atje kemi xhiruar disa pamje nga veprimtaria e Ushtria Çlirimtare e Kosovës në komunën e Therandës, e kështu me radhë. Ndërkohë dua t'them se kontributi i mjekëve në zonat e luftës ka qenë shumë i veçantë, sidomos i Doktor Fadil Bekës i cili ka vepruar që në ditët e para të luftës i ka shëruar shumë luftëtar të lirisë në ambulancën e Nënës Terezë në Likoc pastaj edhe në spitalin ushtarak në Likoc.

Pastaj edhe Fitim Selimi në Shalë të Lipjanit ka qenë ndër mjekët më të angazhuar që ka qenë në shërbim të plotë të UÇK-së po edhe të popullatës civile. Duke kontribuar në shërimin e plagëve të luftës. Osht' e pamundur që kur flitet për Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe luftën e saj të mos përmendet edhe kontributi i femrave shqiptare, të cilat krahas vllazërve të tyre kanë qenë të radhitura në njësitë të ndryshme të Ushtria Çlirimtare e Kosovës në të gjitha nivelet.

Kam takuar gjatë luftës heroinën e Kosovës Xhevë Lladrovcin. Pastaj Xhemile Jashari e familjes Jashari, Valbonë Morinën. Kom takuar edhe Shqipe Mehmetin-Selimi, bashkëshorten e Rexhep Selimit. Bile kom bo edhe në intervistë me të për revistën e atëhershme të rinisë Jeta që ka qenë në kuadër të Zërit javor. Bukurie Zogaj. Janë edhe disa luftëtarë tjera të cilat kanë marrë pjesë në betimin e Ushtria Çlirimtare e Kosovës në Kleçkë. Pastaj, si dihet, në UÇK edhe heroikisht ka rënë edhe Myrvete Maksutaj edhe Yrfete Spahiu dhe shumë e shumë luftëtarë të tjerë. Të cilat janë dalluar për guximin e tyre, për heroizmin e tyre gjatë luftës për liri.

Anita Susuri: Gjatë intervistave që keni realizu, a keni dallu diçka ndryshe prej rrëfimit të tyre prej meshkujve për shembull? Cilat kanë qenë pritshmëritë? Çfarë gatishmërie kanë qenë ato për shembull?

Nuhi Bytyçi: Po, vajzat dhe gratë shqiptare ishin të përgatitura për luftë sepse ato dhe familjet e tyre qysh më herët kishin marrë pjesë në mënyrë aktive në demonstrata edhe në rezistencën e armatosur për liri dhe pavarësi. Kështuqë lufta ishte vetëm finalja e kontributit të tyre. Sepse tërë populli ishte në shërbim të luftëtarëve të lirisë dhe vajzat shqiptare, nënat shqiptare ishin në funksion të plotë. Bile mos t'them disa punë i kanë kryer shumë ma më përkushtim sesa meshkujt.

Ato kanë qëndruar edhe në frontet e luftës dhe me logjistikë edhe me shërbime tjera që kanë pasë nevojë luftëtarët e lirisë. Edhe për ndonjë qepje, veshmbathje edhe shërbime tjera t'cilat, pa t'cilat nuk kanë mujtë me vepru luftëtarët e lirisë. Te to kom pa në vendosshmëri të jashtëzakonshme, në optimizëm t'paparë se lufta mund të zgjasë edhe me vite por fitorja do të jetë patjetër e popullit tonë. Po mora informatën nga Shaban Shala se Ambasadori amerikan Christopher Hill do t'vijë në Likoc dhe

do të takohet me përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Interesimi im ishte që të xhirohet ky takim, të kemi imazhet.

Ka qenë me datën 29 korrik të vitit '98. Duke i ditur ato rrugët e Drenicës kah mund të vijë Hill-i, unë thashë Shabanit, "Po shkojmë", thashë. Ka qenë edhe Komandant Raketa me neve. Se Shabani priste te shtabi. I thashë Shabanit, "A ki ti kundër që t'xhirohet takimi?" Tha, "Jo s'kom kurgjo kundër", tha, "veç nëse nuk pajtohet Hill-i". Thashë, "Ju mos e kundërshtoni se për Hill-in", thashë, "nuk ka problem besoj". Kemi shku bashkë me Komandant Raketën, Xhavit Ferizin ktu te lagja në hyrje te Tërsteniku te mulliri aty. Kemi mendu se vjen nga ajo rrugë dhe nëpër Rezallë dhe Likoc. Po ai kishte shku ni rrugë tjetër, ma kah mali. Nuk kemi mujtë me xhiru bile makinën t'u ardhë.

Kemi shku, takimi kish fillu në Shtabin e Likocit. I thashë Abazit, "Hyn dheze kamerën dhe hyn xhiroje". Meqenëse paraprakisht kisha bisedu me Shaban Shalën që mundësisht të gjendjet mënyra për ta xhiruar. Mirëpo si ka hy Abazi aty, Hill-i ka reagu energjitikisht dhe s'ka leju as ta dhezë kamerën, Abazi s'ka arritë as ta dhezë kamerën dhe ka dalë. Sepse atëherë Hill-i mbante takime msheftas dhe s'donte publikisht t'i publikonte për shkak t'reagimeve të Serbisë e tjera e tjera. Ne ishim t'vetëdijshëm për atë po ne na interesonte si gazetar ta kryjmë punën tonë.

Thashë, "Abaz, meqenëse s'ke arritë me xhiru mrena", thashë, "tash kur t'del Hill-i nga Shtabi i Likocit, bile ni imazh patjetër merre", "Ani", tha. Jemi skeju dikund me ni lis aty që mos t'vrehet Abazi. E ka dhezë kamerën i ka marrë nja tre-katër sekonda po ma tepër s'ka arritë se e ka hetu Hill-i si ka dalë e ka hetu. I ka thanë... Rexhep Selimi ka qenë n'atë takim aty. Thotë, "Nuk bon m'u publiku kto imazhe". I ka thanë Rexhepit, "Merre kamerën", Hill-i i ka thanë, "Merrja kamerën". Rexhepi u detyru tash për shkak të respektit ndaj Ambasadorit Hill dhe mos me dalë jo përfillës ndaj tij.

E mori Rexhepi kamerën, na kishim raporte bashkëpunimi shumë sinqert me Rexhepin edhe i thashë, "Rexhë mos u përzij n'punë tona, s'osht' mirë", tha, "Veç p'e marr derisa t'shkon ky s'ka problem". Shkoj Hill-i na dha kamerën. Veton Surroi ka qenë edhe Mehmet Hajrizi ka qenë me të me Hill-in dhe Blerim Shala. Tha Vetoni tha, "Nuhi, t'u kisha lut mos publiko asni informatë që ka qenë Ambasadori Hill ktu në takim me UÇK-në", "Ani", thashë, "Veton nuk osht' mirë m'u përzi. Na koleg jemi po kjo është ngjarje shumë me randësi dhe unë si gazetar e kom obligim me raportu".

E thirra Asllan Bajramin me telefon satelitor nga telefoni i Murat Musliut aty që ishte në Likoc dhe raportova për këtë ngjarje se ishte ngjarje me randësi. Se ni diplomat amerikan po takohet me përfaqësuesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Ndërkohë po ndëgjoj Veton Surroi ka dhanë vet intervistë ndaj Deutsche Welle po dojke që ta ketë vetëm ai ekskluzivitetin dhe jo unë dhe Televizioni Shqiptar. Mirëpo unë nuk dështoj në raste të tilla sepse gazetari nuk duhet të bij në ndikim e askujt por ta kryj detyrën në mënyrë profesionale, ashtu si duhet.

Kshtuqë kur folet për Rexhep Selimin kom edhe ni kujtim tjetër gjatë kohës t'luftës. Thashë Rexhepi ma herët bonte vrejte se nuk po përmendet Ushtria Çlirimtare e Kosovës po po përmendet që populli po mbron pragun e shtëpisë. Unë shkova, hyra, ishte Skenderaj i rrethuar me forca ushtarake dhe

policore serbe. Por isha kureshtar të hyja në Skenderaj dhe të xhiroja disa imazhe si duket Skenderaj në ato rrethana. Me ndihmën e disa veprimtarëve humanitar të Shoqatës Nënë Tereza, Rifat Bejtës edhe disa veprimtarëve tjerë kemi hy.

Tha, “Nuhi osht’ rrezik”, tha, “me bo me has në patrollë të policisë unë s’mund t’ju mbroj kurgjo as vetën as juve”, thashë, “S’po kërkoj me na mbrojtë ti”, thashë, “na duhet me rreziku me hy me xhiru”. Kemi hy në Skenderaj, kemi xhiru nga makina s’kemi mujtë me dalë jashtë. Nga makina kemi xhiru ato imazhet, objektet e shkatërruara, lokalet e zejtarëve në qendër të Skenderaj afër stacionit të autobusave. Pastaj kem shku në lokalet e Këshillit për të Drejtat e Njeriut në Skenderaj ku ka qenë Ajnishahe Halimi.

Thashë, “Ajnishahe, m’vyn ni telefon me çu ni informatë për Televizionin Shqiptar”, tha, “T’ludem Nuhi mos e përdor telefonin se policia na ka vëzhgu edhe pas ni ndërpreme për ni kohë t’gjatë na kanë lshu. Pas intervenimit të organizatave humanitare ndërkombëtare na kanë lshu telefonin”, tha, “po na rrezikon neve, na ndërpreme prap telefonin”, thashë, “Unë shkurt do ta çoj ni raport”. E dërgova ni raport për Televizionin Shqiptar edhe aty përmenda haptas që Ushtria Çlirimtare e Kosovës në pozicionet e veta në Likoc dhe Llaushë është duke ju bërë rezistencë forcave ushtarake policore serbe.

Kshtuqë kur takohem me Rexhën pas disa dite tha, “A bravo t’qoftë”, tha, “i ke dhanë provimin Nuhi. Tash e ki përkrahjen e plotë edhe timen për të xhiruar dhe për të raportuar nga zonat e luftës”. Kshtuqë jam përpjekur gjithmonë që t’jem në nivel të detyrës dhe të jem në shërbim të informimit objektiv. Kurrë nuk kom raportu për ni ngjarje që s’e kom pa vet ose m’ka thanë dikush. Kur e kom vlerësu që osht’ me rëndësi kom raportu po nuk kom raportu për ditë se s’ka pasë nevojë, s’ka pasë zhvillime shumë t’randësishme n’atë kohë.

Anita Susuri: Deshtët edhe me na tregu për ni masakër, vrasja e ni t’riu 14 vjeçar në Poklek të...

Nuhi Bytyçi: Po. M’kujtohet si sot ka qenë fundi i majit ‘98. Ishim me Muharrem Xhemajlin edhe disa luftëtar të tjerë aty afër Drenasit. E pam ni flakë, ishte mbarmje, e pam ni flakë në Poklek të Ri edhe tym. U bona kureshtar çka ka ndodhë. Dikush tha që forcat serbe kanë granatu edhe kanë djegë shtëpitë. Shkum. Atë natë ishte e pamundur natën me xhiru dhe kemi bujtë aty në fshatin Kraikovë te familja Elshani. Kshtuqë të nesërmen ka ardhë ni djalë i ri, luftëtarë i UÇK-së, Tahir Tahiri. Ishte, thënte që është nip i Fazli Grajçevcit.

Tha, “Mora vesh që jeni ktu”, tha, “zoti gazetar”, tha, “a s’priton me ardhë në Poklek të Ri se janë disa vrasje dhe i kanë djeg shtëpiat. Popullata civile u largu nga fshati”, thashë, “Po patjetër, e kom pa flakën mram po s’disha çka ka ndodhë”. Kemi shku. Niherë kemi mendu me shku arave n’kambë. Ishin arat me grur. Mirëpo thashë na vrejne arave ishte rrugë e gjatë, bukur e gjatë arave me shku. Unë mora vendim që t’shkoj me makinë. Jemi shku i bjen kah Drenasi. Ishte bukur rrezik me çarkullu asajde se nuk kishte lëvizje fare të qytetarëve, vetëm policia serbe që çarkullonte.

Kur kemi kalu hekurudhën e Drenasit aty bashkë kemi qenë me Zarije Podrimçaku, Shaban Nezirin edhe Tahir Tahirin. Ka qenë ni kerr i policisë serbe t'u ardhë nga ana e Komoranit për me hy në Drenas. Thashë me siguri kanë me na nalë tash ku po shkoni, kush jeni ju. Jemi frikësu shumë sidomos për kamerën. Por për fat nuk na kanë nalë. Kemi vrapu, kemi vozitë deri në Poklek aty afër, s'ishte larg Gjimnazit Skënderbeu të Drenasit. Kemi, makinën e kemi lanë mrapa ni pompës së benzinës aty që ishte jo aktive, jo funksionale n'atë kohë që t'mos vrehet makina.

Kemi fillu me xhiru ato imazhet në Pokelk të Ri. Ishin imazhe shumë t'rënda. Aty pam ni djalë të ri gjakun që kishte rrjedhë aty para shtëpisë. Pastaj në shtëpi brenda kish hy, kish gjakderdhje t'madhe. Ka qenë Blerim Shishani [Ardian Deliu], m'kujtohet si sot. Kom pytë emrin për me mujtë me ditë kush osht' rreth 14 vjeçar. Ishte ni pamje shumë e rëndë. Djalë i ri. Ishte vrarë aty. S'kish pasë kush, sigurisht ka vdekë se s'ka pasë kush m'i dhanë ndihmën e parë, nga gjakderdhje e madhe.

Pastaj kemi xhiru gjurmë gjaku aty jashtë te shpitë tjera. Ishin ndezur u dilke flaka ende, tymi. Ishin pamje me t'vërtetë që ishte fillimi i luftës për neve n'atë kohë. Nuk kishim pa asniherë pamje të tilla tronditëse. Aty pastaj kemi taku edhe disa civil që kishin ardhë m'i pa shtëpitë e tyre. Kemi bo disa intervista me Ahmet Morinën, Shefqet Bytyçin e disa të tjerë. Tregum për gjendjen qysh ka qenë dhe disa ishin edhe të vrarë po nuk dihet saktë numri i tyre. Sigurisht kishin marrë kufomat, kishin çu në morg. Ishin momente shumë t'vështira për ne.

Pastaj kemi përgatit ni emision, masakra e padurueshme, qashtu ni titull e kemi pagëzu se janë përfshi edhe disa masakra tjera që kanë ndodhë edhe në Obri edhe në vendet e tjera të Kosovës, sidomos të Drenicës dhe të Llapushës. Kemi bo përpjekje që të pasqyrojmë gjithë dhunën dhe terrorin shqiptar serb mbi shqiptarët në atë periudhë.

Anita Susuri: Qysh jeni ndje ju kur jeni ballafaqu me kto? Se ju na thatë që masi e keni përcjellë luftën në Kroaci nuk e keni pasë ma atë frikën, po kur jeni ballafaqu me vrasjet, me masakrat qysh ka qenë për juve? Qysh jeni ndje?

Nuhi Bytyçi: Shumë, shumë situatë e vështirë ishte me t'vërtetë. Ne u duhke me kry detyrën, m'i marrë gjithë ato imazhe. Në anën tjetër nuk mund t'i publikonim. Ne imazhin e atij djalit t'ri nuk kom mujtë me publiku se ajo mund të shkaktoj frikë te popullata civile edhe në përgjithësi te njerëzit. Kshtuqë kemi kursy opinionin me disa pamje që kanë qenë shumë tronditëse. Kemi dhanë ma shumë shkatërime, djegie edhe pamje kshtu të përgjithshme. Shumë vështirë ka qenë, me t'vërtetë.

Tash tjetër është të shish në Kroaci, tjetër n'vëndin tond. Sepse aty ishin rrethana krejt tjera për arsye se Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk kishte armatim për t'i përballuar gjitha sulmeve të ushtrisë dhe policisë serbe. Ajo nuk kursente asgjë edhe fmitë edhe t'ritë edhe pleqt edhe t'gjithë që sipas tyre ishin pengesë. Nuk i kursenin. Por, ne kishim detyrë që s'paku për historinë, për gjeneratat e ardhshme t'i kemi ato imazhe dhe për fat i kemi rujtë t'gjitha ato imazhe t'cilat mund të shërbejnë për historianët, për ekspertët e lëmive të ndryshme për të bërë hulumtime shkencore edhe n'këtë drejtim.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë tek pas ofanzivës së verës nga biseda që keni pasë me Hashim Thaçin edhe betimin e UÇK-së...

Nuhi Bytyçi: Po, m'kujtohet si sot kur propaganda e Serbisë ishte se UÇK-ja osht' shpërbë, nuk ka UÇK kanë mbetë do grupe t'vogla. Ne për me dëshmu se ka UÇK dhe është duke konsoliduar gjithnji e më shumë radhët e veta përgatitëm ni dokumentar me titull, 'Këtu janë'. Këtë dokumentar kemi përfshirë betimin e ushtarëve të Brigadës 114 Fehmi Lladrovci në Shkabë, në vendlindjen e Komandant Fehmi Lladrovci. Pas rënies së tij, ai ka rënë heroikisht me Xhevën dhe bashkëluftëtarët e tyre me 22 shtator të vitit '98.

Kshtuqë ky moment ishte me rëndësi se luftëtarët e kësaj brigade, t'ritë e Drenicës iu kishin bashkangjitë ksaj brigade të UÇK-së dhe ishte ni moment i mirë për ne për t'xhiruar betimin në Shkabë dhe kemi xhiruar betimin me 08 nëntor të vitit '98. Ka qenë ni betim me t'vërtetë dinjitoz. Aty ka qenë edhe Komandant Ilaz Kodra, ka mbajtë ni fjalim. Se ai u zgjodh komandant i brigadës në vend të Fehmi Lladrovci, e vazhdoj rrugën e tij. Shaban Shala, Sylejman Selimi, Sami Lushtaku, Gani Koci dhe luftëtarët e tjerë.

Kshtuqë i përfshim ato imazhe në atë dokumentar. Pastaj kemi bo edhe intervistë me përfaqësuesin e përgjithshëm politik të UÇK-së, Zoti Adem Demaçin në Prishtinë, në zyrën e tij në Prishtinë. Ku ka vepruar edhe sekretari i kësaj zyre Zoti Albin Kurti. Kurtin e kemi takuar edhe disa herë në Dragobil në takimet me diplomatët amerikan dhe evropian si përfaqësues i zyres, si përfaqësues i UÇK-së në Prishtinë. Ka qenë i angazhuar shumë në kto takime. Ka marrë pjesë në takimin me diplomatin amerikan, Rosin, me Christopher Hill-in, me Petriçin edhe diplomat të tjerë.

Kshtuqë në këtë dokumentar kemi përfshi intervistën me Bacën Adem. Baca Adem kishte ni paraqitje në të vërtetë si i ka hije ni simboli të rezistencës sonë kombëtare. Jepte shpresë të madhe se UÇK-ja do ta fitoj luftën. Pastaj kemi realizuar paraqitjen e parë publike të udhëheqësit politik të UÇK-së, Zotit Hashim Thaçi në Fshatin e Ri. Kemi xhiruar intervistën me të. Kjo ka qenë paraqitja e parë publike e tij, të cilën e kemi përfshi në këtë dokumentar.

Ku Zoti Thaçi flet për luftën e UÇK-së, betejën e saj, sidomos në planin diplomatik, takimet me diplomatët amerikan dhe evropian. Me optimizmin e tij për përkrahjen gjithnjë më të madhe nga faktorët ndërkombëtarë dhe përkrahjen gjithnji më të madhe nga populli i Kosovës nga të gjitha anët edhe nga diaspora. Kshtuqë ky dokumentar u realizua me sukses dhe Serbia u bind se UÇK-ja ekziston, UÇK-ja po konsolidohet gjithnji e më shumë dhe asaj po i bashkangjiten gjithnji më shumë të ri dhe të reja nga të gjitha viset etnike shqiptare.

Anita Susuri: Gjatë qëndrimit...

Nuhi Bytyçi: M'fal, harrova me përmend. Në këtë dokumentar kemi përfshi edhe imazhet nga ushtrimet e shumë profesionale të realizuara nga luftëtarët e zonës operative të Llapit, udhëhequr nga Komandant Leka. Ato në Bjeshkët e Kaçanollit i kemi xhiruar kto imazhe të cilat me të vërtetë kanë

qenë profesionale sepse n'atë kohë edhe zona operative e Llapit i zgjeroj radhët e veta dhe mori pjesë në shumë beteja frontale me forcat serbe. Duke dëshmuar se nuk osht' e përfshirë në luftë vetëm Dukagjinin dhe Drenicën po edhe Llapi edhe Shala edhe zona operative e Karadakut dhe t'gjitha zonat, Neredimës dhe t'gjitha zonat e tjera.

Anita Susuri: Gjatë qëndrimit t'juj nëpër kto zonat e luftës, ndoshta ju ka zanë nata apo ka qenë rrezik m'u kthy. Qysh ka qenë raporti me njerëzit, për shembull, popullatën aty. A keni qëndru te ata? A ju kanë bërë strehë?

Nuhi Bytyçi: Ne me Abazin shkonim në Drenicë edhe zonat tjera mirëpo ishte problem me qarkullu për çdo ditë. Se ishte rreziku mos po bijmë në kontrollë të forcave policore serbe. Në këtë mënyrë mund të zbuloheshim dhe puna jonë të marrë fund. Rreziku ekzistonte mirëpo ne kishim ni gatishmëri, vendosshmëri t'madhe të punojmë vazhdimisht. Shkum në Likoc të takohem me Kadri Kryeziun dhe Ramadan Gashin të cilët kanë qenë të burgosur politik edhe kishin ardhë m'i vizitu shokët e tyre në zonën e Drenicës.

I them unë Ramadanit dhe Kadriut i them... ishte ofru nata, s'kishim as makinë m'u kthy në Prishtinë po edhe me pasë makinën ish rrezik mos po, kasetat tona dhe kamera mos po bjen në sy të policisë mos po zbulohen. I thom, "Me pasë mundësi diku që ka naj odë ktu, naj vend që kishim mujt", Ramadani tha, "Po hajde shkojmë te ni shok i imi i burgut. Ata kanë odën edhe kanë vend, s'kanë problem. Janë familje e mirë". Kemi shku në Rizallë të Skenderajt në familjen e Bedri Deliu, babës së Bedriut, Nezirit, Nezir Shaban Deliu.

Kemi hasë në ni mikpritje përzemërt nga kjo familje, nga të gjithë anëtarët e familjes. Ishte aty edhe Bedriu, shok i burgut i Ramadanit dhe Kadriut. Se ka qenë pjesëmarrës i demonstratave të vitit '81 dhe është dënuar si ndër organizatorët e ktyre demonstratave. Kshtuqë aty baba i Bedriut tha, "Nuhi", tha, "ti me Abazin e keni ktu si shpinë e ju. Sa t'keni nevojë, sa t'jeni në Drenicë s'keni nevojë me shku kërkund, vend kemi në odë".

Kur kemi shku natën na shpesh, se luftë ka qenë, kemi xhiru në zona të ndryshme kemi shku aty në ora 10:00-11:00 të natës, kemi gjetë bukën e gatshme të shtrume me ni tepsi. Kemi gjetë venin e shtruar gati jorganin, jastakun krejt për me pushu pak, me bo pak pushim e për me vazhdu punën të nesërmen. Kshtuqë aty kemi nejtë ma së shumti prej t'gjitha zonave që kemi vizitu, aty kemi nejtë me dy javë e tri javë, kemi bujtë. Na kanë pritë si me qenë pjesë e asaj familje.

Kshtuqë shfrytëzoj rastin që të falënderoj familjen Deliu edhe shumë familje tjera. Për shembull, familjen Shala në Kleçkë, [familjen Zogaj në Fshat të Ri] familjen Gashi në Luzhnicë, familjen Gashi në Drenoc të Zastriqit. Pastaj familjen Selmanaj në Gllogjan, Lekaj në Lumbardh. Familjen Ali Toxhës, Halim Krasniqit në Negoc të Drenasit dhe shumë e shumë familje t'cilat është e pamundur m'i përmend. [Jemi strehuar edhe në familjen e Berat Hoxhës në Shalë të Lypjanit] Edhe në zonën e Llapit në Llapashtic kur kemi qëndru edhe në Kçiq të Madh te Vebiu, Xhabir Berisha e të tjerë e të tjerë. Të

cilët na kanë strehuar dhe na kanë ndihmuar shumë që të pushojmë që të punojmë pastaj në kryerjen e obligimeve tona si gazetar.

Anita Susuri: Cilat janë ngjarjet tjera për shembull, në dhjetor në fundin e vitit '98? Edhe qysh u bo që e keni festu vitin e ri me ushtarët?

Nuhi Bytyçi: Po. Para vitit të ri kam shku në zonën e Llapit, 27 dhe 28 dhjetor '98. Sepse morëm informacione se zonën e Llapit forcat serbe kanë përgatitë në ofenzivë të ashpër ndaj forcave të UÇK-së. Kshtuqë na interesonte që të kemi disa imazhe nga gjendja në Llap. Me makinën time, se nuk e praktikoj që t'shkoja me makinën time se mund të zbulohesha ma lehtë nga policia. Po atë ditë kur mendoja me shku nuk kish ndonjë shok që më dërgonte në Llap. E marr makinën time edhe shkoj në Konushevc. Pastaj kemi shku kemi xhiru në Llapashticë.

Aty kemi bo edhe në intervistë me Komandant Remi. Komandant Remi nuk donte të jepte intervistë. Thashë, "Pse?" "Unë i vogël, kur t'më shohin shumë i vogël ma mirë mos me m'pa se me m'pa ashtu t'vogël" (qeshë), "Po", thashë, "kjo mbetet histori nuk p'e qesim, mas luftës e qesim". Ashtu kemi vepru. I kemi dhanë vetëm në insert kronikë po jo me pamje. Mas luftës i kom përfshi me në dokumentar special kushtuar luftës së UÇK-së edhe në zonën operative të Llapit.

Pastaj kemi marrë në intervistë me oficerin e karrierës Kadri Kastratin, me Muhamet Latifin që ka qenë komandant i shtabit të civilëve. Pastaj me Sabit Nezirin, ka qenë komandant i njësitit special të UÇK-së në Llap. Do pamje me Latif Gashin edhe pamje tjera në këtë zonë. Kshtuqë kemi arritë që edhe nga zona e Llapit të kemi imazhe në emisionet e tona. Kjo të pasqyrohet, t'ketë në pasqyrim gjithë përfshirës për mbarë Kosovën.

Kurse sa i përket vitit të ri, ishte data 30 dhjetor. Thashë, çka me ba isha në Prishtinë. Thashë në Prishtinë e kom prit mjaft vitin e ri thashë po provoj me prit në vit të ri në mesin e luftëtarëve të UÇK-së. I thashë Abazit, thashë, "Abaz unë do t'shkoj me prit vitin e ri në mesin e luftëtarëve të UÇK-së, a don me ardhë ti a s'don me ardhë?" I kishte fmitë e vegjël, thashë kanë qef me pasë babën e vet aty edhe thashë, "Konsultohu me bashkëshorten edhe me fmitë. Nëse munësh me ardhë mirë nëse jo unë do t'shkoj", thashë. Unë kisha vendos me shku.

Pa kamerë, pa kamerë me shku me ta me marrë pjesë. Ndërkohë Arianiti mori vesh që unë do t'shkoj në mesin e luftëtarëve të UÇK-së me prit vitin e ri. Tha, "Babi", tha, "edhe unë du me ardhë me ty". Unë vet s'e disha as kah me shku, ishte situatë lufte, ishte shumë rrezik me udhëtu ato ditë. Thashë, "Arianit, t'lutëm naj herë tjetër", thashë. Se m'thonte shpesh, "A ki me më marrë naj ditë?" Unë tash për mos me ia humb vullnetin i thojsha, "T'marr naj ditë", "Po kom qef m'i pa luftëtarët e UÇK-së".

Anita Susuri: Sa vjeçar ka qenë?

Nuhi Bytyçi: Po ai ka qenë në gjimnaz atëherë, ka qenë në vit të katërt. Maturant ka qenë. Tha, "Kom qef m'i pa luftëtarët e UÇK-së". I kisha premtu që do t'marrë naj herë kur kisha mundësi. Po s'isha i

sigurt që mund t'ishkojmë pa u hetu nga policia. Ai ishte me trup mjaft i gjatë. Për veti s'kisha dert po për to thojsha mos po rrezikohet ai. Munova me bind po nuk, kot ishte e kot. Tha, "Unë", tha, "ka me shku edhe nëse s'më merr ka me gjetë rrugë me pytë edhe ka me shku". Atëherë u frikësua ma shumë thashë ma rrezik se s'e din as kah me shku. S'e disha edhe unë se s'kishte siguri kërka me çarkullu.

Abazi tha, "Po vij. Fola", tha, "me djemtë edhe me bashkëshorten", tha, "m'dhanë pëlqimin", edhe Abazi tha, "Po vij". E morëm makinën, e lam në stacion të autobusave në Prishtinë edhe thashë kur kthehem e marrim. S'dishim ku me hyp në autobus a me shku në drejtim të Suharekës, atje me zbrit dikund te Suhareka e tani me shku dikund në Kleçkë a në Fshat të Ri a në Lladrovc në zonën e Brigadës 121.

Po hypëm me ni autobus për Lipjan. Tani prej Lipjanit hypëm në autobus në Magurë. Nëpër Magurë edhe kemi shku në Shalë, në Shalë të Lipjanit. Fati aty kur jemi shku afër rrugës që shkon, afër Burgut të Lipjanit, policia serbe kishte qenë edhe hyn në autobus. Po ish autobusi plot se ish nata e vitit të ri 31 dhjetori edhe plot njerëz në kamë ishim ne. Kontrollonin dy-tre vet në fillim aty ne ishim pak më mrapa. Fati që nuk na kontrollun edhe nuk hetun që jemi ne aty.

Kemi vazhdu rrugën kemi shku në Shalë të Lipjanit. Aty jemi taku, në stacionin shëndetësor të cilin e udhëheqte Doktor Fitim Selimi, jemi taku aty me Sali Veselin ni epror officer i karrierës, epror i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Saliun e kisha takuar në vitin '91 në Zvicërr. Nga ajo periudhë mbaj mend kujtimet e tij kur thojke, "Duhet Nuhi me organizu luftën". Atëherë prej '91-tes ai kishte menduar bashkë me shokët e vet me organizu luftën për çlirimin e Kosovës.

M'erdh mirë që e takoj Saliun aty. Arianiti shkoj me Abazin me ni xhip tjetër, unë mbeta me Shaban Dragën me shku ma vonë se nuk kishte vend në atë xhipin për t'gjithë. Kemi shkuar. Ishte borë, ishte rruga e vështirë, akull. Po kemi mbërri në Fshatin e Ri. Tani prej Fshatit të Ri kemi shkuar në Lladrovc, aty ishte Rexhep Selimi edhe Fatmir Limaj. Kemi bo ni plan. Kur na kanë pa ju ka ardhë mirë. Tha, "Keni lanë Prishtinën me ardhë me na vizitu neve ktu në zona të rrezikshme".

Kshtuqë na mirëpritën, na mirëpritën në mesin e Shtabit të Brigadës 121 dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. E bom ni plan, tham, "Meqenëse kemi ardhë kemi dëshirë me xhiru". UÇK-ja në detyrë në pozicione gjatë natës së vitit të ri, "Kemi dëshirë ni takim me luftëtarët", në ato odat që kishte lshuar populli për ta. "Dhe kemi dëshirë disa familjar të dëshmorëve nëse vizitoni ju me ardhë me xhiru na". Ashtu e bom planin. Veç kur kemi xhiru në Tërpezë në bataljonin e UÇK-së në Tërpezë. Nga aty pastaj në Banjë kemi xhiru, Çerkin Dugolli e ka dhanë ni raport.

Pastaj kemi shku në Lladrovc kemi vizitu familjen e dëshmorëve Habib Zogaj, Ali Zogaj. Pastaj të Afrim Buqajt, dëshmor të kombit. Ni luftëtar që ishte plagosur atëherë... edhe ni Buqaj e kanë vizitu, ne i kemi xhiru ato imazhe. Ndërkohë Avni Buqaj ka ra dëshmor pas ni kohe. Pastaj kemi vizitu edhe familjen e dëshmorit Nuhi Mazreku në Guriq të Malishevës. Axhës Zejnullah, ni burrë me t'gjitha tiparet e ni plakut t'meqëm, atdhetar.

Kur Rexhep Selimi edhe Fatmir Limaj e ngushëlluan për rënien e djalit të tyre ai tha, “Unë”, tha, “jom krenar që kom pasë Nuhin djalë edhe për Kosovën duhet me dhanë ma shumë”. Ishte ni përjetim i veçantë për neve. Sepse babai kishte dhimbje për djalin e vet por ishte krenar për sakrificën e tij, për lirinë e Kosovës. Ishin ato momente që s’kishim përjetuar asniherë. Abazi ka xhiruar krejt atmosferën që ka qenë aty, vllazërit e Nuhiut, babën e Nuhiut, bashkëluftëtarët e Nuhiut. Ka qenë me neve edhe Haxhi Shala dhe Çerkin Dugolli dhe Nexhmi Krasniqi. Gjithmonë na ka përkrahë Komandant Nexhi.

Kshtuqë kemi ba ato imazhe t’cilat kanë mbetë, kanë mbetë n’kujtesën e popullit. Përgatitëm ni emision, viti i ri në linjën e parë. Pastaj shkum edhe i bom kto pamjet në pozicione të UÇK-së në fshatin Javur në borë. UÇK-ja ishte në nivel të detyrës duke vëzhguar ndonjë lëvizje të forcave serbe t’cilat mund të befasonin edhe në ato rrethana të natës së vitit të ri. Kshtuqë kemi xhiru edhe ni takim të luftëtarëve të bataljonit Sadik Shala në Javur.

Kemi përgatitur ni emision të veçantë i cili ka pasë ni jehonë, ni jehonë të jashtëzakonshme në opinion dhe shumë shikues... e mbaj mend ato momente shumë të rralla kur UÇK-ja osht’ në pozicione edhe në natën e vitit të ri, edhe në borë vetëm për të mbrojtur popullatën civile. Aty Komandant Fatmir Limajt ia jep raportin Ajet Kastrati, oficeri i njohur i asaj zone. Fatmiri në fjalimin e tij para ushtarëve thotë, “Kemi arritë sivjet vitin ‘98 shumë suksese në beteja me forcat serbe. Kanë ra shumë dëshmor por shpresojmë se vitin e ardhshëm vitin e ri ‘99 do t’shlirohet Kosova dhe do ta festojmë në liri”, dhe ashtu ndodhi.

Parashikimi i tij se viti ‘99 do t’jetë vit i fitorës të popullit të Kosovës. Si dihet në qershor të vitit ‘99 forcat ushtarake dhe policore serbe u detyruan të pranojnë kapitullimin nga forcat e NATO-s dhe nga UÇK-ja. Kshtuqë edhe Kosova përfundimisht është shliuar nga Serbia.

Pjesa e Dhjetë

Anita Susuri: Desha me ju pytë tash për pjesën e vitit ‘99, për, në Reçak që ka ndodhë masakra, keni qenë atje.

Nuhi Bytyçi: Po. Isha në Radion Kosova e Lirë jam shku me bo ni xhirim për Radion Kosova e Lirë, dokumentar. Kishte filluar punën Radio Kosova e Lirë. I propozoj drejtuesve të UÇK-së që të përgatisja ni dokumentar. Ata frikësoheshin që nëse përgatiti edhe zbulohet vendi ku funksionon Radio Kosova e Lirë do t’i bëja më dëm edhe UÇK-së edhe Radios Kosova e Lirë edhe Agjencisë Kosova Press. Mirëpo thashë e përgatis në atë mënyrë që s’mundet me kuptu kërkush, jo Serbia po as shqiptarët s’munden me kuptu ku gjindet Kosova e Lirë.

Shkum aty për me fillu xhirimet ku morëm informata që ka ndodhë masakra në Reçak, me 15 janar të vitit ‘99. Ishte e pabesueshme drejtën me të thanë. Sepse n’atë kohë fillun përgatitjet për Konferencën ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje dhe Serbia kishte marrë premtime nga faktorët ndërkombëtarë se do të ndërprej ofenziva ndaj popullatës civile shqiptare. Kjo ishte ni masakër në të vërtetë e cila ka tronditë njerëzimin. Kemi xhiru aty për Kosova e Lirë dhe Agjencinë Kosova Press.

Niherë kom mendu si me shku me hy në Reçak edhe me xhiru, mirëpo është e pamundur. Sipas informatave që ishin, policia serbe kishte marrë kufomat nga xhamia që ishin vendosë në xhaminë e fshatit pastaj kishte marrë i kishte çu në Morgun e Prishtinës. Unë tentova, shkova me autobus nga Theranda dhe u nala aty afër Pishave të Shtimës për me mujt me shku n'kamë pastaj në Reçak. Takova kameramanin Sylejman Kllokoqi duke xhiruar aty.

Takoj kolegun Shaban Buza, i cili ishte me Agjencinë e huj të lajmeve Reuters, si përkthyes. I them, “A mund t’shkojmë bashkë atje në Reçak”, tha, “Është e pamundur me hy në Reçak, policia i ka marrë kufomat” edhe ishin, ai ishte me ni ekip të huj do të thotë me ni xhip. E luta thashë, “A ka mundësi atëherë mu me më marrë me veti me shku në Prishtinë”, se ishte i rrezikun tash me çarkullu, kishte patrollime të veçanta nga policia serbe. E pyti atë udhëheqsin e ekipit dhe më morën. Jemi kthy në Prishtinë.

Masanej kur ka ndodhë vorrimi i masakrës së Reçakut kom shku me Abazin dhe kolegët e tjerë kemi xhiruar vorrimin. Ka qenë ni masë e madhe e njerëzve. S’i dihet Ambasadori William Walker aty majti ni fjalim edhe e përsëriti vlerësimin e tij se kjo është masakër kundër njerëzimit edhe Serbia për këtë duhet të ndëshkohet. Kshtu ndodhi. Kjo ngjarje boni ni kthesë të madhe te faktorët ndërkombëtarë të cilët më në fund u vetëdijësuan edhe më shumë se Serbia me takime diplomatike, me premtime t’kota të Millosheviçit nuk mund të ndalet dhe duhet të gjindet mënyra tjetër se si me ndëshku ushtarakisht Serbinë.

Kshtuqë n’atë kohë është diskutuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga Anglia, nga Gjermania edhe nga Franca dhe nga vendet e tjera që janë aleate të NATO-s, të Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe pastaj meqenëse Millosheviçi nuk e pranoi marrëveshjen e paqes, eminoj paqen në Kosovë. Faktori ndërkombëtarë me 24 mars të vitit ‘99 filloj bombardimet ajrore të NATO-s mbi caqet ushtarake policore serbe në Kosovë dhe në Serbi.

Kjo ishte kthesa ma e madhe e ni force të fuqishme ushtarake ndërkombëtare. Serbia n’këtë mënyrë u ndëshkua për t’gjithë ato veprime që kishte bërë edhe në Bosnje edhe në Slloveni edhe në Kroaci. Për t’gjithë ato masakra që kishte bërë ndaj popullatës civile në Kosovë, u ndëshkua. Kshtu 50 vjetori i NATO-s u shënuar me këtë intervenim historik të forcës veri-atlantike të NATO-s mbi Serbinë.

Anita Susuri: Para se me vazhdu anej, deshta me ju pytë për Rambuje. Ju keni përcjellë edhe ata a po?

Nuhi Bytyçi: Jo, unë në Rambuje s’kam qenë se atëherë gazetarët s’kanë leju mrena me hy. Po unë e kom përcjellë, kemi xhiru në Likoc me 23 shkurt vitit ‘99 UÇK-ja qysh e ka prit ditën e fundit të kësaj konference. Aty kemi xhiru në Shtabin e Likocit kemi xhiru pamjet, eprorët e UÇK-së të kësaj zone të Drenice duke përcjellë zhvillimet në Konferencën në Rambuje. Kemi bo disa intervista me Shaban Shalën, me disa epror të UÇK-së aty. Kemi prezentu do të thotë interesimin e luftëtarëve të UÇK-së për këtë konferencë ndërkombëtare për Kosovën.

Si dihet në këtë konferencë nuk u arrit të nënshkruhet marrëveshja paqësore për Kosovën, marrëveshja kalimtare për Kosovën. Sepse edhe faktori ushtarak dhe politik i UÇK-së kishte rezervat e veta, sidomos për tekstin final të marrëveshjes. Nuk ishte parapa as pavarësia, as ekzistimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës por delibetarizimi i saj. Kshtuqë kishin disa rezerva, kjo kishte nevojë për konsultime.

Mbaj mend kur u kthy shtabi, përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Kosovë kom realizu ni intervistë me Jakup Krasniqin, anëtarë i delegacionit të Kosovës në Rambuje edhe me udhëheqësin e këtij delegacioni të Kosovës në këtë konferencë Zotin Hashim Thaçin. Për konsultimet që janë bërë në Kosovë dhe a ka gatishmëri tani UÇK-ja dhe Kosova ta nënshkruaj marrëveshjen paqësore në konferencën që ishte caktuar.

Kshtuqë realizova ni intervistë me Jakup Krasniqin, anëtarë i delegacionit të Kosovës dhe me udhëheqësin e delegacionit të Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje të Franës, me Zotin Hashim Thaçin. Ata thanë se tash janë ba t'gjitha konsultimet me Shtabin e Përgjithshëm dhe popullin e Kosovës dhe ne jemi t'gatshëm si delegacion i Kosovës ta nënshkrujmë marrëveshjen në vazhdimin e konferencës që ishte caktuar me 13 mars të vitit '99.

Intervistën e kam realizuar me 12 mars me Zotin Thaçi kurse me Zoti Krasniqin disa ditë ma herët. Në kuadër të përgatitjes për këtë konferencë është mbajtur ni takim edhe në Tërstenik të Drenasit. U mbajt pikërisht me 05 mars të vitit '99. Ku osht' biseduar mes përfaqësuesve të diplomacisë europiane dhe gjermane, ku ka qenë edhe Ambasadori Petriç edhe një ushtarak nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë.

Me takimin që është mbajtur me 05 mars të vitit 1999 në Tërstenik të Drenasit mes të përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm ku ka marrë pjesë Sylejman Selimi, komandant i përgjithshëm. Pastaj Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Fatmir Limaj dhe Rexhep Selimi. Si dhe përfaqësuesit e diplomacisë europiane dhe gjermane ka qenë aty Ambasadori Petriç dhe një ambasador diplomat gjerman. Të cilët kanë qenë të autorizuar të bisedojnë me përfaqësues të Shabit të Përgjithshëm lidhur me tekstin final të marrëveshjes për Kosovën, më saktësisht për fatin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në tekstin e marrëveshjes ishte propozuar që Ushtria Çlirimtare e Kosovës të shpërbëhet, të delimitarizohej dhe për sigurinë në Kosovë kompetent është vetëm NATO, KFOR-i. Ky propozim hasi në kundërshtim të fuqishëm nga përfaqësuesit e Shabit të Përgjithshëm, e në veçanti nga Rexhep Selimi dhe Fatmir Limaj. Të cilët thanë se, "Kosova duhet ta ketë ushtrinë e vet, pavarësisht NATO-s, miqve tanë, aleatëve tanë. Kemi besim t'madh në NATO-në, KFOR-in por Kosova populli i Kosovës duhet ta ketë ushtrinë e vet", ky ishte konstatimi i Rexhep Selimit, Fatmir Limajt por edhe anëtarëve tjerë të Shtabit të Përgjithshëm që morën pjesë në këtë takim të rëndësishëm.

Aty kam qenë gjatë tërë takimit, kemi xhiruar, i kemi edhe xhirimet. Aty isha në insistimin e vazhdueshëm të përfaqësuesve të Shtabit të Përgjithshëm që të gjindet ni marrëveshje kompromisi që megjithë propozimin që t'shpërbëhet UÇK-ja nuk ishte e lehtë për ta që ta pranojnë që nuk do t'ketë

UÇK. Ishin kundër krahasimit të ushtrisë dhe policisë serbe me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Pastaj, kom përcjellë n'atë kohë ni vjetorin e, ni vjetorin e bejetës së Likoshanit, me 28 shkurt të vitit '99 në Likoshan. Aty në Likoshan në Çirez.

Pastaj edhe ni vjetorin e Epopesë së UÇK-së me 05, 06 dhe 07 mars. Ku me 06 mars është mbajtur manifestimi në Lagjen Lushtakët. Do të thotë ishte pak ma larg se te shtëpitë e Jasharëve. Me ni ledinë aty ishin tubuar edhe populli edhe komandantët, t'gjithë komandantët e zonave. Edhe nga Llapi kishte ardhë edhe Remi nga Llapi edhe Rrahman Rama nga Shala. Kuptohet, Zoti Jakup Krasniqi nga Shtabi i Përgjithshëm, Sylejman Selimi, Sami Lushtaku, Gani Koci, Shaban Shala.

Ishte ni manifestim me t'vërtetë që shënonte ngjarjen e parë, përvjetorin e parë të Epopesë së UÇK-së, rënien heroike të Komandantit Legjendar Adem Jasharit, Hamëz Jasharit, Shaban Jasharit dhe të familjes Jasharit dhe të dajës së Jasharëve, dajës Osman Geci dhe të luftëtarëve të tjerë, dëshmorëve të tjerë të lirisë. M'kujtohet si sot aty ku Ilir Shaqiri, Violet Kukaj Ratkoceri e kanë kënduar këngë për UÇK-në, për Adem Jasharin. Është shfaq edhe ni recital edhe ni pjesë dramatike, 'Ai është gjallë', të realizuar nga regjisorët Latif Zariqi dhe Dibran Fylli. Ishte ni realizim me të vërtetë artistik për rrethanat e luftës.

Në skenë doli Ramadan Kaçkini i cili luajti rolin e Komandantit Legjendar Adem Jasharit dhe aty kishte emocione për paraqitjen dinjitoze të aktorëve të Drenicës. Duke i dhënë ni kurajo popullit se UÇK-ja është e fuqishme dhe ne jemi t'gatshëm ta vazhdojmë luftën, sakrificën e Komandantit Legjendar Adem Jasharit deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës. Kto xhirime i montova në dy emisione speciale i bëra. Në Prishtinë i montova te Fatos Kadiu dhe Luan Sefedini. I kom dërgu në Televizionin Shqiptar. Kshtuqë kom arritë që ngjarjet e para në rrethana të luftës, përvjetorët e parë që janë shënu në ato rrethana të luftës e kishin ni mesazh shumë të qartë, t'i plasoj në Televizionin Shqiptar dhe opinionin të informohet për to.

Dua të përkujtoj ni moment shumë interesant kur delegacioni i Kosovës nga Shala e Lipjanit përgatiti për të shkuar në Aeroportin e Prishtinës dhe për të ateruar për Paris, për vazhdimin e Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Paris. Ishte 12 marsi '99 edhe bisedoj me përfaqësuesit e UÇK-së në këtë delegacion dhe them, "Si mund t'vij edhe unë deri në Aeroportin e Prishtinës të xhiroj nisjen e ju?"

U morëm vesh aty me ambasadorin francez në Shkup, i cili ishte në organizim të kësaj konference. Ai tha, "Mundeni me ardhë me ni makinë të disa përfaqësuesve të Ambasadës Franqeze që do t'shkojnë deri në aeroport, hypni në makinë me ta", "Ani", thashë, "mirë shumë". Kemi hypë unë Abazi në makinë me diplomatët francez. Kur kemi mrrë te udhëkryqi në Sllatinë tha, "Zbritni qitu", te udhëkryqi në Sllatinë. Thashë, "Ku me shku na tash? N'kamë me ecë a?" Tha, "S'guxojmë se policia serbe na heton që jeni gazetar edhe na thojnë që po ju ndihmojmë gazetarëve shqiptarë".

E kuptova atë frikën e tyre por unë insistova, "Jo ktu s'bon me zbrit", edhe nuk zbritëm. E vazhduam rrugën në drejtim të aeroportit. Kur kanë ardhë te hyrja e aeroportit atje, policët ishin shumë afër por

neve na nalën pak ma larg mos me hetu që jemi na aty në makinën e tyre. U dasht me zbrit e tani kemi ecë disa metra n'kamë. Po ishte, ishte me t'vërtetë moment i vështirë për ne që tash të bijmë n'sy të forcave serbe. Por për fat ata kishin obligime tjera dhe nuk na kanë hetu shumë. Janë marrë ma shumë me anëtarët e delegacionit të UÇK-së. Se flitej që kanë me arrestu Hashim Thaçin e kshu me radhë.

Hashimi ishte bashkë me Jakupin, me Ramë Bujën e Azem Sylën e tjerët ishin aty. Ne xhirum ato nga, ku ishin edhe gazetarët tjerë. M'kujtohet ka qenë Millosh Antiqi korrespondent i Borbës të Beogradit. M'pyti mu tha, "Zoti Bytyçi", tha, njiheshim si koleg, tha, "a osht' edhe Hashim Thaçi aty me ta?" Thashë, "Po, edhe Hashim Thaçi është me ta". Ai nuk besonte. Tha, "S'osht' e mundur. Nëse vjen kanë me arrestu", tha. Thashë, "Amerikanët e kanë marrë përsipër këtë punë edhe nuk besoj që Serbia guxon me arrestu Hashim Thaçin", thashë, "se ktu është Konferencë Ndërkombëtare për Kosovën dhe s'guxon me dështu për shkak të amerikanëve".

Kshtuqë kanë ateru, ka ateru aeroplani ushtarak për Paris. Ne jemi kthy me ni makinë të ni vozitësi shqiptar që vozitëste makinë të OSBE-së. Rrezikoj me na marrë mu e Abazin na ka dërgu deri në Prishtinë dhe pastaj e kom dhanë informatën për Televizionin Shqiptar me telefon për nisjen e delegacionit të Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare për Kosovën në Paris të Francës.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për kohën kur kanë fillu bombardimet se u përkeqësu situata edhe n'qytete. Ku keni qenë ju? Familja?

Nuhi Bytyçi: Po. Flitej se do t'ketë bombardime të NATO-s mirëpo dikush nuk besonte se do t'ketë bombardime. Unë rastësisht qëllova në Prishtinë, t'u montu ato emisionet nga Prekazi dhe nga Likoshani. Mbete me ato emisione, pasi i montova... dhe me 24 mars qëllova në Prishtinë me familjen time. Vjen kojshiu im Gani Sejdiu edhe m'thotë, "Nuhi", thotë, "hajde n'banesë time mos rri n'banesë tane se ti je i përcjellun dhe rrezikon vehtën dhe familjen", tha, "merre djaln edhe bashkëshorten dhe hajde te une".

Ai e kishte familjen e vet, e kishte edhe nanën, e kishte edhe dy vllaznit e vet aty me fmi. Ishin t'gjithë me ni banesë ishin aty të strehuar. Tash edhe na bëheshim ngarkesë për ta. Thashë, "Merre ti djaln", thashë, "edhe bashkëshorten unë po rri n'banesë time", thashë, "Jo", tha, "s'bon, nuk ka shansë, s'bon. Pse po rrezikon pa nevojë" tha, "hajde te unë. Nëse u shkru diçka me ndodhë le t'ndodhë për t'gjithë po nëse ka naj informatë që je ktu në banesë mujnë me ardhë edhe me të arrestu me t'burgosë edhe pasoja tjera".

Kshtuqë u detyrova ta respektoja vullnetin e fqiut tim, Ganiut. Aty disa ditë deri me 31 mars kemi qëndruar në banesën e Ganiut. Me 24 mars si dihet në ora 20:00 kanë fillu bombardimet e NATO-s. Ishte ni shkëndi e veçantë për Kosovën, ni shkëndi që paralajmëronte çlirimin e Kosovës, paralajmëronte dhënien fund të luftës dhe sakrificës së popullit të Kosovës për liri dhe pavarësi. Kshtuqë ne prisnim që shumë shpejt Millosheviçi të dorëzohet. Mirëpo si dihet 78 ditë u dasht NATO të bombardoj Serbinë dhe më në fund të pranoj kapitullimin.

Aty do të thotë kemi nejt deri me 31 mars në banesën e Ganiut. Ndërkohë kishte informacione nga fqinjët e tjerë se do t'vijne tash grupet paramilitare dhe po hyjnë nëpër banesa, po largojnë dhunshëm, po vrasin dhe po i plaqkisin shqiptarët. Jemi përgatitë me dalë kshtu krejt kolektivisht krejt ndërtesa. Ashtu ata dërgojshin urdhëra, disa paramilitar serb ma herët. Kishin takuar ni kojshi tonë, Jusufin e të tjerët. I kishin thanë që ma mirë dilni vet sesa që vijmë na aty. Ne kemi dalë.

Unë kom dalë e kom dhezë makinën kishte pasë pak benzin në garazhdë. E kom marrë edhe ni djalë të vllaut të Ganiut edhe ni vajzë të vllaut të Ganiut në makinë. Ganiu ka pasë nanën e vet, ka pasë edhe fmi tjerë, bashkëshorten dhe ka shku në stacion të hekurudhor në Fushë Kosovë dhe ka shku pastaj në Maqedoni. Ne jemi nisur në drejtim të Jazhincës, Tetovës anej, Malet e Sharrit. Kemi pritë pesë ditë aty sepse Maqedonia nuk lshonte, kërkonte që nga Kombet e Bashkuara të paguhet për t'gjithë refugjatët shqiptarë nga Kosova.

Kshtuqë derisa rash në kontakt me Arben Xhaferin, kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare në Maqedoni, ishte ni koleg i joni në Televizionin e Prishtinës, ishte mik i joni. Kshtuqë bisedova me Arbenin. Tha, "Tash i dërgoj disa aktivista t'mi edhe dil ti edhe të strehojmë përkohësisht në familjen e Enver dhe Naim Xhaferit në Bogovinë të Tetovës". Enveri ishte ni burrë shumë i respektuar, ishte vozitës i Poletit, Autobusit Polet që çarkullonte nga Tetova në Prishtinë dhe anasjelltas. E kisha takuar disa herë, m'kishte ndihmuar që t'i dërgoj disa kaseta në Tiranë. Mirë njihesha me të.

Si ka marrë vesh ai që unë isha aty, ai ka ardhë. Tha, "Ti Nuhi", tha, "je me familje tane je i strehuar te unë edhe te vllau". Na kanë pritë në mënyrë bujare, në mënyrën më të mirë të mundshme familja e Enverit dhe vllaut të tij Naimit. Aty kom qëndru ni natë unë ma tepër s'kom nejt. Vetëm sa me pushu pak psiqikisht se pesë ditë mbetëm n'rrugë...

Anita Susuri: Qysh kanë qenë qato pesë ditë?

Nuhi Bytyçi: Ato pesë ditë kanë qenë shumë t'randa sepse ishim në rresht aty me makinë, nuk lejonin me kalu. Mirëpo kishim ushqim mjaft. Na morëm disa rezerva tona po edhe shoqatat e ndryshme humanitare edhe shqiptarët e Maqedonisë na kanë ndihmuar shumë me ushqim, me t'gjitha që kishte nevojë. Mirëpo fakti që duhej me prit aty natën ish, nuk ishim sigurt. Se aty çarkullonin policët serb edhe nuk silleshin mirë, nënçmonin. Thoshin që, "NATO, NATO le t'ju shliron juve tash". Në mënyrë ironike. Kshtuqë ishin momente t'vështira.

Mirëpo kur pushova ni natë te familja e Enverit aty edhe unë i thashë Enverit, "Shoqen p'e la ktu edhe djaln", ishte edhe ai djali i vllaut i Ganiut dhe vajza e djalit të vllaut të Ganiut. Thashë, "Kta le t'rrijnë ktu niherë unë do t'shkoj në Tiranë se kom nevojë me punu atje për Televizionin Shqiptar". Kishte shumë obligime që të ndihmoja Asllanit dhe Besa Çekut për t'i përgatitur lajmet nga Kosova dhe rreth Kosovës. Kshtuqë shkova me autobus në Tiranë, e sigurova ni banesë atje. Kta shokët e Bogovinës ma sigurun ni banesë atje.

Disa student që kishin banuar aty shprehën gatishmërinë që ta lshojnë atë banesë për nevoja të familjes time. Kshtuqë pas disa dite kanë ardhë edhe Arianiti edhe bashkëshortja Ryva, kanë ardhë në Tiranë. Unë kom vazhdu punën. Ata janë vendosë në banesë aty. Unë kom vazhdu punën në Televizionin Shqiptar si redaktor i lajmeve dhe kemi përgatitur bashkë me Abaz Zekën gjithë ato kronika nga arritja e vullnetarëve, nga Amerika, nga Gjermania, nga Austria, nga Suedia, nga vendet e tjera europiane për t'ju bashkangjitur betejave përfundimtare të UÇK-së për çlirimin e Kosovës.

Ishte ni vullnet i jashtëzakonshëm i shqiptarëve nga mërgimi t'cilët kishte nga Amerika... edhe ni plak e kom takue, ishte shumë i moshuar mbi 60 e kusur vjet. Kishte lanë punën atje, kishte lanë familjen edhe kishte ardhë me luftu për çlirimin e Kosovës. Ka qenë edhe ni vajzë 16 vjet s'i ka pasë ma tepër. Ajo osht' Moriçi, Elinda, ashtu po m'duket. E kom intervistuar edhe atë. Ka qenë ni vullnet i paparë edhe t'rive edhe pleqve edhe t'gjitha grup moshave nga radhët e mërgimtarëve tanë për t'ju bashkangjitur luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Aty kemi realizuar edhe betimin e ushtarëve në Burrel me 13 maj të vitit '99. Ishte ni betim vërtetë imponant. Ishin me mijëra ushtar të cilët e jepshin betimin para Zëvendës Ministrit të Mbrojtjes në atë kohë, Hajdin Abazit edhe komandantëve të tjerë të UÇK-së. Kemi realizuar ni emision të veçantë nga ky betim edhe disa intervista me luftëtarë nga gjitha viset shqiptare. M'kujtohet si sot e kom bo edhe ni intervistë me Astrit Sulën. Ka qenë luftëtar nga Shqipëria por që ka ra dëshmor pastaj n'luftën e Kosovës. Edhe shumë e shumë luftëtar të tjerë të cilët ishin të gatshëm për t'u flijuar për lirinë e Kosovës.

Pastaj kemi xhiruar edhe imazhe në Kazermën e UÇK-së në Kalimash, në Kukës, në Krunë. Në Krunë kemi xhiruar edhe civilët në Krunë që ishin strehuar nga, që kishin ardhë nga Kosova ishin strehuar në xhaminë e Krunës dhe ishin strehuar në shumë shtëpi të Krunës dhe Hasit të Shqipërisë. Imazhe tjera, dëshmi të civilëve shqiptarë të cilët vinin nga Korenica e Gjakovës, nga Meja e Gjakovës. Që tregonin për tmerret që kishin parë gjatë largimit nga Kosova. Për vrasjen e fëmijëve të tyre, për vrasjen e bashkëshortëve të tyre, pleqve, t'rive. Ishin ato rrëfime rrënqethëse. Me të vërtetë që paraqitshin atë anën e vërtetë të një regjimi të dhunës, një regjimi terrori serb ndaj shqiptarëve në Kosovë.

Ndërkohë kom realizuar edhe disa intervista drejtpërdrejt me ish Zëvendës Kryeministrin e Shqipërisë, Zotin Ilir Meta n'atë kohë dhe me Zëdhëndës Kryeministrin e Kosovës Mehmet Hajrizin, i cili ishte në Tiranë ato ditë. Kemi xhiruar drejtpërdrejt në studion e Televizionit Shqiptar për të gjitha zhvillimet në Kosovë, rreth Kosovës, diplomacinë shqiptare, diplomacionë ndërkombëtare. Ishin ato, ishte do të thotë fillimi, fillimi i qershorit '99 kur pritej çdo moment që bombardimet e NATO-s të ndërpriten dhe Millosheviçi të kapitulloj.

Pastaj kemi bo edhe, kemi përcjellë edhe ni konferencë për media të ministrit të atëhershëm të informacionit Bajram Kosumit me 08 qershor në Tiranë, para gazetarëve shqiptar dhe mediave të huja. Vizitën e Kryeministrit të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës Hashim Thaçit në Kukës dhe në Korçë. Vizitën e tyre bashkë me Ilir Metën në kampet e refugjatëve shqiptarë në Kukës dhe në kampin e

Korçës. Ku vrehet ni optimizëm te popullata e Kosovës se së shpejti do të krijohen kushte për t'u kthyer në Kosovën e lirë.

Anita Susuri: A keni pasë gjatë asaj kohe kontakt me familjen e juaj n'fshat ose çka po ndodhë atje?

Nuhi Bytyçi: Familje ime për fat pas hyrjes së forcave ushtarake dhe policore serbe në fshatin tim në Shkozë të Malishevës me 01 dhe 02 prill të vitit '99, ishte larguar nga, si edhe shumë familja tjera, t'gjitha familjet e tjera të fshatit ishin larguar dhe ishte ardhë në Tiranë. Ishte vendosur në Kampin Don Bosko në Tiranë. Aty e kisha babën, nanën, fmitë e vllazërvë, nipa e mesa, axhën Sadik, axha Bajrush. Axha Bajrush edhe djali i axhës Limani ishin në Dibër edhe në afër Dibrës, cili vend osht' afër Dibrës atje? Ni qytezë është atje në pjesën afër Dibrës ata ishin strehuar atje.

Ndërkohë marr, gjatë kthimit, gjatë hyrjes në Tetovë, Malet e Sharrit, marr vesh se nga forcat ushtarake dhe policore serbe është masakruar xhaxhai Alushi dhe fqiu ynë Avdullah Uka. Kishte rënë heroikisht edhe msusi i shkollës së fshatit, moshatari im, Sali Bytyçi, dëshmor. Pastaj ishin vrarë, masakruar edhe pesë civil të tjerë meshkuj Ibish Isaj edhe disa gra të fshatit tonë. Ishte ni lajm shumë i zi për mua sepse xhaxhai Alushi ka qenë ma i madhi i familjes sonë, kryeplaku i familjes sonë dhe ka qenë njeri shumë i respektuar, jo vetëm n'fshat po edhe më gjerë.

Kshtuqë ishte ni humbje e madhe për familjen tonë vrasja, masakrimi i tij. Kom përjetu rëndë këtë ngjarje sepse ai ka qenë tri vjet i jesir i ushtrisë gjermane në Gjermani dhe gjithmonë thoshte se "Pa e shkelë gjermani Kosovën nuk mund t'shlirohet Kosova". Kshtuqë simbolikisht ishte se pa e shkelë NATO, edhe Gjermania ka qenë pjesë e NATO-s, ai ishte optimist se liria do t'vijë. Mirëpo fati deshi që ai mos ta gzoj lirinë. Kshtuqë mund të them se ishin ngjarje me t'vërtetë, nuk mujsha as me besu që do t'ndodhë që xhaxha Alushi nuk do t'jetë bashkë me ne për ta kremtuar shkrimin e Kosovës. Sepse ai ishte vazhdimisht njeri që na mobilizonte, na përkrahte edhe ishte optimist që liria do të vijë.

Pjesa e Njëmbëdhjetë

Anita Susuri: Si e keni pritë ju çlirimin e Kosovës, lajmin si e keni marrë?

Nuhi Bytyçi: Unë kom qenë në Tiranë kur Millosheviçi ka kapitullu. Kur osht' nënshkru marrëveshja e Kumanovës mes Gjeneralit Xheksion edhe Komandantit të atëhershëm të ushtrisë serbe. Përgaditëshim tash në koordinim me KFOR-in, me forcat e NATO-s që ishin në Tiranë, AFOR-i atëherë ka qenë. Aty shkum në Shtabin e NATO-s në Tiranë me disa gazetar që ishim të Televizionit Shqiptar po edhe mediave tjera.

Jemi interesu se si t'i marrim akreditimet, të kemi nga një akreditim se atëherë për siguri përgjigjej KFOR-i dhe duhej patjetër me pasë ni ID të KFOR. Pas dy dite na kanë dhanë ID-të se u duhke m'i përgatitë ato. Ne me 14 qershor jemi nisur me ni kombi nga Tirana bashkë me Abaz Zekën, bashkë me Nehat Zherkën që ka qenë kameraman, bashkë me Fadil Bytyçin edhe ka qenë edhe ni koleg nga Gjakova, gazetar. Jemi nisë për Kosovë.

Kur jemi ardhë në kufi në Vërmicë, aty kemi pa do të thotë forcat e KFOR-it që kanë qenë në vend të policisë serbe, forcat e KFOR-it edhe të UÇK-së normalisht. Kemi shku në Prizren. Në Prizren për herë të parë kemi përjetuar momentet e para në Kosovën e lirë. Unë Prizrenin e mbaja mend si nxënës në vite të '70-ta, tash më dukej më i bukur. Më i bukur sepse nuk kishte forca serbe, populli frymonte lirisht. Ishte atmosferë gzimi, feste.

Gjithë përgëzonin për fitoren e madhe edhe bashkarisht me luftëtarët e UÇK-së, luftëtarët, ushtarët e KFOR-it kremtonin në sheshin kryesor të Prizrenit, te shadervani dhe te Hotel Theranda. Kshtuqë unë meniherë kontaktova me kryetarin, përfektin e atëhershëm të Prizrenit, Zotin Kadri Kryeziu. Shkova e vizitova në zyrën e tij në komunë. Ia urum njëri tjetrin festën e madhe, çlirimin e Kosovës, ditën e madhe të cilën e pritshim me padurim të gjithë.

Unë pata realizu edhe ni intervistë me të si po funksionon pushteti lokal në rrethana të reja. Me të vërtetë ishte ni gatishmëri e madhe nga të gjithë bartësit e pushtetit lokal n'atë kohë për ta organizuar jetën. Sepse çdo gjë ishte e shkatërruar, çdo gjë ishte e djegur, nuk funksiononte kurgjo. Furnizimet ishin bukur t'dobëta mirëpo vullneti ishte i madh. Ishte ni optimizëm i paparë te t'gjithë që ditët e para të lirisë t'i kalojnë ashtu si është më së miri pa ndonjë ekces. Që mos të ndodhë që në eufori të ketë edhe humbje të reja e kshtu me radhë.

Ishin momente të papërshkruara në jetën time. Unë gjithmonë kom qenë optimist se kjo ditë do t'vijë dhe fati deshi që edhe ta përjetoj bashkë me shumë bashkëkombas të tjerë. Të cilët ishin të gatshëm tani të angazhoheshin për normalizimin e jetës në të gjitha sferat në Prizren dhe në Prishtinë. Aty takoj në Prizren edhe nipin Islam Gashin bashkë me eprorin e UÇK-së Muhir Hasanin. M'pysin mu, "A don me shku në Prishtinë?" Thashë, "Po, do t'shkoj në Prishtinë", tha, "Na vijmë t'përcjellim ty edhe Abazin", tha, "se në Lipjan ka serb shumë edhe po i provokojnë dhe janë të armatosur", tha, "nuk guxojmë me ju lonë vet se mund të ndodhë diçka", "Ani", thashë, "nëse keni, është iniciativë e juja është e mirëseardhur, jemi ma t'sigurt me juve".

Kemi mrri në Prishtinë. Nuk kemi hy në qendër të Lipjanit, s'kemi pasë nevojë me hy në qendër të Lipjanit po rrugës tranzit dhe kemi mrri në Prishtinë. Kur kemi mrri në Prishtinë te banesa ime aty atmosferë e vdekun, s'ishin kthy hala banorët. Asni banor s'ish kthy aty. E takoj ni kojshi serb që ka qenë kryetar i Gjykatës Komunale të Prishtinës, ni hymje tjetër aty afër nesh. Ai, ia kom haru emrin tash s'muj me ditë saktësisht. Ai kur i ka pa kta me armë edhe me uniformë të UÇK-së u ikë, e ka lshu aty u shku me ni lagje tjetër aty në Breg të Diellit te banesat e bardha në Breg të Diellit. Aty e patën strehu përkohësisht disa familje serbe.

Edhe pse thashë kta nuk kanë pasë qëllim me sulmu kërkënd po me na siguru mu edhe Abazit që t'mos kemi ndonjë problem gjatë rrugës për në Prishtinë. Kshtuqë kemi fillu meniherë përgaditjet për të xhiruar organizimin e luftëtarëve të UÇK-së në ato rrethana, në rrethana të reja në Prishtinë. Shkoj në Shtabin e Zonës Operative të Llapit në periferi të Prishtinës në drejtim të Kolovicës atje, ka qenë në familjen e Adem Dëshishkut. Në shtëpinë e tyre ka qenë i vendosur shtabi, i Zonës Operative të Llapit

të paqërimit të Kosovës kuptohet. Aty pastaj ka ardhë edhe Jakup Krasniqi që ka qenë Ministër për Rindërtim dhe Zëdhënës i Qeverisë së Kosovës.

Aty jemi taku edhe me Jakupin, pastaj me Bajram Kosumin. Edhe kshtu me radhë kemi filluar m'i përcjellë gjithë ato manifestimet përkujtimore që mbaheshin ato ditë në Kosovë. Bashkë me Xhavit Halitin kemi shkuar në vendlindjen e tij në Novosellë edhe kemi xhiruar shtëpitë e djegura dhe të hallës së tij edhe shumë familje tjera. Në atë fshat kemi xhiru edhe dëshmitë e dëshmitarëve për krimet që kishte bërë Serbia në Kosovë, në fshatin Novosellë, Jabllanicë dhe fshatrat tjera aty përreth.

Kom pasë xhiru edhe ni rrëfim të veçantë të Xhavit Halitit aty te Drini i Bardhë tash në rrethana tjera. Qe disa vite ai s'e kishte vizituar Kosovën se ka qenë në Zvicërr dhe në Tiranë i angazhuar, sidomos gjatë periudhës së luftës po edhe ma herët. Ishin përjetime t'Veçanta të tij ta shihte Kosovën e lirë. Gjithë ishin optimist se së shpejti Kosova do të rindërohet, do të eliminohen pasojat e luftës. Mirëpo ishte e pamundur që shumë shpejt të harrohen gjithë ato viktima të terrorit shtetror serb ndaj civilëve shqiptarë.

Kudo flitej për masakra, kudo flitej se ende ka t'burgosun politik edhe institucionet e atëhershme, Qeveria e Përkohshme e Kosovës bashkë me UNMIK-un bonin përpjekje që të kontribonin në normalizimin e jetës në Kosovë. Çka t'them tash tjetër? Unë vazhdova...

Anita Susuri: Në cilin medium jeni angazhu?

Nuhi Bytyçi: Në Televizionin Shqiptar. Vazhdova t'punoj për Televizionin Shqiptar se atëherë ende RTK-ja nuk ishte hapur. Raportojsim me telefon, ku kishim mundësi dërgonim edhe disa kaseta që i dërgonim në Tiranë. Ndonjëherë shkojsa m'i montu edhe atje kur ishte me randësi. Sidomos kur ishte përvjetori i rënies së Komandantit Fehmi Lladrovci me 22 shtator '99 në Skenderaj. Kemi ba përpjekje në mënyrë intenzive t'i pasqyrojmë opinionet tona gjitha zhvillimet e pas luftës në rrethana tjera. Prap kishim ni vullnet të madh për të informuar.

Ndërkohë në Prishtinë fillun përgatitjet edhe për hapjen e Radio Televizionit të Kosovës. Mirëpo unë ende vazhdoja të punoja për Televizionin Shqiptar. Edhe pse ashtu si startoj Radio Televizioni i Kosovës nuk mund ta gjeja veten. Si dukej kishte jo profesionalizëm ende. Gazetarët nuk ishin të lirë të informonin ashtu në mënyrë profesionale kshtuqë kishte nifar' lloj censure moderne, si t'them. Nuk mund ta gjeja n'atë ekip.

Kshtuqë unë jom angazhuar më vonë në RTK, nga prilli i vitit 2000. Ku kam filluar të punoj fillimisht pa kontratë, pastaj jam detyruar të hyj me ni testim që ishte ni konkurs publik që ishte shpallur ato ditë në media. Kom konkuru si gazetar fillestar edhe pse isha me përvojë, e kisha, titullin redaktor e kisha ma herët edhe... mirëpo tash ishin rrethana tjera, ishin kushte tjera dhe duheshe t'i nënshtrohesht testimit. Unë s'kom hezitu si krahas shumë koleg të tjerë ju kemi nënshtro testimit.

Për fat komisioni që ka qenë nga Avni Spahiu, nga Sylejman Gashi dhe Smajl Smaka kanë vlerësuar testimin tim, punimet e mija profesionale. Kam qenë në listën e atyre që janë propozuar për t'u pranuar si gazetar i rregullt në Radio Televizionin e Kosovës. Aty n'fillim kemi pasë disa sfida me redaktorët e programit në gjuhën shqipe. Ka qenë kryeredaktor ni gazetar italian, i cili nuk dëshironte shumë që të afirmohej Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

Unë me 12 qershor xhiroj ni vjetorin e hyrjes së UÇK-së në Prishtinë. Xhiroj Komandant Remin, Isak Shabanin dhe luftëtarët e tjerë. Duke marshuar në qendër të Prishtinës pastaj deri në Stadiumit të Prishtinës ku bohej manifestimi qendror me rastin e ni vjetorit të çlirimit të Prishtinës. E kemi transmetu ni emission special. Mirëpo si duket atyne italianëve, atij kryeredaktorit italian nuk i kishte pëlqyer mënyra se si kisha raportuar bashkë me Shaqir Foniqin.

Të nesërmen na komunikuan se unë e Shaqiri nuk duhej të vijmë në televizion niherë derisa t'mirren vesh për statusin tonë. Unë me lehtësi e pranova atë sygjërim nuk dojsa me për shkak të ndonjë incidenti aty të panevojshëm. Sepse konsideroja që kjo punë do të zgjidhet shumë shpejt. Ishte zgjedhë drejtor i televizionit kolegu ynë Migjen Kelmendi, me t'cilin kemi bashkëpunuar gjatë luftës. Nuk dyshoja në menaxhimin e tij.

Kshtuqë Migjeni masi u kthy nga ni vizitë zyrtare që ka qenë në Kanada më ftoj në zyren e tij dhe më komunikoj se, "Nuhi ti tash ki kontratën e rregullt si gazetar i rregullt në RTK". Kom vazhduar punën deri në pensionimin tim në Radio Televizionin publik të Kosovës duke përcjellur ngjarje të rëndësishme që kishin të bënin jo vetëm me luftën, po me t'gjitha zhvillimet e tjera në Kosovë dhe rreth Kosovës.

Anita Susuri: Deshta pak me u nal me folë për do ngjarje ma të rëndësishme që kanë qenë n'atë kohë, si për shembull Lufta në Luginën e Preshevës, që ju e keni...

Nuhi Bytyçi: Po. Se di fati deshi që... tash meqenëse kisha ni përvojë nga Lufta e Kosovës, kta kolegët e mi pritonin t'shkonin në zonat e luftës se ishte rrezik, s'kishte privilegje s'kishim as ndonjë përfitim material, as meditje as kurgjo. Majshe me marrë naj shpërblim ndonjë plumb, kurgjo ma tepër. Mirëpo ishte vullneti prap që të kontriboja si gazetar n'këtë drejtim. Ishin organizuar vllazërit tanë në Luginën e Preshevës për të luftuar për çlirimin e Luginës së Preshevës në trojet e tyre të cilat ende janë mjerisht nën okupimin e Serbisë.

Kshtuqë unë konsiderohna se kom obligim meqenëse kta na kishin ndihmu gjatë luftës në Kosovë edhe unë të shkoja të raportoj atje. Kontaktova me drejtuesit e atëhershëm të Shabit të Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc. Kom pasë ni përkrahje të veçantë nga të gjithë. Po ashtu duhet të them se kom pasë përkrahjen e veçantë edhe nga ish drejtori i përgjithshëm i RTK-së në atë kohë, Agim Zatriqi edhe nga ish drejtori i përgjithshëm i RTK-së gazetari i BBC-së Richard Lukas, nga Migjeni dhe nga t'gjithë drejtuesit e Radio Televizionit të Kosovës. Nga Avni Spahiu dhe të tjerë.

Kshtuqë kam shkuar bashkë me kameramanët Mumin Jashari, me Bekim Qyqallën, Gazmend Elshanin, Lulzim Kryeziun dhe disa koleg të tjerë. Për të xhiruar të gjitha ato imazhe që ndodhnin në

Dobrosin, në Konçul, në Lluçan dhe në beteja të tjera në Luginën e Preshevës. Duhet të them ni përjetim që e kom pasë me ni oficer të ushtrisë amerikane në Dobrosin. Kur shkova aty, tha, “Ku po shkon?” Thashë, “Në Dobrosin”. Tregova që kisha lejen e KFOR-it, gazetar i RTK-së. Tha, “T’lshoj me ni kusht”, tha, “nëse kur kthehesh m’i tregon ato xhirime çka ke xhiru ti atje”, thashë, “Po patjetër s’ka problem”, a din.

Shkum i xhirum atje çka kishim me xhiru. Kur u kthym tha, “A bon m’i pa qato xhirime? M’ke premtu”, thashë, “Po m’vjen keq”, thashë, “ato janë publike, mund m’i pa në lajmet e RTK-së” (qeshë), thashë, “unë t’kom premtu po t’kom premtu m’i pa n’lajme jo tash me m’i cenzuru”. Ai s’e kish qëllimin m’i cenzuru po i ka interesu çka po ndodhë atje. Thashë, “N’lajmet të RTK-së kemi m’i qit”. Edhe ashtu ka ndodhë. I kemi qit’ në lajmet e RTK-së. Edhe ai qeshi dhe tha, “Qenke shumë i mençur ti, ke ditë mos me pasë pengesa për ty për me kalu andej”.

Niherë tjetër kemi pasë probleme atje në Konçul duke shkuar për të përcjellë ato takimet me diplomatin Faith. Ka qenë përfaqësues, si ndërmjetësues për bisedimet mes UÇPMB-së dhe Serbisë. Aty ka qenë kompetent KFOR-i rus në Konçul, në të vërtetë në pikën kufitare afër Konçulit. Na ndalin ata ushtarët rus edhe thojnë, “Lejen, a ki lejën?” Thashë, “Po, e kom lejën e KFOR-it”. E kisha lejen e KFOR-it qendror në Prishtinë, komunës së KFOR-it qendror. Tha, “Jo”, tha, “duhet me marrë lejen e KFOR-it rus”, tha, “shko në Kamenicë”, e kishin ata komandën, tha, “Shko në Kamenicë merre atje tani munësh me shku”, thashë, “Jo unë s’kom nevojë me shku në Kamenicë, e kom lejen e KFOR-it qendror, shtabit qendror edhe nuk shkoj atje, kot e ke”.

Gjatë asaj bisede ka qenë ni përkthyes i KFOR-it amerikan, Muharremi nga Tërnoci i Madh. E kom njoftë atë. Ai i ka tregu atij ushtarakut amerikan. Tha, “Çka po ju thotë ai gazetari atij ushtarakut rus?” Thotë, “Po i thotë unë e kom lejen e KFOR-it, shtabit qendror edhe nuk kom nevojë me marrë lejen e KFOR-it rus edhe t’lutëm mos më pengo duhet me shku me kry detyrën”. Atij i ka ardhë mirë shumë amerikanit dhe e ka urdhnu atë ushtarin rus që me na liru. Thotë, “Vetëm shënoj dhe mos i pengo ekipin e RTK-së se ata e kanë lejen e Shtabit Qendror të KFOR-it në Prishtinë”. Kto kanë qenë disa përjetime të cilat mund t’i veçoj për atë periudhë.

Kur kemi xhiru me Mumin Jasharin në malet e afër Lluçanit aty, ka qenë ni moment shumë i rrezikshëm. Sepse Mumini dëshironte të merrte sa më shumë pamje me ilustru kronikën për lajme. Unë i thashë, “Mumin”, ai ishte djali i ri, s’kishte vendim t’rregullt, s’kishte kontratë t’rregullt ende s’kishte. Unë kom ndiku që ai të merr kontratën sepse knej rrezikohej jeta e tij, knej pa kontratë ishte edhe ni lëshim i madh për RTK-në nëse ndodhë diçka ma e keqja për të. Familjes si mund t’i thush që ke çu njeri pa kontratë në zona të luftës.

Mumini shumë i përkushtuar në punën e tij, filloj të xhiroj edhe më tepër. Thashë, “Mumin, ktu film artistik s’jem t’u ba”, thashë, “ktu plumi mund me marrë plumin edhe sa ma shpejt t’ikim”. Se ishin shumë afër forcat serbe. Si kemi mbaru xhirimin as dy minuta meniherë kanë gjujt serbët aty në pozicionet që ka qenë, afër Maleve të Lluçanit. Ka edhe momente tjera. Bashkë me Bekim Qyqallën kemi shku me ni, me ni vozitës anglez i cili na ka vozit atje. Kur shkum atje në Grykën e Lluçanit, nuk e

dijshim na rrugën kah me shku, ishte nifar' borë e vogël kishte ra dhe s'kishte lëvizë askush. U kriju nifar' panike.

Ushtria serbe u shihshin me ni kodrin nalt na ishim pak ma poshtë. Unë nuk e disha rrugën, s'i kisha ra asniherë aty. Ai po m'pytë, "Kah m'i ra?" Thashë, "Qitu". Mos me kriju dilemën te ai që nuk p'e di rrugën. Thashë, "Grahi qiknej". Kemi has pastaj te UÇPMB-ja dhe kemi xhiru ato pamjet aty. Gjithmonë gazetari për me mujtë me raportu duhet me rreziku, osht' e pamundur me bo diçka në mënyrë profesionale pa rreziku.

Pastaj aty kemi përcjellë edhe takimet e delegacionit të UÇPMB-së me përfaqësuesit e Qeverisë së Serbisë në atë kohë në Lluqan. Aty kemi kalu bile edhe ni punkt të policisë serbe aty. Po meqenëse kemi qenë në përcjellje të KFOR-it amerikan nuk na kanë ndalë edhe kemi kalu pa pasoja. Pastaj mund t'flas kshtu lufta nuk m'u ka nda as në Maqedoninë Veriore. Kur filloj lufta në vitin 2001 atje. Unë meniherë fillova të kontaktoj me drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Në bashkëpunim me kolegun tim Qani Mehmedin i cili ishte nga Kërçova dhe kishte mik të shtëpisë Ali Ahmetin. Thashë, "Qani, unë jom i gatshëm me ardhë me ty bashkë me raportu nga Tetova, nga Kumanova". Sepse Ismet Jashari, Kumanova, ka qenë në Kosovë dhe ka rënë dëshmor për lirinë e Kosovës. Kshtuqë edhe na e kemi obligim edhe si gazetar të informojmë edhe për luftën në trevat shqiptare, në Maqedoni. Kemi kontaktu me Ali Ahmetin dhe kemi bashku bashkë me Qaniun në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së në Shipkovicë, në malet e Shipkovicës.

Kemi xhiru ni intervistë, unë kom xhiru me Ali Ahmetin, me Gzim Mustrenin edhe me disa luftëtar të tjerë atje. Pastaj kemi bashkëpunu edhe me Arben Xhaferin, kryetarin e Partisë Demokratike Shqiptare i cili na ka ndihmu që ta realizojmë intervistën me ambasadorin amerikan në Shkup edhe me ambasadorin e BE-së në Shkup. Ka qenë shumë kooperativ, na ka ndihmu shumë që emisioni ynë të jetë gjithëpërfshirës. Kshtu pastaj me Gazmend Elshanin kemi shku me xhiru edhe në Zonën e Likovës ku ka qenë Ushtria Çlirimtare Kombëtare e pozicionuar.

Kemi shku në fshatin Sllupçan ku popullata civile ishte strehuar në podrume. Gratë, fmitë, pleqtë në podrume të shtëpive që kishin ndërtuar mërgimtarët shqiptarë që punonin në shtetet perëndimore. Ato ditë ushtria dhe policia serbe kishte dhënë ultimatum civilëve që të dalin nga podrumet dhe nëse nuk dalin ata do të granatojnë fshatin dhe pastojat do t'i bartin edhe civilët. Mirëpo popullata civile ishte solidarizuar me Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare dhe ata nuk dilnin nga podrumet sepse nuk kishin siguri të qëndronin diku tjetër.

Shkum ne me Gazmend Elshanin në Osla edhe në Sllupçan. Nuk e kemi ditë që forcat maqedone ishin kanë shumë afër aty dhe ishte tereni shumë rrafshët. Mund t'na shihnin, mund t'na vrenin. Por, ishte me rëndësi për neve që ne t'i pasqyrojmë sakrificën e popullatës civile në podrume edhe aty meniherë kemi fillu me xhiru me Gazmendin. Për ni kohë Gazmendit iu ka harxhu bateria pasi qëndroj disa minuta, iu harxhu bateria.

Doli me marrë baterinë tha, “Po shkoj me marrë baterinë”. Unë dola pas tij edhe ata maqedonët granatonin aty vazhdimisht. Unë u frikësova që mos e ka rrokë ndonjë granatë Gazmendin edhe bojsha, “Gazmend, Gazmend”, veç dojsha me konfirmu a është gjallë. Tha, “Po, po gjallë jom, veç p’e marrë baterinë edhe po kthehem”. Po du me thanë që me imazhe tona t’cilat i kemi plasu në 76 televizione botërore... atë natë meniherë kom bo ni koncept çka po du me nda për televizione botërore se qëllimi ishte botës m’i tregu çka po ndodhë me popullatën civile në trevën e Likovës.

Kshtu në lajmet tona qendrore pastaj kemi dhanë ni kronikë të cilën e kanë mirëpritur edhe ish drejtuesit e atëhershëm të Televizionit të Kosovës, Agim Zatriqi edhe Richard Lukas. M’kanë shpërblyer mu dhe Gazmend Elshanin për këtë kronikë profesionale që kemi realizuar në Sllupçan. Si shpërblim thanë, “Shkoni në Antali me pushu nja pesë ditë”, shkonte ni ekip i gazetarëve edhe mediave tjera. Na s’kishim lidhje me turizëm po thanën, “Nuk kemi mjete materiale me ju kompenzu”, tha, “shkoni pushoni pak. S’keni nevojë me xhiru kurgjo”, thashë, “Unë pa xhiru osht’ e pamundur”.

Po Gazmendi nuk kishte pasaportë edhe u dashtë me marrë Mumin Jasharin. Me Muminin kemi bo ni tele-reportazh të mirë për Antalinë si qendër e njohur turistike. Kjo ka qenë ni mirënjohje për punën time dhe të kolegëve të mi në rrethanat e vështira të luftës në Maqedoni dhe në Luginën e Preshevës...

Anita Susuri: Ju keni raportu edhe për Hagë kur kanë shku politikanët tonë...

Nuhi Bytyçi: Po është e vërtetë, unë kom raportu nga dy procese shumë t’randësishme kundër Fatmir Limaj, Hajredin Balaj dhe Isak Musliut dhe kundër Ramush Haradinajt, Lahi Ibrahimajt dhe Idriz Balajt. Jemi shku atje me Gazmend Elshanin, i cili ka qenë njeri shumë i shkathët ka xhiru edhe ka montu dhe kemi bo ni punë të rëndësishme për informimin e opinionit. Kemi përgadit emisione speciale nga të gjitha dëshmitë që janë paraqitur në atë periudhë atje.

Kanë ardhë për të dëshmuar përveç drejtuesve të UÇK-së kanë ardhë edhe diplomatët e huaj ndërkombëtarë për të raportuar, për të qenë dëshmitar në këto procese. Ne jemi munduar që të raportojmë në mënyrë profesionale por kaniherë i kemi ndihmu edhe ktyne dëshmitarëve që kanë ardhë. Tash kur ishte rasti i dëshmisë së Ramiz Qeriqit, pas tij erdh për të dëshmuar Shukri Buja. Ne u takum me Shukri Bujën te banesa jonë aty ku e kishim në Shemeningen.

I tham Shukriut, “Nëse don me dëgju çka ka folë ky Komandant Luani, Ramiz Qeriqi e ke ma lehtë se nesër naj pyetje mund me t’ra nga përgjegjja e tij dhe me qenë i informuar”. Kemi ndihmuar edhe Shukri Bujës edhe Rexhep Selimit edhe dëshmitarëve të tjerë. Të cilët kanë ardhë për të qenë dëshmitarë. Edhe Jakup Krasniqi për të dëshmuar në procesin gjyqësor ndaj Fatmirit, Ramushit dhe të tjerëve.

Pjesa e Dymbëdhjetë

Nuhi Bytyçi: Dua të them se para se me fillu procesi gjyqësor në vitin 2003, me 02 prill 2003 unë kom bo ni kërkesë ma herët për ta vizituar në Burgun e Shemeningenit Fatmir Limaj, si vendas i imi, si shok i imi. M’u lejua pas shumë presioneve që bëra m’u lejua vizita. Unë u paraqita, jo si gazetar po si mik i tij

dhe m'u lejua vizita nga drejtoria e burgut. Jemi takuar me Fatmirin aty, te ai e kom pa ni vendsosshmëri që edhe në këtë proces UÇK-ja do të dëshmoj që ka qenë ni ushtri që ka luftu për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës dhe nuk ka ba as masakra, as krime ndaj popullatës civile, po ka luftuar kundër regjimit ushtarak dhe policor serb.

Me këtë rast dua ta përkujtoj edhe momentin kur osht' shpallë aktgjykimi ndaj Fatmir Limajt. Para se m'u shpallë gjykimi, sipas atyre dëshmive që dëgjojshe në procesin gjyqësor të cilat ishin fabrikuar nga Beogradi dhe bashkëpunëtorët e tij. Ekzistonte ni përshtypje se vështirë se do të shpëtojnë pa u dënua luftëtarët e UÇK-së. Mirëpo edhe pritoja, hezitoja të raportoja nga shpallja e aktgjykimit të Fatmir Limaj sepse nëse, thojsha, nëse shpallen fajtor nuk du me qenë pjesë e raportimit nga ky proces.

Arianiti ka ndikuar, djalin e kam shumë kshilltar të mirë për shumë çështje, dhe ka kshtu vizion edhe thotë, "Babi", thotë, "është mirë me shku ti atje me raportu se nëse ndodh që shpallën të pafajshëm, edhe duhet me u shpallë të pafajshëm", sipas tij po edhe sipas meje por kisha ni rezervë që mund të ndëshkohen se ishte ni gjykim politik. Tha, "Çka bon ti nëse shpallën t'pafajshëm e s'je ti me raportu", a din, "osht' dështim i yti". Më bindi se ashtu ishte.

Bisedoj unë me drejtorin e televizionit, n'atë kohë, Liridon Cahani ka qenë edhe Mërgim Zatriqin. Thashë, "Po shkoj atje se nëse shpallen t'pafajshëm është mirë me qenë RTK atje edhe unë". E kom siguru vizën shpejt e shpejt te ni mik i imi që punonte në Ambasadën e Greqisë. Sepse Holanda kërkonte shumë kohë ma gjatë edhe procedura ma t'vështira. I tregova Shkelzen Raçës, thashë, "Shkelzen", ni intelektual i treguar. I drejtova drejt thashë, "Nëse munësh me më ndihmu ta kem vizën", edhe ma siguroj Shkelzeni vizën.

Shkova me raportu unë atje me Gazmendin edhe kemi raportu dhe fati deshi që Fatmir Limaj u shpall i pafajshëm edhe Isak Musliu po ashtu u shpall i pafajshëm. Por u dënua Haredin Bala, për të cilat disa vepra akuzohej për disa vepra penale. Aty kom realizuar drejtpërdrejt me avokatin e Limajt, Zotin Mensfilld, me vllaun e Fatmirit, Demirin dhe disa bashkëatdhetar të cilët kishin ardhur për ta përcjellë epilogun e Gjykatës së Hagës për Limajt dhe të tjerët.

Ndërkohë kom përcjellë edhe gjykimin ndaj Ramush Haradinaj. Fillimisht pat' fillu me raportu dikush tjetër, nuk e di tash kush prej kolegëve ka qenë, m'duket Petrit Musolli edhe disa koleg tjerë. Ata u kthyen nga Haga. Nuk ishin t'knaqur me transmetimin e kronikave në Televizionin e Prishtinës dhe u kthyn në Prishtinë. Pastaj ishte insistimi që ky proces të përcillet nga unë. Drejtori na thirri, Agim Zatriqi tha, "Nuhi është mirë me shku në Hagë se nuk guxojmë pa e përcjellë këtë ngjarje me rëndësi".

Shkova në Hagë po ashtu bashkë me Gazmend Elshanin pastaj ma vonë edhe me Jeton Bajgorën, Mehdi Puskën, Milot Dibrnin dhe të tjerë. Kshtuqë posa shkova ditën e parë bona kronikën për televizion, për RTK edhe t'nesërmen po vjen te unë aty ni përkthyes shqiptare nga Shqipëria e cila përkthente procesin. Thotë, "Zotëri Bytyçi a ka mundësi me ma dhanë numrin e telefonit t'juj se p'e

lypë Ramushi dhe Lahiu. Ka dëshirë m'u dëgju me ty". Ia dhashë telefonin. Kisha telefon mobil atje dhe të Holandës.

Në mbramje pasi u transmetu kronika në lajmet e RTK-së m'thirrë Lahiu tha, "Ki t'fala prej Ramushit edhe prej Idriz Balajt dhe të përgëzojnë për raportimin tënd profesional nga gjykata dhe procesi gjyqësor ndaj tyre". Unë jom mundu, drejt me thanë, m'i paraqit në mënyrë profesionale gjitha ato dëshmi që ishin paraqitu aty edhe argumentet e mbrojtjes së atyre që akuzohen se akuzohen padrejtësisht dhe se UÇK-ja ka qenë ni ushtri çlirimtare që ka luftu për lirinë e popullit të Kosovës.

Kshtuqë për mu kjo ishte ni kurajo që të punoj dhe të raportoј prap, të vazhdoј të raportoј në mënyrë profesionale dhe kom raportuar deri në përfundimin e gjykimit të Ramushit. Ka qenë prill 2008 kur ka përfundu procesi gjyqësor. Aty po ashtu kom raportu që Ramushi u shpallë i pafajshëm dhe Idriz Balaj. Lahiu është dënuar, se u dashtë dikush me pagu faturën aty të atij procesi. Kshtuqë konsideroj që kam arritur që të kryej me sukses detyrën time si gazetar të raportoј edhe për këto procese gjyqësore ndaj ish komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Anita Susuri: E pavarësinë qysh e keni pritë?

Nuhi Bytyçi: E pavarësinë... unë n'atë kohë kom qenë në redaksinë, dokumentare dhe disa emisione tjera për ekonominë m'kanë caktu për me punu. U munojshin me m'largu pak prej temave të luftës e tjera e tjera. Nuk mund t'kërkoja që t'jem unë pjesë e ekipit të lajmeve për të raportu për pavarësi. Po i tregoj tash Arianitit. M'thotë, "Babi", thotë, "a ki me shku me raportu për pavarësi?" 17 shkurt 2008.

Thashë, "Arianit, unë nuk jom pjesë e redaksisë së lajmeve, tani punoj tjera punë në dokumentar", tha, "E di që punon në programin dokumentar po osht' mirë me bisedu edhe ti ke përcjellë pavarësinë e Kosovës, deklaratën kushtetuese të 02 korrikut, ke përcjellë edhe luftën e krejt. Kjo është ni kurorëzim i krejt asaj sakrifice të Kosovës edhe osht' mirë me shku", thashë, "Po s'o mirë m'u imponu se s'o problem me shku unë. Muj m'i thanë edhe Zotit Jakup Krasniqit", që ishte kryetar i kuvendit, "me ma bo ni ftesë me shku si mysafir. Por si gazetar", thashë, "s'di a ka kuptim me insistu meqenëse s'punoj n'redaksinë e lajmeve", tha, "Jo jo shko bisedo me drejtorin".

Bisedova me Liridon Cahanin edhe me Agim Zatriqin, Sylejman Shaqirin e të tjerët. I tregova drejt qishtu, qishtu, "Propozimi i Arianitit", edhe thashë, "nashta osht' mirë me qenë edhe unë", "Po patjetër". Më përkrahën edhe këtë iniciativë dhe pa asni hezitim thanë, "Po more s'ka problem për ata, vetëm s'deshëm me t'ngarku". Shkum. Kemi raportu me Shkumbin Ahmetgjeqen edhe me koleg tjerë. Po me Shkumbinin kemi qenë te salla solemne e Kuvendit të Kosovës. Kemi bo intervista me delegat e mysafir që vinin aty. Me Bajram Kosumin, me Fatmir Limen, me shumë përfaqësues tjerë të popullit.

Ishte protokolli ishte se mbledhja e mbyllur e kryesisë së Kuvendit të Kosovës nuk duhej të përcillej nga gazetarët. Ishte paraparë që t'jetë e mbyllur ajo. Unë thashë do t'mundohem t'ja thej protokollin edhe ksaj radhe (qeshë). E thrras n'telefon Jakup Krasniqin që ishte Kryetar i Kuvendit të Kosovës edhe i them, "Kom propozim që mbledhja e mbyllur e kryesisë të jetë e hapur për RTK-në, vetëm për

RTK-në”. Ishte ni sallë e vogël dhe s’kishte mundësi me hi kameramanët dhe fotoreporterët e të gjithë gazetarët. Për ata sigurisht e kanë parapa ashtu.

Thashë, “Unë po propozoj që unë me ni kamerë me hy aty edhe me xhiru atë mbledhje edhe me transmetu drejtpërdrejt”. Jakupi e përkrahu këtë ide. Aty në protokoll ishte Vlora Çitaku e tjerë. Vlora e kundërshtoj pak tha, “Po na then protokolin”, thashë, “Po hajt se është pozitive për kuvend dhe për këtë ngjarje historike”. Kom raportu. Kom qenë gazetari i vetëm që kom raportu nga kjo mbledhje e jashtëzakonshme e kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Para se me fillu seanca solemne e Kuvendit të Kosovës ku Hashim Thaçi lexon deklaratën e Pavarësisë së Kosovës dhe atë e përkrahë edhe Fatmir Sejdiu dhe Jakup Krasniqi dhe t’gjithë delegatët që kanë marrë pjesë në atë mbledhje historike.

Kjo ishte ni moment shumë i rëndësishëm për mua si gazetar sepse më në fund po merrja pjesë në ni ngjarje historike për Kosovën. Kisha fatin që t’jem pjesë edhe e ktyne pjesëmarrësve të kësaj ngjarje. Ishte ni përjetim vërtetë emocionues. Do ngjarje nuk përsëriten, rrallë përsëriten. Kjo do të ekzistoj në mbamendjen time dhe të opinionit kosovar dhe atij ndërkombëtar gjithmonë.

Dua të përmend në mënyrë të veçantë edhe shkurjen time dhe të Abaz Zekës në Fshatin e Ri ku zhvilloheshin negociatat mes përfaqësuesit të departamentit amerikan Xhejms Robin dhe drejtuesve të atëhershme të qeverisë së përkohshme dhe Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së lidhur me tekstin final të marrëveshjes për demoltarizimit dhe transformimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E di se negociatat kanë qenë bukur të vështira, kanë zgjatë me orë të tëra.

Xhejms Robin ka kontribuar që në kontakt me sekretarin e atëhershme Medlin Ollbrajt t’i fus disa paragraf, disa nene në kuadër të tekstit të marrëveshjes për transformimin dhe demoltarizimin e UÇK-së. M’kujtohet kur nga KFOR-i baza e KFOR-it në Prishtinë ka ardhë ni helikopter i NATO-s në Malet e Divajkës, te Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së. Aty kanë hypur gjithë drejtuesit e atëhershëm të qeverisë së përkohshme dhe të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Nga gazetarët kom qenë vetëm unë dhe Abaz Zeka dhe kemi shkuar në bazën e KFOR-it në Prishtinë, ktu te zona industriale.

Aty u mbajtë negociatat me gjeneralin e KFOR-it të atëhershëm, Gjeneralin Michael Jackson. Ishin aty përfaqësuesit edhe të ushtrisë amerikane dhe të diplomacisë amerikane dhe shumë përfaqësues të Bashkimit European. Kemi xhiruar ato imazhe aty nga atmosfera para nënshkrimit të marrëveshjes nga Zoti Thaçi dhe Zoti Jackson. Kemi realizuar edhe ni deklaratë nga Jackson për këtë për këtë marrëveshje. Të nesërmen në Prishtinë me 20, kjo ka qenë me 21 qershor ‘99. Po ashtu kjo ka qenë natën, ditët e para të natës.

Ditën është mbajtë ni konferencë për gazetar në Pallatin e Rinisë në Prishtinë. Aty ka qenë Gjenerali Jackson edhe ka qenë Xhejms Robin, Hashim Thaçi, Agim Çeku, Gjenerali Agim Çeku. Kanë paraqitur tekstin e kësaj marrëveshje. Kshtuqë kemi realizuar edhe disa intervista edhe me Zotin Agim Çekun, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Edhe atë ditë në qendër të Prishtinës pas ksaj konference me gazetar mbaj mend kur Xhejms Robin bashkë me delegacionin e Kosovës, Qeverisë së Përkohshme të Kosovës atëherë. Aty tek Ëmbëltorja Korzo, tash ku osht’ Korneri. Aty jashtë ka qenë, meqenëse ka

qenë qershori, 21 qershori. Ka qenë verë dhe ka qenë koha e mirë. Aty kanë hapur shampanjën në shenjë të festimit të çlirimit të Kosovës.

Ishte hera e parë që përfaqësuesit e UÇK-së dhe përfaqësuesit e Qeverisë së Përkohshme të Kosovës ishin në qendër të Prishtinës dhe bashkë me miqtë tanë amerikan dhe europian kremtonin çlirimin e Kosovës. Kto ishin momente shumë të rëndësishme sepse edhe qytetarët e Kosovës i përgëzonin Xhejms Robinin, Hashim Thaçin, Xhavit Halitin, Agim Çekun dhe të tjerët. Për kontributin e tyre për çlirimin e Kosovës. Ni Kosove t'libër e cila aspiron të antarësohet edhe në familjen e madhe europiane.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për dokumentart edhe librin që e keni bo vitin e fundit, domethonë aktivitetet që keni pasë vitet e fundit.

Nuhi Bytyçi: Po. Pas ni pune shumë intensive disa vjeçare edhe me ndihmën e pa kursyer të birit tim Arianitit kam arritur që ta botoj monografinë me kujtimet e mija për ngjarjet që kom pasë rastin dhe nderin t'i përcjelli si gazetar. Prej vitet '74 e tutje edhe para luftës, gjatë luftës, pas luftës edhe t'gjitha proceset deri në çlirimin dhe deri në Pavarësinë e Kosovës dhe në krijimin e Ushtrisë së Kosovës. Kshtuqë ka qenë ni punë shumë intensive sepse në rrethanat kur nuk ke mundësi të mbash ditar t'saktë, të përmendësh data, emra të njerëzve. Sepse nuk ishte qëllimi që unë aty t'paraqitem ni hero i veçantë, t'flas vetëm për vetën e mos t'i përmendi ngjarjet, mos te përmendi sakrificën e popullit tonë gjitha periudhat për liri dhe pavarësi. Do të ishte dështim i madh.

Kshtuqë derisa i kom komponu ato data, shënime ma t'sakta duke hulumtuar edhe në arkiva, në gazeta e tjera dhe me qenë sa ma të sakta, nuk e kom botu librin. Kshtuqë në mars të vitit 2019 me ndihmën edhe të Shtëpisë Botuese Armgagedoni të mikut tim Berat Daka dhe me ndihmën sugjerimet e miqve t'mi Bajram Kosumi, Haqif Mulliqi, Muhamet Mavraj dhe të miqve tjerë kom arritur që ta publik, ta promovoj librin tim me titull 'Libri i Luftës'. Meqenëse nuk osht' fjala ktu vetëm për luftën por është fjala për luftën e popullit shqiptar në të gjitha fazat e tij në rrugëtimin e gjatë shekullor them për liri dhe pavarësi.

Ishte lufta im si gazetar, përpjekja ime si gazetar me informu. Lufta e luftëtarëve të lirisë, lufta e intelektualëve, lufta e humanitarëve edhe lufta e bashkësisë ndërkombëtare për ta mbyllur ni periudhë të sundimit okupues serb në Kosovë. Kshtuqë libri konsideroj se është pritur mirë, ashtu si meriton nga lexuesit. Dhe unë synoj që meqenëse nuk ka mbetë asni ekzemplar nga ky libër, synoj që ta ribotoj mundësisht. Por qëllimi im kryesor është që të botohet në gjuhën angleze dhe gjermane. Sepse për ngjarjet që kanë ndodhë në Kosovë dhe rreth Kosovës është mirë që të informohet në mënyrë më të hollësishme, më konkrete edhe opinioni i huaj.

Ne nuk kemi nevojë njëri tjetrit t'i tregojmë mirë është m'i lanë për histori por qëllimi kryesor duhet t'jetë edhe argumentimi profesional para opinionit botëror. Sepse edhe bota demokratike na ka ndihmuar. Nuk jemi na që vet kemi arritë lirinë, na ka ndihmuar shumë edhe bota demokratike. Kshtuqë duhet t'i jemi mirënjohës edhe botës demokratike. Kurse kohëve të fundit përveç 120 filmave dokumentar, televiziv që kam realizuar në RTK dhe jashtë RTK-së me produksionin tim Ideja dhe

kompaninë Kthesa, kom arritur që të trajtoj kontributin e shumë figurave kombëtare gjatë rrugëtimit të gjatë të popullit tonë për liri dhe pavarësi. E sidomos flijimin e dëshmorëve të lirisë të cilët janë më meritoret për këtë ditë që ne po gzojmë sot.

Kohëve t'fundit kam filluar t'i ndriçoj edhe disa figura intelektuale të cilat kanë kontribuar në mënyrën e vet për mbajtjen gjallë të shpirtit të lirisë të popullit shqiptar. Është fjala për akademik Gazmend Zajmi i cili në vitin '81 ka qenë rektor i Universitetit të Prishtinës dhe ka qenë tok me studentët me kërkesat e tyre për Kosovën Republikë. Pastaj Gazmend Zajmi është edhe autor i deklaratës kushtetuese 02 korrikut dhe ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në argumentimin të së drejtës të Kosovës për vetëvendosje për shtet të pavarur dhe sovran.

Ndërkohë kom realizuar edhe filmin dokumentar 'Mbijetesa' së bashku me regjisorin Blerim Gjoci dhe Abaz Zekën, kuptohet me xhirimet e Abaz Zekës. Kom xhiruar edhe bashkë me regjisorin Ilir Kabashin dhe drejtorin e fotografisë, montazherin Bekim Qyqalla filmin dokumentar 'Mbijetesa dhe shkolla'. Ku osht' kushtuar funksionimit të shkollës së nxënësve në Malet e Berishës në rrethana të luftës. Ky film dokumentar është prezentuar në shumë festivale ndërkombëtare dhe deri tani e ka marrë dymbëdhjetë çmime nga këto festivale. Duke u shpallur filmi më i mirë. Ne do t'marrim pjesë edhe në festivale tjera dhe konsideroj se ky film do t'ketë sukses edhe më t'madh.

Kurse ndërkohë jom duke punuar në realizimin e filmit dokumentar kushtuar Profesor Doktor Ejup Statovcit ish rektorit të Universitetit të Prishtinës. I cili në vitet '91-'97 ka qenë kontribuesi kryesor për kontinuitetin e Universitetit të Prishtinës në rrethana të okupimit. Ai ka punuar që ky universitet me t'vërtetë të jetë i pavarur dhe t'jetë n'funksion të ndërtimit gjithë mekanizmave për shtetin e Kosovës. Kom edhe shumë skenar tjerë të cilët jam në fazën finale por kërkohet një përkrahje ma e madhe nga, nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Konsideroj se tani kemi obligim që gjeneratave të ardhshme t'ua dëshmojmë të gjithë atë terror që ka përdorë Serbia në Kosovë ndaj shqiptarëve. Dhe të dëshmojmë në mënyrë shkencore dhe profesionale gjitha dëshmitë për masakrat që ka bërë ushtria dhe policia serbe në Kosovë. 22 vjet pas luftës ne nuk kemi arritur që ta kemi një dosje si duhet të argumentime me dëshmitar. Unë e kom pasë rastin që në zona të luftës së bashku me Abaz Zekën të xhirojmë dëshmitarët të cilët kanë pasë fatin të mbijetojnë nga këto masakra. Kanë qenë në rresht për pushkatim, por fati ka deshtë që kanë shpëtuar.

Menjëherë pas atyre ngjarjeve ne kemi marrë rrëfimet e tyre shumë tronditëse për dhunën dhe terrorin që ka ushtruar policia dhe ushtria serbe ndaj popullatës civile dhe ndaj fëmijëve dhe ndaj pleqve dhe ndaj grave. Kështu që ne kemi obligim që këtë ta paraqesim në mënyrë të argumentuar por kërkohet një përkrahje ma e madhe nga Ministria e Drejtësisë, nga Ministria e Kulturës nga Qeveria e Kosovës dhe nga t'gjitha institucionet relevante në Kosovë.

Anita Susuri: Zoti Nuhi keni pasë edhe diçka me shtu, me na tregu?

Nuhi Bytyçi: Po, deshta në fund të kësaj interviste bukur të gjatë të falënderoj në mënyrë të veçantë Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe gjithë luftëtarët e lirisë edhe veçmas familjet e dëshmorëve të cilat janë më meritoret për këtë liri dhe këtë pavarësi që po gëzojmë sot. Dua të falënderoj edhe të gjithë ato familje që na kanë strehuar dhe ndihmuar gjatë periudhës së luftës dhe shumë koleg me t'cilët kam bashkëpunuar në kohë të vështira. Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj edhe familjen time për arsye siç thashë, prindërit e mi, nënën Qamile, babain Malushin të cilët më kanë edukuar se si të kontribuoj për atdheun.

Ata dhe mbarë familja ime gjatë periudhës së luftës kanë qenë në shërbim të plotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kanë ndihmuar në mënyrën e vet për organizimin e njësitit të UÇK-së në fshatin tonë dhe në rrethinë. Nëna Qamile bashkë me kunatat e saj e kanë edhe mbesat dhe kunatat e mija kanë gatuar bukë për luftëtarët e lirisë. Ato nifar' mënyre kanë kontribuar që djemtë dhe vashat tona të angazhohen në mënyrë më intensive në fushë beteja kundër forcave serbe.

Kur është fjala për kontributin e familjes time gjatë kohës së luftës dua t'them se në odën e xhaxhës Sadik ka qenë Shtabi i Njësitit të UÇK-së të fshatit tonë dhe komandant i atij njësi ka qenë djali i axhës Sadik, Seferi. Kurse komandant i logjistikës ka qenë vllau im, Njaziu. Të cilët kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm gjatë periudhës së luftës. Në mënyrë të veçantë dua të falënderoj edhe bashkëshorten time, Ryvën, birin Arianitin edhe nusen e tij Lumturinë, e cila është menaxhere edhe ekonomiste e dëshmuar dhe shumë e zonja.

Po ashtu ni falënderim i veçantë i takon edhe mbesave të mija Arianës dhe Aries si dhe nipit Lumit, të cilët edhe sot më japin kurajo që të angazhohem më me përkushtim në realizimin e detyrave më të reja në profesionin tim. Po ashtu dua të potencoj se gjatë tërë periudhës së angazhimit tim si gazetar më kanë mbështetur edhe motra ime, Sevdia. Vllezërit e mi Isufi, Nazmiu, Njaziu, Fadili, Ragipi dhe të gjithë nipat dhe mbesat e familjes sonë. Sepse ne jemi ni familje e madhe dhe ata më kanë përkrahur dhe më kanë motivuar që të punoj me përkushtim në këtë drejtim.

Dua të përmend edhe faktin se nipi im, Albin Bytyçi ka qenë dhe është kadeti i parë nga Kosova që aktualisht vijon studimet në Akademinë e Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ne si familje mburremi me angazhimin e tij, përkushtimin e tij në kryerjen e studimeve që nesër t'i kthehet Kosovës për t'i shërbyer ushtrisë sonë të re. [Albin Bytyçi, pikërisht më 30 qershor 2024 ka diplomuar me sukses të lartë në Akademinë e Forcave Ajrore Amerikane dhe është kthyer në Kosovë, duke shërbyer si epror në Ushtrinë e Kosovës.]

Në fund dua të falënderoj edhe ekipin e juaj, të cilët ma keni dhënë mundësinë që në ni rrëfim bukur të gjatë të përkujtoj disa nga ngjarjet më të rëndësishme nëpër të cilat ka kaluar populli ynë dhe ne nuk duhet t'i harrojmë ato.

Por duhet të punojmë më shumë në rrethana të reja, në ndërtimin e shtetit të ri të Kosovës, bashkëpunimin me miqtë tanë ndërkombëtarë të cilët na kanë ndihmuar për të realizuar aspiratat tona shekullore për liri dhe pavarësinë e Kosovës. Konsideroj që jeni duke bërë ni punë shumë të

rëndësishme që gjeneratat e ardhshme t'ua lëmë të gjitha ato sakrifica të cilat shërbejnë si dëshmi për të shkruar historinë më të re të popullit tonë.